



# INTERKULTURA

Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane  
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки  
Scientific Journal of the Faculty of Human Sciences

# 6



**GJUHA, LETËRSIA DHE KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR**  
**ЈАЗИКОТ, ЛИТЕРАТУРАТА И ИНТЕРКУЛТУРНАТА КОМУНИКАЦИЈА**  
**LANGUAGE, LITERATURE AND INTERCULTURAL COMMUNICATION**



# **INTERKULTURA**

**Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane  
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки  
Scientific Journal of the Faculty of Human Sciences**

# **6**

Shkup/Skopje, 2025

# INTERKULTURA

## 6

**Botues / Editor**

**Fakulteti i Shkencave Humane/ Faculty of Human Sciences**

**Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup/ Mother Teresa University in Skopje**

**Redaktori përgjegjës / Editor-in-chief**

Mustafa IBRAHIMI

**Këshilli botues / Editorial board:**

Mustafa IBRAHIMI

Izer MAKSUTI

Mirvan XHEMAI

Arta TIKA – BEKTESHI

Rilind MAHMUDI

Edona VINCA

**Redaksia ndërkombëtare / International editorial office:**

Niko QAFOKU (SHBA)

Oliver Jens SCHMITT (Zvicër)

Thede KAHL (Gjermani)

Beata GRZESZCZAKOWSKA-PAWLIKOWSKA (Poloni)

Robert PICHLER (Austri)

Laszlo MARÁCZ (Hollandë)

Goran Bandov (Kroaci)

Emil LAFE (Shqipëri)

Kristaq JORGO (Shqipëri)

Begzad BALIU (Kosovë)

Sejdi GASHI (Kosovë)

Goran BASHIQ (Serbi)

Zeqirja NEZIRI (Maqedonia e Veriut)

Vebi BEXHETI (Maqedonia e Veriut)

Rubin ZEMON (Maqedonia e Veriut)

Ismet OSMANI (Maqedonia e Veriut)

Qatip ARIFI (Maqedonia e Veriut)

# **INTERKULTURA**

---

**Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane  
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки  
Scientific Journal of the Faculty of Human Sciences**

**6/2025**

---

**Shtypur në shtypshkronjën "GRAFODEN" - Shkup, 2025  
Tirazhi: 300 kopje**



## Përmbajtja / Contents

<b>PËRMBAJTJA / CONTENTS.....</b>	<b>5</b>
<b>OLIVER JENS SCHMITT.....</b>	<b>7</b>
PSE MERREMI ME HISTORINË SHQIPTARE? .....	7
WHY DO WE ENGAGE WITH ALBANIAN HISTORY? .....	7
<b>MUSTAFA IBRAHIMI .....</b>	<b>17</b>
NDIKIMI I GLOBALIZMIT NË ZHVILLIMIN E BLENDEVE SI DUKURI SOCIOLINGUISTIKE.17	
THE IMPACT OF GLOBALIZATION ON THE DEVELOPMENT OF BLENDS AS A	
SOCIOLOGICAL PHENOMENON .....	17
<b>BEGZAD BALLIU .....</b>	<b>27</b>
FJALËSHPEJTA NË GJUHËN SHQIPE .....	27
TONGUE TWISTERS IN THE ALBANIAN LANGUAGE .....	27
<b>IZER MAKSUTI.....</b>	<b>45</b>
MBI RËNDËSINË E RUAJTJES SË GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË: VËSHTIRËSITË DHE	
MUNDËSITË - NË SHEMBULLIN E VENDEVE GJERMANISHTFOLËSE .....	45
ON THE IMPORTANCE OF LANGUAGE MAINTENANCE IN THE ALBANIAN DIASPORA:	
CHALLENGES AND OPPORTUNITIES – THE CASE OF GERMAN-SPEAKING COUNTRIES45	
<b>AJTEN HAJDARI – QAMILI .....</b>	<b>59</b>
PËRBALLJET E SHQIPES STANDARDE NË MAQEDONINË E VERIUT ME POLITIKAT	
VENDORE DHE ME GLOBALIZIMIN.....	59
CHALLENGES OF THE STANDARD ALBANIAN LANGUAGE IN NORTH MACEDONIA WITH	
LOCAL POLICIES AND GLOBALIZATION .....	59
<b>TEUTA ARIFI.....</b>	<b>73</b>
GRUAJA NË TRADITËN ZAKONORE SHQIPTARE .....	73
<u>THE</u> WOMAN IN ALBANIAN CUSTOMARY TRADITION .....	73
<b>QATIP ARIFI .....</b>	<b>90</b>
THE ROLE OF DICTIONARIES IN ENGLISH LANGUAGE LEARNING: A CONSTRUCTIVIST	
PERSPECTIVE .....	90
ROLI I FJALORËVE NË MËSIMIN E GJUHËS ANGLEZE: NJË PERSPEKTIVË	
KONSTRUKTIVISTE .....	90
<b>KOSOVARE KRASNIQI .....</b>	<b>101</b>
LETËRSIA SHQIPTARE NË KOSOVË GJATË DEKADAVE '80 DHE '90: REZISTENCË DHE	
TRANSFORMIM .....	101
ALBANIAN LITERATURE IN KOSOVO DURING THE 1980S AND 1990S: RESISTANCE AND	
TRANSFORMATION .....	101

<b>SEJDI M. GASHI</b> .....	<b>107</b>
LEKSIKU I JURISPRUDENCËS NË DISA MEDIE TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË.....	107
THE LEXICON OF JURISPRUDENCE IN SOME MEDIA OF KOSOVA AND ALBANIA .....	107
<b>FATON KRASNIQI</b> .....	<b>117</b>
FJALËSI GJUHËSOR DHE ESTETIK I VEPRËS LETRARE TË BEQIR MUSLIUT.....	117
THE LINGUISTIC AND AESTHETIC LEXICON IN THE LITERARY WORK OF BEQIR MUSLIU .....	117
<b>ALBULENA DEHARI</b> .....	<b>127</b>
PASURIMI I GJUHËS NGA KADAREJA.....	127
LANGUAGE ENRICHMENT FROM KADARE .....	127
<b>AGRON KURTISHI, AGRON VRANGALLA, AVNI AVDIU</b> .....	<b>133</b>
GENDER STEREOTYPES IN MEDIA ADVERTISING IN NORTH MACEDONIA: AN EMPIRICAL STUDY.....	133
STEREOTIPET GJINORE NË REKLAMAT MEDIATIKE NË MAQEDONINË E VERIUT: NJË STUDIM EMPIRIK .....	133
<b>MILICA DENKOVSKA</b> .....	<b>151</b>
DER REISEBERICHT: EINE LITERARISCHE GATTUNG? .....	151
THE TRAVELOGUE: A LITERARY GENRE? .....	151
RRËFIME UDHËTIMI: NJË ZHANËR LETRAR?.....	151
ПАТОПИСОТ: КНИЖЕВЕН ЖАНР? .....	151
<b>DRENUSHA KAMBERI, AVNI AVDIU</b> .....	<b>163</b>
ETNOCENTRICIZMI MITOLOGJIK SERB MBI KOSOVËN .....	163
SERBIAN MYTHOLOGICAL ETHNOCENTRISM ON KOSOVO .....	163
<b>RILIND MAHMUDI<sup>1</sup>, MAJLINDA ISMAILI-MAHMUDI<sup>2</sup></b> .....	<b>178</b>
DIFFERENCES BETWEEN ACQUIRING ALBANIAN AND LEARNING ENGLISH AS A SECOND LANGUAGE .....	178
DALLIMET MIDIS PËRVETËSIMIT TË SHQIPES DHE TË MËSUARIT E ANGLISHTES SI GJUHË E DYTË .....	178
<b>CHEN FENGHUA</b> .....	<b>187</b>
PEIZAZHI GJUHËSOR SI FUSHË STUDIMI DHE TRAJTIMI I TIJ NË PUNIMIN E DISERTACIONIT “PEIZAZHI GJUHËSOR I HAPËSIRAVE KOMERCIALE - STUDIM KRAHASUES I SHQIPËRISË DHE KINËS” NGA BENIAMIN SHURDHI .....	187
“THE LINGUISTIC LANDSCAPE AS AN AREA OF RESEARCH AND ITS ELABORATION IN THE DISSERTATION ‘THE LINGUISTIC LANDSCAPE OF COMMERCIAL SPACES – A COMPARATIVE STUDY OF ALBANIA AND CHINA’ BY BENIAMIN SHURDHI.” .....	187
<b>NUMRAT E BOTUARA DERI MË TANI</b> .....	<b>195</b>

ISSN 2671-3004

UDC 94(496.5)

Punim studimor

Oliver Jens SCHMITT<sup>1</sup>  
 Universiteti i Vjenës,  
[oliver.schmitt@univie.ac.at](mailto:oliver.schmitt@univie.ac.at)

### PSE MERREMI ME HISTORINË SHQIPTARE?

#### WHY DO WE ENGAGE WITH ALBANIAN HISTORY?

Një pyetje e tillë, me sa di unë, nuk është shtruar deri tash në lidhje me historinë shqiptare. Kjo tingëllon kaq e çuditshme sa ka nevojë për shpjegim. Së pari: pyetja është një citat i modifikuar. Në vitin 1789, Friedrich Schiller, krahas Goethes, përfaqësuesi më i famshëm i klasicizmit gjerman, mbajti ligjëratën e tij inauguruese në Universitetin e Jenës, ku do të jepte histori. Në vitin e Revolucionit Francez, ai zgjodhi temën “Çfarë do të thotë dhe për çfarë qëllimi studiojmë historinë universale?”

Pyetja e Schillerit ndryshon nga e jona në dy pika thelbësore. Komuniteti i tij i imagjinuar i pyetësve përfshinte potencialisht mbarë botën – por veçanërisht pjesëtarët, studentët dhe profesorët e Universitetit të Jenës, të cilëve ua adresonte ligjëratën e tij inauguruese. Si mendimtar i epokës së iluminizmit, ai mëtonte të interpretonte asgjë më pak se

---

<sup>1</sup> "Ky tekst është lexuar nga prof. dr. Oliver Jens Schmitt gjatë ligjëratës së tij, në muajin mars 2025, në Universitetin „Nënë Tereza“ në Shkup. Prof. dr. Oliver Jens Schmitt është një nga historianët dhe albanologët më të njohur ndërkombëtarisht, që merret me historinë shqiptare dhe rajonin e Ballkanit. Ndër veprat e tij më të njohura janë: “Arbëria venedike (1392–1479)”, (Das venezianische Albanien 1392–1479), 2001; “Skënderbueu - Aleksandri i ri i Ballkanit”, (Skanderbeg - der neue Alexander auf dem Balkan, 2009; përkthyer në shqip më 2008); “Shqiptarët. Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit”, (Die Albaner - eine Geschichte zwischen Orient und Okzident”, 2012; “Kosova: Një histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike”, (Kosovo - Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft”, 2008; “Ballkani në shekullin XX: Një histori post-imperiale”, (Der Balkan im 20. Jahrhundert. Eine postimperiale Geschichte”, 2019; si dhe dhjetra artikuj tjerë për historinë shqiptare dhe Europën Juglindore, që janë një kontribut i jashtëzakonshëm për studimet historike në fushë të albanologjisë. Ne e kemi mirëpritur me shumë kënaqësi si ligjërues të ftuar në universitetin tonë dhe e falënderojmë për ligjëratën e jashtëzakonshme.”

historinë universale. Dhe me të vërtetë, synimi i tij përmbledh atë që sot quhet histori globale – megjithëse Schilleri fillon nga Gjermania dhe Evropa, shikimi i tij zgjerohet për të përfshirë një botë, e cila në shekullin XVIII ishte afruar mjaft me Evropën. Atij nuk i interesonte historia e shoqërisë së tij, historia e gjermanëve apo e shteteve gjermane.

Kjo “ne” që ai e formuloi në titullin e tij përfshin një republikë studiuesish dhe studentësh pa kufij kombëtarë. Jo vetëm tema ishte universale, por edhe bashkësia e atyre që vrisnin mendje rreth saj. Por si qëndron puna me me rastin tonë? Kush është këtu “ne”? Fillimisht po ju drejtohem juve në këtë sallë, studentëve, profesorëve dhe të interesuarve për çështje intelektuale. Gjatë kohës sa do të zgjasë kjo ligjëratë, ne do të formojmë një komunitet që bashkohet rreth interesimit për temën që po trajtoj. Por tema nuk është universale, ajo është kombëtare.

Historia shqiptare merret me të kaluarën e njerëzve që flisnin shqip dhe të cilët për shkak të gjuhës së tyre të përbashkët, e ndjenin veten si bashkësi në mënyra që padyshim ishin shumë të ndryshme nga njëra epokë në tjetrën, qoftë edhe vetëm në aspektin e diferencimit nga njerëzit që flisnin gjuhë të tjera dhe/apo nuk kuptonin shqip. Historia kombëtare në mbarë botën hulumtohet dhe shkruhet kryesisht nga vetë ata që janë të prekur nga ajo.

Megjithatë, nuk është e pazakontë që edhe të tjerët të interesohen për të – shkenca historike e quan këtë qasje hapësinore, për shembull një studim historik i Kinës apo SHBA-së, Ruisë apo Portugalisë, apo edhe rajoneve të tëra sikurse është Evropa Juglindore. Duhet theksuar se shumica e historianëve në mbarë botën merren ende kryesisht me shoqëritë e veta; duhet gjithashtu të theksohet se ata që merren me shoqëri të tjera zakonisht e orientojnë interesimin e tyre drejt shteteve dhe shoqërive të mëdha. Shoqëritë më të vogla, dhe kjo vlen edhe për kulturën dhe shoqërinë shqiptare, studiohen shpesh vetëm brenda kuadrit të studimeve gjuhësore dhe kulturore – ka departamente studimesh lusitiane për studimin e gjuhës dhe kulturës portugeze, departamente studimesh fino-ugrike për finlandishten dhe hungarishten dhe departamente studimesh neohelenistike për greqishten moderne.

Edhe albanogjia, siç praktikohet jashtë zonës qendrore shqiptare në Ballkan, orientohet në radhë të parë drejt studimeve linguistike, letrare dhe kulturore. Aty ku gjenden katedrat e pakta të albanologjisë, vështirë se bëhet ndonjë kërkim historik.

Historianët që nuk janë vetë shqiptarë dhe që hulumtojnë historinë shqiptare zakonisht e bëjnë këtë në kuadër të historisë së Evropës Lindore, të studimeve orientale apo të historisë së përgjithshme.

Brenda këtyre lëndëve, historia shqiptare është çdo herë marginale. Është e natyrshme që situata do të jetë krejt ndryshe në dy shtetet shqiptare si dhe në universitetet shqiptare në Maqedoninë e Veriut, ku historia kuptohet kryesisht si histori kombëtare vetjake, ndërsa historia e

shoqërive fqinje, për të mos përmendur pjesët e tjera të botës, luan vetëm një rol të vogël.

Pyetja „pse merremi me historinë shqiptare” do të tingëllojë çuditshëm për studentët dhe studiuesit në botën shqiptare – njësoji siç do të habitej studiuesi italian apo francez nga një pyetje analoge. Pyetja e Schillerit u formulua në entuziazmin e iluminizmit, në frymën e një zgjimi shpirtëror, kur intelektualët donin të përqafonin mbarë botën në mendje. Kushdo që pyet për kuptimin e historisë shqiptare merr një pozicionim tjetër. Por kjo „ne” në pyetjen tonë është gjithashtu potencialisht universale – dhe ky është edhe qëllimi i kësaj ligjëratare.

Po ju drejtohem juve intelektualëve shqiptarë, kjo „ne” synon të përfshijë ata që tashmë janë marrë me historinë shqiptare – por ligjërata u drejtohet potencialisht edhe intelektualëve që nuk janë marrë kurrë më parë me historinë shqiptare.

Këtyre të fundit, në rastin tonë një audiencë imagjinare, meqenëse nuk ka të tillë në këtë sallë, dua t’ua shpjegoj pse ia vlen të thellohemi në historinë e një populli të vogël evropian – ndërsa për ju si intelektualë shqiptarë, shpresoj që me këtë ligjëratare diçka të njohur ta vë në një dritë të re dhe të tregoj se kjo që po hulumtoni si pjesë e së kaluarës suaj që juve ju duket e vetëkuptueshme, për historianët tjerë, mund të jetë krejtësisht e panjohur, madje edhe diçka e re dhe fascinuese.

Pas këtyre diskutimeve teorike, të cilat janë të nevojshme duke pasur parasysh karakterin potencialisht të çuditshëm të pyetjes, po kthejmë vëmendjen drejt përgjigjeve të mundshme. Edhe këtu perspektiva është vendimtare – për historianin shqiptar të gjithë kapitujt e së kaluarës kombëtare janë me interes.

Por pyetja jonë ka një sfond historik universal – çfarë arsye *thelbësore* mund ta shtyjë një historian të merret me historinë shqiptare? Formuluar ndryshe: si mund të pikaset kuptimi i historisë shqiptare në kontekstin e historisë universale? Pse historia shqiptare është e rëndësishme përtej historisë së pastër kombëtare?

Në vijim do të diskutojmë tema të veçanta. Asnjëra prej tyre nuk është specifike për historinë shqiptare – por secila nga temat e mëposhtme të historisë shqiptare ka një rëndësi të madhe për çështjet e historisë së përgjithshme. Në çka mendojmë konkretisht?

1. Historinë shqiptare e përkufizuar si histori të folësve të kësaj gjuhe. Dhe kjo na çon në një pikë qendrore të diskutimit tonë: shqipja është një nga gjuhët më të vjetra në kontinentin tonë. Ndonëse përgjatë mijëra viteve të kontaktit kulturor me perandoritë (Romën, Perandorinë Osmane), grupet migratore (sllavët) dhe fqinjët (arumunët, grekët, italianët), gjuha shqipe ka marrë shumë elemente të huaja, ajo e ka ruajtur strukturën dhe visarin thelbësor leksikor – dhe këtë përkundër faktit se nuk ka pasur kurrë shtet shqiptar para vitit 1912, apo ndonjë institucion të veçantë kulturor apo religjioz të qëndrueshëm që ta ketë lëvruar gjuhën shqipe.

Deri në shekullin XX shqipja mbeti kryesisht gjuhë e folur – fakti që shumica dërrmuese e shqiptarëve shkruajnë shqip është një fenomen i gjysmës së dytë të shekullit XX.

Për historianin e përgjithshëm, kjo vazhdimësi gjuhësore, ruajtja e një gjuhe të pashkruar, është me interes të madh – në Evropë vetëm baskët, të cilët flasin një gjuhë para-indoevropiane, mund të krahasohen me shqiptarët në këtë çështje.

Arsyet për këtë reziliencë gjuhësore nuk janë ende mjaftueshëm të qarta – këtu mund të ndihmojnë krahasimet me gjuhë të tjera, folësit e të cilave ishin të integruar në perandori dhe hapësirat të cilave ishin prekur nga migrime masive. Me rëndësi qendrore është vetëkuptimi i folësve, të cilët e definojnë bashkësinë përmes përkatësisë së tyre në gjuhën e vet.

Dhe kjo vlen jo vetëm për zonën thelbësore, por edhe për grupet historike të emigrantëve në Greqi dhe Itali, të cilët zunë të heqin dorë nga gjuha e tyre vetëm në epokën e komunikimit masiv dhe të homogjenizimit të shteteve kombëtare.

Në Itali dhe Greqi, arbëreshët dhe arvanitasit u vendosën në zona të thella gjegjësisht në fshatra të veta – por megjithatë u përballën me tradita të lashta gjuhësore të italishtes dhe greqishtes që vinin nga kultura të larta. Megjithatë, ashtu si me (proto-)shqiptarët në Perandorinë Romake dhe në atë Osmane, kontakti gjuhësor i elitave shqiptare me elitat administrative, sociale dhe kulturore në mjedisin ku jetonin nuk çoi në braktisjen e gjuhës së tyre para shfaqjes së shtetit modern.

2. Krahas vazhdimësisë së gjuhës, interes të veçantë paraqet edhe fakti se shqiptarët bëjnë pjesë ndër ato shoqëri në Evropë që kanë jetuar më së gjati në pjesë të hapësirës aktuale të banimit.

Rezultatet e gjuhësisë, por edhe gjetjet fillestare nga paleogjenetika, tregojnë se në kohët e lashta Ballkani qendror, pra Kosova dhe pjesë të Maqedonisë së Veriut dhe të Serbisë jugore, përbënin zonën bërthamë të folësve të formave të hershme të shqipes.

Kjo njohje ngre shumë pyetje të reja, veçanërisht rreth dyndjes sllave në Ballkan dhe modaliteteve të saj.

Teoria e një tabula rasa dhe e zhvendosjes së plotë të popullsisë romake – shqiptarëve dhe arumunëve – në male nuk mund të mbahet më.

Shqiptarët duhen krahasuar shumë më tepër se më parë me shoqëritë e tjera provinciale romake në epokën e dyndjeve të mëdha, sepse vetëm shqiptarët dhe baskët, si grupe gjuhësore pararomane, i mbijetuan kolapsit të sistemit të pushtetit romak.

3. Kapitulli i tretë, të cilit i qasemi, është ai që i bëri të njohur shqiptarët në mbarë Evropën e krishterë – kryengritja e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane dhe lufta e tij kundër Muradit II dhe Mehmetit II, e cila zgjati plot një çerek shekulli.

Në atë kohë parakushtet dhe motivet e kryengritjes nuk ishin kuptuar në Evropë. Por, për historianin ajo ka rëndësi të madhe, sepse për herë të parë ofrohet një pasqyrë më e qartë se si pozicionoheshin shqiptarët në

raport me perandoritë mbizotëruese, një strukturë bazë e dokumentuar mirë me burime që vlen për gjysmëmijëvjeçarit e sundimit osman dhe e cila me gjasë vlen edhe për kohët bizantine, të cilat nuk janë dokumentuar me burime të shkruara – për më tepër, arkeologjia mesjetare me pak përjashtime (Koman-Dalmace) është akoma krejtësisht e pazhvilluar.

Këtu mendohet në rregullin bazë, sipas të cilit shqiptarëve u pëlqente të integroheshin në perandori dhe të merrnin poste të rëndësishme në ushtri dhe administratë; ata ishin gjithashtu të gatshëm ta linin atdheun dhe të luftonin në kufijtë e largët të perandorive.

Në këmbim, ata prisnin që perandoria të mos ndërhynte në punët e brendshme të zonave kryesore shqiptare, dhe kjo vlen veçanërisht për dy fusha: taksat dhe drejtësia.

Osmanët kishin shkelur pikërisht këtë parim që nga pushtimi i Shqipërisë (1417) – në vitin 1431/32 ata kishin filluar të mbanin regjistër tatimor në Shqipërinë e Jugut dhe t'u jepnin të drejta çifliku të huajve.

Kjo shkaktoi kryengritjen e parë të madhe, të cilën e udhëhoqi vjehri i mëvonshëm i Skënderbeut, Aranit Komino. Edhe vetë Skënderbeu vinte nga kjo traditë politike, e cila mund të përshkruhet me termin e huazuar nga historia irlandeze „home rule”.

Por ajo që e dallonte Skënderbeun nga të gjithë udhëheqësit e tjerë rebelë nga shekulli XV deri në fillim të shekullit XX ishte se qëllimi i tij nuk ishte thjesht një kthim në kushtet e vjetra – domethënë që osmanët të hiqnin dorë nga mbledhja e taksave dhe të zbatoheshin ligjet e vendit. Skënderbeu donte ta luftonte rrënjësisht sundimin osman, jo vetëm për të arritur një pozitë më të mirë për shqiptarët brenda sistemit osman. Skënderbeu aspironte atë që konsiderohej seriozisht si synim vetëm në shekullin XX: një shtet të pavarur shqiptar si pjesë e botës evropiane të shteteve.

Ai kërkoi legjitimitet aty ku sundimtarët ballkanikë (Kroacia, Dioklea / Mali i Zi, Serbia, Bullgaria) kishin kërkuar kurorë me shekuj: nga Papa. Si pakkush nga liderët tjerë kryengritës, ai e ndërkombëtarizoi luftën e tij herët, meqë ishte i vetëdijshëm se resurset e atdheut të tij të afërt (Mati, Dibra) nuk do të ishin kurrë të mjaftueshme për t'i bërë ballë një perandorie.

Për dallim nga despoti serb dhe politikanët tjerë ballkanikë të kohës së tij, Skënderbeu refuzoi ofertat osmane për kompromis – ai nuk donte të ishte vasal i Sulltanit, pasi e dinte se kjo do të ishte vetëm paralojë e nënshtrimit të plotë.

Skënderbeu shquhet jo vetëm si luftëtar i shkëlqyer, siç njihej me të drejtë në Evropë, por edhe si një nga politikanët më mendjemprenhtë që ka njohur ndonjëherë Ballkani – ai vlerësoi realisht mundësitë e veta politike dhe rrethanat ndërkombëtare dhe ndoqi një cak politik të formuluar qartë. Kësaj duhet t'i shtohet edhe fakti se deri në fillim të shekullit XIX, Skënderbeu në Evropë ishte padyshim personi më i famshëm nga Ballkani, simbol i mbrojtjes kundër sulmeve osmane.

4. Elementi tjetër që lidhet ngushtë me Skënderbeun është fakti se asnjë popull tjetër autokton i Evropës nuk është konvertuar në Islam në shumicë. Njëkohësisht asnjë popull tjetër në Ballkan nuk u bëri rezistencë më të madhe osmanëve sesa shqiptarët.

Ky është vetëm në dukje paradoks. Rezistenca këmbëngulëse u shtyp nga osmanët me një brutalitet të paparë në Ballkan – Mati dhe Dibra u rrënuan dhe u shpopulluan në masë të madhe, këtë mënyrë kaq sistematike osmanët nuk e përdorën kundër kryengritësve shqiptarë as në shekullin XX.

Shqipëria e Veriut, rajoni rreth Shkodrës, gjithashtu u shkatërrua pothuajse plotësisht. Shqiptarët që i kishin luftuar osmanët ose kishin rënë, ose ishin syrgjynosur si skllavër ose kishin ikur në Itali.

Në Shkodër u bë një shkëmbim pothuajse i plotë i popullsisë, pasi të mbijetuarit e të dy rrethimeve osmane kishin emigruar në Venedik. Strukturat e rezistencës, pjesë të aristokracisë dhe të kishës katolike, u dobësuan më mënyrë të konsiderueshme.

Kisha katolike, e cila kishte një rol të rëndësishme në ruajtjen e kulturës së shkruar shqipe, nuk u këndell më kurrë nga goditja që mori në shekullin XVII, kur kryengritjet që ajo mbështeti u shtypën përsëri.

Deri më sot nuk është shkruar një histori gjithëpërfshirëse e islamizimit të shqiptarëve.

Ai paraqet gjithashtu një nga temat më të polemizuara të historisë shqiptare – nëse ai kishte qenë një katastrofë që i shkëputi shqiptarët nga lidhjet evropiane apo i kishte shpëtuar shqiptarët nga sllavizimi dhe helenizimi që i kërcënonte?

Rreth dy dekada më parë u zhvillua një nga debatet e mëdha kulturore në botën shqiptare, me protagonistë Ismail Kadarenë dhe Rexhep Qosjen. Por, qëndrimet politike dhe kulturore e fshehin faktin se këto procese, të cilat shtrihen në një periudhë gjigante prej 500 vitesh, janë hulumtuar vetëm në mënyrë fragmentare, vetëm për periudha kohore dhe hapësira të veçanta.

Për më tepër, islamizimi i shqiptarëve mund të kuptohet vetëm në krahasim me proceset tjera islamizuese në Ballkan dhe pjesë të tjera të botës islame. As ky krahasim konsekuent nuk është bërë ende – edhe për shkak se as islamizimi në pjesë të tjera të Ballkanit nuk është hulumtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse.

5. I lidhur ngushtë me islamizimin qëndron edhe një fakt që është vërtet unik – shqiptarët janë i vetmi popull në shumicë mysliman, te të cilët zuri vend koncepti i kombit që i njëjti të krishterët që flasin të njëjtën gjuhë si anëtarë të barabartë të kombit – ndonëse kjo është në veçanti e vërtetë për Shqipërinë perëndimore, ku diversiteti fetar ishte shumë më i madh se në rajonet pothuajse homogjene myslimane të lindjes.

Megjithatë, ajo që dështoi në botën arabe pati sukses te shqiptarët – kombi fitoi përparësi kundruall besimit.

Të paktën për një kohë, sepse sot ka lëvizje islamike, të cilat këtë vetëkuptueshmëri e vënë në dyshim masiv. Në rastin shqiptar, disa faktorë e shpjegojnë suksesin e mendimtarëve të Rilindjes: vendndodhja gjeostrategjike e shqiptarëve, të cilët ishin të rrethuar nga shoqëri të krishtera; vullneti i myslimanëve shqiptarë për të mos u shpërngulur në Anadoll si myslimanët e tjerë të Ballkanit; shembja e Perandorisë Osmane, e cila Shqipërinë e la si një vend mezi të zhvilluar me shtetësi jashtëzakonisht të kërcënuar në një Evropë të krishterë; për shqiptarët në Jugosllavi kësaj i shtohet edhe fakti që qeveria jugosllave qëllimisht promovonte identitetin fetar për ta shtypur lëvizjen kombëtare shqiptare dhe për t'i dëbuar shqiptarët në Turqi si myslimanë; shtetësia shqiptare u ndërtua në të njëjtën kohë me rritjen e kontrollit shtetëror mbi fetë, veçanërisht mbi islamin.

Një nga arritjet më të mëdha të mbretit synit Ahmet Zogut ishte përkthimi në politikë praktike i baraspeshës ndërmjet bashkësive fetare që mendimtarët rilindas e kishin formuluar thjesht si qëllim.

Zogu filloi një rrugë që Enver Hoxha e përfundoi më vonë në një formë të radikalizuar: shteti i futi nën kontroll komunitetet fetare. Derisa Zogu u mjaftua me kontrollin dhe imponimin e primatit të shtetit, marksisti dhe stalinisti Hoxha shkoi shumë më larg – Shqipëria komuniste ishte i vetmi shtet në botë që ndaloi fetë dhe u shpall zyrtarisht shtet ateist. Me këtë Hoxha kishte ekzekutuar atë që e kishin ditur mendimtarët rilindas, se fetë e kërcënonin primatin e kombit.

Ndonëse propaganda drejtohej fuqishëm kundër kishës katolike, ishte e qartë se kërcënimi më i madh për një komb shqiptar që do të qëndronte përmbi fetë vinte nga islami. Për shqiptarët e Jugosllavisë, ndërkaq, identiteti shqiptar ishte i lidhur me tri elemente: gjuhën, kanunin dhe islamin. Sfida e kombit shumëkonfesional nuk ishte aq akute këtu sa ishte për shqiptarët perëndimorë. As Jugosllavia komuniste nuk ndoqi ndonjëherë politikë kaq ekstreme kundër fesë siç kishte bërë Shqipëria enveriste. Megjithatë, një nga proceset vendimtare në mesin e shqiptarëve lindorë ishte që së paku në Kosovë shumë njerëz e vendosën gjithnjë e më shumë identitetin kombëtar mbi atë fetar. Ky proces ende nuk është shqyrtuar fare nga historianët – ai përfshinte formimin e një elite intelektuale laike në Universitetin e Prishtinës, shfaqjen e një shtrese të mesme urbane, ndryshimin e roleve gjinore, ndryshimin e modeleve familjare.

Në Kosovë, ky ishte një proces jo i dhunshëm, ngjashëm si reformat e Zogut, i cili angazhohej në zbatimin e reformave përmes arsimit dhe dialogut (shamitë nuk u hoqën me dhunë nga kokat e grave, por përfaqësuesit e shtetit ua shpjegonin grave qëllimin e zbulimit të tyre). Megjithatë, rajonet e thella rurale pa elita të veta intelektuale ishin shumë më pak të prekura nga ky laicizim i identitetit, kjo është në veçanti e vërtetë për shumë shqiptarë në Maqedoninë e Veriut.

Në Shqipëri, ashtu si në Jugosllavinë komuniste, imponimi i nacionalizmit laik ishte gjithmonë i lidhur me idenë e socializmit, i cili i ndante

njerëzit sipas klasave dhe jo sipas konfesioneve, siç kishte qenë e zakonshme në shoqëritë islame. Aktivistët kombëtarë shqiptarë nuk ishin të vetmit që donin të kapërcenin modelin social islam përmes një kombinimi të nacionalizmit dhe socializmit – edhe nationalistët arabë argumentuan në këtë mënyrë. Por ata dështuan – dhe kështu shembulli shqiptar mbetet i vetmi, në të cilin një shoqëri kryesisht myslimane e vlerësonte gjuhën dhe kombin më shumë sesa përkatësinë fetare.

Nëse dhe në ç'mënyrë ky model do të mund të qëndrojë në të ardhmen në një botë, ku islami sërish bën pretendim gjithëpërfshirës për pushtet dhe për interpretim varet nga shoqëritë shqiptare në Ballkan dhe në diasporë.

6. Kultura shqiptare ofron mundësi fascinuese për reflektim kulturo-historik edhe në një fushë tjetër – me këtë nënkuptoj larminë e sistemeve të shkrimit, në të cilat është shkruar shqipja.

Pikërisht për shkak se gjuha nuk ishte e shkruar për një kohë të gjatë, nuk kishte ndonjë shkrim apo drejtshkrim të standardizuar.

Në asnjë gjuhë tjetër evropiane nuk gjejmë kaq shumë sisteme shkrimi, të cilat nga njëra anë janë shprehje e konteksteve kulturore dhe fetare, në të cilat lëviznin shqiptarët e shkolluar, por nga ana tjetër janë edhe shprehje e vullnetit për t'u emancipuar nga sistemet e krijuara të shkrimit dhe për të krijuar një shkrim të veçantë për shqipen.

Fakti që Kongresi i Manastirit propozoi shkrimin latin për shqipen ishte edhe një rikthim në zanafillë – sepse monumenti i parë gjuhësor i shqipes, formula e pagëzimit e Pal Engjëllit, ishte shkruar me alfabet latin.

Për një kohë të gjatë shqipen e shkruanin katolikët, por edhe ata ecnin shtigjeve të veta, siç shihet te alfabeti i Mesharit të Gjonit Buzuku, i cili si katolik u ndikua nga kultura katolike në Bosnje dhe nga shkrimi i veçantë atje Bosančica. Në zonat ortodokse dhe islame përdorëshin gjithashtu shkrime me konotacion fetar (alfabeti grek dhe arab).

Në epokën e lëvizjes kombëtare, u shfaq pastaj një shumësi e pazakontë shkrimesh, të hartuara nga individë apo grupe intelektualësh, por asnjëri prej tyre nuk mbizotëroi.

Ata u ndikuan nga ideja se shqiptarët duhet të kishin sistemin e vet të shkrimit në një botë, në të cilën shkrimi ishte gjithmonë i lidhur me identitetin fetar, i cili në shekullin XIX u shndërrua në identitet kombëtar – kështu ndodhi, për shembull, me alfabetin grek, i cili rreth vitit 1800 u përdor nga ortodoksët në jug të Ballkanit (përfshirë edhe bullgarët), por më pas mori një karakter kombëtar në rritje.

Ndër alfabetet e shqipes, që synonin të përmbushnin mision kombëtar, pra kapërcimin e alfabeve konfesionale, ishte sajesa e Naum Veqilharshit (botuar më 1844). Alfabeti i shoqërisë së Stambollit, i cili bazohej më shumë në shkrimet ekzistuese, ndiqte gjithashtu synimin e neutralitetit fetar. Në kulmin e Rilindjes, rreth vitit 1900, kishte një numër veçanërisht të madh shkrimesh në qarkullim, por shpesh ato zotëroheshin nga vetëm pak njerëz. Edhe alfabeti cirilik ishte përdorur për të shkruar shqip.

Ky kompleksitet i karakterizuar nga konflikte fetare dhe pjesërisht personale, gjeti zgjidhje radikale në Kongresin e Manastirit.

Edhe këtu historia shqiptare ka një rëndësi të veçantë: si shoqëria e parë në shumicë myslimane, elitat intelektuale shqiptare u përcaktuan për alfabetin latin.

7. Domethënës për historinë universale është edhe fakti se në shekullin e XX shqiptarët bënë pjesë ndër kombet e ndara, ku përfshiheshin edhe gjermanët midis viteve 1945 dhe 1990 dhe koreanët deri në ditët e sotme. Shembulli i shqiptarëve na lejon të shqyrtojmë se si zhvillohet një shoqëri, kur ajo shkëputet nga konteksti i përbashkët – në këtë rast ai perandorak-otoman – dhe detyrohet të jetojë në dy sisteme shumë të ndryshme socio-ekonomike dhe politike.

Vendosja e kufijve e vitit 1912, e cila u përcaktua kryesisht nga Rusia dhe Franca, krijoi një situatë, në të cilën vetëm rreth gjysma e shqiptarëve bënë pjesë në shtetësinë shqiptare. Derisa komunistët morën pushtetin në Shqipëri dhe Jugosllavi, kishte pak dallime ekonomike midis shqiptarëve në Shqipëri dhe në Jugosllavi – sepse edhe në Shqipëri, strukturat e vjetra (pronat e mëdha, bujqësia subsistente në bjeshkë, mungesa e industrializimit) pothuajse nuk ndryshuan fare. Por kishte dallime të mëdha në ndërtimin e kombit modern – Shqipëria krijoi një sistem arsimor kombëtar dhe i zmbropsi shkollat fetare; në pah doli një klasë e mesme intelektuale që ndjehej e përkushtuar ndaj idesë së kombit që qëndronte mbi fetë; u morën masa fillestare për përmirësimin e infrastrukturës; dhe, siç u përmend, shteti mori kontrollin mbi bashkësitë fetare.

Mbi të gjitha, Ahmet Zogu arriti të siguronte ekzistencën e shtetit shqiptar në rrethana shumë të vështira të politikës së jashtme. Të gjitha elementet e lartpërmendur u mungonin shqiptarëve të Jugosllavisë – atyre iu mohua arsimi kombëtar laik, as që bëhej fjalë për autonomi politike, përkundrazi Jugosllavia donte t'i shihte shqiptarët si myslimanë dhe, si të tillë, t'i shpërngulte në Turqi.

Pas Luftës së Dytë Botërore, mosmarrëveshjet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë u intensifikuan dhe që nga viti 1948 ato hynë në një rivalitet sistemik brenda kampit komunist. Në Shqipërinë enveriste, bujqësia u kolektivizua në mënyrë radikale, fetë u ndaluan dhe u vendos një regjim totalitar i mbikëqyrjes shtetërore që depërtoi thellë në familje; lojalitetet tradicionale (fetare, krahinore, familjare) u shpërbënë dhe u zëvendësuan me lojalitet ndaj liderit dhe partisë; shoqëria u militarizua tërësisht dhe mbahej me frikë të vazhdueshme nga lufta; që nga viti 1978 e në vazhdim Shqipëria përjetoi edhe një eksperiment tjetër, izolimin e thellë nga bota e jashtme. Represioni ishte ekstrem dhe ai ushtrohej nga shqiptarët kundër shqiptarëve.

Shqipëria mbajti kampe pune deri në fund të diktaturës dhe e shihte veten si mburojë mbarëbotërore të mësimeve të Stalinit. Shqiptarët e Jugosllavisë vuajtën shtypje të rëndë nga nacionalizmit serb deri në vitin 1966 – por fshatarët kishin akoma tokën e vet, migrimi dhe lëvizshmëria

ishin të mundshme (së pari në Turqi, pastaj në Evropën Perëndimore), qasja në mallra, teknologji dhe në dituri perëndimore nuk pengohej dhe nga fundi i viteve 1960 e tutje, veçanërisht në Kosovë, kultura shqiptare u zhvillua në Universitet dhe në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të sapothemeluar.

UDBA jugosllave nuk mundi asnjëherë të rrënojë solidaritetin në familje, për dallim nga sigurimi enverist. Meqenëse regjimi perceptohej si i huaj (serb/jugosllav), u mbajt një solidaritet kombëtar që nuk ishte i mundur në këtë formë në Shqipërinë enveriste. Kjo u bë e qartë në krizën e regjimeve – në Shqipërinë enveriste, shoqëria dhe shteti imploduan në trazira të rënda fare afër luftës civile, dhe besimi shoqëror nuk është rikthyer deri më sot, që sistemi politik është autoritar dhe dallimet partiake janë të papajtueshme.

Në Kosovë, nga ana tjetër, shoqëria shqiptare u unifikua në masë të madhe kundër nacionalizmit serb të Slobodan Millosheviqit. Derisa në Shqipërinë enveriste shteti ishte i plotfuqishëm dhe paralizonte çdo iniciativë individuale, shqiptarët në Kosovë mbijetuan pikërisht sepse ishin në gjendje ta organizonin vetë rezistencën civile dhe atë të armatosur. Ata kurrë nuk ishin mbështetur te shteti, por ndryshe nga shqiptarët në Shqipërinë enveriste, ata në Jugosllavi nuk kishin qenë nën një regjim totalitar, por nën një diktaturë autoritare, e cila nuk kishte arritur kurrë ta kontrollonte plotësisht zonën rurale. Në Kosovën e pavarur sot mbizotëron një kulturë politike ndryshe nga ajo në Shqipëri – zgjedhjet funksionojnë pa probleme, ndryshimet e pushtetit të legjitimuara në mënyrë demokratike janë të mundshme dhe shteti funksionon më mirë në trajtimin e të gjitha problemeve.

Nga sa u tha, mund të nxirret teza se dy shtetet shqiptare sot përfaqësojnë edhe kultura të ndryshme politike – por fakti që kulturat politike mund të jenë shumë të ndryshme edhe kur gjuha është e njëjtë nuk është diçka specifike për shqiptarët: vetëm në zonën gjermanishtfolëse janë katër prej tyre, një gjermane perëndimore, një gjermane lindore, një austriake dhe një zvicerane.

Në këtë ligjëratë kemi diskutuar shtatë pika – por tema nuk është shteruar, sepse një historian tjetër do të kishte vënë pyetje të tjera në plan të parë. Kam tentuar të tregoj pse historia shqiptare është me rëndësi të madhe për çështjet krahasuese në historinë universale. Dijen për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve e zhvillojnë specialistët e historisë shqiptare. Pra, nuk bëhet fjalë për një kundërshti mes historisë kombëtare dhe asaj universale.

Për më shumë, desha të tregoj pse historia kombëtare është e rëndësishme edhe për kontekste që tejkalojnë kufijtë kombëtarë. Gjithashtu, desha të theksoj se shumë nga çështjet madhore të historisë shqiptare me rëndësi universale ende nuk janë hulumtuar përfundimisht.

Dhe shpresoj që kjo t'i inkurajojë veçanërisht të rinjtë ndër ju për kërkime të mëtejshme.

ISSN 2671-3004

UDC 81'373.43:316.774

Punim studimor

**Mustafa IBRAHIMI**  
Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup  
Fakulteti i Shkencave Humane  
mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk

**NDIKIMI I GLOBALIZMIT NË ZHVILLIMIN E BLENDEVE SI DUKURI  
SOCIOLINGUISTIKE  
THE IMPACT OF GLOBALIZATION ON THE DEVELOPMENT OF BLENDS  
AS A SOCIOLINGUISTIC PHENOMENON**

**Abstrakt (shqip)**

Globalizmi, si proces që thellon ndërvarësinë kulturore, ekonomike dhe gjuhësore, ka ndikuar ndjeshëm në mënyrën e krijimit, përdorimit dhe perceptimit të njësive leksikore në komunikimin bashkëkohor. Ky ndikim nuk shfaqet vetëm në emërtimin e reklamave, mediave dhe institucioneve, por shtrihet edhe në përdorimin e terminologjisë leksikore për përshkrimin e dukurive sociolinguistike të reja që burojnë nga kontakti ndërkulturor dhe zhvillimet teknologjike. Një nga këto dukuri është **blendi** (nga ang. *blend*), një proces fjalëformues që krijon njësi të reja përmes kombinimit të pjesëve të dy ose më shumë fjalëve ekzistuese, shpesh duke ruajtur një nga fjalët burimore. Fillimisht i kufizuar në gjuhën angleze, përdorimi i blendëve është zgjeruar në mënyrë të ndjeshme në shumicën e gjuhëve moderne, duke marrë përmasa ndërkombëtare. Kjo prirje është bërë veçanërisht e dukshme në **diskursin mediatik**, në **komunikimin digjital** dhe në **rrjetet sociale**, ku nevoja për ekonomi gjuhësore dhe komunikim efikas ka nxitur lindjen e formave të reja leksikore.

Blendet shërbejnë si tregues të **kreativitetit gjuhësor** dhe të aftësisë së gjuhës për t'u përshtatur ndaj realiteteve të reja kulturore e teknologjike. Ato janë bërë pjesë e pandashme e fushave si **media, teknologjia, zhargonit politik, komunikimi komercial, kultura popullore dhe letërsia**, duke pasuruar strukturën e gjuhës dhe duke reflektuar dinamizmin e shoqërisë globale. Në këtë kuptim, blendi nuk është vetëm

një formë e inovacionit leksikor, por një **pasqyrim i zhvillimit ndërkulturor dhe global të komunikimit** në epokën digjitale.

### Abstract (English)

Globalization, as a process that deepens cultural, economic, and linguistic interdependence, has profoundly influenced the creation, use, and perception of lexical units in contemporary communication. This influence extends beyond the naming of advertisements, media outlets, and institutions, affecting the use of lexical terminology to describe new sociolinguistic phenomena emerging from intercultural contact and technological advancement. One of these phenomena is the **blend**—a creative word-formation process that produces new lexical items by combining parts of two or more existing words, sometimes retaining one of them in full.

Initially limited to the English language, the use of blends has expanded across most modern languages, acquiring a global dimension. This linguistic trend is particularly visible in **media discourse, digital communication, and social networks**, where the need for brevity and efficiency fosters the creation of new, compact forms of expression.

Blends serve as indicators of **linguistic creativity** and of the language's adaptability to new cultural and technological realities. They have become an integral part of fields such as **media, technology, political jargon, commercial communication, popular culture, and literature**, enriching the lexicon and reflecting the dynamic nature of global society. In this sense, blending represents not only a linguistic innovation but also a **mirror of intercultural development and global communication** in the digital age.

### Hyrje

Procesi bashkëkohor i **shkrirjes së fjalëve** (ang. *word blending*) përfaqëson një dukuri gjuhësore universale, e cila është bërë pjesë përbërëse e zhvillimit leksikor në të gjitha gjuhët natyrore. Ky proces krijues, që bazohet në kombinimin e segmenteve leksikore nga dy ose më shumë fjalë ekzistuese, ka marrë përmasa ndërkombëtare dhe është bërë objekt i studimeve të shumta në fushën e **sociolinguistikës** dhe **morfologjisë fjalëformuese**.

Në terminologjinë ndërkombëtare, kjo dukuri njihet dhe përkufizohet përmes termave të ndryshëm, që megjithëse ndryshojnë nga gjuha në gjuhë, i referohen të njëjtit fenomen. Në gjuhën angleze përdoren termet **blending, amalgamation** dhe **portmanteau words**, të cilat kanë hyrë në përdorim të gjerë në literaturën gjuhësore. Secili prej këtyre termave thekson aspekte të ndryshme të procesit të krijimit të fjalëve të reja përmes përzierjes semantike dhe fonetike të elementeve ekzistuese.

Në gjuhët e tjera ndërkombëtare vërehen përshtatje terminologjike që reflektojnë traditat e tyre gjuhësore dhe kulturore. Në **gjuhën frënge**

përdoren termat *portmanteau* (portmonto) ose *amalgam* që përmban dy pjesë, duke i kombinuar këto pjesë formohet një fjalë e re. Lindi nga shkrimtari Lewis Carrol, në romanin *liza në botën e çudirave*, i cili nëpërmjet pasqyrës nga dialogu mes lizës dhe personazhit aq të këndshëm hampti dampiti, fjalëve u jepte kuptimin që ai dëshironte. Në dublimin në shqip të këtij filmi ndeshet fjala *i rrëzhvjellët (rrëshkitës+i zhdërvjellët)* (çerpja 2018:193). Në **gjuhën gjermane** kjo dukuri emërtohet me termin **“Zusammenbildungen”**, që në përkthim të lirë nënkupton “bashkime” ose “ndërthurje fjalësh” me prirje drejt përdorimit popullor.

Prania e këtyre varianteve terminologjike në gjuhë të ndryshme tregon se procesi i blendimit është **fenomen ndërkulturor dhe ndërgjuhësor**, i cili jo vetëm pasqyron kreativitetin dhe dinamizmin e gjuhës, por edhe rolin e globalizimit në unifikimin e koncepteve gjuhësore përmes ndikimeve të ndërsjella midis traditave shkencore dhe komunikimit ndërkombëtar.

Në studime të ndryshme të gjuhës shqipe, vëmë re se ky proces sociolinguistik, nuk ka një term të njësuar dhe të përba shkët. Siç theksuam, ai në disa raste përdoret me terma të ndryshëm, si: *shkrirje, ngjeshje, përputhje ose kontaminim*, kurse shkrimtari Visar Zhiti e përdor edhe termin *hibridizim i fjalëve* nëpërmjet ndër- thurjeve të dy a më shumë njësive semantike. (Kërbizi 2014:87). Studiuesja Adelina Çerpja përdor termin *“shkrirje leksikore”*, duke theksuar se “fjalët që shërbejnë për të formuar këtë shkrirje leksikore quhen fjalëburimore, fjalë bazë ose përbërës, nga të cilët parapëlqejmë “fjalë burimore”. Ajo na paraqet edhe disa terma të ndryshëm sinonimë të përdorur në literaturën e huaj si: **“amalgamë - amalgam, kryqëzim fjalësh - vocabulary crossing, fjalë-valixhe - word-valise, miks - mix, shkrirje, bashkim fjalësh - vocabulary fusion dhe portmonto - portmanteau”**. (Çerpja 2018:194). Përveç këtyre, në gjuhën shqipe përdoren edhe forma tjera: *“përngjitje leksikore”, “përzierje leksikore (Lexical Blending)”*. Kjo e fundit mund të jetë:

1). **Ngritje fjalësh:** Përdorimi i një pjese të një fjale për të krijuar një fjalë të re, si *dizyrë (“ditë” + “zyrë”)* në vend të “zyra ditore”.

2). **Kombinim fjalësh:** Përdorimi i dy fjalëve separate, si “bar” + “kafe” për të formuar një fjalë të re “bar-kafe”. 3). **Fjalë portokalli:** Fjalë që janë të përziera nga dygjuhë të ndryshme, si “car” + “telefon” për të formuar “cartel”.

Si sinonim përdoret edhe termi kontaminim, i cili është mënyra e vetme e formimit të fjalëve në çdo gjuhë të huaj. Shkrirja e dy fjalëve në një fjalë të vetme realizohet nëpërmjet kontaminimit. Në rastin e kontaminimit nuk kemi të bëjmë me bashkim fjalësh, pasi një pjesë e fjalës së parë apo e fjalës së dytë, gjatë formimit të fjalës së re humbet, duke bërë që të dyja fjalët të shkrihen në një.

Leksikologu Valter Memisha, përdor termin hiperonimik *“emërtimet e shkurtuara”*, ku përfshihen të gjitha njësitet që i përkasin si ligjërimet shkrimor, edhe atij bisedor, që mund të jenë njësi të mëvetësishme ose jo

(gjith- çka që ka lindur nga procesi i shkurtimit) (Memisha – Bregasi 2008;93). Nën emërtimet e shkurtuara ai përfshin termin **shkurtesë** për këtë lloj fjalësh të përbëra që mund të ndeshet rregullisht e lehtësisht në të folur dhe në të shkruar, pra gjallon në komunikimin gjuhësor si njësi e vetëqëndrueshme, dhe termin **shkurtrim** për të shënuar përdorimet e shkurtuara të fjalëve të veçanta, të atyre që nuk gjallojnë në komunikim si njësi të vetëqëndrueshme, që nuk janë fjalë, por paraqitje grafike e një fjale apo një grupi fjalësh në trajtë të shkurtuar për nevoja të shkurtësisë shkrimore (Memisha-Bregasi 2008: 14).

Valter Memisha i konsideron këto shkurtesa si një lloj i veçantë kompozitash (duke kundërshtuar tezën e studiuesit Rami Memushaj) (Memisha-Bregasi 2008:57-59). Nëse ndalemi konkretisht te trajtimi që u ka bërë shkurtesave, edhe ky studiues vë në dukje se këto janë njësi emërore, marrin kategoritë që të perceptohet saktësisht njësia e formuar si shkurtesë, është e domosdoshme që ajo të përdoret së bashku me emërtimin e përbërë (togfjalëshor a të pathjeshtë). Prania dyshe e tyre në njësinë e kohës është e kushtëzuar nga denduria e përdorimit të shkurtesës dhe e emërtimit të plotë, nga vlefshmëria e realies që shënon etj. (Memisha-Bregasi 2008:37). Ndonëse V. Memisha e përfshin te shkurtesat këtë grup fjalësh, ky tipar i fundit i shkurtesave lë automatikisht jashtë këtij grupi shkrirjet leksikore që po shqyrtojmë, sepse këto të fundit janë fjalë të krijuaraposaçërisht, dhe jo për shkak të përdorimit për një kohë paralelisht me emërtimin e përbërë (p.sh. *narkoma*, tëformuar nga shkrirja e dy fjalëve burimore: **narkotik + koma**) (Çerpja 2018:198-199).

Prandaj do të theksojmë se në gjuhën shqipe nuk ka një mendim të njësuar, ky proces në disa raste përdoret me terma të ndryshme, si: *shkrirje, ngjeshje, përputhje, hibridizim, shkrirje leksikore, përngjitje leksikore, përzierje leksikore, bashkim fjalësh, ngritje fjalësh, kombinim fjalësh, përzierje fjalësh, kryqëzim fjalësh, fjalë valixhe, emërtime të shkurtuara, shkurtesa, shkurtesa rrokjesore, shkurtrim miks, kontaminim, kontaminim i shkurtesave rrokjesore etj.*

Si lindën blendet?

Në fillim të shekullit të 20-të në Skoci, për shkak të rritjes së numrit të pacientëve me sëmundje të mushkërive, Dr. Harold Antoine Des Voeux shpiku fjalën *smog*, nga termat anglezë *smoke* (tym) dhe *fog* (mjegull), për të treguar rrezikun e një forme të re të ndotjes së ajrit të shkakuar nga djegia e sasive të mëdha të qymyrit në fabrikat e afërta. Përdorimi i këtij blendi kontribuoi në një përcaktim më të saktë të dukurisë, për të treguar seriozitetin e efekteve shëndetësore të njerëzit.

Me këtë filloi një proces i ri i krijimit të blendeve, i cili u inspirua nga përngjitjet që lindën në gjuhën angleze, të tipit: *motel* (**motor + hotel** 'hotel për motoristë'), *smog* (**smoke + fog** 'përzierje të tymit dhe mjegullës'), *pozitron* (**pozitiv + elektron** 'pjesëz me masë elektroni, por që ndryshe prej

tij ka ngarkesë pozitive') etj. Elementet që shkrihen janë zakonisht njëra nga pjesët e njëres fjalë burimore dhe njëra nga pjesët e fjalës tjetër. Në tërësi, blendet janë një mjet i dobishëm për zhvillimin e gjuhës dhe shprehjen e koncepteve të reja në mënyrë koncize.

Procesi i shkrirjes së fjalëve ka ndodhur në shumë gjuhë të botës edhe atë në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre. Ato janë ndeshur në sanskritishte, në greqishten e vjetër, në gjermanishten e vjetër e të lashtë, në latinishte, në frëngjishte e rusishte dhe veçanërisht në gjuhët moderne gjermanike, si suedishtja, danishtja, gjermanishtja dhe anglishtja. (Cannon 2009: 725-754).

Blendet fillimisht u zhvilluan në gjuhën angleze, por më pas u zgjeruan edhe në gjuhë të tjera. Ata u bënë më të zakonshëm në shekullin e 20-të, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore. Këtë proces të pazakontë leksikor e gjejmë në shembujt e disa gjuhëve të botës.

Në gjuhën gjermane lindën blendet e tipit: *Fraport* (**Frankfurt**+**Airport** 'për kompaninë që vepron në këtë aeroport'), *Bankfurt* (**Bank** +**Frankfurt**), *Kurlaub* (**Kur** + **Urlaub**) etj. Blendet që janë kryesisht emra: *Stagflation* (**Stagnation** + **Inflation**), *Medyziniker* (**Medyzin** + **Zyniker**) dhe shumë më pak janë pjesë të tjera të ligjeratës, si p. sh.: *angeheitert* (**angetrunken** + **aufgehe-iter**), *jein* (**ja** + **nein**). Është për t'u përmendur se blendi "*Teuro*" (gjerm. *Teuer* 'shtrenjtë' + *Euro*, me ngjyrim ironik për shtrenjti min e përgjithshëm që ndodhi me kalimin e markës në euro, në vitin 2002 u zgjodh si fjalë e vitit në Gjermani). (Bugarski 2013:19-26).

Në gjuhën ruse veçuan blendet: *pivonieri* (**pivo** + **pionier** 'që pi birra në moshë të re'), *bifsheviki* (**bifshi** + **bolsheviki** 'ish - bolshevikët'), *katastrojka* (**katastrofa** + **perestrojka**) 'reformat e pasuksesshme në ish-Bashkimin Sovjetik'. Në gjuhën polake kemi blendet: *demokratura* (**demokraci**+**diktaturë**) dhe *LEHValensa*. Në gjuhën rumune veçohen blendet: *Çaushvic* (**Çaushesku** + **Aushvic**), *Drakulesku* (**Drakula** + **Çaushesku**), të lidhur me liderin komunist Nikollai Çaushesku. Në gjuhën hungareze *HungarIQ* (emision në TV-në hungareze) etj. Në gjuhën frënge: *franglais* (français +anglais), *gélule* (**gélatine** + **capsule**), *courriel* (*courrier* + *électronique*), *plapier* (*plastique*+*papier*). Nuk kanë ngelur anësh edhe blendet që janë krijuar me emrat e politikanëve më me ndikim në Bashkimin Evropian, si: *Merkozi* (**Merkel**+**Sarkozi**), *Merkoland* (**Merkel** + **Oland**) etj.

### Blende në morfologjinë krijuese të gjuhës shqipe

Për dallim të fjalëve angleze, procesi i shkrirjes së fjalëve në gjuhën shqipe, nuk është trajtuar në mënyrë të veçantë, sidomos jo para vitit 2000. I pari që ka futur nocionin e shkrirjes dhe e ka përdorur gjithashtu këtë term në literaturën tonë gjuhësore është studiuesi Rami Memushaj (Çerpja 2018:199). Në tekstin *Morfologjia*, krahas emrave të prejardhur dhe të përbërë, ka renditur dhe emrat e formuar me shkurtim, ku përfshin

shkrirjet e fjalëve (motel, smog) dhe akronimet (OKB, NATO) (Memushaj 2007:47). Duhet dalluar kuptimin si term hiperonimik tek i cili po në të njëjtin punim përfshin tre

lloje: *shkrirjet*, *shkurtesat* dhe *akronimet* (Memushaj 2007:47). Sipas tij, shkrirjet janë krijime të ngjashme me kompozitat, veçse tek ato nuk bashkohen tema të plota, por tema të cinguar arbitrarisht, më fort sipas shoqërue-shmërisë së tyre fonetike (Memushaj 2006:192). Për këtë grup fjalësh R. Memushaj jep këto shpjegime:

- formohen nga bashkimi i dy fjalëve të shkurtuara, si p.sh.: *smog* (nga angl. smoke fog), *motel* (nga angl. motor + hotel), *profarma* (prodhime farmaceutike) etj....

Në gjuhën shqipe ky trajtim lindi dhe u zhvillua në mënyrë të pavarur. Shumë blende janë huazuar nga gjuhët tjera, ose janë përzier me fjalë shqipe, por ka edhe shumë përngjitje të fjalëve që bazohen në gurrën e gjuhës shqipe dhe në këtë mënyrë paraqesin risi dhe vlerë për sociolinguistikën shqiptare. Shembujt që do t'i paraqesim në këtë studim janë prurje të reja, që shumica e fjalëve nuk kanë qenë regjistruar më parë, si p.sh.: *Bunkart* (**bunker**+ **art**) 'për bunkerin në Tiranë që u zëvendësua në atraksion turistik', *arbdhetar* (**Arbëria** + **atdhetar**), *pluap* (**pluhur** + **sapuni**), *profarma* (**prodhime** + **farmaceutike**), *rrëmoj* (**rrëmih** + **gërmoj**), *kaposh* (**kapua** + **kokosh**), *kongjill* (**kondil** + **thëngjill**), *lela* (**letër** + **larëse**), *mapo* (**magazinë** + **popullore**) (Memushaj 2006: 192). Këtu nuk do të shqyrtohen disa blende të kalkuara që përbëhen nga shkurtesa të pjesës së dytë, si p. sh. : *automat*, *bankomat*, *kafemat*, *parkomat* etj.

Si proces i ri sociolinguistik, kjo dukuri është e motivuar për të ndërtuar fjalë të reja në gjuhë që krijohen me anë të *përngjitjes*, *shkrirjes*, *bashkimit* ose *kontami-nimit*, ndërsa në aspektin terminologjik ndërkombëtar rëndom përdoret termi **blende**. Qëllimi ynë nuk është që t'i huazojmë blendet, por të ndjekim këtë proces edhe në gjuhën shqipe, që deri para disa vitesh ishte i panjohur, kurse sot ka marrë një hov shumë të madh dhe paraqitet si mënyra më e gjallë e krijimit të fjalëve të reja. Shembujt ndërkombëtarë i kemimarrë vetëm si një lloj modeli gramatikor e deri diku edhe si një qëndrim psikologjik, që mund të zgjerohet me blende nga brumi gjuhësor. Ata lehtësojnë komunikimin duke krijuar fjalë më të shkurtra dhe të koncentruara. Ato shpesh bëhen pjesë e gjuhës së përditshme, veçanërisht në fushat e teknologjisë, marketingut dhe medias.

Në shumë raste, theksimi me shkronja të mëdha është i kufizuar vetëm në formën e shkruar, pasi në të folur krejtësisht humbet. Blendet mund të krijohen nga tri grupe krijuesish, edhe atë nga: *adoleshentët* (zbavitja), *gazetarët* dhe *ekspertët e marketingut* (për të tërhequr auditorin) dhe klientët (për prodhimet ose shërbimet e tyre). Procesi i shkrirjes duket se po ndodh në të gjitha gjuhët e botës. Të zakonshëm u bënë në shekullin e

20-të, që sot kanë një përdorim të madh në çdo medie, rrjetet sociale, por edhe në vepra artistike apo shkencore.

Shkrirjet eptohen si fjalë të zakonshme të gjuhës.

Blendet anë leksema të formuara nga bashkimi i dy fjalëve në mënyrë të tillë që është e vështirë të bëhet ndarja në morfema (Memushaj 2006:192).

Shkrimtari Visar Zhiti është nga ata shkrimtarë me “laborator të hapur” krijues, laborator që nuk e mpak punën, në funksion të “gdhendjes” së formave gjuhësore. Sipas gjuhëtarit Gjovalin Shkurta: “Ai është një nga të paktët krijues të brezit të tij, që merret thekshëm me gjuhën” (Shkurta 2009: 209). Ky kujdes i gjuhës shihet në të gjitha romanet e V. Zhitit dhe mund të themi se gjuha është shenja e tij më e pastër letrare. Neologjizmat në tekstet e tij të gjata narrative (por edhe në poezi e tregi-me), ndërtohen mbi një koncept specifik: mbi hibridi- zimin e fjalëve nëpërmjet ndërthurjeve të dy a më shumë njësive semantike. Njësi të tilla shkruhen brenda trupit të një fjale-shenje duke formuar një koncept, që është më i madh nga ana kuptimore se fjalët formuese veç e veç.

Kështu në romanin “Në kohën e britmës” sintagmatitullore përcjell një kohë subjektive emocionale (kohë e britmës), që materializohet nëpërmjet një gjuhe të re (në këndvështrim të lidhjeve që krijohen, ndjeshmërisë dhe risive gjuhësore). Në mënyrë që të analizohen risitë gjuhësore. Neologjizmat në kontekstin e botës poetike, së pari duhet të vëzhgojmë marrëdhëniet e tyre me strukturën (procesin e grumbullimit dhe sistemet përshkruese), dhe të kuptohen marrëdhëniet në mes të termit të ri dhe termit nga i cili u krijua. P.sh., përgjithësisht neologjizmat në veprën e Visar Zhitit janë eksplicite, ndaj marrëdhënia që krijohet ndërmjet neologjizmit dhe konceptit që ai përcjell, është dialektike.

Për të kuptuar këtë marrëdhënie na ndihmon “përkufizimi” i kohës së britmës, nëpërmjet gjuhës zhitjane: *Rrjepublikë, Pluhuralizëm, Demonkreaturë, Mono-harki, SoCIALIZëm, Shkretëtirë dhe deve* (Zhiti, 2009: 309). Secila nga fjalët përkufizuese të gjendjes politike të Shqipërisë bëhet nëpërmjet neologjizmave. Ndërtimi i neologjizmave zhitjane bëhet nëpërmjet operacionit të ndërkaljes së semave jokuptimplota brenda trupit të fjalës. Procesi i ndërfitjes së tyre i nënshtrohet dukurisë së bashkëshoqërimit; kuptimi i tyre gjeneron, nëpërmjet lidhjes asociative që ekziston mes fjalës dhe konceptit të ri të cilën ajo duhet të referojë. Në këtë mënyrë: sema - republikë kthehet në *rrjepublikë*. Në të vërtetë ndryshimi formal është fare minimal. Fjalës i janë shtuar vetëm dy shkronja -r, -j, por efekti konotativ që shtohet, e bën atë të “aftë”, të përcjellë një koncept tjetër: *Republikë e rrjepur*.

Të njëjtit proces i nënshtrohet edhe neologjizmi i dytë. Fjala “*pluhuralizëm*”, është një nga fjalët e lidhura ngushtësisht me historinë e ndryshimit në vendin tonë. Ndryshimet në Shqipëri nisën me kërkesat e studentëve të '91-shit, të cilët pluralizmin politik barazuan me idealin e ardhmërisë. Kjo ngarkesë e madhe kuptimore e emocio-nale e fjalës, shihet

në leksemën neologjike *Pluhuralizëm*. Kjo fjalë e re, duket sikur shenjon shkërmoqjen e një ëndrre, shkeljen me këmbë (pluhur në tokë) të një ideali, dyshimin e madh në ardhmërinë ndryshe.

Ndërfutja e rrokjeve, semave, në trupin e fjalëve qëshënjojnë koncepte të rëndësishme politike, sjell çmitizi- min e tyre. Siç pohon edhe vetë shkrimtari: Fjalët .....ringjallen me kuptim tjetër (Zhiti, Funerali 2009: 136). Njëpërmjet këtij operacioni gjuhësor, thyhet tabuja e mitit të demokracisë. Ndryshimi mes së shkuarës dhe së tash- mes kthehet në çështje terminologjike. Pushteti i popullit (**demos + kratos**), kthehet në një krijesë diabolike (*Demonkreaturë*), shumë e ngjashme me simotrën e saj të fabrikuar në laboratorët e ideologëve komunistë, (*SoCIALIZëm*).

Neologjizma të këtij tipi gjejmë edhe tek veprat e Ismail Kadaresë. Sipas studiuës të Tefik Çaushtit (Çaushtit 2002), Kadaresë i njihen rreth 2000 fjalë në fondin e krijimeve apo rivitizimeve gjuhësore, një pasuri kjo e lakmueshme për çdo shkrimtar. Studiuesi Gjovalin Shkurtaç bën klasifikimin sipas burimit, modelit etj., për këtë pasuri gjuhësore kadareane veçuan dy fjalë: *arkëmort* (**arkëvol + mort**) (për arkivol, qivur, tabut), *arkeoëndërr* (**arkeologji + ëndërr**) (Shkurtaç 2009: 196 – 199) që përputhet me përngjitjet në fjalë.

Njëpërmjet gjuhës poetike fiksionalizohen ngjarje reale që lidhen me diktaturën e post-diktaturën komuniste në Shqipëri. Funkcionet e neologjizmave në disa rrethime bashkëkohore shqiptare, veçanërisht në veprën e V. Zhitit janë njësi konceptkrijuese. Format e reja gjuhësore përcjellin lëndë specifike kuptimore, që nuk shprehet menjësitë ekzistuese gjuhësore. Neologjizmat zhitiane janë **fjalë-hibrde**, të formuara nga bashkimi formal dhe semantik. Ato mund të kategorizohen si njësi që përftohen njëpërmjet procesit të brendashkruarjes së fjalës brenda fjalës, konceptit brenda konceptit. (Kërbizi 2014:87-89).

Ndër autorët, të cilët në veprat e tyre kanë trajtuar tema të përzierjes së fjalëve ose blendeve janë:

- **Naum Prifti:** Studioi shqipen në mënyrë akademike dhe publikoi shumë vepra mbi gjuhën shqipe, duke përfshirë edhe përdorimin e teknikave kreative si përzierja e fjalëve.

- **Eqrem Çabej:** Gjuhëtari i shquar shqiptar, ka bërë studime të rëndësishme mbi fushën e gjuhësisë shqipe, duke përfshirë dhe analizën e fjalëve të përzierja.

- **Martin Camaj:** Poet dhe intelektual shqiptar, ka shkruar poezi dhe prozë ku shpesh përdor teknikën e përzierjes së fjalëve për të krijuar efekte artistike.

- **Ismail Kadare:** është një nga shkrimtarët më prodhimtarë në lëmin leksikor, për sa i përket mjeteve të shumëllojta fjalëformuese, procesit të detajuar të përshtatjes mes fjalës dhe konceptit etj.

- **Visar Zhiti:** Shkrimtar me “laborator të hapur” krijues, laborator që as nuk e mpak punën, në funksion të “gdhëndjes” së formave gjuhësore.

- **Xhevat Lloshi:** Gjuhëtari i shquar shqiptar, ka bërë studime mbi

fushën e gjuhësisë shqipe, duke përfshirë dhe stilistikën, pragmatikën, etnolinguistikën etj..

- **Gjovalin Shkurtaç:** Gjuhëtari i shquar shqiptar, ka bërë studime të rëndësishme për përzierjen e fjalëve në fushën e sociolinguistikës dhe etnolinguistikës shqiptare.

- **Rexhep Qosja:** është historian letërsie, kritik letrar, shkrimtar, publicist dhe akademik shqiptar, i cili edhe ai në veprat e tij ka përfshirë analizën e fjalëve të përziara.

Këta autorë janë vetëm disa nga shkrimtarët dhe gjuhëtarët e shquar që kanë trajtuar temat e përzierjes së fjalëve dhe teknikave tjera të krijuara nga kombinimi i fjalëve në veprat e tyre.

### **Përfundim**

Dukuria e **blendimit leksikor** përbën një proces të rëndësishëm në zhvillimin e gjuhëve bashkëkohore, duke reflektuar dinamizmin, kreativitetin dhe ndikimin e globalizimit në komunikimin ndërkulturor. Krijimi i fjalëve të reja përmes ndërthurjes së elementeve leksikore jo vetëm pasuron sistemin gjuhësor, por edhe dëshmon për fleksibilitetin e gjuhës për t'iu përshtatur nevojave të komunikimit modern.

Përdorimi i termave të ndryshëm ndërkombëtarë për të përshkruar të njëjtin fenomen tregon karakterin **ndërgjuhësor dhe ndërkulturor** të kësaj dukurie, e cila ka tejkaluar kufijtë kombëtarë dhe është bërë pjesë e përbashkët e praktikave gjuhësore globale. Në këtë kuptim, blendet nuk janë vetëm një formë fjalëformimi, por edhe një pasqyrim i transformimeve kulturore dhe teknologjike që ndikojnë në mënyrën se si njerëzit ndërveprojnë, komunikojnë dhe krijojnë kuptime të reja në hapësirën globale të diskursit.

## Referencat:

- BUGARSKI, R. (1976). Zargonizacija u tvorbi reci. Biblioteka XX vek:Beograd.
- BUGARSKI, Ranko. (2006). *Žargon*. Biblioteka XX vek:Beograd.
- CANNON, G. (1986). "Blends in English word-formation. Linguistics 24 (4), 725-753. of\_Blends\_in\_English\_and\_French
- GURGA, Gëzim (1996). *Emri – shenjë e identitetit qytetar dhe kombëtar*. Rilindja, Prishtinë. 13 qershor 1996. f.9. HALIDOVIĆ, Alma. (2011). *Frazemi u reklamnimtekstovima*. Philologia , 2011, 9, 21-28, Beograd.
- HAXHIHASANI, Qemal (1964), " *Të folmet shoqnore. Dogançja, e folmja shoqnore e zejtarëve shëtitës të Permetit dhe të Leskovikut*". Në revistën "Studime filologjike, Tiranë, nr. 1,2,3.
- IBRAHIMI, M. (2008). *Vëzhgime mbi disa dukuri sociolinguistike tek shqiptarët e Maqedonisë e më gjerë*. Në Studime etnolinguistike,folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni. (koautorë V.Bexheti, H.Xhaferi) UEJL:Tetovë.
- IBRAHIMI, M. (2009). *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmave shqiptare*. Interlingua:Shkup.
- IBRAHIMI, Mustafa. (2018). *Sociolinguistika*. UNT, Shkup.
- IBRAHIMI, Mustafa. (2024). *Zhargone dhe blende*. Interlingua, Shkup.
- KËRBIZI, Marisa (2014). Funksionet e neologjizmave në disa romane bashkëkohore shqiptare. ANAS nr.7- 8.2014. Instituti Alb-Shkenca, Shkup. (fq. 85-96).
- KLOSI, Doriana.(2014). *Çështje të variacionit gjuhësor në mjedisin universitar të qytetit të Vlorës*.Tiranë (disertacion doktorate në dorëshkrim).
- LLOSHI, Xhevat (2001). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Shblu:Tiranë.
- MEMISHA, V. - BREGASI. M. (2008). Emërtimet shkurtuara në gjuhën shqipe, Tiranë.
- MEMUSHAJ, Rami. (2006). *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë.
- MEMUSHAJ, Rami. (2007). *Bukuria e gjuhës I*, tekst i gjuhës shqipe për shkollat e mesme të përgjithshme të Malit të Zi, Podgoricë.
- METANI, Idriz (2010), *Gjurmë semantike dhe strukturore në shqipen e sotme nga kontaktet gjuhësore*. Në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Nr. 29.1, Prishtinë.469-474.
- MONTEKO, K. (2009). *Neologjizmat e fjalorit personal të gazetarëve shqiptarë*, Tiranë, 2009, f. 94.
- PARLLAKU, Matida (2010), *Reklama si mishërim i kontakteve në gjuhë e mes gjuhë*. Në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Nr. 29.1, Prishtinë.
- SHKURTAJ, Gjovalin. (2003) "*Sociolinguistika*". Tiranë.
- YMERI, Mariana (2002). *Zhargonet dhe dëshmitë e tij në gjuhën shqipe*. Në Revistën Gjuha jonë. Tiranë, nr.1-2.
- ZHITI, Visar (2009). *Në kohën e britmës*. Tiranë: OMSCA.
- ZHITI,Visar (2009). *Funerali i pafundmë*,Tiranë: OMSCA.

ISSN 2671-3004

UDC 811.18'42

Punim studimor

**Begzad BALLIU**  
**Universiteti i Prishtinës, "Hasan Prishtina"**  
bbaliu@yahoo.com

**FJALËSHPEJTA NË GJUHËN SHQIPE**  
**TONGUE TWISTERS IN THE ALBANIAN LANGUAGE**

**Hyrje**

Në gjuhësinë shqiptare janë studiuar ku më pak e ku më shumë të gjitha veçoritë fonetike, fonologjike, leksikore, gramatikore, sintaksore, frazeologjike e stilistike. Në rastet më të shpeshta kemi të bëjmë me përshkrimet normative, dialektore apo historike të fjalësit të shqipes dhe veçorive të tij, por nuk kanë munguar as studimet me qasje, të cilat i kanë tejkaluar orientimet diturake të kohës.

*Fjalëshpejta* është strukturë fonetike, morfologjike, sintaksore, frazeologjike, stilistike, logjike dhe semantike, e cila nuk është studiuar në përmasat gjuhësore, sociale e kulturore të ndikimit të saj dhe në shkallë të ndikimit të saj në jetën mendore e psikologjike të folësve të kohës.

Në gjuhësinë shqiptare fjalëshpejtat janë të njohura gjerësisht. Prej shembujve të shumtë të tyre me formim periudhash e kohësh shumë të largëta, për të mos thënë edhe në vende e krahina etnografike shumë të thella larg qendrave urbane, dëshmohet se ato e kanë bërë një jetë mjaft të pasur në jetën tonë sociale, kulturore e mendore. Por, mbledhja dhe tipologjia e tyre duket të jetë e një kohe shumë të vonë dhe për shkaqe krejt anësore. E para, në interes të identifikimit të tyre dhe përdorimit për specialistë të fushave të artit (muzikës, teatrit); dhe e dyta, e studiuar krejt së voni, në interes të përdorimit të tyre për fëmijët me problematika shqiptimi. Në kontekstin dokumentues, fjalëshpejtat janë identifikuar dhe përshkruar madje vetëm në raport me ushtrimet në fushë të muzikës, por nuk na dalin edhe në fushë të kulturës së shkrimit dhe shqiptimit në dokumentet, përkatësisht sillabuset e lëndës.

A është kjo arsyeja pse studimi i fjalëshpejtave është bërë pothuajse në mënyrë krejt të pavarur, në fushë të muzikës në njërin anë, ndërsa në

fushë të kulturës së gjuhës në anën tjetër. Si në rastin e parë ashtu edhe në rastin e dytë, teksti i këngës përkatësisht teksti letrar shërbejnë vetëm si lëndë e zbatimit të tyre.

Megjithëse gjejmë shumë shembuj të përdorimit të fjalëshpejtave për fëmijët në shkollat tona, me synim drejtshqiptimin e tingujve të caktuar: *f:v; th:s; r:rr, l:j* etj., shembujt janë të radhitur kryesisht si një radhë fjalësh po jo me kuptim të plotë të një fjalie. Në këtë kontekst do parë vërejtja e studiuesit Schourup, i cili fjalëshpejtat i shihte edhe si “një listë fjalësh, pa lidhje të domosdoshme tematike, me kuptimin të rastit”<sup>2</sup>. Pra, kemi të bëjmë kryesisht për stimuj artificialë. Në shikim të parë shembujt radhiten si shqiptim, përkatësisht “rrëshqitje spontane” e përdorimit të tyre, por në realitet ata janë rezultat i shqiptimit verbal të folësve naivë që kontrollohen dhe imponohen kryesisht nga mësuesi. Në gjuhësinë shqiptare nuk ka tekste dhe vepra të specializuara të kësaj natyre, duke përfshirë këtu edhe ato letrare për fëmijë, ndërkohë që botimet shkencore qoftë në shkencën nacionale, qoftë në shkencën e përgjithshme ndërkombëtare mungojnë. Në literaturën ndërkombëtare, ndërkaq, botimet e kësaj natyre për fëmijë janë të pafundme. Ndërmjet kërkimeve shkencore dhe botimeve praktike letrare, dija e studimeve eksperimentale dhe ajo e krahasuar sapo ka filluar. Por, ata që sot merren me fjalëshpejtat nuk janë linguistët, janë gjuhëzgjdhësit, logopedët, edukatorët, prindërit. Gjuhëtarët ende hezitojnë t'i hetojnë këto fenomene në çdo detaj, me një bindje të habitshme se prej tyre nuk mund të përftohen njohuri interesante dhe të qëndrueshme gjuhësore të folësve. Prej korpusit të kësaj vepreje besoj se mund të bëhen disa vëzhgime jo të parëndësishme për strukturën fonologjike të komunikimit gjuhësor dhe për mënyrën se si komunikimi me shkrim e sidomos me gojë manifestohet pas zhdërvjelltësimit të gjuhës, në njërën anë, si dhe tipologjinë gjuhësore, hapësinore e motivuese të saj, në anën tjetër.

### Probleme të zhanrit dhe të përkufizimit

Në dy *Fjalorët e gjuhës shqipe* (1980, 2020), njësia *fjalëshpejtë*, pas kategorizimit gramatikor të saj, jep një shpjegim prej një fjalie dhe një shembulli, pa asnjë ndryshim, nga njëri *Fjalor* te tjetri: “Lojë zbatimëse popullore, në të cilën marrin pjesë dy a me shumë veta, që përsëritin sa më shpejt e pa gabim fjalë ose fjali të vështira për t'u shqiptuar së bashku (p.sh. Kupa me kapak - kupa pa kapak)”<sup>3</sup>.

Fjalorët normativë dhe tekstet e vjetra të shqipes nuk e kanë të thelluar shpjegimin për këtë strukturë gjuhësore, por i kanë trajtat fjalëformuese, të cilat i përgjigjen strukturës gramatikore e leksikore të fjalës gjejeje apo trajtave të përafërta me të:

<sup>2</sup> Schourup, L. 1973. *Unique New York Unique New York Unique New York*. CLS 9. CLS. 587-96.

<sup>3</sup> Androkli Kostallari (red.). *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1980, f. 453; Jani Thomai (red.). *Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2020, f. 160.

*Fjalaman-i*. em. shm. (FGJSH, 1954: 122); *fjalëgjatë*. agg. (Leotti, 1936: 212); *fjalëkeq*. mb., (Budi, 1618-1621. Shih, Ashta, II: 198); *fjalëkryq*. s. m. (Leotti, 1936: 212); *fjalëkrýq-i*. em. shm. (FGJSH, 1954: 122); *fjalëmádh*. (Mitko, 2014: 615); *fjalëmádh-e*. mb. (FGJSH, 1954: 122); *fjalëmáth*. agg. (Leotti, 1936: 212); *fjalëmàth-dhe*. agg. (Giordani, 1963: 113); *fjalëmbël*. mb. (FGJSH, 1954: 122); *fjalëmbëlë*: agg. (Leotti, 1936: 212); *fjalëmbëlsi*. s. f. (Leotti, 1936: 212); *fjalëmirë*. emf. mb. (FGJSH, 1954: 122); *fjalëmjáltë*. agg. (Leotti, 1936: 212); *fjalëpak* mb. (FGJSH, 1954: 122); *fjalëpákët*. agg. (Leotti, 1936: 212); *fjalërendë* mb. (FGJSH, 1954: 122); *fjalëri-a*. (Mitko, 2014: 615); *fjalëshkúrtër*. agg. (Leotti, 1936: 212), *fjalëshmit (të)*. (Mitko, 2014: 615); *fjalëshúmë* (Mitko, 2014: 615); *fjalëshumë*. mb. (FGJSH, 1954: 122); *fjalëshúmë*. agg. (Leotti, 1936: 212); *fjalëshúmës*. s. m. (Leotti, 1936: 212); *fjalëtar* "lajmëtar" e përdor Bogdani, ndërsa *fjalëtor* e përdor krahina e Luma. (Luka, SGJ, II, 2002: 38); *fjalëtār-i*. (Mitko, 2014: 615); *fjalëtar-i*. em., (Bogdani, 1685. Shih, Ashta, IV: 174); *fjalëtër-i*. em., (Bardhi, 1635. Shih, Ashta, III: 134); *fjalëti-a* (Mitko, 2014: 615); *fjalëtóhem* (Mitko, 2014: 615); *fjalëtoj* (t.), (Kristoforidhi, FGJSH, 1904: 104); *fjalëtój*. fint. (FGJSH, 1954: 122); *Fjalëtónj*. v. (Leotti, 1936: 212); *fjalëtóre*. s. f. (Leotti, 1936: 212); *fjalëtúar* (Mitko, 2014: 615); *fjalëtúar*. s. m. (Leotti, 1936: 212); *fjalëtúar-i*. (Mitko, 2014: 237); *fjalëtuar-ori*. (t.), *fjalëtore-ja*. sh. *fjalëtorë-të*. (m.), *fjalëtore-të*. (fm.), (104) *fjalohem*. (g.) *fol. rifl.*, (Kristoforidhi, FGJSH, 1904: 105); *fjalë-úrdhër*. s. m. (Leotti, 1936: 212); *fjalëz-a*. ef. shm. (FGJSH, 1954: 122); *fjalëzë-a*. em., (Bogdani, 1685. Shih, Ashta, IV: 174); *fjalimthënjë*. s. f. (Leotti, 1936: 213); *fjalohem*. fm. (FGJSH, 1954: 122); *Fjalò-i*. sm. (Giordani, 1963: 113); *fjalónem*. (Mitko, 2014: 237); *fjalónj*. (Mitko, 2014: 615); *fjalónj*. v. (Leotti, 1936: 213) etj<sup>4</sup>.

Edhe ndër botimet enciklopedike të leksikografisë së viteve të fundit nuk shohim shumë të dhëna me interes për fjalëshpejtat, për të mos thënë nuk paraqiten fare si njësi më vete. Bie fjala, në veprën *Enciklopedia elementare e gjuhës angleze*, shpjegimet për fjalëshpejtat jepen në kuadër të njësisë së aliteracionit dhe lojës dhe gjuhës në shkrim, fillimisht si mjet për përzgjedhjen e gjuhës dhe më tej për aspektet stilistike e artikuluese në fushë të reklamës dhe gazetarisë, ndërsa në rastin tjetër në krijimtarinë letrare<sup>5</sup>. Në fjalorë të tjerë mungon fare, ndërsa në *Enciklopedinë e gjuhës*

<sup>4</sup> Begzad Baliu, *Leksiku historik i shqipës (1462-1954)*, I, Prishtinë. (Dorëshkrim)

<sup>5</sup> Shih, *The Primary English ENCYCLOPEDIA. The Heart of the Curriculum THIRD EDITION* Margaret Mallett with a Foreword by Sue Palmer., This edition published 2008 by Routledge, p. 24-25 dhe 266. Bashkë me bibliografinë, të cilën këtu po e sjellim të plotë për shkak se përfqëson literaturën e zgjedhur për këtë fushë, në kontekstin fonetik: Flynn, Simon (2004) '*Animal stories*' in Peter Hunt (ed., second edition) *International Companion Encyclopaedia of Children's Literature, Volume I* London and New York: Routledge; Hunt, Peter (ed.) (1995). *Children's Literature: An Illustrated History Oxford and New York: Oxford University Press.* (Chapter 7, Section on Animals' Lands.); Townsend, John Rowe (1995 edition) *Written for Children London: The Bodley Head.* (Chapter 10, *Articulate Animals.*); si dhe në nëntemën *Loja dhe gjuha në shkrim-lexim*: Browne, Ann (2001) *Developing Language and Literacy* 3-8

dhe të gjuhësisë tek zëri i fjalëshpejtave jepet një listë botimesh për ushtrime. Vepra e parë, një *Antologji e fjalëshpejtave në gjuhën angleze*, është botuar në vitin 1969. Kjo është antologjia e parë e specializuar e fjalëshpejtave të gjuhës dhe është ende një vepër themeltare për ngritjen dhe përmirësimin e artikulimit të përgjithshëm. Janë zgjedhur mbi 600 fjalëshpejta të gjuhës angleze brenda një korpusi mjaft të pasur<sup>6</sup>. Fjala është për një përzgjedhje të fjalëshpejtave në gjuhën angleze<sup>7</sup>, si dhe një liste tjetër krahasuese në gjuhën frënge<sup>8</sup>. Po kështu do shquar edhe botimin dygjuhësh, të parit botim në gjuhën meksikane, të autorit Robert J., Haddad<sup>9</sup>. Karakteristikë e këtij hulumtimi në botimet engleze është përzgjedhja e fjalëshpejtës model në gjuhën angleze: *Peter Piper picked a peck of pickled pepper*<sup>10</sup>. Kjo fjalëshpejtë e famshme i prinë edhe botimit enciklopedik të fjalëshpejtave në gjuhën angleze<sup>11</sup>.

Ndër studime të kësaj natyre do të veçoja konceptin e Munro MacKenzie, sipas të cilit fjalëshpejta është “një krijim i pranuar i një artikulesi dhe si i tillë nuk është i dobishëm as në përkufizimet e fjalorit të gjuhësisë<sup>12</sup>. Po kështu kemi shembullin e studiuesit Morris, i cili fjalëshpejtën e përkufizonte si çdo "fjalë të vështirë për t'u artikulluar me shpejtësi, zakonisht për shkak të një sërë tingujsh të ngjashëm bashkëtingëllorë"<sup>13</sup>

Në *Wikipedi*, në gjuhën shqipe, jepet një përkufizim përgjithësues për fjalëshpejtat, ku jepen edhe disa përbërës, kryesisht të karakterit fonetik: *Fjalëshpejtat janë shprehje që përdoren si lojë për t'i thënë me shpejtësi disa herë pa gabime. Këto shprehje kanë në vete tinguj të cilët, kur gjenden afër njëra-tjetrës, nyjëtohen me vështirësi dhe ngatërrohen*<sup>14</sup>.

---

London: Paul Chapman; Mallett, Margaret (1999) *Young Researchers: Informational Reading and Writing in the Early and Primary Years London: Routledge.*; Whitehead, Marian (2004, third edition) *Language and Literacy in the Early Years London: Paul Chapman (Shih kapitullin 7); Wyse, Dominic and Jones, Russell (2007). English, Language and Literacy London: Routledge.*

<sup>6</sup> Shih, Ken Parkin, *Antologjia e përdredhësve të gjuhës britanike*, 1969.

<sup>7</sup> Shih, *English Tongue Twisters*, 1. Përmbledhja ndërkombëtare *Tongue Twisters*. [www.uebersetzung.at/twister/en.htm](http://www.uebersetzung.at/twister/en.htm) © 1996-2013 Mr.Twister. (6.8.2024)

<sup>8</sup> [https://www.academia.edu/8913925/French\\_tongue\\_twisters?sm=b](https://www.academia.edu/8913925/French_tongue_twisters?sm=b). (6. 8. 2024)

<sup>9</sup> Shih, *Mexican tongue twisters = Trabalenguas mexicanos*, mbledhur dhe përkthyer nga Robert J. Haddad. Shtypi Editorial Bilingüe, ©1989.

<sup>10</sup> <https://www.encyclopedia.com/literature-and-arts/language-and-linguistics-and-literary-terms/language-and-linguistics/tongue-twister>. (6.8.2024)

<sup>11</sup> Shih, Gyles Brandreth, *The biggest tongue twister book in the world / by Gyles Brandreth ; illustrations by Alex Chin*. New York : Sterling Pub. Co., ©1978. (6.8.2024)

<sup>12</sup> Munro MacKenzie, M. D. 1973: 98. *Modern English pronunciation practice*. London: Longman.

<sup>13</sup> Morris, W. (ed.). 1975. *The American Heritage dictionary of the English language*. Boston: American Heritage Publishing Co., Inc. Motley, M. and Barrs, B. 1979.

<sup>14</sup> Shih, Vviedenskiy, B. A. 1956: 253. *Bolshaya sovetskaya entsiklopediya*. Moscow. State Scientific Publishers. 35. ([https://sq.wikipedia.org/wiki/Fjal%C3%ABshpejtan%C3%AB\\_gjuh%C3%ABn%C3%ABshqipe](https://sq.wikipedia.org/wiki/Fjal%C3%ABshpejtan%C3%AB_gjuh%C3%ABn%C3%ABshqipe))

Më është dukur shumë interesant një përkufizim për vendin e fjalëshpejtave në *Enciklopedinë e Madhe Sovjetike*, në të cilën thuhet se fjalëshpejta ('skorogavorka') është një "zhanër i vogël folklorik shakatar"<sup>15</sup>.

A është kjo arsyeja pse në një nga studimet e rralla në gjuhësinë kroate, ku është bërë një pasqyrë e historisë së fjalëve /nacioneve /termave të përdorura në shkencën kroate të letërsisë dhe folkloristikës për të emërtuar përgjithësisht zhanret e retorikës gojore (bekimet, mallkimet, fabulat, dollitë, talljet etj.), brenda së cilave janë përfshirë edhe fjalëshpejtat (kroat. "brzalice"), nuk është botuar në revistat me specializim gjuhësinë, por në revistën *Kultura popullore: etnologji dhe folkloristikë*<sup>16</sup>.

Njohuritë për fjalëshpejtat parashihen kryesisht në sillabuset apo planet dhe programet e teksteve të gjuhës, letërsisë dhe lëndës së muzikës, por nuk mund të thuhet se tekstet e përgatitura mbi bazën e atyre sillabuseve i përmbushin kërkesat e lexuesve apo mësimeve: "Tekstet e *Gjuhës shqipe dhe letërsisë*, shkruan studiuesja Greta Jani, në arsimin parauniversitar janë ndërtuar në mënyrë të tillë që njohuritë gjuhësore të merren nëpërmjet veprimtarive praktike, zbatimit konkret të tyre në tekstet letrare. Për t'i kuptuar këto tekste, vëmendja, veç të tjerash, duhet të përqendrohet edhe tek zbulimi dhe përdorimi i dukurive gjuhësore, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia, hiperonimia / hiponimia, *fjalëshpejtat*, shprehjet frazeologjike etj."<sup>17</sup>.

Përmes disiplinave artistike, fëmijët e moshës më të hershme, në mënyrën më të përshtatshme për ta, manifestojnë përmes formës së lojës, si prirjet dhe shkathtësitë e veta, ashtu edhe përjetimin dhe njohjen e vetvetes e të botës që i rrethon. Reagimi i nxënësve ndaj tingujve të ndryshëm gjatë procesit të këndimit dhe të interpretimit me vegla muzikore duhet të stimulohet përmes hulumtimit të tingujve dhe interpretimit të tyre mbi gjithçka që i rrethon ata. Instrumentet nga instrumentari i Orfit, arrijnë t'i plotësojnë mundësitë e shumëllojshme të krijimit të tingullit ose të ritmit me të cilët ndiqen këngët dhe fjalëshpejtat (hapadollapat)"<sup>18</sup>. Në tekstet shkollore të muzikës në Maqedoninë e Veriut,

<sup>15</sup> Shih, Vviedienskiy, B. A. 1956: 253. *Bolshaya sovietskaya entsikolopiedya*. Moscow. State Scientific Publishers. 35.

<sup>16</sup> Shih, Davor Nikoliq, *Mali, sitni, jednostavni, govornički ili jednostavno - retorički: povijest naziva i koncepta usmenoretoričkih žanrova u hrvatskoj folkloristici*, in "Narodni umjetnost", nr. 52/2, 20215. Institut za etnologiju i folkloristiku, Zagreb, Croatia, f. 163-178.

<sup>17</sup> Shih, Greta Jani, *Dukuritë gjuhësore përmes tekstit letrar*, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës. në Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë. *Buletini shkencor*, Numër 3, Vëllimi 1, 2015. ISSN 2310-6719), f. 284.

<sup>18</sup> Shih syllabusin *Bazat e metodologjisë së mësimeve në muzikë*. (chrome-extension: //efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://old.uni-prizren.com/repository/docs/ Formular\_p%C3%ABr\_SYLL ABUS\_t%C3%AB\_L%C3%ABnd%C3%ABs\_se\_muzikes\_per\_nivelin\_parafi\_llor\_145243.pdf)

ndërkaq parashihet që nxënësit të mësojnë bashkërisht numëroret dhe fjalëshpejtat<sup>19</sup>.

Ndërkohë që në shkollat dhe universitetet tona fjalëshpejtat ende trajtohen si çështje formale, në studimet bashkëkohore ato janë kthyer në përvoja dhe teknika të mësimdhënies së gjuhës angleze për të huajt. Në përvojë me interes sjellin profesorët e një Universiteti në Indonezi: Fatchul Mu'in, Rosyi Amrina dhe Rizky Amelia, të cilët eksperimentuan me mundësinë e të nxënët të gjuhës angleze përmes dy formave: përsëritjes dhe përdredhjes së gjuhës (fjalëshpejtave). Ata erdhën në përfundim se të mësuarit përmes fjalëshpejtave dhe përsëritjes nuk kishin shumë dallime domethënëse, por modeli i të mësuarit përmes fjalëshpejtave sillte më shumë hare, motivim dhe përparësi në të shqiptuarit e anglishtes<sup>20</sup>.

Në kuadër të rezultateve jo të shumta, por me interes, në këtë rrjedhë do theksuar kërkimin e Carolyn E. Wilshire nga Universiteti i Kembrixhit, në temën *Paradigma "Tongue Twister (përdredhja e gjuhës)" si një teknikë për studimin e kodimit fonologjik*, në të cilën "duke përdorur një variacion të detyrës që minimizon ngarkesën artikuluese", prej së cilës ai arriti të nxirrte përqindje të mira të gabimeve në dukje "të pastra" dhe të paraartikuluara<sup>21</sup>.

### Sprova e Profesor Gjovalin Shkurtajt

Prej studimeve a paraqitjes së tyre diturake, shkrimin më të zgjeruar në veprat e tij e ka sjellë Profesor Gjovalin Shkurtajt, në tekstin e tij universitar *Shqipja e sotme*<sup>22</sup>, i cili fjalëshpejtat i ka përfshirë brenda ligjëratave të tij për stilet e shqiptimit, për diksionin dhe si ushtrime për të shkathtësuar e ngulitur drejtshqiptimin, por edhe si defekt i të folurit shpejt, frymëmarrjes, frymënxjerrjes, pushimit, mënyrave të frymëmarrjes, zërit, cilësisë së tij, ritmit të të folurit, si dhe theksimit (theksit të fjalës dhe theksit logjik).

Në fillim të ligjërimit të tij, - Profesor Shkurtajt, - sjell një përkufizim të karakterit historik dhe të zbatimit të fjalëshpejtave. Për Profesor Shkurtajn fjalëshpejtat janë në funksion të ushtrimit të shqiptimit të saktë dhe të zhdërvjelltësisë së aparatit të të folurit, "të cilat me sa duket janë përdorur qysh në kohët më të hershme si mjet për zbavitjen e të vegjëlve,

<sup>19</sup> Shih Programin e lëndës së *Muzikës* nga Ministria e Arsimit e Republikës së Maqedonisë Veriore).chrome-extension: // efaidnbmnnnib pcajpcglcl efindmkaj/https:// www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020 /09/ Skrat ena\_programa-Muzichko\_obrazovanie-VI\_odd-alb-2020.pdf)

<sup>20</sup> Mu'in, Fatchul, Rosyi Amrina & Rizky Amelia, *Tongue Twister, Students' Pronunciation Ability, and Learning Styles*, Arab World English Journal (AWEJ) Volume. 8 Number. 4 December 2017 Pp. 365-383. DOI: <https://dx.doi.org/10.24093/awej/vol8no4.25>

<sup>21</sup> Shih, Wilshire, Carolyn, E., *The "Tongue Twister" Paradigm as a Technique for Studying Phonological Encoding*, "Language and speech", 1999, 42 (1), 57-82.

<sup>22</sup> Gjovalin shkurtajt, *Shqipja e sotme*, - *Kulturë e të shkruarit dhe e të folurit*, (Për studentë dhe pasuniversitarë të degëve gazetari, gjuhë, letërsi dhe mësuesi), Shtëpia botuese Universitare U.F.O. Press, Tiranë, 2010, f. 60.

po njëherazi edhe si ushtrime që *zgjidhin gjuhën*. Në italisht quhen pikërisht ashtu: *gjuhëzgjdhëse*<sup>23</sup>.

Pasi sjell një listë të gjerë të fjalëshpejtave, si: *Rrota rrotullohet rreth karrocës. Rreth karrocës rrotullohet rrota; Plasi plepi e doli pleshti. Doli pleshti se plasi plepi; Coli ngacmon cucat. Cucat ngacmoi Coli. Coli luan me cucat. Cucat luajnë me Colin; Ceni nga Hyseni, si Kini nga Jakini, si Cani nga Hasani, si Leci nga Koleci; Çeço Çani çoi çajnikun në çajtore për çaj; Çelësi çel e ngel. Ngel çelësi se çelësi s'çel; Dini donte dorën e Dritës. Drita druhej prej dorës së Drinit; Fran Filani prej Fani, ia fali fishekun Faik Fistekut; Fatmir Fiku prej Rrasfiku hëngri fiq e vdiq, piu dhallë e u ngjall; Gargulli i madh e gargulli i vogël gurgullon; Kroi i madh e kroi i vogël gurgullonin; Gargulli gurgullon, uji gurgullon; Gjin Ukgjini, i biri i Ukgjin Gjinit, prej Dukagjinit, gjeti gjënë e gjallë te Gurrat e Shëngjinit; Hysniu hyri në hanin e Halimit. Hani i Halimit është Hani i Hasjanëve; Hasjanët hynë në Han të Halimit, etj., Profesor Gjovalin Shkurtaçaj e përmbyll mendimin tij hyrës mbi fjalëshpejtat me udhëzimin se: "Fjalëshpejta për ushtrim të foluri ka pasur dhe ka mjaft, por ato edhe mund të sajohen sipas nevojës që i del secilit për të mënjanuar të metat shqiptimore"<sup>24</sup>. E kjo do të thotë se gjuha shqipe ka aftësi të veçanta për formimin e fjalëshpejtave. Prej shpjegimeve që japin tekstet e hershme të shqipes dhe prej shpjegimeve që kanë dy fjalorët e fundit, nuk mund të thuhet se i përmbushin të gjithë përbërësit historikë, dialektorë, fonetikë, morfologjikë e sintaksorë, semantikë e artistikë të përkufizimit të fjalëshpejtave. Për tejkalinin e dobësive të artikulimit të nyjëtimeve zanoreve dhe sidomos bashkëtingëlloreve, kërkohet të kihen parasysh disa dobësi të mënyrës së komunikimit si dhe të tejkalohen ato qoftë me kujdes të shtuar, qoftë me ushtrime logjike. Për tejkalinin e këtyre sfidave, Profesor Gjovalin Shkurtaçaj, jep tri udhëzime:*

Së pari, folësi që vuan nga e meta e të folurit shpejt, duhet t'i japë rëndësi të folurit logjik, analizës logjike e të gjithanshme të domethënies, të rrokë plotësisht kuptimin e asaj që do të thotë, para se të fillojë të flasë. Kjo e bën atë më të përmbajtur, e disiplinon dhe e shtrëngon të ketë kujdes për fjalën, e ndihmon folësin ta theksojë dhe ta nxjerrë në pah domethënien e fjalës, të mëtojë që gjithmonë fjala të shkojë krahas me kuptimin, me idenë, me mendimin që shpreh. Vetëm kështu folësi do të mbërrijë të shqiptojë qartë, t'i nxjerrë fjalët në kohën e duhur dhe në lidhje të plotë me kuptimin e tyre, pa lejuar që ato t'ia zënë hapësirën njëra-tjetrës. Jo më kot thuhet se qartësia e fjalës shpreh qartësinë e mendimit. Të nxitohesh në të folur, duke mos iu bindur mendimit, është njësoj si të nisesh për udhë e të vraposh pa e ditur se për ku je nisur.

Së dyti, folësit që kanë vesin e të folurit shpejt, duhet të kenë parasysh mirë se me kë flasin, të kenë marrëdhënie të drejta me bashkëfolësit ose me auditorin përkatës. Parimi teorik edhe këtu është një

<sup>23</sup> Gjovalin Shkurtaçaj, *Po aty, f. 60*.

<sup>24</sup> *Po aty, f. 60*.

dhe vetëm një: kush flet, me kë, ku, kur, për çfarë, prej nga del në plan të parë që folësi të dijë dhe të marre kurdoherë parasysh se a e kuptojnë njerëzit të cilëve u drejtohet ai. Sado i madh të jetë intensiteti i veprimit dhe i përmbajtjes së asaj që duam të shprehim, gjithnjë duhet pasur parasysh jo vetja, jo folësi, por ata që dëgjojnë, ata të cilëve u drejtohem me fjalën tonë.

Së treti, ka rëndësi të madhe që folësi të ketë përfytyrime të qarta e të gjalla për atë që thotë, prandaj si ushtrime, veç të tjerash, mund të vlejné edhe tregimet, fabulat etj. Puna me fjalëshpejtat për folësit që kanë defektin e të folurit shpejt duhet të lë mënjanë përsheptimin e ritmit të shqiptimit dhe të përmbahet kryesisht në nyjëtimin e saktë të çdo tingulli të tyre, duke e lënë mënjanë përsheptimin e ritmit të shqiptimit”.

Në kontekst të shembujve të artikulimit të gjuhës në skenë dhe në film, Profesor Gjovalin Shkurtaç sjell shembullin gati “proverbial në qarqet teatrore, nxitimi i njërit prej aktorëve të shquar të skenës shqiptare, Sandër Prosi, në fillimet e karrierës së tij, i cili, në një rast, nga nxitimi, fjalinë “Hidh parullën e kalo!” e shqiptoi nxitimthi e krejt pa kuptim: “Hidh karullën e palo!”<sup>25</sup>

### **Pesë përkufizime përgjithësuese për fjalëshpejtat**

1. Fjalëshpejtat janë forma të shqiptimit me nyjëtime të veçanta, të cilat kanë ndikim të madh në ushtrimin e shqiptimit të zanoreve dhe sidomos të bashkëtingëlloreve të caktuara, shqiptimi i të cilave e ndihmon ndjeshëm përmirësimin e komunikimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Studuesit e gjuhësisë së zbatuar tek fëmijët, fjalëshpejtat i kanë përdorur kryesisht për lojëra zbavitëse. Ato i kanë përdorur që në kohërat më të hershme për ushtrimin e shqiptimit të saktë po edhe për zhdërvjelltësinë e aparatit të të folurit. Ata kanë vënë re se fjalëshpejtat përdoren kryesisht për zbavitjen e të vegjëlve, si ushtrime që “zgjidhin gjuhën”. Fjalëshpejtat gjuhën e fëmijëve, këngëtarëve dhe artistëve e bëjnë më të shpejtë e më të shkathët<sup>26</sup>. Tash së fundi më duket shumë i thellë një studim me titull *Brain imaging of tongue-twister sentence comprehension: Twisting the tongue and the brain*, i një grupit studiuesish, i cili synim ka krijimin e imazheve brenda trurit, ndërkohë që një grup i zgjedhur i lexuesve artikulojnë në heshtje disa tekste me nyjëtim të ndryshëm fillestar, të mesëm apo përfundimtar. Studimi dëshmon veç tjerash edhe për rëndësinë që kanë fjalëshpejtat në fushë të neorologjisë<sup>27</sup>. Në një studim që ka bërë studiuesit Sieb Nooteboom & Hugo Quené, kanë konstatuar se bashkëtingëlloret në fillimet e fjalëve janë më të shpeshta se të tjerat. Gjithashtu bashkëtingëlloret

<sup>25</sup> Gjovalin Shkurtaç, Vep. e cit., f. 62-63.

<sup>26</sup> Shih, ([https://www.facebook.com/keshilluesigjuhesor/posts\\_/390666\\_6142727251/](https://www.facebook.com/keshilluesigjuhesor/posts_/390666_6142727251/))

<sup>27</sup> Timothy A. Keller, Patricia A. Carpenter, and Marcel Adam Just. *Brain imaging of tongue-twister sentence comprehension: Twisting the tongue and the brain*. *Brain and Language* 84 (2003) 189-203.

përfshihen më shumë në gabimet ndërvepruese të të folurit(...). Në eksperimentet e tyre për fjalëshpejtat ata erdhën te një përfundim, sipas të cilit (a) fjalët në kontekstin e afërt të njëra-tjetrës prodhojnë më shumë gabime ndërvepruese nëse fjalët ndajnë modelet e tyre të stresit sesa nëse nuk e bëjnë<sup>28</sup>. Do theksuar se edhe në gjuhën shqipe, si edhe në gjuhën angleze për të cilën është realizuar eksperimenti, gabimet më së shpeshti ndodhin kur fjala përmbillet, bie fjala me buzoren *p* dhe fjala tjetër fillon me buzoren *b*, dhëmboret: *th/dh*; dhëmboret: *t/d*; dhëmbore/alveolare: *th/s*; paraqellzore/aveolare: *sh/s* etj.

2. Fjalëshpejtat janë forma të ushtrimit të shqiptimit të fjalëve, togfjalëshave, fjalive e teksteve të një fabule të tërë, të artistëve e këngëtarëve për të ofruar para publikut pamje sa më të përafërta me personazhe të caktuara bashkëkohore apo historike.

Gjatë kërkimeve në teren kam vënë re mundësi të mëdha të krijimeve tekstore në gjuhën shqipe: *Pardje para pijetores "Pepsi" pesë pijaneca po pinin pije pa pare. Plaku i pijetores "Pepsi" pyeti pesë pijanecat pse pini pije pa pare. Pesë pijanecat përgjigjen, përditë pimë pije pa pare. Plaku pijetores "Pepsi" paraqet problemin në polici. Pas pak paraqiten policia pyetin plakun përsëri, plaku paraqet problemin polici. Plaku përgjigjet, po pesë pijaneca po pinë pije pa pare. Policia pyesin pesë pijanecat pse po pini pije pa pare n'pjetoren "Pepsi". Pesë pijanecat përgjigjen përnjëherë përditë pimë pije n'pjetore "Pepsi" pa pare. Plaku përzemërohet plas pijet për patosi. Policia përplas plakun për pasqyre. Plakut prej pasqyre plasin puqrrat... Pranoni përshëndetje përzemërta prej Petritit Prishtinës...*

3. Fjalëshpejtat janë jo vetëm ushtrime për të shqiptuar apo artikulluar trajta historike, dialektore, fonetike, morfologjike e sintaksore po edhe mënyrë e ushtrimit të kujtesës, përkatësisht mbamendjes për artistë dhe oratorë, të cilët përgatiten për shfaqje teatrore, filma apo fjalime historike.

Mbështetur në përvojat historike të përdorimit të saj, linguistët janë kujdesur ta diskutojnë edhe etimologjinë e mundshme të saj. Nëse prejardhja e saj në tekstet leksikografike shfaqet së pari nga mesi i shekullit të 14-të, me kuptimin: *shtysë*, "të nxisë në veprim, të nxit", nga latinishtja *promptus*, paskajorja e promere "për të sjellë përpara", nga *pro* "përpara" (nga rrënja PIE \*per- (1) "përpara") + emër "për të marrë" (nga rrënja PIE \*em- "për të marrë, shpërndarë"). Kuptimi i saj i parë del "*stërvit* (dikë), *ndihmoj* (një nxënës ose folës) duke sugjeruar diçka të harruar ose të mësuar ose të njohur në mënyrë të papërsosur". Fjalëshpejtat thuhet në studimet leksikografike shfaqen nga fillimi i shekullit të XV-të, veçanërisht në kuptimin teatror të shekullit XVII "të ndihmohet një folës me rreshta"

<sup>28</sup> Shih, Nooteboom, Sieb & Hugo Quené, *Word-onsets and stress patterns: speech errors in a tongue-twister experiment, chrome-extension* [://www.siebnooteboom.nl/file\\_s\\_pdf/ICPhS2015\\_WorfdOnsetAndStress\\_Patterns.pdf](https://efaidnbmnnnibpajpcglclefindmkaj/https://www.siebnooteboom.nl/file_s_pdf/ICPhS2015_WorfdOnsetAndStress_Patterns.pdf)

(1670)<sup>29</sup>. Në qoftë se fjalëshpejtat janë instrumenti më i mirë ushtrimit të oratorisë<sup>30</sup> atëherë mund të thuhet se fjalëshpejtat janë të një moshe me shkallën e vetëdijes së njeriut për një komunikim më të lartë, në raport me komunikimin normativ.

Mosha e përdorimit të fjalëshpejtave në gjuhën shqipe ndërlihet jo vetëm me numrin e madh të fjalëshpejtave me motive rurale, po edhe me përmbajtjen figurative e etnografike të saj: Le të sjellim disa shembuj, të *fjalëshpejtave lakonike*: A erdh s'erdh, pse s'erdh, pse erdh, po mos të ardhke, patë me ardh, po erdh, s'erdh; Dikur deshta dikë, por asnjëherë si dikur dikë; Hangra thana, bana thana, bana sherrin sa sana; Ky që shtrihet në këtë varr, s'hante bar, se s'qe gomar, porse vdiq se s'gjeti bar; Mollë dhe, dhe mollë more, mollë more se dhe mollë.

Treguesit e tyre kanë edhe shpjegimin e tyre. Le të sjellim domethënien e fjalëshpejtës *A erdh s'erdh, pse s'erdh, pse erdh, po mos të ardhke, patë me ardh, po erdh, s'erdh*.

Nëna e kishte dërguar djalin ta merrte motrën e martuar në një vend të largët. Burri i motrës gjithashtu punonte në një vend të largët. Ditën që vëllai shkoi ta merrte motrën në shtëpi u kthye edhe burri i saj. Vëllai kthehet në shtëpi, në të cilën kishte mysafirë. Nëna e pyeti të birin në formë lakonike:

- A erdh?
- Nuk erdh, - përgjigjet i biri.
- Pse nuk erdh? - e pyet nëna.
- Pse erdh!, - përgjigjet i biri.
- Mos me pas ardhë?, - vazhdon nëna.
- Kish ardhë, - thotë i biri.
- Meqë paska ardhë dhëndri, - thotë nëna.
- Nuk erdh motra, - thotë i biri.

Shpresoj që studiuesit në të ardhmen të gjejnë tek fjalitë: fjalëshpejta, edhe elemente të strukturave indoeuropiane, të cilat vështirë gjenden në tekstet e hershme, qofshin ato edhe tekste të fillimit të mileniumit të dytë.

4. Fjalëshpejtat janë forma të shprehjes semantike, përmes së cilave shkrimtarët kanë realizuar struktura përmbajtjesore, stilistike dhe estetike të krijimeve të tyre artistike. Shembulli më brilant është shkrimtari Lasgush Poradeci. Në poezinë *Gjeniu i anijes* shkrimtari i shquar Lasgush Poradeci, i njohur për përdorimin e pasur të strukturave leksikore në krijimtarisë së tij, ka shfrytëzuar pikërisht modelin e fjalëshpejtave për të sjellë jo vetëm përmbajtje motivuese po edhe artistike. Vargu:...*Me **krismë-e me prush prej stër**k**alash***, mund të konsiderohet varg me nyjëtim kundërvënës **KR X RK** ndërmjet mbylltores së shurdhët K dhe dridhëses R, po edhe bashkim i dy përbërësve krs+sh (krismë+prush) = stërk+sh

<sup>29</sup> [https://translate.google.com\\*per-PIE=translate](https://translate.google.com*per-PIE=translate)

<sup>30</sup> Për rrolin e fjalëshpejtave në përmirësimin e komunikimit, shih udhëzuesin: *Disa këshilla praktike që do t'iu ndihmojnë të jeni një debatues i mirë*. (<https://news-31.com/lifestyle/disakëshilla-praktike-qe-do-tiu-ndihmojne-te-jeni-nje-debatues-i-mire-i26055>)

(stërkalash) // Vargu: *Hepohem... anohem... humbohem...* mund të konsiderohet fjalëshpejtë me nyjetim në shtegoren e pazëshme H, e cila në fjalën e parë është nistore dhe përmbyllëse, ndërsa në të dytën dhe të tretën vetëm përmbyllëse. Një shembull brilant i krijimit të poezisë për fëmijë duke shfrytëzuar fjalëshpejtat është vjersha “Are are abetare”. Në këtë rrjedhë artikulimi verbal i folësit shquhet përtej metagjuhës, për ne, në interes të funksionit poetik të tekstit, ku mbizotërojnë, shumë lloje lojërash dhe humori verbal, formimi i shkurtesave, fonemat në majë të gjuhës, diskursi dialektor ose variete, drejtshkrimi dialektor, enigmat gjuhësore të të gjitha llojeve, frazeologjizmat popullore, etj<sup>31</sup>.

5. Fjalëshpejtat në gjuhën shqipe janë struktura gjuhësore të cilat mund të krahasohen edhe me gjuhë të tjera. Mundësitë e gjuhës shqipe që të krahasohen me gjuhë të tjera edhe në këtë rrafsh, dëshmojnë edhe njëherë për bashkëjetesën e saj me familjen e madhe të gjuhëve indoeuropiane. Studiuesit e gjuhësisë së krahasuar kanë ardhur në përfundim se “fjalëshpejtat mund t’i thuash në të paktën tri gjuhë të ndryshme, pak a shumë saktësisht brenda një minute? Fjalëshpejtat janë të ndërlikuara në një gjuhë, por tri ose më shumë sigurisht që nuk janë të porealizueshme!

P.sh.: *Kali kalon kanalin, këmbët e kalit kërcasin kërc kërc kur kalon kanalin.* (The horse passes the ditch the horses feet go kërc kërc when he passes the ditch); *Kupa me kapak, kupa pa kapak.* (A cup with a lid, a cup without a lid).

### Sprovë për një tipologji

Parë në tërësinë e tyre fjalëshpejtat mund të ndahen sipas karakterit të prejardhjes së tyre sociale, sipas përmbajtjes, sipas nyjetimit të tyre fonetik, morfologjik, sipas përbërjes filozofike dhe sidomos fjalëshpejtave tipike për ushtrime, të cilat në parim përmbledhin pothuajse tërësinë e plotë të tyre. Mbi disa nga këto parime, po e bëjmë më tej edhe klasifikimin e tyre edhe në nënndarje të tjera më të ngushta:

#### 1. Fjalëshpejtat sipas prejardhjes sociale

<sup>31</sup> Vitaly Moshin, ka sjellë një listë shembujsh të kësaj natyre në gjuhën angleze, por pa ndonjë studim hyrës apo koment: *[i:]* Some people reason that «seeing is believing». They feel that they are frequently deceived; *[i]* Bill saw a big pickerel swimming in the ripples. He licked his lips in anticipation of a delicious fish dinner; *[e]* Several veteran members of the senate expressed displeasure. Special legislation to regulate the selling of eggs was not necessary, they said; *[æ]* Sally banged the black packard into a taxicab. It was badly daamaged by the crash; *[ʌ]* I am unable to understand my uncle Gus. He mutters and mumbles about nothing; *[a:]* John started across the yard toward the barn. His father remarked calmly that he’d better not wander too far; *[:]* Is Shaw the author of «Walking on the Lawn»? I thought it was Walter Hill; *[u]* Captain Hook pushed through the bushes to the brook. From where he stood it looked like an ambush; *[u:]* As a rule we canoeing in the forenoon. The pool is too cool in June; *[ju:]* Hugh refused to join the musicians’ union. His excuse was viewed with amusement; *[ou]* Don’t go home alone in the snow. You’ll be cold and soaked and half frozen. ([https://www.academia.edu/6426444/Tongue\\_twisters?sm=b](https://www.academia.edu/6426444/Tongue_twisters?sm=b). Më 6.8.2024).

*Fjalëshpejta rurale:* A guxon me sha ti kur t'vjen Reshati me shati t'vet i shtati prej fshati?; A la kun lis era, a s'la kun lis era: Arën e shes, thesin se shes; As te Hyka as te Huma, në mes Drinit te dy cunga; Bagëtitë blegërojnë bregut t'bjeshkës; Musha koshin molla Mamushe; Mushi Sheqa koshin boça.

*Fjalëshpejta fjalë e urtë:* Besnik bëhu besë mos nxi; Dhe gur gur behet mur; Gurë gurë bëhet kalaja, fjalë fjalë bëhet hataja.

*Fjalëshpejta bisedore:* Qerimi çliroi ç'do çerdhe çetnike; Doni donte dorën e Donës, Dona druhej prej dorës së Edonit.

*Fjalëshpejta rrotull:* E hëna e pyeti te marten që ta dëgjonte e mërkura se a e dinte e ejta se e premtja i kishte thënë të shtunës se e diela është pushim; Ky që shtrihet në këtë varr, s'hante bar, se s'qe gomar, porse vdiq se s'gjeti bar; Po ta them se po s'ta thash, do t'më thuash pse s'ma the.

*Fjalëshpejta me artikulum përmbyllës:* Erdhi Niku dhe siç erdhi iku; Erë në terr therrë në ferr; Fjalët si Demushi, punët si kërkushi; Iriq te thana, iriq te sana; Palli Lara në male t'ralla; Pushkët me teneqe, burrat pa musteqe; Shko e eja si Adem Peja.

*Fjalëshpejta slleng:* Gjali i Gjilanit n'gjyn gjath me gjishta!

*Fjalëshpejta popullore apo e përshtatur:* Kush s'ka kokë ka këmbë! Hajrullah te shpija, lopë nëpër bija; Kadal Beg se ka hendek; Ku rafsha mos u vrafsha, mos u vrafsha ku rafsha; Lufton vendi, se s'lufton Kelmendi; Pak thumba pak patkoj; Prej beteri del Skënderi; Punë për Selimin ka e qet timin; Qëndrimi qanë Qëndresa qeshë, qeni e bubu han përshesh; Qysh të jetë mbreti, qashtu edhe mileti; Shko e eja si Adem Peja; Tap lekun, tap burekun.

*Fjalëshpejta fjalë e huaj:* Pastaj, piano, piano, përgatitën procedurën për prokurori! Sabër Selamet.

*Fjalëshpejta fabulë:* Kur Kastriot Krasniqi kalonte katundin, këndonte këngë kreshnike, krejt katundi kumbonte, krahas kësaj knusat kikirikojshin ki-ki-ki-ki! Katundarë kënaqeshin, kurse Kushtrim Kumanova kulloste kingjat kaçubave karshi. Korabi kishte katër kalama, katërmbëdhjetë kojshi katërdhjetë kushëri. Korabi krejt kohën kulloste kingjat kopshteve ku kishte kastraveca, kunguj, kumbulla. Kingjat kullotshin kodrës, kërcenin kecat, katundarët kositshin kurse Korabi kujtonte kohën kur kishte kombaja, kerre. Kenan Kastrati kushërinë Korabit këndon kushedisa.

Pesë politikanë po pinin pije pa pare pranë picerisë "Patriotët", politikanët piskatshin pa pa pa pa...politikanët me pare t'popullit plot, po pa pagu pijet. Pas pak pronarja e picerisë "Patriotët" Puhija, pyeti politikanët pisa, pse po pini pa pare? Puhija përplasi patlixhonin për politikanin pllapp... pastaj politikani pickoj Puhinë. Puhija policiaaaa policiaaaa. Policia: Pronto, pronto!. Puhija paja paja, problemo problemo. Pas pak pasoi patrulla e policisë piu piu piu piu. Policët patën pendreka, pushkët plot plumba, policët patën patika puma, palltot pa pulla plus pantollat pa patenta. Policët pyetën politikanët pse po pini pa pare? Politikani pështyu policin, pastaj polici përplasi politikanin për pasqyre. Puçrrat i pëlçitën politikanit për pasqyre përrrrrrr. Puhija piskatke PDK

PDK PDK...

*Fjalëshpejta këngë:* Lariçka me therra na ka ardh te dera, lariçka me lara na ka dal përpara. (Fragment i një kënge dasme)

*Fjalëshpejta lojë:* Pa i fol s'um foli, pa m'fol si foli, po pres mem fol pa i fol; Pak ata pak na, ma shumë ata se na; Qypin me musht e dhashë, qypin me mjaltë e lashë, qypin me mjaltë e hëngra, qypin me musht e lashë; Ra plaka prej plepi plaf pluf i plasi plonci; Shita thes e bleva thes, thesi thes se thes; Udhëtari hypi ne tren. Vjen kundukteri e i thotë: Zotri biletën. Ai nxjerr kuletën hap kuletën, nxjerr lekun, blen biletën, merr biletën hap kuletën, fut biletën mbyll kuletën; Unë e di që ti e di, po se bën sikur se di, atë që unë e di që ti e di; Vajza vështroi vendin vrullshëm, vërejtji vetëm vetveten, vetmia ja vrau vetëbesimin dhe e vrau veten; Veja e vogël vlon në vegsh të vogël, në vegsh të vogël vlon veja e vogël; Vër veshin e vë re, Vera Vitës i vë fre.

## 2. Fjalëshpejta sipas përmbajtjes

*Fjalëshpejta rurale:* A guxon me sha ti kur t'vjen Reshati me shati t'vet i shtati prej fshati?; A la kun lis era, a s'la kun lis era; Arën e shes, thesin se shes; As te Hyka as te Huma, në mes Drinit te dy cunga; Bagëtitë blegrojnë bregut t'bjeshkës; Musha koshin molla Mamushe; Mushi Sheqa koshin boqa.

*Fjalëshpejta fjalë e urtë:* Besnik bëhu besë mos nxi; Dhe gur gur behet mur; Gurë gurë bëhet kalaja, fjalë fjalë bëhet hataja.

*Fjalëshpejta filozofike:* Bota e hiçit, për hiçin rrotullohet rreth qëllimit të hiçit. (Nga romani i Sterio Spasses, *Nga jeta në jetë, Pse?!*)

*Fjalëshpejta shpjeguese:* Katrorët kanë katër kënde.

*Fjalëshpejta formulë:* Dy pata plus dy pata që i pata, sa pata pata?; Çelsi çel e ngel, ngel çelësi se çelësi s'çel;

*Fjalëshpejta dialog:* Pa pare? - Pyeti plaku. Po, pa pare, pjanecat pinë pa pare. -Përgjigjet pjaneci parë. Plaku prapë përzuri pjanecat përjashtë. Të poshtër po pini pa pare. Pra plaku prapë përzuri pjanecat përjashta. Përralla përfundon, pikë; Tringë, - triumfoi trimëria e tre trimoshave; U qum, a u qut ju? -Edhe na u qum. Pse ju çka pat që u qut kaq herët?

*Fjalëshpejta parullë:* Ne dimë duam dhe ia dalim.

*Fjalëshpejta kundërvënëse:* Ramush aga shumar, shumar aga Ramush.

## 3. Fjalëshpejta sipas 'nyjëtimit' fonetik

*Fjalëshpejta me 'nyjëtim' fillestar:* Artikuluesi artikulon artikujt.

*Fjalëshpejta me 'nyjëtim' përmbyllës:* Erdhi Niku dhe siç erdhi iku; Erë në terr therrë në ferr; Fjalët si Demushi, punët si kërkushi; Iriq te thana, iriq te sana; Palli Lara në male t'rralla; Pushkët me teneqe, burrat pa musteqe; Shko e eja si Adem Peja.

*Fjalëshpejta kundërvënëse:* Fiq hiq, hiq fiq; Llula, pulla, pulla, llulla; Tenxherja me kapak, tenxherja pa kapak, tenxherja pa kapak, tenxherja me kapak.

*Fjalëshpejta përsëritëse:* Kam ni ka ndasha e shes ndasha e ha; Vera ikte vjeshta vinte, vera vjeshtën se arrinte.

*Fjalëshpejta me nyjëtim dhëmbor:* Një thesaxhi që shet thes, del në shesh e nuk shet thes, o ti thesaxhi që del në shesh e thes nuk shet, a s'ma shet mua një thes?

*Fjalëshpejta me 'nyjëtim' të mesëm:* Ra sorra n'zallë, e bani zallin t'rrallë.

*Fjalëshpejta me 'nyjëtim' fundor:* Shkon Pejani, shkon Dardani; Shita thes e bleva thes, thesi thes se thes.

*Fjalëshpejta e krahasuara me gjuhë të tjera:* Kali ka katër këmbë, këmbët e kalit kërcasin kur kali kalon kanalin. (*The horse has four legs, the horse's legs crack when the horse passes the canal*); Kupa me kapak, kupa pa kapak. (*A cup with a lid, a cup without a lid*).

#### 4. Fjalëshpejta sipas strukturës gramatikore

*Fjalëshpejta lidhëz:* As me sheher as me Barilevë; As te Hata, as te Fata, midis Drinit n'cunga t'thata.

*Fjalëshpejta folje:* Do dhe dhé, ai dha dhe ti dhé, dha ajo, dha edhe ai, dhe dhe ti, dhamë se dhe ti ke dhënë.

*Fjalëshpejta kundërvënëse:* Fiq hiq, hiq fiq; Llula, pulla, pulla, llulla; Tenxherja me kapak, tenxherja pa kapak, tenxherja pa kapak, tenxherja me kapak.

*Fjalëshpejta emër:* Fjalët i merr era, karaifilit i vjen era.

*Fjalëshpejta antonim:* Gargulli i madh e gargulli i vogël gurgullonin.

*Fjalëshpejta pseudonim:* Farma Filani prej Fani, ia fali fishekun Faik Fistekut; Shaip shakaxhia shet shaka shumë shtrenjtë, shtatë shilinga.

*Fjalëshpejta përemrore:* Kam, ke, ka, kemi, keni, kanë; Tha ai, m'tha ky, i thash atij, m'i than k'tij, që ai me t'than ty, që thiu po therret n'therrtore (Komunikimi paralel në dy vetat I, II dhe përmbyllja në vetën e tretë); Tha ai, m'tha ky, i thash atij, m'i thanë k'tij, që ai me t'thanë ty, që thiu po therret n'therrtore); Thimi tha: se më the e të thashë, janë si ma dhe e ta dhashë; Thuaj tha m'i thanë, a i ke thanë, thuaj tha i kam thanë m'i thanë.

*Fjalëshpejta 'neologjizmë':* Muristi muron murin; Një zhurmë e zhurmshe, një gocë deti; Qohu çikë qëndis çorapa qysh qëndisnin çikat qëlashti; Unë dëshiroj të dëshiroj dëshirën, që t'i dëshiron të dëshirosh.

*Fjalëshpejta antroponim:* O Asllan lule zambaku, bjeri me pëllëmba barkut; Petriti pëlciti petarden para policisë, policia pyeti Petritin pse Petrit pëlcite petarten para policisë? Petriti përgjigjet pelcita petarden para policisë për pavarësi; Plaku Pajaziti përplasi pesë persona për parketi, përjashta pisa. Pas pak paraqitet policia. Policia pyesin plakun: pse plak përplase pesë persona për parketi? Plaku përgjigjet: po pinin pa pare, polic.

Po pinin pa pare? Po, polic!; Valbona vuri në vig vetëm të veshurat e Viganit, veçse të veshurat e Viganit të veçohen nga të veshurat e Vlorës dhe Valdrinit.

*Fjalëshpejta toponim:* O Përmet, more Përmet, bukë pak e ujë det; Shaban Shabani shkoi në Shkodër shalqi me ble; Shaban Shkoza shkoj në Shkodër shalqi shiti; Shabani në Shalë sharron me sharrë; Shqiptarët shkuan n'Shqipëri; Shqyptari i Shqipërisë u shqua për shquarësi në Shangai; Artani aktroi me një aktor të Australisë; Artani arratiset atje n'Armeni.

*Fjalëshpejta me theks të veçantë dialektor:* Shaban Shala shkojke në sheher shitke shtalba. As me sheher as me Barilevë.

*Fjalëshpejta me 'nyjëtim' fjalën:* Shpëtimi shuton, Shpendi shpëton shytin afër shtyllës.

## 5. Fjalëshpejtat ushtrimore

*Fjalëshpejta rurale:* A guxon me sha ti kur t'vjen Reshati me shati vet i shtati prej fshati?; A la kun lis era, a s'la kun lis era: Aren e shes, thesin se shes; As te Hyka as te Huma, ne mes Drinit te dy cunga; Bagëtit blegrojnë bregut t'bjeshkës; Musha koshin boqa; Musha koshin molla Mamushe; Mushi Sheqa koshin boqa.

*Fjalëshpejta folje:* Do dhe dhé, ai dha dhe ti dhé, dha ajo, dha edhe ai, dhe dhe ti, dhamë se dhe ti ke dhënë.

*Fjalëshpejta formulë:* Dy pata plus dy pata qe i pata, sa pata pata?; Çelsi çel e ngel, ngel çelësi se çelësi s'çel.

*Fjalëshpejta rrotull:* E hëna e pyeti te marten që ta dëgjonte e mërkura se a e dinte e enjta se e premtja i kishte thënë të shtunes se e diela është pushim; Ky që shtrihet në këtë varr, s'hante bar, se s'qe gomar, porse vdiq se s'gjeti bar; Po ta them se po s'ta thash, do t'më thuash pse s'ma the; Hap çantën marr kuletën, mbyll çantën hap kuletën, marr lekët mbyll kuletën, jap lekët marr lekët hap kuletën, fus lekët mbyll kuletën, hap çantën fus kuletën mbyll çantën.

*Fjalëshpejta dialog:* Pa pare? - Pyeti plaku. Po, pa pare, pjanecat pinë pa pare. -Pergjigjet pjaneci parë. Plaku prapë përzuri pjanecat përjashtë. Të poshtër po pini pa pare. Pra plaku prapë përzuri pjanecat përjashtë. Përralla përfundon, pikë; Tringë, - triumfoi trimëria e tre trimoshave; U qum, a u qut ju? -Edhe na u qum. Pse ju çka pat që u qut kaq herët?

*Fjalëshpejta kundërvënëse:* Fiq hiq, hiq fiq; Llula, pulla, pulla, llulla; Tenxherja me kapak, tenxherja pa kapak, tenxherja pa kapak, tenxherja me kapak.

*Fjalëshpejta slleng:* Gjali i Gjilanit n'gjyn gjath me gjishta!

*Fjalëshpejta popullore apo të përshtatura:* Hajrullah te shpija, lopë nëpër bija; Kadal Beg se ka hendek; Ku rafsha mos u vrafsha, mos u vrafsha ku rafsha; Lufton vendi, se s'lufton Kelmendi; Pak thumba pak patkoj; Prej beteri del Skënderi; Punë për Selimin ka e qet timin; Qëndrimi qanë

Qëndresa qeshë, qeni e bubu han përsesh; Qysh të jetë mbreti, qashtu edhe mileti; Shko e eja si Adem Peja; Tap lekun, tap burekun.

*Fjalëshpejta përemrore:* Kam, ke, ka, kemi, keni, kanë; Tha ai, m'tha ky, i thash atij, m'i than k'tij, që ai me t'than ty, që thiu po therret n'therrore (Komunikimi paralel në dy vetat (I, II) dhe përmbyllja në vetën e tretë Tha ai, m'tha ky, i thash atij, m'i than k'tij, që ai me t'than ty, që thiu po therret n'therrore); Thimi tha: se më the e të thashë, janë si ma dhe e ta dhashë; Thuaj tha m'i thanë, a i ke thanë, thuaj tha i kam thanë m'i thanë.

*Fjalëshpejta 'neologjizmë':* Muristi muron murin; Një zhurmë e zhurmshe, një gocë deti; Qohu çikë qëndis çorapa qysh qëndisnin çikat qëlashti; Unë dëshiroj të dëshiroj dëshirën, që t'i dëshiron të dëshirosh.

*Fjalëshpejta me nyjëtim dhëmbor:* Një thesaxhi që shet thes, del në shesh e nuk shet thes, o ti thesaxhi që del në shesh e thes nuk shet, a s'ma shet mua një thes?

*Fjalëshpejta lojë:* Pa i fol s'um foli, pa m'fol si foli, po pres mem fol pa i fol; Pak ata pak na, ma shumë ata se na; Qypin me musht e dhashë, qypin me mjaltë e lashë, qypin me mjaltë e hëngra, qypin me musht e lashë; Ra plaka prej plepi plaf pluf i plasi plonci; Shita thes e bleva thes, thesi thes se thes; Udhëtari hypi ne tren. Vjen kundukteri e i thotë: Zotri biletën. Ai nxjerr kuletën hap kuletën, nxjerr lekun, blen biletën, merr biletën hap kuletën, fut biletën mbyll kuletën; Unë e di që ti e di, po se bën sikur se di, atë që unë e di që ti e di; Vajza vështroi vendin vrullshëm, vërejtje vetëm vetëvetën, vetmia ja vrau vetëbesimin dhe e vrau veten; Veja e vogël vlon në vegsh të vogël, në vegsh të vogël vlon veja e vogël; Vër veshin e vë re, Vera Vitës i vë fre.

*Fjalëshpejta me 'nyjëtim' fundor:* Shkon Pejani, shkon Dardani; Shita thes e bleva thes, thesi thes se thes.

## 6. Fjalëshpejta filozofike

*Fjalëshpejta rurale:* A guxon me sha ti kur t'vjen Reshati me shati vet i shtati prej fshati?; A la kun lis era, a s'la kun lis era: Arën e shes, thesin se shes; As te Hyka as te Huma, në mes Drinit te dy cunga; Bagëtitë blegërojnë bregut t'bjeshkës; Musha koshin molla Mamushe.

*Fjalëshpejta fjalë e urtë:* Besnik bëhu besë mos nxe; Dhe gur gur behet mur; Gur gur bëhet kalaja, fjalë fjalë bëhet hataja.

*Fjalëshpejta filozofike:* Bota e hiçit, për hiçin rrotullohet rreth qëllimit të hiçit. (Nga romani i Sterio Spasses, *Nga jeta në jetë Pse?!*)

*Fjalëshpejta folje:* Do dhe dhë, ai dha dhe ti dhë, dha ajo, dha edhe ai, dhe dhë ti, dhamë se dhe ti ke dhënë.

## Përfundime

Kjo vepër është prova e parë e kësaj natyre në gjuhësinë shqiptare. Materiali i vjelë shquhet edhe për paraqitjen e mentalitetit social në jetën shqiptare, jetën kulturore dhe trashëgiminë dialektore të folësit, ndërsa materiali i mbledhur në hapësirën urbane dhe në mjetet internetike,

dëshmon për praninë e tij në jetën kulturore të qytetit, për komunikimin rajonal e ndërkombëtar, në të vërtetë për europeizimin edhe të këtij lloji komunikimi.

Duke qenë se jemi në fillim të punës së një projekti të madh të *Fjalorit të gjuhës shqipe*, ne shpresojmë që fjalëshpejzat të përfshihen brenda tij më gjerësisht, ndërsa ndikim të rëndësishëm të kenë si material edhe në Fakultetin e Artit në Prishtinë, Tiranës e Tetovës.

Besoj që kjo vepër të kuptohet edhe si një shembull i angazhimit kolektiv të shumë individëve, studentëve dhe krijuesve për të mbledhur e ruajtur trashëgiminë gjuhësore e kombëtare. Fjala është për një pasuri të trashëgimisë gjuhësore, kulturore e artistike, të pidentifikuar më parë në Kosovë e Shqipëri, si dhe në trojet shqiptare gjithandej, madje duke përfshirë edhe diasporën.

## Literatura

Baliu, Begzad. *Leksiku historik i shqipes (1462-1954)*, I, Prishtinë. (Dorëshkrim)

*Bazat e metodologjisë së mësimdhënies në muzikë*. (chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj /https://old.uni-1

Brandreth, Gyles. *The biggest tongue twister book in the world / by Gyles Brandreth ; illustrations by Alex Chin*. New York : Sterling Pub. Co., ©1978. (6.8.2024)

Browne, Ann. *Developing Language and Literacy*, 3–8 London, 2001.

*Disa këshilla praktike që do t'iu ndihmojnë të jeni një debatues i mirë*. (<https://news-31.com/lifestyle/disa-keshilla-praktike-qe-do-tiu-ndihmojne-te-jeni-nje-debatues-i-mire-i26055>)

*English Tongue Twisters*, Përmbledhje ndërkombëtare. Tongue Twisters. www.uebersetzung.at/twister/en.htm © 1996-2013 Mr.Twister. (6.8.2024)

Flynn, Simon. 'Animal stories' in *Peter Hunt* (ed., second edition) International Companion Encyclopaedia of Children's Literature, Volume I London and New York, 2004.

Haddad, Robert J. *Mexican tongue twisters = Trabalenguas mexicanos*, mbledhur dhe përkthyer nga Shtypi Editorial Bilingüe, ©1989.

Hunt, Peter (ed.). *Children's Literature: An Illustrated History Oxford and New York*: Oxford University Press. (Chapter 7, Section on Animals' Lands.), 1995.

Jani, Greta. *Dukuritë gjuhësore përmes tekstit letrar*, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës. në Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë. *Buletini shkencor*, Numër 3, Vëllimi 1, 2015. ISSN 2310-6719), f. 284.

Kostallari, Androkli (red.). *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1980, f. 453; Jani Thomai (red.). *Fjalori i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2020, f. 160.

- MacKenzie, Munro M. D. *Modern English pronunciation practice*. London: Longman, 1973: 98.
- Mallett, Margaret & Foreword by Sue Palmer. *The Primary English ENCYCLOPEDIA*. The Heart of the Curriculum THIRD EDITION, This edition published 2008 by Routledge, p. 24-25 dhe 266.
- Morris, W. (ed.). *The American Heritage dictionary of the English language*. Boston: American Heritage Publishing Co., Inc. Motley, M. and Barrs, B. 1979.
- Mu'in, Fatchul, Rosyi Amrina & Rizky Amelia, *Tongue Twister, Students' Pronunciation Ability, and Learning Styles*, Arab World English Journal (AWEJ) Volume. 8 Number. 4 December 2017 Pp. 365-383. DOI: <https://dx.doi.org/10.24093/awej/vol8no4.25>
- Nikoliq, Davor. *Mali, sitni, jednostavni, govornički ili jednostavno – retorički: povijest naziva i koncepta usmenoretoričkih žanrova u hrvatskoj folkloristici*, in "Narodni umjetnost", nr. 52/2, 20215. Institut za etnologiju i folkloristiku, Zagreb, Croatia, f. 163-178.
- Nooteboom, Sieb & Hugo Quené, *Word-onsets and stress patterns: speech errors in a tongue-twister experiment*, chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfefindmkaj/https://www.siebnoteboom.nl/files/pdf/ICPhS2015\_WorfdOnsetAndStressPatterns.pdf
- Parkin, Ken *Antologjia e përdredhësve të gjuhës britanike*, 1969.
- Paul Chapman & Mallett, Margaret. *Young Researchers: Informational Reading and Writing in the Early and Primary Years* London: Routledge, 2001.
- Programin e lëndës së Muzikës nga Ministria e Arsimit të Republikikës së Maqedonisë Veriore).chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfefindmkaj /https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/Skratena\_programa-Muzichko\_obrazovanie-VI\_odd-alb-2020.pdf)
- Schourup, L. 1973. *Unique New York Unique New York Unique New York*, CLS 9. CLS. 587–96.
- Shkurtaç, Gjovalin. *Shqipja e sotme, - Kulturë e të shkruarit dhe e të foluri*, (Për studentë dhe pasuniversitarë të degëve gazetari, gjuhë, letërsi dhe mësuesi), Shtëpia botuese Universitare U:F:O: Press, Tiranë, 2010, f. 60-
- Townsend, John Rowe. *Written for Children London: The Bodley Head*. (Chapter 10, Articulate Animals.), (botimi i vitit 1995).
- Vviedenskiy, B. A. *Bolshaya sovetskaya entsiklopiya*. Moscow. State Scientific Publishers. 35, 1956: 253.
- Whitehead, Marian. *Language and Literacy in the Early Years* London: Paul Chapman (See Chapter 7), 2001.
- Wyse, Dominic & Jones, Russell *English, Language and Literacy* London: Routledge, 2007.

ISSN 2671-3004

UDC 811.18'27:314.15(100)

**Punim studimor**

**Izer MAKSUTI\***

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup

E-mail: izer.maksuti@unt.edu.mk

**MBI RËNDËSINË E RUAJTJES SË GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË:  
VËSHTRËSITË DHE MUNDËSITË - NË SHEMBULLIN E VENDEVE  
GJERMANISHTFOLËSE**

**ON THE IMPORTANCE OF LANGUAGE MAINTENANCE IN THE  
ALBANIAN DIASPORA: CHALLENGES AND OPPORTUNITIES – THE CASE  
OF GERMAN-SPEAKING COUNTRIES**

**Abstract**

Maintaining the Albanian language in the diaspora is crucial for the cultural identity and social cohesion of Albanian communities worldwide. Language serves not only as a means of communication but also as a carrier of traditions, values, and historical awareness. In times of increasing globalization and migration, Albanian diaspora communities face numerous challenges that hinder the maintenance and development of their language. One key factor is the integration into majority societies of host countries. This process can lead to a reduction in the use of the Albanian language in favor of the local language. Particularly in the second and third generations of the diaspora, the native language is often spoken and used scarcely or not at all. Additionally, educational systems rarely provide sufficient opportunities for maintaining the native language, and there is a lack of structured language programs for Albanian children and youth. In addition to social and educational aspects, technological developments also play a dual role. While social media and digital platforms provide new opportunities for cultivating and maintaining the language, they also facilitate faster influence from other languages, primarily English but also the host country's language, which affects the use of Albanian.

However, there are many initiatives that offer hope: Albanian schools, cultural associations, and diaspora networks actively contribute to the maintenance of the language. Likewise, projects and programs from countries of origin, such as

---

\* Prof. dr. Izer Maksuti, profesor në Fakultetin e Shkencave Humane, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup; izer.maksuti@unt.edu.mk. Studimet e larta dhe ata të doktoratës i ka mbaruar në Universitetin e Vjenës në fushë të gjuhësisë, gjermanistikës dhe translato-logjisë. Ka specializuar në fushë të sociolinguistikës dhe politikës gjuhësore.

Albania, Kosovo, and North Macedonia, support diaspora communities with educational offerings and cultural activities. These initiatives show that the Albanian language, even in exile, remains an important symbol of national and cultural identity. This article examines the challenges and opportunities of maintaining the Albanian language in the diaspora – The Case of German-Speaking Countries as an example. The aim is to highlight not only the obstacles but also concrete proposals for solutions, that can contribute to the maintenance of the Albanian language for future generations in the diaspora.

**Keywords:** Language maintenance, diaspora, migration and identity, language loss.

### **Abstrakti**

Gjuha nuk shërben vetëm si mjet komunikimi, por edhe si bartëse e traditave, vlerave dhe vetëdijes historike. Kujdesi për ruajtjen e gjuhës shqipe në diasporë është i rëndësishëm për identitetin kulturor dhe bashkimin shoqëror të komuniteteve shqiptare në mbarë botën. Në një kohë të globalizimit dhe migracionit në rritje, komunitetet shqiptare në diasporë përballen me sfida të shumta, që e vështirësojnë ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës së tyre. Një faktor kyç është integrimi në shoqëritë shumicë të vendeve pritëse. Ky proces mund të çojë në zvogëlimin e përdorimit të gjuhës shqipe në dobi të gjuhës vendase. Veçanërisht te brezat e dytë dhe të tretë të diasporës, gjuha amtare shpesh flitet dhe përdoret vetëm rrallë ose nuk përdoret fare. Të përmendim këtu edhe sistemet arsimore, që rrallëherë ofrojnë mundësi të mjaftueshme për ruajtjen e gjuhës amtare, si dhe mungesa e programeve të strukturuarra gjuhësore për fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë. Përveç aspekteve sociale dhe arsimore, zhvillimet teknologjike luajnë gjithashtu një rol të dyanshëm. Ndërsa mediat sociale dhe platformat digjitale ofrojnë mundësi të reja për kultivimin dhe ruajtjen e gjuhës, ata gjithashtu lehtësojnë ndikimin më të shpejtë nga gjuhët tjera, kryesisht të anglishtes, por edhe të vendit pritës, që ndikojnë në përdorimin e gjuhës shqipe. Megjithatë, ka edhe shumë nisma që japin shpresë: Shkollat shqipe, shoqatat kulturore dhe rrjetet e diasporës, kontribuojnë aktivisht në ruajtjen e gjuhës. Po ashtu, projektet dhe programet e shteteve të origjinës, si Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut mbështesin komunitetet e diasporës me oferta arsimore dhe aktivitete kulturore. Këto nisma tregojnë se gjuha shqipe, edhe në mërgim, mbetet një simbol i rëndësishëm për identitetin kombëtar dhe kulturor. Ky artikull shqyrton sfidat dhe mundësitë e ruajtjes së gjuhës shqipe në diasporë – në shembullin e vendeve gjermanishtfolëse. Qëllimi është që të përmenden jo vetëm vështirësitë, por edhe mundësitë konkrete për zgjidhje, që mund të kontribuojnë në ruajtjen e gjuhës shqipe, sot dhe te brezat e ardhshëm në diasporë.

**Fjalët kyçe:** Ruajtja e gjuhës, diaspora, migrimi dhe identiteti, humbja e gjuhës.

### **Hyrje**

Nga zhvillimet historike dimë se ndër arsyet kryesore, si të ruajtjes edhe të humbjes së gjuhës, janë faktorët socialë, politikë, ekonomikë, demografikë e psikologjikë. Mbrojtja e gjuhëve në botë, lufta kundër zhdukjes së tyre dhe ruajtja e identitetit të kombeve nëpërmjet gjuhës, mbeten sot e gjithë ditën tepër të rëndësishme. Për ruajtjen e gjuhës, sidomos në diasporë, duhet punuar në vazhdimësi, veçanërisht në mënyrë të institucionalizuar.

Ruajtja e gjuhës shqipe në diasporë është thelbësore për mbrojtjen e identitetit kulturor dhe kombëtar, si dhe fuqizimin e ndjenjës së përkatësisë së përbashkët. Ky punim, përpiket të trajtojë vështirësitë dhe mundësitë me të cilat përballen komunitetet shqiptare në vendet gjermanishtfolëse, për të ruajtur gjuhën e tyre ndër breza. Në këtë kuadër merren parasysh faktorët socialë, arsimorë dhe gjuhësorë që ndikojnë përdorimin e gjuhës. Në qendër të vëmendjes janë roli i familjes, institucioneve arsimore dhe mediave, të cilat mund të shihen si pengesë, por edhe si burim për vitalitetin gjuhësor. Në fund, paraqiten rekomandime për një politikë gjuhësore të qëndrueshme dhe masa praktike që mund të kontribuojnë në forcimin e gjuhës shqipe në vendet gjermanishtfolëse.

Ruajtja e gjuhës bazohet në një proces të vetëdijshëm, përmes të cilit një bashkësi gjuhësore e mëson, kultivon dhe e promovon gjuhën e tij ndër breza. Për komunitetet pakicë, brenda një vendi, dhe sidomos në diasporë, ky proces është jetësor, pasi gjuha nuk shërben vetëm si mjet komunikimi, por edhe si bartëse e historisë, traditës dhe identitetit kulturor e kombëtar. Në këtë punim jepet edhe një pasqyrë mbi rëndësinë e përparimit shkencor lidhur me ruajtjen e gjuhëve. Duam të rikujtojmë sesi faktorët e jashtëm, dominimi i një shoqërie shumicë apo qasja në arsim në gjuhën e vendit, mund të ndikojnë në përdorimin e gjuhës. Njëkohësisht, theksojmë rëndësinë e vazhdueshme të gjuhës shqipe për formësimin e identitetit të komuniteteve shqiptare në diasporë. Shqipja mbetet simboli kryesor, strumbullari i përkatësisë kombëtare dhe lidhjes kulturore, duke u mundësuar anëtarëve të diasporës të ruajnë rrënjët e tyre dhe të kultivojnë një identitet të përbashkët gjuhësor dhe kombëtar.

### **Termi “Ruajtja e gjuhës” dhe domethënia e tij**

Janë të shumta studimet për ruajtjen e gjuhës, sidomos disa nga vetë sajuesi i këtij termi “language maintenance”, Joshua Fishman.<sup>32</sup>

Termin “Ruajtja e gjuhës” e gjejmë edhe te “Leksioni i termave të sociolinguistikës”<sup>33</sup> ku përshkruhet si: “Përpyetje e koordinuar për të ruajtur një gjuhë, e cila është e rrezikuar dhe folëset e së cilës shfaqin prirje për ta këmbyer atë me një gjuhë tjetër. Prirja e njerëzve për ta braktisur gjuhën dhe për ta zëvendësuar atë me një gjuhë tjetër, e cila ka prestigj dhe është dominuese në një bashkësi të caktuar, ndodh nën tryshninë e faktorëve të ndryshëm socio-politikë e kulturorë. ...” (Ismajli, R. 2020:295). Ndër të tjera në këtë zë të këtij leksikoni, hartuar nga sociolinguisti Shkumbin Munishi, përmenden prirjet e braktisjes së gjuhës, si tryshnia nga denduria e kontaktit me gjuhë tjera, gjendja e vazhdueshme e dygjuhësisë, sidomos në rrethana të emigrimit, por edhe të pushtimit dhe

<sup>32</sup> Fishman Joshua A. 1964. “Language maintenance and language shift as a field of inquiry: A definition of the field and suggestions for its further development”. *Linguistics* 1964, Volume 2, issue 9, 32–70.

<sup>33</sup> Ismajli, Rexhep et al. 2020. “Leksikon i termave të sociolinguistikës”. Prishtinë: ASHAK.

kolonizimit, ku ushtrohet dominimi i një gjuhe. Aty radhiten dhe faktorët që kërkohen për ruajtjen e gjuhës, si shkalla e konsiderueshme e lojalitetit gjuhësor ndaj gjuhës amë, por edhe përpjekjet për ruajtjen e gjuhës përmes mësimi të gjuhës. Kontaktet me folës të gjuhës së njëjtë, krenaria për gjuhën e prejardhjes dhe për përkatësinë kombëtare, kultivimi i tyre në një bashkësi të përbashkët gjuhësore, vijnë si faktorë tjerë shtesë me shumë rëndësi për ruajtjen e gjuhës (Krh. Ismajli, R. 2020:296).

Termi „Ruajtja e gjuhës“ i referohet masave dhe përpjekjeve që ndërmerren për të ruajtur një gjuhë në formën e saj origjinale dhe për të nxitur e promovuar përdorimin e saj. Kjo përfshin mbrojtjen kundër ndërrimit, humbjes apo edhe zhdukjes së gjuhës, si dhe përkrahjen dhe inkurajimin e përdorimit të saj nga breza të ndryshëm, sidomos në kontekste ku gjuha është e kërcënuar ose e marginalizuar, siç është rasti në diasporë ose në shoqëri shumëgjuhëshe. Dihet se ruajtja e gjuhës është e lidhur ngushtë me ruajtjen e identitetit kulturor, kombëtar dhe të traditave të vendit të prejardhjes.

### **Çka ndërmerret sot për të ruajtur një gjuhë?**

Për ruajtjen e një gjuhe, sot ndërmerren masa të shumta në nivel shkencor, politik dhe shoqëror. Këto masa mund të ndahen në tri fusha kryesore: dokumentim dhe kërkim shkencor, nisma arsimore, si dhe mbështetje kulturore dhe institucionale.

Studiues të fushave ndërdisiplinore, në të shumtën e rasteve gjuhëtarët, përmes botimeve dhe fushatave të ndërgjegjësimit për gjendjen e një gjuhe, sesi mund të mbështetet dhe të ruhet, japin një ndihmesë vendimtare. Programet arsimore mbështesin ruajtjen e gjuhës përmes mësimdhënies dhe aktiviteteve kulturore. Këtu përfshihet mësimi i gjuhës amtare në diasporë ose kurse gjuhe për të rritur. Veçanërisht i rëndësishëm është integrimi i gjuhës në sistemin e rregullt arsimor, për të forcuar statusin e saj dhe për t'ua përcjellë brezave të rinj.

Ngjarjet kulturore, promovimi i kulturës dhe letërsisë, si dhe mediat, luajnë një rol kyç në ruajtjen e gjuhës. Publikimet dhe përkthimet në gjuhën përkatëse rrisin praninë e saj. Institucione si qendrat kulturore, institutet dhe shkollat e gjuhës janë gjithmonë në mbështetje të ruajtjes së gjuhës. Digjitalizimi hap mundësi të reja për ruajtjen e gjuhës. Aplikacionet gjuhësore, platformat online për mësim dhe rrjetet sociale, mundësojnë përhapjen dhe përdorimin global të gjuhës, pa dallim të numrit të folësve të saj. Komunitetet virtuale mund të kontribuojnë në përdorimin aktiv dhe zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës.

Ruajtja e një gjuhe kërkon një qasje integruese, ku shkenca, politika dhe shoqëria bashkëpunojnë. Suksesi varet kryesisht nga mënyra sesi këto masa përshtaten me realitetin e jetës së komunitetit gjuhësor dhe nëse ato mbështeten aktivisht nga folësit e saj. Njëri prej sociolinguistëve më të njohur Joshua Fishman, përmend 5 arsye kryesore të masave të pasuksesshme të politikës gjuhësore për ruajtjen e gjuhës:

“Humbja e kulturës përshpejton ndërrimin e identitetit – gjuha bëhet më pak e rëndësishme për folësit e saj; Gjuha e trashëguar, e prejardhjes shihet si jomoderne, “nuk është cool”; Gjuha e rrezikuar nuk ka funksione, të cilat nuk (mund të) plotësohen edhe nga gjuha dominonte; Masat për mbrojtjen e gjuhës zbatohen, ose vetëm “prej lartë”, ose vetëm “prej poshtë”, pa mos bashkëvepruar të dyja anët; Ruajtja e gjuhës shihet si rrezik për njësimin kombëtar, (prej popullatës shumicë apo pakicë), dhe ndërlidhet me tendencat separatiste (qofshin ato të dyshuara apo reale)” (cituat sipas Marten, H., 2016:71).

Në studime të shumta të gjuhëtarit të njohur britanik David Crystal<sup>34</sup> trajtohet në vazhdimësi tema e ruajtjes së gjuhës. Edhe sipas profesorit Ulrich Ammon,<sup>35</sup> që mbetet njëri prej gjuhëtarëve më të njohur gjermanë, i shquar sidomos në fushë të sociolinguistikës, duhet vlerësuar gjithmonë rëndësia e larmisë gjuhësore, për zhvillimin kulturor e intelektual të njerëzimit. Ai në vazhdimësi thekson rëndësinë e ruajtjes dhe mbështetjes së gjuhëve, duke argumentuar se humbja e gjuhëve, nuk është vetëm një humbje e dijes dhe identitetit kulturor, por edhe kufizim i mundësive të komunikimit dhe mendimit njerëzor.

Bazuar në këta studime të shumta, ndër mundësitë reale të ruajtjes së gjuhës sot mbeten: Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të duhura gjuhësore në nivel mbarëkombëtar e rajonal. Përmirësimi i statusit, njohja, përdorimi zyrtar dhe mbështetja e shumëgjuhësisë, sigurojnë ruajtjen e gjuhëve. Përkrahja nga institucionet shtetërore, të cilat mbështesin financiarisht programe shkollore, aktivitete kulturore për përdorimin dhe ruajtjen e gjuhës. Programet arsimore, që përfshinë: mësim të gjuhës, përgatitje të materialeve mësimore, shkollim të mësimdhënësve, garantojnë ruajtjen e gjuhës për brezat e ardhshëm.

Mbështetja e bashkësisë gjuhësore, për të përdorur dhe kultivuar gjuhën e vet, forcon komunitetin gjuhësor. Kjo punë bëhet përmes organizimit të takimeve, manifestimeve kulturore, festivaleve, koncerteve, shkollave verore, përgatitjes së materiale mësimore, mbledhjes dhe ruajtjes së tyre, sot edhe në version digjital, të librave, këngëve, filmave, veprave letrare, si dhe veprave tjera të rëndësishme, për të ruajtur trashëgiminë gjuhësore e kulturore edhe për gjeneratat e ardhshme. Për këtë duhet përdorur gjithnjë e më shumë teknologjia gjuhësore: Apps, resurset online, softuer për mësim dhe përkthim, të cilat janë të dobishme dhe lehtësojnë mësimin dhe përdorimin e gjuhës, sidomos për raste të tilla ku gjuha duhet të mësohet e përdoret jashtë vendeve të prejardhjes. Pra ruajtja e gjuhës kërkon një sërë masash dhe përpjekjesh; përveç mbështetjes institucionale nga shteti amë, apo i vendit të migrimit, edhe një angazhim nga i gjithë komuniteti, për të rritur vetëdijen për rëndësinë që ka gjuha, për të mbështetur bashkëpunimin dhe përpjekjet për ruajtjen e gjuhës. Pastaj duhet mbështetur

<sup>34</sup> Shih më shumë në: <https://www.thebritishacademy.ac.uk/fellows/david-crystal-FBA/>

<sup>35</sup> Shih më shumë për atë në: <https://www.ulrichammon.de/>

aktivistët e gjuhës, individë apo grupe që punojnë për ruajtjen e gjuhës dhe kulturës, përfshirë këtu financimin, apo krijimin e resurseve dhe infrastrukturës së duhur që nevojitet për këtë çështje.

### **Cilat janë vështirësitë dhe mundësitë e ruajtjes së gjuhës shqipe në diasporë – në shembullin e vendeve gjermanishtfolëse?**

Gjuha shqipe, si tipari kryesor kombëtar i shqiptarëve, edhe në mijëvjeçarin e tretë, mbetet gjëja më me vlerë për të gjithë popullin shqiptar. Shqipja, pavarësisht rrethanave politike dhe migrimeve të shumta, mbijetoi ndër shekuj dhe është pjesë e pandashme e trashëgimisë sonë mbarëkombëtare. Krahasuar me gjendjen e saj, para më shumë se një shekulli, nga një gjuhë e ndaluar, sot kemi zhvillime mjaft pozitive, që rritën statusin e shqipes në gjuhë pune, të vetme zyrtare në Shqipëri, gjuhë të parë zyrtare në RKS, gjuhë të dytë zyrtare në RMV, gjuhë pakicë në Mal të Zi e Serbi, gjuhë pakicë, me status të mbrojtur në disa zona të Italisë.

Ruajtja e gjuhës shqipe në diasporë përballet me vështirësi të shumta, të cilat janë të natyrës sociale, ekonomike, por edhe politike. Faktorët socialë dhe demografikë luajnë një rol vendimtar, pasi migrimi dhe integrimi në shoqëritë shumicë, gjithmonë çojnë në uljen e përdorimit të gjuhës amtare. Ndikimi i gjuhëve të vendeve pritëse, mbi gjuhën e diasporës është shpesh i madh, sepse gjuha dominuese në këta vende mbizotëron në shumë aspekte të jetës së përditshme. Një faktor tjetër thelbësor është sistemi arsimor. Qasja në arsimim cilësor për ruajtjen e gjuhës amtare në vendet pritëse nuk është çdoherë e garantuar, çka e vështirëson ruajtjen e gjuhës shqipe. Në shumë raste, gjuha shqipe nuk promovohet mjaftueshëm në shkolla, duke bërë që të rinjtë të kenë më pak kontakt me gjuhën e tyre amtare. Edhe mediat dhe teknologjia luajnë një rol të dyfishtë, herë ndihmues dhe herë kërcënues. Mediat sociale, kanalet televizive dhe platformat digjitale, ofrojnë mundësi për rrjetëzim dhe promovim të gjuhës, por nga ana tjetër mund të pakësojnë përdorimin e shqipes në publik, pasi shpesh parapëlqehet gjuha dominuese e vendit, apo anglishtja si gjuhë gjithkund e pranishme.

Si edhe me gjuhët tjera edhe në rastin e shqipes, vështirësia e komunikimit në mes brezave, përshpejton ndërrimin e gjuhës. Gjenerata e parë, që e përdor aktivisht gjuhën shqipe, gjithnjë e më shpesh nuk e bartë atë përherë në të njëjtën masë, si vite më parë, tek fëmijët e tyre. Në gjeneratën e dytë dhe të tretë, përdorimi i gjuhës shqipe, tanimë shpesh nuk ruhet as në familje, pasi të rinjtë integrohen në shoqërinë shumicë dhe shqipja përdoret gjithnjë e më pak në përditshmëri (Krh. Holmes, J. 2021: 65). Shqipja në diasporë mbetet dhe mbijeton në rrethana tepër të pafavorshme. Kemi tanimë mjaft arsye, që të japim kushtrimin: *“Ta shpëtojmë shqipen”!* Çfarë duhet bërë për të ruajtur atë sot, por edhe që të trashëgohet te brezat e ardhshëm, që lindin e rriten jashtë vendit amë? Bashkësia shqiptare në diasporë, veçanërisht në Shtetet e Europës Perëndimore, është shtuar shumë. Vetëm në vendet gjermanishtfolëse,

bazuar në zhvillimet e dhjetëvjeçarit të fundit, me këtë dinamikë të emigrimit, mendohet të jenë rreth 1 milion shqiptarë, nga vise të ndryshme të trojeve tona, ku historikisht ndër shekuj flitet shqip. Por këta shqiptarët nga të gjitha anët, në radhë të parë përballen me vështirësi të mbijetesës dhe integritit në vendin pritës, shumica ende mbeten në mes të dy botëve dhe kulturave.

Përmendëm se shtetet e zhvilluara që në pjesën e dytë të shekullit XX kanë bërë zgjidhje institucionale të mësimit, mbështetjes, ruajtjes dhe përhapjes së gjuhës së tyre, brenda dhe jashtë vendit në mbarë botën. Këtu bëjnë pjesë: Shkolla të gjuhës, institute, qendra kulturore, shoqata e fondacione me mbështetje shtetërore. Për të ruajtur gjuhën shqipe në diasporë, si gjuhë e familjes, me përdorim të vazhdueshëm ndër breza, kudo që janë shqiptarët, duhet të përfshihen aspektet sociale, kulturore dhe politike për ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare në botë.

Edhe shtetet tona e dinë peshën e diasporës sonë, njohin kontributin e saj për këto arritje kombëtare që kemi, dhe kanë themeluar disa institucione për mbështetjen e saj.

Po përmendim këtu më të rëndësishmit:

*Qendra e Botimeve për Diasporën*, në Tiranë, *Departamenti për Diasporë*, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës,<sup>36</sup> *RKS, Agjencia e Mërgatës e Republikës së Maqedonisë së Veriut*.<sup>37</sup>

Qendra e Botimeve për Diasporën, ka për detyrë:

*“Zhvillimin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar përmes mësimit të gjuhës, kulturës së prejardhjes si dhe njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare”* dhe mision i saj është: *“mbështetja e mësimit të gjuhës shqipe, njohja dhe përhapja e kulturës kombëtare në diasporë përmes botimit të teksteve shkollore, botimit të librave me përmbajtje letrare, historike, sociale etj. si dhe organizimi dhe mbështetja e veprimtarive edukative, kulturore dhe sociale, që kanë për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar”*.<sup>38</sup>

Me projekte institucionale të shteteve tona, do duhej të punohet më shumë në mësimin, mbështetjen dhe ruajtjen e gjuhës shqipe në diasporë. Urojmë që këta synime të parapara prej tyre (Qendra, Departamenti, Agjencia), si: *“ndërtimi i platformave për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e kulturës amtare për diasporën; ndërtimi i platformave për librin elektronik, ... organizimi dhe mbështetja e veprimtarive, konferencave, seminareve, shkollave dhe projekteve në ndihmë të përhapjes së gjuhës dhe kulturës amtare në diasporë”*<sup>39</sup>, të realizohen dhe të arrihen qëllimet e parapara, pasi ndërrimi i gjeneratave vështirëson ruajtjen e shqipes në diasporë dhe përshpejton asimilimin e tyre gjuhësor e kulturor.

<sup>36</sup> <https://mfa-ks.net/departamentet/diaspore/>

<sup>37</sup> <https://minisel.gov.mk/sq/>

<sup>38</sup> <https://qbd.gov.al/misioni-dhe-vizioni/>

<sup>39</sup> <https://qbd.gov.al/misioni-dhe-vizioni/>

Tepër të dobishëm janë projektet e përbashkëta të dy ministrive të arsimit, të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, për përgatitjen e teksteve mësimore për diasporën “*Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare*”,<sup>40</sup> për organizimin e mësimit plotësues, të gjuhës dhe kulturës shqipe, kudo në botë, ku kemi një numër të madh të bashkëkombësve tanë.

Sipas studimeve të Qendrës së Botimeve për Diasporë, kumtuar nga drejtorja e saj dr. Mimoza Hysa, në një konferencë në Universitetin e Durrësit, në maj 2023, në diasporë janë tashmë mbi gjysmë milion fëmijë, nën moshën 15 vjeçare, duke përfshirë këtu të dhëna, të viteve të fundit, vetëm për Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës. Bazuar në trendët e përshpejtuara të lëshimit të vendit, që ka prekur të gjithë vendet tona dhe rajonin, kjo shifër duhet të jetë rritur dukshëm. Ky numër kaq i lartë i fëmijëve shqiptarë, na detyron të bëjmë organizim institucional, për mësimin dhe ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Por këtu na dalin mjaft sfida e probleme.

Si pengesa më reale të organizimit të mirëfilltë institucional të mësimit të gjuhës shqipe në diasporë mund të përmenden: Niveli jo i duhur i arsimit dhe mungesa e vetëdijes kombëtare te një pjesë e madhe e mërgatës sonë. Të shumta janë familjet shqiptare të gjeneratës së parë që nuk i dërgojnë fëmijët në shkolla shqipe, një pjesë e mirë e brezit të dytë në emigracion, nuk ua mësojnë shqipen fëmijëve të tyre, ngurojnë të flasin me ata në shqip, në shumë raste nga gjenerata e treta tanimë shqipja nuk përdoret, pra nuk është më gjuhë e familjes.

Mos harrojmë edhe zhgënjimin dhe dëshpërimin e madh që kanë këta kur e lëshojnë vendin amë, i gjithë ai zhgënjim, mlllef i grumbulluar, te shumica shton dëshirën për të harruar gati gjithçka që lënë pas, ndikon në mospërdorimin e gjuhës amtare, braktisjen e saj dhe rrezikon ruajtjen e gjuhës së prejardhjes te brezat e ardhshëm në mërgim. Nevojitet një fushatë ndërgjegjësimi, që shqipja si gjuhë e prejardhjes, për t’u ruajtur, jo vetëm që duhet të përdoret në familje, por edhe në shkolla, dhe mundësisht kudo në jetën e përditshme. Organizimi jo i duhur institucional i mërgatës sonë në diasporë e vështirëson këtë proces. Me gjithë përpjekjet e deritanishme të shteteve tona, duket se nuk është bërë sa duhet, që shumica e mërgimtarëve tanë atje të ndjekin mësimin e gjuhës së prejardhjes, me këtë të lehtësohet ruajtja e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Sigurimi i mbështetjes për organizimin sa më cilësor të mësimit plotësues të gjuhës dhe kulturës shqiptare, do duhet që të jetë një ndërmarrje e përbashkët e shteteve tona, përmes përfaqësive të tyre në shtete të ndryshme. Këta përfaqësues, me ndërmjetësimin e politikave ndërshtetërore, duhet të ndikojnë edhe në mos diskriminimin e qytetarëve të tyre, si të huaj në vendin përkatës, përmirësimin e imazhit shqiptar, shtimin e ndihmës të shtetit pranues për gjuhët e prejardhjes, pasi jo të gjitha shtetet kanë rregullim ligjor, që garanton të drejtat gjuhësore.

<sup>40</sup> <https://masht.rks-gov.net/promovohet-teksti-mesimor-per-diasporen-gjuha-shqipe-dhe-kultura-shqiptare-niveli-i/>

Të përmendim këtu kontributin e madh, edhe në këtë drejtim, të albanologut zviceran, prof. dr. Basil Schader, si mbështetës i projekteve të tilla dhe hartues i *“Materialeve për mësimin në gjuhën e prejardhjes”*.<sup>41</sup> Përmes botimeve të shumta për gjuhën shqipe, ai në vazhdimësi përmend rëndësinë e mësimin të gjuhës shqipe, zotërimin e paktë të shqipes nga të rinjtë shqiptarë,<sup>42</sup> si dhe rrezikun e humbjes së saj pas dy brezash,<sup>43</sup> nëse nuk ndërmerret shumëçka serioze, në mënyrë institucionale. Nga gjuhëtarja zvicerane dr. Cristina Lucchetti përmendet *“Shqipja si gjuha më e rëndësishme e origjinës në Zvicër”*.<sup>44</sup> Por megjithatë, edhe sipas saj, shqipja në Zvicër ende nënvlerësohet.<sup>45</sup> Ajo është pjesë e projektit të Universitetit të Cyrihut *“për rolin e gjuhës shqipe në Zvicër”*,<sup>46</sup> po ashtu vrojton dhe hulumton prestigjin e gjuhëve në Zvicër, ku përfshihet edhe shqipja.<sup>47</sup>

Në Universitetin e Cyrihut<sup>48</sup> nga shkurti 2025 nis punën, me një përqindje tepër të ulët, edhe një lektor i gjuhës shqipe. Uroj që ky hap të jetë vetëm fillimi, pasi bazuar në numrin e madh të shqiptarëve në Zvicër, thuhet se janë mbi 300<sup>49</sup> mijë, jo vetëm ky universitet, por edhe të tjerët, duhet të ofrojnë dhe bëjnë më shumë për gjuhën shqipe. Për këtë duhet punuar edhe në shtimin e prestigjit të gjuhës shqipe edhe në mesin e shqiptarëve të diasporës sonë, sidomos në këta vende. Portali Albinfo<sup>50</sup> me shkrimet e përditshme për diasporën tonë në këta vende, emisioni javor *“FolShqipShow”*<sup>51</sup>, janë prej shembujve më të mirë, sesi mundet dhe duhet të punohet për integrimin, por edhe për ruajtjen e kulturës dhe gjuhës së prejardhjes.<sup>52</sup> Instituti Shqiptar (Albanisches Institut)<sup>53</sup> vepron nga viti

<sup>41</sup>[https://myheritagelanguage.com/sq/?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTEAAR3x0JMyTEJ eYngsld6dwlx57Jj1HjtQcOTZtcGbE1RjRBXzmNjsV1Niqk4\\_aem\\_Dp5rNo94BAfP9HoJ1 mLlUg](https://myheritagelanguage.com/sq/?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTEAAR3x0JMyTEJ eYngsld6dwlx57Jj1HjtQcOTZtcGbE1RjRBXzmNjsV1Niqk4_aem_Dp5rNo94BAfP9HoJ1 mLlUg)

<sup>42</sup><https://www.tagblatt.ch/ostschweiz/junge-albaner-in-der-schweiz-beherrschen-ihre-muttersprache-oft-nur-noch-muendlich-ld.1161194>

<sup>43</sup> <https://www.albinfo.ch/de/prof-dr-schader-ohne-angemessene-bemuehungen-koennte-albanisch-in-der-schweiz-nach-zwei-generationen-aussterben/>; <https://www.albinfo.ch/prof-dr-schader-pa-perpjekjet-e-duhura-shqipja-ne-zvicer-rrezikon-te-shuhet-pas-dy-brezave/>; <https://www.albinfo.ch/shqipja-ne-zvicer-populli-mbetet-por-gjuha-e-tij-zhduket/>

<sup>44</sup><https://www.albinfo.ch/dr-cristiana-lucchetti-shqipja-gjuhe-shume-e-perhapur-ne-zvicer-por-ende-pak-e-vleresuar/>

<sup>45</sup> <https://www.albinfo.ch/de/dr-cristiana-lucchetti-albanisch-wird-in-der-schweiz-immer-noch-unterschaezt/>

<sup>46</sup><https://www.albinfo.ch/universiteti-i-cyrihut-me-projekt-per-rolin-e-gjuhes-shqipe-ne-zvicer/>

<sup>47</sup><https://www.slav.uzh.ch/de/seminar/mitarbeitende/sprachwiss/Cristiana-Lucchetti.html>

<sup>48</sup> <https://www.slav.uzh.ch/de/seminar/mitarbeitende/sprachen/lhala.html>

<sup>49</sup> <https://www.koha.net/arberi/shifrat-zyrtare-ne-zvicer-jetojne-300-mije-shqiptare>.

<sup>50</sup> <https://www.albinfo.ch/>

<sup>51</sup> <https://folshqipshow.ch/>

<sup>52</sup> <https://www.albinfo.ch/diaspora-ne-zvicer-dhe-gjuha-shqipe/>

<sup>53</sup> <https://albanisches-institut.ch/>

2002 në Zvicër, ku përmes botimeve kryesisht në shqip e gjermanisht, aktivitetëve, ligjëratave luan me shumë sukses, jo vetëm rolin e urës lidhëse në mes të hapësirave gjuhësore dhe kulturave të ndryshme, por punon edhe për ndërgjegjësimin e rëndësisë së ruajtjes të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë.

Një shembull tjetër i suksesit të shqiptarëve edhe në fushën e arsimit të lartë është prof. dr. Naxhi Selimi, profesor në Universitetin e Edukimit në Schwyz.<sup>54</sup>

Edhe në Austri në disa universitete, në Qendrat e gjuhëve ofrohet mësimi i shqipes.<sup>55</sup> Më herët për disa dekada në këtë universitet, ku studim i gjuhës, historisë dhe kulturës shqiptare ka traditë të gjatë, ka pasur edhe një lektorat të gjuhës shqipe, me lektor, gjuhëtarin e njohur nga Prishtina, dr. Skënder Gashin. Të përmendim këtu edhe një varg albanologësh të sotëm në Vjenë, si vazhdimësi e traditës së gjatë të albanologjisë austro-gjermane: Prof. dr. Oliver Jens Schmitt me bashkëpunëtorët e tij, dr. Robert Pichler, dr. Konrad Clewing dhe dr. Joachim Matzinger, i cili përkujdeset më shumë për bibliotekën shqiptare.<sup>56</sup>

Në Gjermani krahas Katedrës së Albanologjisë<sup>57</sup> në Universitetin e Munihut, themeluar nga Martin Camaj dhe drejtuar deri më tani nga prof. dr. Bardhyl Demiraj, që disa vite është themeluar edhe një lektorat i shqipes në Universitetin e Regensburgut, përfaqësuar nga Ledio Hala<sup>58</sup>. Më herët në Gjermani kemi pasur një numër më të madh të albanologëve, pjesë e kësaj tradite është sot edhe prof. dr. Gerd-Dieter Nehring.<sup>59</sup> Si vazhdues i kësaj trashëgimie, viteve të fundit shquhet prof. dr. Christian Voß,<sup>60</sup> i cili mbështet studimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Universitetin e Humboldt në Berlin, përmes përkrahjes së studiueseve, si dhe të studentëve shqiptarë nga të gjitha trojet tona, por edhe me aktivitete si “Kosova në Berlin”. Në Universitetin e Jenës, prof. dr. Thede Kahl, përfshin në vazhdimësi edhe mësimin dhe studimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare.<sup>61</sup>

Studiues dhe autorë të njohur si dr. Pandeli Pani<sup>62</sup> dhe dr. Lumnije Jusufi<sup>63</sup>, si dhe vetë ekipi i redaksisë shqipe<sup>64</sup> të Deutsche Welle-s, por edhe

<sup>54</sup> <https://www.phsz.ch/person/naxhi-selimi>, <https://www.albinfo.ch/nga-punetori-sezonal-ne-ndertim-te-pedagogu-universitar/>

<sup>55</sup> <https://sprachenzentrum.univie.ac.at/de/ueber-uns/team/albanischteam>

<sup>56</sup> <https://iog.univie.ac.at/bibliotheken/albanienbibliothek/>

<sup>57</sup> <https://www.albanologie.uni-muenchen.de/personen/professoren/demiraj/index.html>

<sup>58</sup> <https://www.uni-regensburg.de/sprache-literatur-kultur/slavistik/institut/sprach-und-kulturwissenschaft/ledio-hala/index.html>

<sup>59</sup> <https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/personal/personal-zis/148396/143913>

<sup>60</sup> <https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/cvoss>

<sup>61</sup> <https://www.gw.uni-jena.de/3390/kahl-thede>

<sup>62</sup> [https://www.goodreads.com/author/show/1504763.Pandeli\\_Pani](https://www.goodreads.com/author/show/1504763.Pandeli_Pani);

[https://www.harrassowitz-verlag.de/titel\\_7112.ahtml](https://www.harrassowitz-verlag.de/titel_7112.ahtml).

<sup>63</sup> <https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/jusufilu/vita>

<sup>64</sup> <https://www.dw.com/sq/gjuha-shqipe/t-71027209>

mjaft të tjerë, me tekste në shqip dhe për mësimin e gjuhës shqipe, si dhe me aktivitete të shumta për njohjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare, gjithsesi janë tepër të dobishëm edhe për ruajtjen e shqipes në këta vende. Edhe qindra e mijëra (ish)studentë, që studiojnë nëpër universitetet e ndryshme të vendeve gjermanishtfolëse, mund të japin ndihmesën e tyre edhe në këtë proces e mision të ruajtjes së gjuhës shqipe atje. Për fat në disa qytete, ata janë të organizuar mirë, nëpër klube e shoqata (ish)studentësh, siç është rasti në Vjenë<sup>65</sup> dhe Hamburg.<sup>66</sup>

I përmendëm këtu këta fakte, pasi janë një mundësi shtesë për nxitjen e mësimin, studimit dhe ruajtjes së gjuhës shqipe edhe në hapësirat gjermanishtfolëse. Ne shqiptarët, kudo që jemi, duhet të vazhdojmë të bëjmë pjesën tonë të punës, për këtë mision fisnik dhe për këtë kërkesë të kohës së sotme. Hapja dhe funksionalizimi i duhur i Qendrave Kulturore, i shkollave për mësimin e gjuhës shqipe, në çdo qytat ku ka me mijëra mërgimtarë shqiptarë nga viset tona, si dhe bashkëveprimi i konsullatave dhe ambasadave të shteteve tona, do ta ndihmonte dukshëm këtë proces. Edhe në një shkrim tjetër tonin, përshkruajmë rëndësinë e mbështetjes së mësimin të gjuhës shqipe, si vijon: “Është e nevojshme të shtojmë shkollat e mësimin të shqipes në diasporë. Por jo vetëm si numër. Ato duhet të bëhen sa më funksionale, me nivelin e duhur, me certifikime të vlefshme dhe me përfshirjen e sa më shumë fëmijëve që gjuhën shqipe e kanë gjuhë amtare”.<sup>67</sup>

Bazuar në modelet e suksesshëm të kombeve e shteteve të zhvilluara edhe hapja e shkollave, instituteve, qendrave kulturore shqiptare, dërgimi i lektorëve të gjuhës shqipe nëpër universitetet më të njohur, të cilët dikur kanë qenë vatra të studimeve albanologjike, si në: Vjenë, Munihi, Regensburg, Cyrih, Bazel, Berlin, Jena, Hamburg, por edhe në kryeqendra tjera të shteteve të Europës Perëndimore, do të ishin hapat e duhur për mbështetjen dhe ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Këta shtete e mbështesin larminë gjuhësore dhe investojnë miliarda për shumëgjuhësinë, pasi i njohin e i kanë të studiuara përparësitë e shumta, që ka një individ dhe shoqëria shumëgjuhëshe në përgjithësi. Me projekte konkrete, ndër dekada, ata kanë punuar që qytetarët e tyre të njohin 3 gjuhë: gjuhën amtare dhe 2 gjuhë të huaja, njëra prej tyre anglishtja, si gjuha kryesore e botës, dhe tjetra gjuha e vendit fqinjë, që në shumë raste është ndër gjuhët kryesore të botës. Përmes ndjekjes së modeleve shembullorë dhe kombinimit të këtyre masave, për bashkësinë shqiptare në diasporë, do të kishte qenë më e lehtë mësimi, ruajtja dhe kultivimi i gjuhës shqipe. Vetëm përmes njohjes e zotërimit të shqipes nga këta qindra mijëra bashkëkombës tanë në vendet gjermanishtfolëse, por edhe shumë të tjerë,

<sup>65</sup> <https://www.albinfo.ch/studentet-shqiptare-te-bashkuar-per-te-ndihmuar-njeri-tjetrin/>.

<sup>66</sup> Organizata e akademikëve gjermano-shqiptarë në Hamburg, <https://www.odahamburg.org/>

<sup>67</sup> <https://gazetadita.al/gjuha-shqipe-dhe-shoqeria-mbareshqiptare-aktualisht/>

kudo në Europë e botë, do të bëhej më e lehtë ruajtja e kontakteve me vendin amë, do të kultivoheshin lidhjet kulturore, si dhe do të mbeten në vazhdimësi një potencial i mirë i zhvillimit të ekonomisë dhe turizmit të vendeve tona. Por edhe vendet pritëse, në rastin tonë, vendet gjermanishtfolëse, nëse atje ruhet, mësohet dhe përdoret gjuha shqipe, do të kenë bashkëvendës, që i zotërojnë mirë gjuhët dhe i njohin shkëlqyeshëm kulturat e të dy hapësirave, si të asaj gjermanishtfolëse dhe të kësaj shqipfolëse. Si të tillë ata janë dhe do të jenë po aq të vlefshëm, si urë lidhëse në mes vendit ku jetojnë e veprojnë dhe vendit të prejardhjes.

Pa mbështetjen e shteteve tona, sado e organizuar të jetë diaspora jonë, ruajtja e gjuhës shqipe, do të mbetet tepër e vështirë. Ajo që na mungon neve shqiptarëve mbetet organizimi i përbashkët, besimi në institucione, kultivimi i kontakteve, sigurimi i vazhdimësisë. Për atë do duhej të punohet më shumë në inkurajimin e prindërve, të flasin me fëmijët e tyre, sa më shumë që të jetë e mundur shqip, së pari brenda familjes, të dërgojnë fëmijët e tyre në shkollat ekzistuese shqipe, të marrin pjesë në aktivitetet kulturore, të ruajnë dhe kultivojnë lidhjet me vendin e prejardhjes, me vendlindjen e të parëve të tyre. I domosdoshëm mbetet formimi i një rrjeti më efikas, tani më lehtë e arritshme, edhe falë asaj që kemi institucionet e shteteve tona gati kudo në diasporë, por edhe duke iu falënderuar zhvillimit të sotëm teknologjik, krijimi i rrjeteve dhe partneriteteve me komunitete dhe organizata tjera shqiptare, si në vendet gjermanishtfolëse, edhe në mbarë botën, për të shkëmbyer përvojën dhe për të zbatuar më lehtë bashkërisht projekte për ruajtjen e gjuhës.<sup>68</sup>

### **Përmbledhja dhe përfundimi**

Ruajtja e gjuhës shqipe në diasporë është e një rëndësie të veçantë, për ruajtjen e identitetit kulturor dhe kombëtar shqiptar kudo në botë. Edhe në këtë studim theksohet fakti që gjuha shqipe për shqipfolësit, nuk është vetëm një mjet komunikimi, por duhet kuptuar si një trashëgimi kulturore, një thesar kombëtar, që shërben si urë lidhëse me rrënjët e prejardhjes dhe për ruajtjen e përkatësisë kombëtare.

Me gjithë vështirësitë e mbijetesës në emigracion, të procesit të integritimit, si dhe të ndikimit të gjuhëve dominuese të vendit të migrimit dhe të anglishtes në përgjithësi, ka nisma të shumta, nga vetë pjesëtarët e diasporës, një pjesë e saj tanimë mjaft e kamur dhe e arsimuar, mbështetur nga institucionet e shteteve tona, që ndihmojnë në ruajtjen e gjuhës shqipe në diasporë. Të rekomandueshme janë veprimet praktike të përfaqësimit tonë politik, dhe na gëzon fakti që në vendet gjermanishtfolëse, kemi bashkëveprim të ambasadorëve të tre shteteve tona, si dhe të institucioneve dhe klubeve, shoqatave me organizim të përbashkët në shërbim të ruajtjes së gjuhës dhe kulturës së përbashkët shqipe. Do duhej të punohet në sigurimin dhe mbështetjen e programeve mësimore për

<sup>68</sup> Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë, bënë punën e duhur për ruajtjen e gjuhës amtare. <https://kkad.al/>

gjuhën shqipe, si në shtetet pritëse, ashtu edhe nga vendet amë. Përveç kësaj do duhej që ministritë, agjencitë dhe institucionet përkatëse të shteteve tona për diasporën, të bashkëpunojnë më ngushtë për mbështetjen e organizimit të diasporës sonë, për ruajtjen e gjuhës shqipe. Edhe globalizimi në rritje, risitë teknologjike, janë mundësi, por edhe rreziqe për ruajtjen e gjuhës. Por pikërisht përfshirja dhe përdorimi i teknologjisë së re, platformat digjitale mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin, mësimin dhe ruajtjen e gjuhës shqipe. Gjithsesi një prej sfidave, vështirësive më të mëdha mbetet motivimi, nxitja e brezave të rinj për të folur, për të mos braktisur dhe për të ruajtur në mënyrë aktive gjuhën e prejardhjes, gjuhën amtare. Përballë këtyre zhvillimeve, është i rëndësishëm bashkëveprimi si i përfaqësuesve shtetërorë, ashtu edhe i shoqërisë civile, për të zhvilluar strategji afatgjata që do të sigurojnë, tash e në të ardhmen, ruajtjen e gjuhës shqipe në diasporë.

Duke e përmbledhur mund të themi se ruajtja e gjuhës shqipe në diasporë, sidomos në vendet gjermanishtfolëse, kërkon një qasje të gjithanshme. Këtu do të përmendim edhe disa mënyra sesi mund të ndihmojmë ruajtjen e gjuhës shqipe atje: *Rritja e numrit të shkollave të gjuhës shqipe*: Mund të hapen më shumë shkolla dhe kurse për mësimin e gjuhës shqipe, për të siguruar që brezat e rinj të kenë mundësi të mësojnë, përdorin dhe të ruajnë gjuhën e tyre amtare. Kjo mund të bëhet me ndihmën e vetë diasporës, por edhe me përkrahjen nga poshtë të shteteve tona, gjetjen e mësuesve të kualifikuar, mbështetur nga të dyja anët.

*Përkrahja e aktiviteteve kulturore*: Aktivitetet kulturore si koncerte, java e filmit shqiptar, si dhe veprimtarive tjera që promovojnë kulturën dhe gjuhën shqipe, janë një mënyrë mjaft efikase për të ruajtur, dhe promovuar përdorimin e gjuhës shqipe. Këta mund të organizohen në bashkëpunim me shoqatat kulturore, organizatat e diasporës, si dhe me mbështetjen e ambasadave dhe institucionet shtetërore të vendeve tona.

*Përfshirja e familjes dhe komunitetit*: Shumë gjuhë ruajnë gjallërinë e tyre përmes komunikimit të përditshëm brenda familjes dhe komunitetit. Prindërit dhe të afërmit mund të nxisin përdorimin e gjuhës shqipe në shtëpi dhe të krijojnë një mjedis, ku gjuha e bukur shqipe, përdoret shpesh. Kjo kërkon një fushatë të ndërgjegjësimit kombëtar, për rëndësinë jetike që ka gjuha shqipe në këtë proces. Pjesëmarrja në aktivitete mbarëkombëtare dhe ndërkulturale, ku përdoret gjuha shqipe, mund të ndihmojë gjithashtu në zhvillimin dhe përhapjen e saj. Kjo po ashtu jep një ndihmesë për forcimin e lidhjeve mes brezave të rinj, për ruajtjen edhe të traditave kulturore, por edhe të vetëdijes kombëtare.

*Mbështetja nga shteti dhe institucione të tjera*: Mbështetja jo vetëm e vendeve pritëse, që jepen në frymën e mbrojtjes së shumëgjuhësisë, por edhe shtetet tona mund të ofrojnë përkrahje për projekte që synojnë ruajtjen e gjuhës shqipe, si mbështetjen e kurseve dhe aktiviteteve kulturore dhe zhvillimin i një infrastrukture, që mundëson mësimin e vazhdueshëm dhe efektiv të gjuhës shqipe në diasporë.

*Mediat dhe teknologjia:* Përdorimi i mediave sociale, kanaleve televizive dhe platformave digjitale në gjuhën shqipe, mund të ndihmojë në ruajtjen dhe përhapjen e saj. Kjo mund të përfshijë aplikacione, faqe interneti që ofrojnë mësim dhe materiale në gjuhën shqipe. Tanimë këta burime materialesh në versionin digjital edhe për shqipen nuk janë të pakta, por mund dhe duhet të punohet edhe më shumë në këtë drejtim, duke marrë shembullin e gjuhëve tjera të Europës.

Ky punim i shkurtër, uroj të jetë një nismë, si dhe një ndihmesë modeste, për një temë tepër me rëndësi, siç është ruajtja e gjuhës shqipe në diasporë.

### **Bibliografia (Përzgjedhje)**

AMMON, Ulrich (2015). *Die Stellung der deutschen Sprache in der Welt*. Berlin.

BARJABA, Joniada (2019). *Albanian Diaspora across the World*. Në: Athens Journal of Mediterranean Studies- Volume 5, 173-184. <https://www.athensjournals.gr/mediterranean/2019-5-3-3-Barjaba.pdf>

COULMAS, Florian (1985). *Sprache und Staat: Studien zur Sprachplanung und Sprachpolitik*. Berlin, New York: de Gruyter.

CRYSTAL, Davil (2008). *A Dictionary of Linguistics and Phonetics*. London, New York: Blackwell Publishing.

FISHMAN, Joshua A. *Language and Ethnicity in Minority Sociolinguistic Perspective*. Multilingual Matters, 1989.

HOLMES, Janet/WILSON, Nick (2021). *Hyrje në sociolinguistikë*. Tiranë: Albas.

ISMAJLI, Rexhep et al. 2020. *Leksikon i termave të sociolinguistikës*. Prishtinë: ASHAK.

KRUMM, Hans-Juergen (2021). *Sprachenpolitik Deutsch als Fremd- und Zweitsprache*. Berlin: ESV.

MAKSUTI, Izer (2023). *Gjuha shqipe dhe shoqëria mbarëshqiptare aktualisht*. Në: Gazeta DITA, 16.05.2023. <https://gazetadita.al/gjuha-shqipe-dhe-shoqeria-mbarëshqiptare-aktualisht/>

MARTEN, Heiko F. (2016). *Sprach(en)politik*. Tuebingen: Narr.

NUSHI, Denis (2016). *Migrimi/mobiliteti dhe identitetet hibride te diasporës*. <https://prointegra.ch/wp-content/uploads/2017/11/Identitetet-hibride-te-diaspores.pdf>

RICENTO, Thomas (Hrsg.). *An Introduction to Language Policy: Theory and Method*. Blackwell Publishing, 2006.

SKUTNABB-KANGAS, Tove. *Linguistic Genocide in Education—Or Worldwide Diversity and Human Rights?* Routledge, 2000.

SPOLSKY, Bernard ed. (2012). *Handbook of language Policy*. Cambridge: University Press.

ISSN 2671-3004

UDC 811.18'26:316.72

**Punim studimor**

**Ajten HAJDARI – QAMILI**

Universiteti “Shën Kirili e Metodi” – Shkup,  
Fakulteti i Filologjisë, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare  
e-mail: ajtenqamili79@gmail.com

**PËRBALLJET E SHQIPES STANDARDE NË MAQEDONINË E VERIUT  
ME POLITIKAT VENDORE DHE ME GLOBALIZIMIN**

**CHALLENGES OF THE STANDARD ALBANIAN LANGUAGE IN  
NORTH MACEDONIA WITH LOCAL POLICIES AND GLOBALIZATION**

**Abstrakti:**

Gjuha standarde shqipe ose gjuha letrare kombëtare pa dyshim se është një arritje jashtëzakonisht e madhe e mbarë kombit shqiptar, pavarësisht nga kufijtë shtetërorë e rendet politike, sepse nuk është thjesht gjuhë zyrtare e Shqipërisë, por ajo flitet dhe shkruhet po ashtu nga shqiptarët në trojet autoktone në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi e gjetiu. Krahasuar me Shqipërinë, madje edhe me Kosovën, në Maqedoninë e Veriut shqipja standarde, ka pasur fatin shumë më ndryshe për shkak të trysnisë së politikave sllave. Përdorimi i shqipes nëpër institucione ka qenë shumë më i kufizuar dhe i anashkaluar. Viteve të fundit filloi të ketë përdorim zyrtar nëpër shumë institucione, por sa arriti të jetësohet Ligji për Përdorimin e Gjuhëve dhe me çfarë pengesash ballafaqohet ky zyrtarizim do të trajtojmë në këtë kumtesë. Gjithashtu do të analizojmë deri në çfarë shkalle rrezikohet shqipja nga trysnia e politikave sllave dhe tash së fundi edhe nga trysnia e globalizimit dhe pse ka pësuar ngritje-ulje zbatimi i shqipes standarde nëpër breza dhe qytete të ndryshme.

**Fjalët çelës:** shqipe, standarde, sfida, faktorë, politika, globalizim

**Abstract:**

The standard Albanian language or the national literary language is undoubtedly an extremely great achievement of the entire Albanian nation, regardless of state boundaries and political order, because it is not just the official language of Albania, but it is also spoken and written by Albanians in their native lands in Kosovo, in North Macedonia, in Montenegro etc. Compared to Albania, and even Kosovo, in North Macedonia the standard Albanian language has had a much different fate due to the pressure of Slavic policies. The use of Albanian in institutions has been much more limited and overlooked. In recent years, it began to be officially used in many institutions, but how far the Law on the Use of Languages was implemented and what obstacles this formalization faces will be discussed in this statement. We will also analyze to what extent Albanian is endangered by the pressure of Slavic policies and now also by the pressure of globalization and why the implementation of the standard Albanian language has undergone ups and downs in different generations and cities.

**Key words:** Albanian, standards, challenges, factors, politics, globalization

**Hyrje**

Gjithçka në botë ndryshon dhe evoluon në rrjedhë të kohës. Njerëzit vazhdimisht janë në kërkimin e të mirës, e të përkryerës, e të dobishmes, por jo gjithmonë aspiratat dhe synimet tona dalin ashtu siç dëshirojmë dhe planifikojmë ne. Ndonjëherë gjërat që i mendojmë të dobishme, na sjellin më shumë dëm sesa dobi. Epoka digjitale, përpos përfitimeve dhe dobive të shumta që na ofron, ka edhe disavantazhe që dëmtojnë thellë nxënien dhe zbatimin e shqipes standarde mirëfilli, shkaktoi analfabetizmin funksional, po asimilon brezat e rinj etj.

Që nga viti 1972 e deri më sot Maqedonia e Veriut ka kaluar në faza të ndryshme tranzicioni në shumë aspekte, gjë që ka lënë gjurmë edhe në mënyrën e zbatimit të shqipes standarde nëpër institucione dhe më gjerë. Në vitet e para ishte faza kur shqipja e normuar filloi të zbatohet vetëm nëpër librat shkollorë, në gazetën ditore “Flaka e Vëllazërimit”, në lajmet e gjuhës shqipe në TVM dhe në radio Shkupi. Më pas përhapet në mesin e njerëzve të arsimuar, të cilët kanë qenë pak në numër, ndërsa sot janë shumëfish më tepër. Sot përveç shkollave fillore dhe të mesme, në RMV kemi 3 universitete ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, po ashtu kemi Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare (në UKM), Fakultetin Pedagogjik, ITSHKSH, AZGJ, IPGj etj. Duke i pasur të gjitha këto mundësi dhe hapësirë për ta kultivuar dhe mbrojtur shqipen standarde, në një kohë ku arsmimi i mesëm është i obliguar, diplomë fakulteti dhe masteri ka gati çdo i dhjeti person i brezave të rinj, përdorimi zyrtar i shqipes është zgjeruar më shumë se më parë, në vend që të lulëzojë përdorimi i shqipes standarde, fatkeqësisht është zvetënuar.

Koha ka dëshmuar se zgjidhjet e Kongresit të Drejtshkrimit përgjithësisht janë të pranueshme nga shqiptarët dhe i kanë mbijetuar kohës, por deri në çfarë shkalle përdoret mirëfilli, në cilat vende dhe nga cilat breza, kjo është e larmishme në trojet shqiptare (shqipfolëse). Cilat janë sfidat që ka përjetuar shqipja standarde në Maqedoninë e Veriut në këto 50 vjet, cilat janë shkaqet e ulje-ngritjeve të nivelit të zbatimit të saj, të ndryshueshmërisë nëpër breza dhe qytete të ndryshme, sa ka qenë shtrirja dhe zgjerimi i përdorimit zyrtar apo jozyrtar nëpër institucione, të gjitha këto do të sqarohen në këtë kumtesë.

### Shtjellimi

Shqipja si një nga gjuhët më të lashta në Ballkan e më gjerë, e dokumentuar shumë vonë, në vitin 1912 u bë gjuhë zyrtare në Shqipëri, kurse u standardizua në vitin 1972; Për njësimin e gjuhës standarde shqipe, një hap bëri “Komisioni letrar shqip”, që u mbledh në Shkodër në vitin 1916. Ky komision gjuhëtarësh e shkrimtarësh, krijuar për të ndihmuar në formimin e një gjuhe letrare të përbashkët përmes afrimit të dy varianteve letrare në përdorim, vlerësoi variantin letrar të mesëm, si një urë në mes toskërishtes dhe gegërishtes dhe përcaktoi disa rregulla për drejtshkrimin e tij, të cilat ndikuan në njësimin e shqipes së shkruar. Vendimet e Komisionit letrar shqip për gjuhën letrare e për drejtshkrimin e saj, u miratuan më vonë edhe nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920) dhe vijuan të zbatoheshin deri në Luftën e Dytë Botërore. Pas Luftës së Dytë Botërore, puna për njësimin e gjuhës letrare kombëtare dhe të drejtshkrimit të saj, nisi të organizohet nga Instituti i Shkencave. U krijuan komisione të posaçme për hartimin e projekteve të drejtshkrimit në vitet 1948, 1951, 1953 dhe 1956. Gjithashtu, u organizuan dy konferenca shkencore në vitin 1952, për të diskutuar për problemin e gjuhës letrare. Më në fund, në vitin 1972 në Tiranë u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit dhe menjëherë pas tij janë botuar edhe një varg veprash të rëndësishme, që kodifikojnë normat e gjuhës standarde shqipe, siç janë: “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973), “Fjalori i gjuhës së sotme letrare” (1980), “Fjalori i shqipes së sotme” (1984), “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe” (1976), “Gramatika e gjuhës së sotme shqipe: Morfologjia (1995), Sintaksa (1997)” etj.

Gjuha standarde shqipe ose gjuha letrare kombëtare pa dyshim se është një arritje jashtëzakonisht e madhe e mbarë kombit shqiptar, pavarësisht nga kufijtë shtetërorë e rendet politike, sepse nuk është thjesht gjuhë zyrtare e Shqipërisë, por ajo flitet dhe shkruhet po ashtu nga shqiptarët në trojet autoktone në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi e gjetiu. Krahasuar me Shqipërinë, madje edhe me Kosovën, në Maqedoninë e Veriut shqipja standarde, ka pasur fatin shumë më ndryshe për shkak të trysnisë së politikave sllave. Përdorimi i shqipes nëpër institucione ka qenë shumë më i kufizuar dhe i anashkaluar. Në kohën e ish-Jugosllavisë, në vitet 1974-1981 statusi i shqipes ka qenë në gjendje më

të mirë, edhe pse përdorej vetëm në nivel lokal, diku më e avancuar e diku më pak. Kurse pas vitit 1981 rrethanat politike sllave ashpërsohen dukshëm dhe nga dita në ditë statusi i shqipes ndrydhej e tkurrej me synim për ta zhdukur plotësisht. Më vonë, pas luftës në Maqedoni, me Marrëveshjen e Ohrit në vitin 2001 shqipja filloi të përdoret në nivel lokal, vetëm në mbishkrime të disa institucioneve, në dëftesat dhe ditarët e shkollave, pastaj u përforcua me ligj në vitin 2008, kurse përdorim zyrtar në nivel shtetëror vetëm aty ku shqiptarët janë 20% mori në vitin 2019 me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

A arriti të jetësohet plotësisht ky ligj apo jo? Me çfarë pengesash ballafaqohet ky zyrtarizim? Deri në çfarë shkalle rrezikohet shqipja nga trysnia e politikave sllave dhe tash së fundi edhe nga trysnia e globalizmit? Pse ka pësuar ngritje-ulje zbatimi i shqipes standarde? Pse dallon nëpër breza dhe qytete të ndryshme? Për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve dhe shumë pyetjeve të tjera, kam bërë një përmbledhje analizash dhe rezultatesh, nga hulumtimet e mia që i kam bërë ndër vite përmes pyetësorëve, testeve e hartimeve të mbledhura në fakultetet, shkollat e mesme dhe filllore në Shkup, Kumanovë, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë dhe Dibër; dokumenteve e shkresave administrative; librave shkollorë të lëndëve të ndryshme prej viteve 1985 – 2020; gazetave ditore nga arkivi dhe të reja "Flaka e vëllazërimit", "Koha", "Fakti" dhe nga kjo përmbledhje do të pasqyrohen të gjitha sfidat që ka përjetuar shqipja në Maqedoninë e Veriut në këto 50 vjet. Në përpjekje për t'i argumentuar rezultatet, po vështrojmë gjendjen prej para 5 dekadash deri sot.

Menjëherë pas Kongresit të Drejtshkrimit, shqipja e normuar filloi të zbatohet vetëm nëpër librat shkollorë, në gazetën ditore "Flaka e Vëllazërimit", në lajmet e gjuhës shqipe në TVM dhe në radio Shkupi me orar të kufizuar. Përveç shkollave fillore në vendbanimet me shumicë shqipatre, shqipja përdorej edhe në fare pak shkolla të mesme, në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsirë Shqiptare në Shkup (në UKM, e cila nga viti 1964 ishte vetëm si lektorat në kuadër të Katedrës së Sllavistikës, më pas në vitin 1967-68 u shndërrua në seminar për gjuhën shqipe, ndërsa nga viti 1971-72 u nda si katedër më vete në kuadrin e Fakultetit të Filologjisë) dhe në Fakultetin Pedagogjik (prej vitit 1967). Shumë më vonë u hapën edhe universitete ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe: në vitin 1994 u themelua Universiteti i Tetovës, në vitin 2001 u hap Universiteti i Europës Juglindore dhe në vitin 2015 u hap Universiteti "Nënë Tereza". Institucione të tjera që merren me gjuhën shqipe janë Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (nga viti 2007), Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (nga viti 2019) dhe Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve (nga viti 2019).

Edhe pse kanë kaluar plot 50 vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, ende flasim për moszbatim të plotë të shqipes standarde në të gjitha institucionet në RMV, e sidomos në shkolla dhe universitete. Janë mbajtur shumë konferenca shkencore, emisione televizive dhe në radio,

tribuna dhe tryeza shkencore lidhur me çështjet e shqipes standarde, megjithatë ende nuk kemi arritur në cilësinë që kërkojmë. Pas vitit 2019 përdorimi i shqipes nëpër institucionet e Maqedonisë së Veriut mori një hov të madh, mirëpo në disa institucione ende ka ngecje të mëdha ose refuzim të plotë për shkak të albanofobisë. Megjithatë, përkrah kënaqësisë dhe gëzimit të madh për shqiptarët, se shqipja po përdoret nëpër institucione dhe tash po zgjerohet edhe në disa segmente të tjera, për albanologët u hap një plagë e rëndë, për shkak se shqipja që filloi të përhapet, jo gjithmonë është në nivelin dhe cilësinë e duhur; shpesh ka shkarje nga normat gjuhësore dhe vende-vende arrin deri në shtrembërim të skajshëm normativ.

Niveli i shqipes standarde në periudha të ndryshme historike në Maqedoninë e Veriut ka ngritje-ulje dhe ndryshueshmëri në shtresa të ndryshme shoqërore dhe në grupmosha, dallon nga institucioni në institucion, ndryshon nga një qytet në tjetër etj. Në anën tjetër, një pjesë e madhe e terminologjisë tekniko-shkencore, politike e ekonomike janë me burim të huaj, sidomos nga anglishtja apo nga gjuhët neolatine, kështu që janë të shpeshta rastet kur fjalitë e shqipes ndërtohen me mënyrën e të menduarit dhe me krijime njësisish sintaksore në frymën e maqedonishtes apo të anglishtes. Para 2-3 dekadash dallonte shumë varieteti gjuhësor i të arsimuarve nga ai i të paarsimuarve, kurse tash edhe të arsimuarit, qofshin me diplomë universitare apo edhe masteri, nuk e zbatojnë gjuhën standarde mirëfilli.

Sidoqoftë, nuk duhet harruar se gjendja në të cilën jemi ne shqiptarët e Maqedonisë së Veriut i ka rrënjët shumë më të thella nga sa na duket. Në LDB nga popujt ballkanikë shqiptarët u çliruan të fundit, kurse për shqiptarët që mbetën në ish-Jugosllavi robëria vijoi edhe më tutje, jeta e tyre politike, ekonomike e kulturore u bë edhe më e rëndë e madje e mjerueshme, sepse nuk gëzonin as të drejtat elementare kombëtare. Pushtetmbajtësit e asaj kohe, që zbatonin një politikë shkombëtarizuese, e kishin ndaluar rreptësisht përdorimin e shqipes letrare. Për përpjekjet më të vogla për të komunikuar me shkrim në shqip, shqiptarët pësonin dënime të rrepta e tortura barbare. Për këtë, përveç të tjerash, flet edhe fakti se, në këto vise 90% e popullsisë shqiptare ishin analfabetë, sidomos femrat.<sup>69</sup> Mbyllja e paraleleve shqipe në shkollat e mesme, mbyllja e Akademisë Pedagogjike, programet e cinguar në mjetet e informimit në gjuhën shqipe, krijuan pengesa serioze në zhvillimin arsimor, kulturor dhe shkencor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Natyrisht, se nga kjo gjendje kemi trashëguar plagë shumë të rënda në shumë sfera të jetës, por më së shumti në përvetësimin e shqipes standarde.

Në analizën e bërë duke krahasuar fshatrat dhe qytetet e Maqedonisë së Veriut me popullsi shqiptare, rezultoi se qytetet e ruajnë më mirë standardin (bëhet fjalë për zbatim nëpër institucione: administratë, shkollë,

<sup>69</sup> ITSHKSH - Shkup, *Remzi Nesimi për gjuhën shqipe*, Shkup, 2019, f. 99.

medie dhe jo në rrugë apo në familje), për arsye se nëpër disa familje elitare qytetare që në shtëpi është kultivuar një variant gjuhësor që është shumë afër gjuhës standarde ose thënë ndryshe një ligjërim bisedor me një përkujdesje më të veçantë, por edhe për shkak të nivelit arsimor të popullatës dhe privilegjet që i gëzonin banorët e qyteteve.<sup>70</sup>

Për më tepër, nëse përpiqemi të bëjmë një renditje të qyteteve sipas nivelit të përvetësimit të gjuhës standarde, mund të jetë si vijon: Strugë, Dibër, mbase edhe Manastiri (në radhë të parë), pastaj Kumanovë, Shkup, Tetovë, e pastaj të tjerat. Faktori i kësaj renditjeje është se nëpër qytete brenda në familje është përdorë edhe gjuha turke krahas shqipes, e cila bën që të pikaset një shqiptim karakteristik që dallon nga shqiptimi standard. Ndërsa, Struga dhe Dibra veçohen, për fat të mirë, për arsye se tradita e shkollimit dhe niveli i arsimimit ka qenë gjithmonë i lartë te një numër i konsiderueshëm i popullsisë; pastaj kontaktet e pandërprera ilegale me Shqipërinë dhe ndikimi pozitiv i programeve të TVSH-së edhe në kohën e komunizmit; ardhja e mësuesve nga Korça, Pogradeci ose vendeve të tjera të Shqipërisë; në Strugë mund të shtojmë dhe bashkëjetesën e tri të folmeve (gegërishtja qendrore, toskërishtja veriore dhe e folmja kalimtare në qytet) e të gjitha këto kanë ndikuar që edhe e folmja të jetë sa më afër standardit, pra t'i ngjasojë pak a shumë ligjërimin libror. Në shkollat e Strugës edhe sot e gjithë ditën gjuha standarde zbatohet me përkushtim të madh edhe në fshatrat gege, e nuk diskutohet që edhe në fshatrat toske dhe në qytet. Vetëm se këtu duhet theksuar patjetër se Dibra afrohet edhe me Kërçovën në këtë renditje, konkretisht është fjala për shqiptimin e diftongojeve dhe diftongoideve dialektore kur e flasin shqipen standarde, pastaj ndërtimi i lidhore me pjesëzën **të + dëftore** në kohën e tashme në vend të **të + pjesore**, si p.sh.: *Nuk guxon të vjen...* (ai / ajo nuk guxon të vijë). *Nuk guxon t'i sheh ajo fëmijët* (nuk guxon t'i shohë) ose forma të tipit: *Nëse vie, duhet të ...* (nëse vjen). *Mos ma bën këtë* (mos ma bëj këtë) etj.<sup>71</sup>

Në Shkup shqipja standarde është ruajtur dhe kultivuar për shkak të institucioneve të vetme dikur (shtypi dhe TV) dhe elitës intelektuale, edhe pse kanë qenë pak në numër. Bile mund të thuhet se kultivues apo zbatues të standardit kanë qenë banorët e qyteteve të tjera të Maqedonisë së Veriut, të cilët kanë ardhur të jetojnë në Shkup, pasi janë punësuar në institucione me ndikim. Në këtë grup rangohen edhe Kumanova me Tetovën, për shkak të afrisë dhe kontakteve me Shkupin, por edhe përpjekjeve për ta tejkaluar atë si rrjedhojë e konkurrencës.

Në Tetovë pas hapjes së dy universiteteve ka përmirësim të dukshëm të nivelit të zbatimit të shqipes standarde, nëse krahasojmë me periudhën kur

<sup>70</sup> Më gjerësisht rreth kësaj shih: Ajten Qamili. *Laryshia e përvetësimit të shqipes standarde në Maqedoni ndër vite*, Konferenca VII Shkencore Ndërkombëtare "Gjuha, letërsia dhe kultura shqiptare nga Pavarësia deri sot", Tetovë, 23 nëntor 2012.

<sup>71</sup> Më gjerësisht rreth kësaj shih: Ajten Qamili. *Shqipja "standarde" e studentëve të Maqedonisë*, Konferencë shkencore "Dyzet vjet të shqipes standarde", Prishtinë, 7 – 8 dhjetor 2012.

popullata e Tetovës dhe e Gostivarit kryesisht merreshin me tregti (ëmbëltore) nëpër bregdetin e ish-Jugosllavisë dhe tash, mund të thuhet se sllavizmat janë pakësuar bukur mirë.

Sipas një klasifikimi të popullsisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut shohim se situata është komplekse, sepse ajo ndahet në disa grupe: 1. të arsimuar: 1.1. me shkollim fillor, 1.2. me shkollim të mesëm; 1.3. me shkollim universitar: 1.3.1. në Shkup, 1.3.2. në Tiranë, 1.3.3. në Prishtinë, 1.3.4. në Tetovë dhe në qytetet e tjera të Maqedonisë së Veriut (fakultetet private apo degët e disperzuara); 1.4. me shkollim pasuniversitar dhe 2. të paarsimuar (sidomos femrat, të cilat janë shtylla e familjes dhe e zhvillimit të shoqërisë). 10-15 vitet e fundit numri i të paarsimuarve është zvogëluar shumë, bile mund të themi se nuk ka fare persona të paarsimuar, sepse shkollimi fillor dhe i mesëm janë të detyrueshëm.

Deri para se të hapen universitetet në gjuhën shqipe, shqiptarët që janë shkolluar në Maqedoninë e Veriut në gjuhën maqedonase (këtu përjashtohen profilet gjuhë dhe letërsi shqiptare dhe ai i mësuesisë, sepse atje një pjesë e lëndëve ishin në gjuhën shqipe), pa dyshim që ata kanë qenë të ngulfatur nga terminologjia sllave dhe e kanë pasur shumë vështirë të gjenden e të përkthejnë secili vetë terminologjinë profesionale të tyre në mungesë të literaturës në shqip. Pikërisht këtu ka qenë burimi kryesor i krijimit të kalkeve me strukturë sllave, që më pas të shoqërohet me një shqipe të cunguar e të shtrembëruar ashtu sikurse i ka konvencuar secilit individ. Ja disa të tilla: *Ministria për arsim* (Ministria e Arsimit), *për dallim nga* (në krahasim me), *është në pyetje kjo punë* (bëhet fjalë për këtë punë), *do të flasim për këtë pyetje* (do të flasim për këtë çështje) e shumë e shumë të tjera. Fatmirësisht, shumë nga këto gabime u korrigjuan pas themelimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (2019).

Po në këtë periudhë (para vitit 2001), shumë të rinj shqiptarë shkolloheshin në Prishtinë. Tek ata breza hetoheshin elemente kosovare, gjegjësisht të gegërishtes verilindore, gjatë përdorimit të shqipes standarde te shtresa e shkolluar; në krahasim me shtresën e paarsimuar që në vend të atyre formave përdorte forma të gegërishtes qendrore, bile shpesh të ndërthurura me struktura ose fjalë sllave. Kështu që të shkolluarit në Prishtinë, pavarësisht në cilin qytet të RMV-së jetonin dhe vepronin, përdornin paskajoren (infinitivin), togun **ua** e alternonin në **ue** ose **u:**, si p.sh. *gru, s'du*, më shumë përdornin emra prejfoljorë, sesa veprimi të shprehet me folje, p.sh.: *do të bëjmë mbjelljen e pemëve* (në vend të: *do të mbjellim pemë*), *do të kryejmë regjistrimin e studentëve* (në vend të: *do t'i regjistrojmë studentët*), *krijoi një grup pune me qëllim mbledhjen e të dhënave dialektore* (në vend të: *krijoi një grup pune për të mbledhur të dhëna dialektore*); përdornin struktura analitike foljore, në vend të atyre sintetikë, si p.sh.: *kjo u ka ndodh shkaku jot* (në vend të: *kjo ndodhi shkaku yt*) etj.

Ndërsa tiparet gjuhësore që vërehen tek ata që janë shkolluar në Tiranë janë: shqiptimi më i butë e me më pak dridhje i dridhëses /r/,

shqiptim tërësisht qiellzor i /q/-së dhe /gj/-së, përdorim të /ë/-së së theksuar të toskërishtes veriore në vend të /e/-së së theksuar, si *vënd, mëndje, mënçur*, e ardhmja ndërtohet me **do + foljen** (në vend: **do të + folja**), pastaj përdoren disa italianizma që nuk i përdor askush në Maqedoninë e Veriut etj.

Sipas të dhënave [të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Entit Shtetëror për Statistikë](#), sot në Maqedoninë e Veriut ka gjithsej 1.205 shkolla fillore dhe të mesme, ku 50% të nxënësve në fillore janë shqiptarë.<sup>72</sup> Numri i shkollave të mesme në gjuhën shqipe pas vitit 2001 është rritur dhe përveç Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare (në UKM) dhe Fakultetit Pedagogjik (në UKM), kemi edhe 3 universitete (UShT, UEJL, UNT) ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Por prapëseprapë, edhe përkundër rritjes së mundësive të arsimit në gjuhën shqipe dhe përdorimit të shqipes nëpë institucione, cilësia e gjuhës standarde që përdoret nëpër institucione po bie.

Thuhet që të shkruarit mund të mësohet, por nuk mund të jepet mësim. Ky paradoks nxjerr në pah një kuptim të rëndësishëm, se të shkruarit nuk është një veprim i thjeshtë, por është shumë i ndërlikuar dhe kërkon një zotërim të mjaftë të arritjes më të sofistikuar të mendjes njerëzore – gjuhës.<sup>73</sup> Gjuha si mjeti kryesor i zhvillimit të arsimit dhe bartjes së civilizimit brez pas brezi, funksion kryesor e ka kumtimin e ideve dhe të mendimeve tona dhe, në përshtatje me këtë funksion, gramatika, drejtshkrimi, drejtshqiptimi e të gjitha normat e tjera shërbejnë për t'i bërë sa më të qarta këto ide dhe mendime. Megjithatë, “formimi i shprehive të të shkruarit drejt dhe pa gabime gjuhësore kërkon jo vetëm njohjen e strukturës gramatikore të shqipes standarde, por edhe një punë këmbëngulëse e sistematike, që nënkupton korrigjimin e vetvetes”.<sup>74</sup> Në përballje me mjetet e informimit, me institucionet (shkollat, zyrat shtetërore dhe publike) qytetari duhet ta zotërojë shqipen standarde në mënyrë aktive. Kjo do të thotë se sot zotërimi dhe përdorimi i shqipes standarde është domosdoshmëri. Gjuha standarde nuk është trashëgimi gjenetike, ajo duhet të studiohet dhe të përvetësohet. Vatra e parë ku mësohet gjuha standarde është shkolla. Prandaj, që në klasët e ulëta duhet që nxënësve t’ua mësojmë shqipen e normuar mirëfilli dhe në të gjitha rrafshet (fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikore). Sepse, “drejtshkrimi nuk mund të zotërohet pa njohur normën gramatikore e drejtshqiptimore, as shqiptimi letrar nuk mund të përvetësohet pa zotëruar morfologjinë dhe drejtshkrimin, as norma gramatikore nuk mund të ngulitet, po s’u përdor

<sup>72</sup> <https://www.info.macedonia/629322/ja-sa-eshte-numri-i-shkollave-filllore-dhe-te-mesme-ne-maqedoni/>

<sup>73</sup> Kane, S. Thomas. *Si të shkruajmë shqip*, Manual i Oksfordit për të shkruarin dhe retorikën i përshtatur për shqipen, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2010, f. 1.

<sup>74</sup> Memushaj, R. *Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Botimet toena, Tiranë, 2005, f. 49.

në të shkruar e të folur. Të mësuarit e gramatikës, drejtshkrimimit e drejtshqiptimit si rregulla e norma pa lidhje midis tyre është i gabuar.”<sup>75</sup>

Shikuar nga ana praktike në shkollat tona përdorimi i shqipes standarde duket se është në nivel të kënaqshëm, por problemi qëndron në atë se gjërat përveçohen në mënyrë mekanike, gramatika mësohet përmendsh pa e lidhur si duhet me praktikën ligjërimore të nxënësve, në vend që nxënësit të aftësohen t’i përdorin rregullat gramatikore gjatë ligjërimit të tyre, duke shmangur trajtat dialektore dhe jonormative.<sup>76</sup>

Nga disa hulumtime që janë bërë në vitin 2008 <sup>77</sup> dhe 2020 rezultojnë se në orë të mësimit 40% nga mësuesit e gjuhës shqipe përdorin shqipen standarde, 57% përdorin shqipen standarde të gërshetuar me elemente dialektore dhe 3% flasin në të folmen dialektore. Ndërkaq, mësuesit e lëndëve të tjera vetëm 23% përdorin shqipen standarde, 75% përdorin shqipen standarde të gërshetuar me elemente dialektore dhe 2% përdorin të folmen dialektore. Në anën tjetër, gjatë orës së mësimit vetëm 20% të nxënësve flasin në shqipen standarde, 60% përdorin shqipen standarde të gërshetuar me elemente dialektore dhe 20% të nxënësve përdorin të folmen dialektore. Shpesh ndodh që të rinjtë e sotëm të kenë turp ta flasin gjuhën standarde, sepse përqeshen nga shoqëria, në vend që të përpiqen ta mësojnë e ta përdorin në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të krenohen me atë.

Për një gjuhë me standardizim të vonë, siç është gjuha shqipe, e cila flitet nga një popullsi rurale që përbën rreth 60% të popullsisë së përgjithshme të trojeve shqiptare, është e kuptueshme që çështja e marrëdhënieve të gjuhës standarde me të folmet dialektore të zërë një vend të dukshëm.<sup>78</sup> Edhe në Maqedoninë e Veriut për shkak të faktorëve që përmendëm më sipër, si: analfabetizmi i një numri të konsiderueshëm të popullatës rurale, sidomos i femrave, zyrtarizimi shumë i vonuar i shqipes në administratë, rënia e cilësisë së mësuesve etj. kanë ndikuar që e folmja dialektore të dominojë mbi shqipen standarde.

Mësuesit që ishin në vitet 1972-1993, edhe pse pak në numër, punonin me entuziazëm të madh në përhapjen e dijes, me përkushtim e altruizëm e praktikonin dhe përhapnin shqipen standarde nëpër shkolla. Kurse këto tri dekadat e fundit vihet re se profesioni “mësues” që dikur ka qenë shumë i kërkuar dhe shumë i vlerësuar, autoritativ (fjala e tij ishte "ligj"), tashmë është në fund të listës së preferencave të nxënësve dhe fatkeqësisht atë e zgjedhin më shpesh nxënës jo shumë të mirë. Prandaj çdo ditë e më shumë cilësia e arsimit pëson rënie. Një ndër shkaqet kryesore që

<sup>75</sup> По аты, ф. 48 - 49.

<sup>76</sup> Këtë çështje shumë bukur e shtjellon dhe e analizon Rami Memushaj në: *Për shqipen standarde II*, Tiranë, 2012, f. 169.

<sup>77</sup> Ајтен Камили. *Социјалните варијанти на албанските струшки говори и меѓузјазичната интерференција (кај еднојазичните, двојазичните и повеќејазичните говорители*, Shkup, 2008 (punim i magjistraturës).

<sup>78</sup> Rami Memushaj. *Pasurimi i leksikut të gjuhës standarde nga dialektet - një mit gjuhësor*, Albanologjia, Vol. 3, No.5-6, Tetovë, 2016, f. 13.

kanë krijuar këtë gjendje, është paga e ulët, jomotivuese dhe e njëjtë për të gjithë mësuesit, pavarësisht punës, lodhjes apo përgjegjesisë jo të njëllojtë.

Është për t'u vënë në dukje se edhe librat shkollorë të arsimit fillor dhe të mesëm në Maqedoninë e Veriut nuk janë në cilësinë dhe nivelin që dëshirojmë, sepse kanë gabime gjuhësore, teknike, përmbajtësore e logjike. Këto gabime ndikojnë negativisht në nxënien e shqipes standarde, por edhe në cilësinë e arsimit, në përgjithësi. Prandaj, duhet që hartuesit e librave, redaktorët gjuhësorë, recensentët, përkthyesit, shtëpitë botuese ta bëjnë punën me përkushtim dhe përgjegjësi më të madhe, Ministria e Arsimit duhet të japë afat kohor më të madh dhe paga më të larta për të gjithë këta, kështu që në të ardhmen të mos lejohet që të përsëriten lëshime të tilla.<sup>79</sup>

Viteve të fundit, qëkur filloi zbatimi i pjesërishëm i dygjuhësisë në administratë, me shpejtësi dhe me ngut filluan të përkthehen shkresat administrative, mbishkrimet, vulat, memorandumet etj., por jo gjithnjë ndodh që ato përkthime t'i bëjnë njerëz të kualifikuar. Mjerisht këtë detyrë të çmueshme shpesh e kryejnë njerëz të pakualifikuar ose përkthyesit më të dobët, të cilët duke mos e njohur plotësisht drejtshkrimin e shqipes, shumë lehtë ndikohen nga gjuha që përkthejnë, në këtë rast nga maqedonishtja, si: terminologjia administrative, emërtimet e disa proceseve apo dukurive sipas formave që i kanë pranuar gjuhët sllave, togje dhe lokucione të kalkuara etj.

Përpos ndikimit nga trajtat dialektore dhe nga maqedonishtja, sfidë më e madhe me të cilën ballafaqohet sot shqipja është epoka e kompjuterizimit. Ky revolucion tejet i rëndësishëm teknologjik, që mundëson ndërlidhje dhe mundësi të lartë informative në trendët globale, po shpërdorohet nga rinia e sotme, edhe pse niveli i arsimit tani po arrin kulmin. Nga shumë analiza dhe hulumtime që janë bërë lidhur me ndikimin e internetit në shumë gjuhë botërore, janë vënë në pah dukuri të ndryshme gjuhësore. Disa nga dukuritë gjuhësore që i krijuan përdoruesit e rrjeteve sociale në mënyrë që të ndërveprojnë midis tyre dhe të përcjellin përjetime të ndryshme emocionale, janë të përgjithshme dhe kanë depërtuar pothuajse në të gjitha gjuhët e botës, kurse disa janë të veçanta për gjuhë të veçanta. Natyrisht, se edhe në gjuhën shqipe janë krijuar disa dukuri tipike nga interneti, duke filluar nga ato të përgjithshmet, si: shkurtesat *FLM*, *KLM*, *t h z*, *ktst*, *fmljn* (= familjen - të shkruarit pa zanore); pastaj: mospërdorimi i [ë]-së dhe [ç]-së dhe zëvendësimi i tyre me [e] dhe [c], gërshetimi i të folmeve dialektore brenda të njëjtit tekst ose përdorimi i veçorive dalluese dialektore gege nga toskët dhe anasjelltas; krijimi i zhargonit të internetit, përsëritja e shenjave të pikësimit (?????, !!!!!, ?!?!?!?); përsëritja e fjalëve, e zanoreve ose e bashkëtingëlloreve (*aaaaa*, *mmmm*, *hmmm*, *psee*);

<sup>79</sup> Më gjerësisht për këtë shih: Ajten Hajdari-Qamili. *Niveli gjuhësor në tekstet shkollorë të arsimit fillor në RMV*, Konferenca e parë shkencore: Shqiptarët, shkollat, programet mësimore dhe tekstet shkollorë në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Organizata joqeveritare "Nisma", Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 15.06.2019, f. 38 - 48.

zëvendësimi i fjalëve ose një pjese të fjalës me simbole të ndryshme ose numra (*vër8, 5imist*); shkronjat e mëdha në mes të fjalisë ose në të gjithë fjalinë (*të dua TYY*), pasthirrmat e ndryshme (*uaaa, ncnncn*), emotikone, përdorimi i anglizmeve (qofshin shkurtesa, fjalë apo fjali të tëra); të shkruarit e emrave të njerëzve të huaj ashtu siç shkruhen në gjuhën origjinale, në vend që të shkruhen sipas parimit fonetik të shqipes, pra ashtu siç lexohen dhe pa i vendosur në rasat përkatëse, si p.sh.: *Clinton për Klinton, Klintoni, Klintonit, Klintonin* etj.<sup>80</sup>

Për ta pasur më të qartë trysninë e madhe që shqipja po e përjeton nga anglishtja, do të paraqesim rezultatet e projektit *Web Characterization* të OCLC-së 4, të realizuar në vitin 2002, ku thuhet se deri 72% e përmbajtjeve nëpër faqe të internetit janë anglisht, 7% gjermanisht, 6% japonisht, 3% spanjisht, 3% frëngjisht dhe 9% në gjuhët e tjera të botës.<sup>81</sup> Dhe jo vetëm kaq. E keqja më e madhe që vjen nga interneti (rrjetet sociale), është një dukuri shumë e dhimbshme që po përhapet te fëmijët shqiptarë, e ajo është se nuk arrijnë ta mësojnë mirë gjuhën e tyre amtare, ngaqë rriten duke dëgjuar më shumë anglishten, sesa shqipen. Fëmijët 2-6 vjeç në familjet 100% shqiptare flasin anglisht, gjegjësisht dëgjojnë prindërit shqip, por u përgjigjen anglisht ose gërshetojnë fjali me fjalë shqipe dhe anglishte, kurse nëpër çerdhe apo në park fëmijët mes vete flasin anglisht. Shumë mësuese të klasës së parë kanë vështirësi të mbajnë mësim, sepse sipas tyre 80% të fëmijëve nuk e dinë shqipen mirë.<sup>82</sup>

Për këtë çështje shqetësohen shumë albanologë. Gj. Shkurtaj thotë se “kjo situatë që nuk është vetëm e gjuhës shqipe, por edhe e kulturës së sotme shqiptare “në tranzicion”, na trishton dhe na bën të trembemi se e ardhmja e shqipes nuk do të jetë e mirë, në qoftë se nuk punojmë me gjithë shpirt, me përkushtimin dhe devotshmërinë më të lartë, për ta mbrojtur gjuhën tonë të bukur.”<sup>83</sup> Ai shpesh në kumtesat, librat dhe deklaratat në medie ka thënë se të rinjtë shqiptarë i dinë aq mirë gjuhët e huaja, sidomos anglishten, italishten, frëngjishten etj., por “për fat të keq kemi aq pak njerëz që dinë ta flasin e ta shkruajnë shqipen ashtu si duhet” dhe nxjerr mllëfin duke përdorë emërtimin e Faik Konicës për gjuhëprishësit si “analfabetë me diplomë”.<sup>84</sup>

<sup>80</sup> Më gjerësisht për këtë shih: Ajten Hajdari-Qamili. *Dukuritë gjuhësore që i krijoi interneti dhe rrjetet sociale*, Konferenca e Shtatë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit filologjik - ISCFP, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 16-18 nëntor 2022 (në bashkautorësi me V. Ismani).

<sup>81</sup> [www.i-uk.com/servlet](http://www.i-uk.com/servlet)

<sup>82</sup> Më gjerësisht për këtë shih: Ajten Hajdari-Qamili. *Ndikimi i internetit dhe videoljërave në (mos)nxënien e shqipes te fëmijët parashkollorë në RMV*, Seminari XVI Ndërkombëtar i Albanologjisë “Kultura dhe Globalizimi”, Tetovë, 28 shtator 2022.

<sup>83</sup> Shkurtaj, Gj. *Si të shkruajmë shqip, Nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale*, Botimet toena, Tiranë, 2008, f. 12.

<sup>84</sup> Shkurtaj, Gj. *Urgjenca gjuhësore*, Naimi, Tiranë, 2017, f. 199-200.

Mjetet më me ndikim dhe që më shumë e më shpejt përhapin informata, njohuri, model që duhet ndjekur për mënyrën e të folurit dhe të shkruarit janë mediet. TVM2 - programi në gjuhën shqipe (më parë quhej Radio Televizioni i Shkupit), atë fare pak kohë që e kishte në disponim për ta shfrytëzuar, e ruante dhe kultivonte me kujdes të veçantë shqipen standarde. Pas pavarësisë së Maqedonisë (1991) u bë shumë aktuale hapja me shumicë e televizioneve, radiove dhe portaleve private. Për shkak të mungesës së redaktorëve gjuhësorë dhe mospërzgjedhjes së kuadrit cilësor në këto medie, që atëherë filloi të bjerë niveli i zbatimit të gjuhës standarde, duke u thurur e gërshetuar me elemente herë dialektore, herë nga idiolekti e herë nga gjuhët e huaja. Emërtimet e emisioneve televizive ose të radios shpesh janë tërësisht në gjuhë të huaja. Disa nga gabimet gjuhësore që përhapen nëpër mediet e Maqedonisë së Veriut janë ndikime të drejtpërdrejta nga mediet private të Shqipërisë dhe të Kosovës, duke menduar se ata duhet të merren për model, por në fakt edhe ata e abuzojnë shumë shqipen standarde. Mediet duhet të lihen në duar të sigurta e jo të eksperimentohet me ato, sepse pasojat mund të jenë fatale.

### **Përfundim**

Në fund mund të përmbylлим se gjatë 50 viteve shqipja standarde në Maqedoninë e Veriut ka përjetuar shumë sfida për shkak të politikave antishqiptare, mungesa e shkollave shqipe, moslejimi i përdorimit të shqipes në administratë, trysnia e madhe nga maqedonishtja, serbokroatishtja, së fundi edhe nga anglishtja, nga teknologjia moderne dhe botëkuptimi i rinisë së sotme. Po ashtu, duhet vënë në spikamë se nga gjeneratat e reja çdo ditë e më shumë po zbehet vlera e shumë gjërave kulturore e shpirtërore në krye të të cilave edhe gjuha standarde. Për këtë situatë nuk duhet të fajësojmë vetëm njërin palë apo strukturë shoqërore, sepse ky është një sistem dhe duhet të funksionojë si i tillë, pra secili element duhet ta kryejë obligimin që ka, duke bashkëvepruar me elementet e tjera për ta krijuar tërësinë (nxënësi – mësuesi – familja – institucionet – mediet). Kjo gjendje mund të përmirësohet me një strategji për të vetëdijësuar shoqërinë dhe institucionet për vlerën dhe rëndësinë e gjuhës standarde të një kombi, sepse zbatimi i saj me korrektesë duhet t'i interesojë tërë shoqërisë e jo vetëm gjuhëtarëve. Strategjia e investimit në dijen shkencore në gjeneratat e reja përplot elan, së bashku me aftësinë për t'i përthithur të arriturat shkencore duhet të përmirësohet, por jo duke bërë eksperimentim që i kalon caqet hapësinore dhe kohore, sepse atëherë ai bëhet i dëmshëm dhe ndikon negativisht. Në këtë kontekst do të ishte e nevojshme të organizohet një studim empirik, i cili do të gjurmonte edhe më thellë korrelacionet që arsimi i ushtron me institucionet e tjera shoqërore, si familja, ndërmarrjet, shoqëria civile, mediet etj., të cilat do të sjellin prurje më të mëdha për përvetësimin dhe zbatimin e shqipes standarde.

**Bibliografia:**

- Ajten Kamili. *Социјалните варијанти на албанските струшки говори и меѓузajичната интерференција (кај еднојазичните, двојазичните и повеќејазичните говорители*, Shkup, 2008 (punim i magistraturës).
- Ajten Qamili. *(Mos)zbatimi i shqipes standarde në Maqedoni*, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare, (13. 06. 2012), Shkup, Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve, Shkup, 13 qershor 2012.
- Ajten Qamili. *Laryshia e përvetësimit të shqipes standarde në Maqedoni ndër vite*, Konferenca VII Shkencore Ndërkombëtare “Gjuha, letërsia dhe kultura shqiptare nga Pavarësia deri sot”, Tetovë, 23 nëntor 2012.
- Ajten Qamili. *Shqipja “standarde” e studentëve të Maqedonisë*, Konferencë shkencore “Dyzet vjet të shqipes standarde”, Prishtinë, 7 – 8 dhjetor 2012.
- Ajten Hajdari-Qamili. *Dukuritë gjuhësore që i krijoi interneti dhe rrjetet sociale*, Konferenca e Shtatë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit filologjik – ISCFP, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 16-18 nëntor 2022 (në bashkautorësi me V. Ismani).
- Ajten Hajdari-Qamili. *Gabimet gjuhësore në shkresat e administratës publike në RMV*, Universiteti i Tetovës, Seminari XIV “Sfidat e (mos)zbatimit të ligjit të gjuhëve në Maqedoninë e Veriut dhe gabimet gjatë përdorimit të shqipes standarde”, Live në Facebook, Tetovë, 25 nëntor 2020.
- Ajten Hajdari-Qamili. *Ndikimi i internetit dhe videolojërave në (mos)nxënien e shqipes te fëmijët parashkollorë në RMV*, Seminari XVI Ndërkombëtar i Albanologjisë “Kultura dhe Globalizimi”, Tetovë, 28 shtator 2022.
- Ajten Hajdari-Qamili. *Niveli gjuhësor i mbishkrimeve dhe artikujve të përkthyer në shqip*, Instituti Albanologjik- Prishtinë, Konferenca Shkencore “Java e Albanologjisë” 23 -27 maj 2016, Prishtinë.
- Ajten Hajdari-Qamili. *Niveli gjuhësor në tekstet shkollore të arsimit fillor në RMV*, Konferenca e parë shkencore: Shqiptarët, shkollat, programet mësimore dhe tekstet shkollore në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Organizata joqeveritare “Nisma”, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 15.06.2019, f. 38 – 48.
- Ajten Hajdari-Qamili. *Përmirësimi i cilësisë së shqipes standarde në institucionet e Maqedonisë*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Scupi vëllimi 22, Gjuha shqipe në Maqedoni – histori dhe perspektiva (Panel shkencor mbajtur më 18.06. 2018, Shkup), Shkup, 2018, f. 101 - 109.
- Ajten Hajdari-Qamili. *Zbatimi i shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut*, Konferenca shkencore “Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë

- së Veriut”, Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve e RMV-së, mbajtur më 30.09.2019, Dita Ndërkombëtare e Përkthimit, Shkup, 2020, f. 11-31.
- Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. **Drejtshkrimi i gjuhës shqipe**, Tiranë, 1973.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, **Konferenca shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot"**, Tiranë, 11 – 12 nëntor 2002, Shtëpia botuese "Shkenca", Tiranë, 2003.
- Gjovalin Shkurtaç. **Si të shkruajmë shqip, Nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale** (Ligjërata dhe elemente të domosdoshme shkrimtarie), BOTIMET TOENA, Tiranë, 2008.
- Gjovalin Shkurtaç. **Urgjenca gjuhësore, Naimi, Tiranë, 2017.**
- ITSHKSH – Shkup. **Remzi Nesimi për gjuhën shqipe, Shkup, 2019.**
- Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë. **Studime filologjike**, 3 – 4, VITI LXII (XLVII), Tiranë, 2008.
- Rami Memushaj. **Pasurimi i leksikut të gjuhës standarde nga dialektet – një mit gjuhësor, Albanologjia, Vol. 3, No.5-6, Tetovë, 2016.**
- Rami Memushaj. **Për shqipen standarde II, Tiranë, 2012.**
- Rami Memushaj. **Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë**, BOTIMET TOENA, Tiranë, 2005.
- Thomas S. Kane. **Si të shkruajmë shqip, Manual i Oksfordit për të shkruarin dhe retorikën i përshtatur për shqipen**, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2010.

<https://www.botasot.info/maqedonia/629322/ja-sa-eshte-numri-i-shkollave-filllore-dhe-te-mesme-ne-maqedoni/>

<https://portalb.mk/162686-50-e-nxenesve-ne-maqedoni-jane-shqiptare/>

[www.i-uk.com/servlet](http://www.i-uk.com/servlet)

ISSN 2671-3004

UDC 305-055.2:340.132(=18)

Punim studimor

**Teuta ARIFI**

Katedra për gjuhë dhe letërsi shqipe,  
Fakulteti Filologjik, Shkup  
teutarifi@gmail.com

## **GRUAJA NË TRADITËN ZAKONORE SHQIPTARE THE WOMEN IN ALBANIAN CUSTOMARY TRADITION**

### **Abstrakt**

Ky punim ka për qëllim vështrimin e traditës zakonore shqiptare, përkatësisht *kanuneve* shqiptare nga perspektiva e të drejtave gjinore si dhe trajtimi që i bëhet gruas në normat e përcaktuara kanunore. Në kuptimin kulturor dhe kombëtar *kanunet* shqiptare kanë rëndësinë e tyre të veçantë si dokumente të normuara me të cilët rregullohen raportet dhe jeta ditore në shoqëri, duke krijuar kështu jo vetëm ligjet e funksionimit të një shoqërie, por njëkohësisht vlerat etiko-morale të cilat karakterizojnë një komb. Tradita zakonore ndërton kështu peshën e saj të jashtëzakonshme ontologjike dhe aksiologjike duke krijuar parakushtet e ndërtimit të raporteve shqiptare brenda vetes dhe në raport me kombet e tjerë ballkanikë dhe europianë. Aspekti tjetër me rëndësi i normave të traditës zakonore shqiptare ka të bëjë me trajtimin e gruas dhe vlerave të saj në tekstet kanunore. Nga analiza e normave kanunore konstatohet se gruaja ka pozitë periferike dhe marginale dhe kjo traditë zakonore është patriarkale në definimin e shoqërisë, ndarjen e funksioneve gjinore duke minimizuar praninë e gruas në shoqëri, mohimin e të drejtës së gruas për të trashëguar pronë dhe përjashtimin e gruas nga të gjitha vendimet shoqërore. Nëse përcjellim qasjen historike që sjell de Bovoire lidhur me pozitën e gruas gjatë historisë, atëherë konkludojmë që normat zakonore shqiptare nuk janë një përjashtim nga historia botërore e marginalizimit të gruas e identifikuar si *tjetra* identitare në periferitë shoqërore. Ashtu si ndryshimi i këtij realiteti mijëvjeçar shënon një progres të madh përgjatë shekujve 20 dhe 21, studimi i pozitës së grave në traditat zakonore botërore na ofron shpjegimet e duhura për sfidat dhe sprovat që has beteja për barazi në këtë botë shumidentitare dhe shumëkulturore.

*Fjalë kyçe: kanuni, gratë, familja, besa, kultura;*

### Abstract

This paper explores Albanian customary tradition, specifically *the Albanian Kanun* through the lens of gender rights, focusing on how women are positioned and treated within these traditional norms. From both cultural and national perspectives, *the Kanun* hold significant value as codified system that once governed daily life and social relations. More than mere sets of rules, they reflect the ethical and moral foundations that helped shape Albanian identity. As such, customary tradition carries substantial ontological and axiological weight, forming the basis of intra-Albanian social dynamics and as well as interactions with neighboring Balkan and European societies. A central focus of this study is the role and status of women as defined by *Kanun* norms. The analysis reveals that women occupied a peripheral and marginalized position, with the *Kanun* reinforcing a patriarchal model of society. This framework imposed strict gender roles, excluded women from property inheritance, and denied them a voice in societal decision-making. Drawing on Simone de Beauvoir's historical perspective on the status of women, the paper argues that Albanian customary tradition is not an exception but part of a broader global narrative of female marginalization—where women have historically been cast as “*the Other*” in social hierarchies. While significant progress has been made in the 20th and 21st centuries toward gender equality, examining women's place in customary traditions worldwide helps illuminate the enduring challenges faced by this struggle in a diverse and multicultural world.

*Keywords: Kanun, women, family, honor, culture;*

### Shënime hyrëse

Të shkruash dhe studiosh pozitën e gruas në normat zakonore përbën një aventurë të veçantë, mendimi apo studimi. Dhe nuk mund të mos ishte një aventurë të parashtruarit e pyetjes se sa këto norma zakonore përfshijnë brenda vehtes vlerat e *tjetrës*, në këtë rast vlerat femërore. Çështja e marrëdhënieve ndërgjinore apo çështja e ndërkomunikimit dhe balansit në raportet mes gruas dhe burrit brenda traditave të ndryshme botërore është një çështje e vjetër po aqë sa është i vjetër qytetërimi botëror. Duke u hedhur një vështrim këtyre shekujve të kaluar konstatojmë se gjatë përcaktimit të normave të funksionimit të këtyre shoqërive, idetë dhe karakteret femërore janë përjashtuar nga këto shoqëri dhe veçanërisht nga ngjarjet me rëndësi të veçantë shoqërore. Historia e qytetërimit që nga fillimet e veta e gjer më sot është kryesisht histori e vlerava të ndërhuara ekskluzivisht vetëm nga njëra gjini. Origjina e një realiteti të tillë gjendet tek miti i dikurshëm, tek marrëveshja historike mes gruas dhe burrit. Shikuar nga perspektiva e sotme ajo marrëveshje e dikurshme duket tejet e thjeshtësuar. Gruaja dhe burri u muarën vesh se si në një mënyrë më të lehtë të vendosnin nën sundim botën të cilën nuk e njihnin dhe që dukej e egër dhe e pashtuar. Kështu edhe ndodhi. Burri

kaloi pragun e shtëpisë e doli për të gjetur ushqimin për mbajtjen e familjes, ndërkaq gruaja mbeti në anën tjetër të pragut për ta gatuar në kuzhinën e theshtë të saj atë që burri e gjuante me mund. Mbase rreth shtëpisë së saj kishte dhe një copë toke të cilën gruaja e punonte duke përkujtuar kështu instiktin e saj për riprodhim dhe rikrijim të jetës së gjallë. Megjithatë, thellë në veten e vet historia e qytetërimit mban shenjën e kësaj ndarjeje të madhe e të thellë të sferave të ndikimit shoqëror. Duke gjuajtur ushqimin burri njëkohësisht njihte dhe botën e cila ishte tërheqëse, e paparashikueshme dhe e panjohur. Duke udhëtuar ai njohu kontinentet e ndryshme bashkë me popuj të ndryshëm për nga gjuha, kultura apo raca e tyre. Duke lundruar në oqeanet pa fund ai kuptoi se toka ishte e rrumbullakët, se mund të fluturohet edhe pa fletët e Ikarit dhe mësoi se si duket kjo Tokë e veçantë e jona nga largësia e një Hëne. Të gjitha këto gjëra burri i mësoi çastin kur kaloi pragun, atë prag fatal të cilin e ëndërrojmë të gjithë kur gjendemi larg tij dhe duam sa më shpejt ti kthehemi përsëri.

Gruas nga ana tjetër e këtij pragu, sipas kësaj marrëveshjeje të pafirmosur, i mbeti pritja. Pritja e një gruaje për kthimin e burrit të saj nga luftërat dhe pushtimet është koncept sa mitologjik po aqë dhe aktual (Zamarovsky, 1985:406), duke ndërtuar kështu një qasje të veçantë civilizuese ndaj kategorisë së pritjes. Në këtë mënyrë, vlera e gruas në shoqëri smadhohej në linjë progresive me atë se sa zgjaste pritja për kthimin e burrit të saj nga udhëtimi që zgjaste pa mbarim. Nga ana tjetër, duke lëvizur nëpër Botën e gjerë, burri zbuloi mjetet e udhëtimit ashtu që të kthehej sa më shpejtë tek pragu. Dhe derisa këto mjete udhëtimi ndryshonin me kohën duke u bërë më moderne, më të shpejta dhe më reaktive, pragu mbetej i njëjti ashtu siç e njëjtë mbetej gruaja në pritje. Ajo mund të kishte emra të ndryshëm, nga Penelopa e deri tek Lenora, nga Marigoja e deri tek Judita, por vetëm një emër kishte pritja e saj – të qenit grua.

Duke u nisur nga kjo rrjedhë e zhvillimit të ngjarjeve sipas të cilave *parimi aktiv* i ndryshimit të situatave të caktuara i takoi burrit, ndërkohë që *parimi pasiv* ai i të pranuarit të ndryshimeve të bëra i takoi gruas, analiza e traditës zakonore dhe të drejtës të dalë nga kjo traditë ka për qëllim vënien në pah të rrethanave shoqërore të cilat prodhojnë këto parime. Duke analizuar traditën zakonore shqiptare bëhet e qartë se ashtu siç është rasti me traditat zakonore të popujve të ndryshëm, se kjo traditë zakonore funksionon sipas konceptit patriarkal i cili përcakton në mënyrë të padebatueshme vendin e gruas në shoqëri. Prandaj edhe të kuptuarit e këtij koncepti dhe analiza e të njëjtit na mundëson të lëvizim përpara duke kuptuar traditën dhe të kaluarën dhe njëkohësisht të vendosim në këmbë të fuqishme idenë dhe nevojën për një barazi të plotë gjinore.

### **Kanunet shqiptare si definues dhe mbrojtës të vlerave kolektive**

E drejta zakonore shqiptare është e shkruar në më shumë kanune nga të cilat veçojmë: Kanunin e Arbërisë ose Skënderbeut, Kanunin e Lek Dukagjinit, Kanunin e Zhulit dhe Kanunin e Labërisë. Këto kanune

rregullojnë të njëjtat sfera të jetës shoqërore dhe bazohen mbi të njëjtat parime, kurse dallojmë disa sosh si rezultat i faktit që me këto kanune mbulohet gati se i gjithë territori etnik i banuar nga shqiptarët-arbërorë. Analiza e këtij punimi bazohet në dy tekste kanunore, pra në *Kanunin e Lek Dukagjinit* dhe *Kanunin e Skënderbeut* si tekstet më të plota kanunore të cilave kemi mundësi tu referohemi deri në ditët e sotme. Po cila është rëndësia e këtyre kanuneve për shoqërinë shqiptare dhe cili është roli i tyre në ndërtimin dhe ruajtjen e parimeve të funksionimit të kësaj shoqërie? Këto kanune si përmbledhje e rregullave të funksionimit të një shoqërie janë një përpjekje sublime për rregulluar raportet dhe organizuar bashkësinë në bazë të parimeve të qarta dhe të dakorduara nga krerët e fiseve e bajraqeve. Kanuni i Lek Dukagjinit dhe ai i Skënderbeut i rregullojnë deri në detaje të gjitha sferat e jetës duke përfshirë këtu edhe ato sfera të cilat në shikim të parë duken si të parëndësishme. Këto kanune rregullojnë çështje të thelbore që kanë të bëjnë me traditën duke kodifikuar çështjet që kanë të bëjnë me nderin, rregullat e sjelljes së individit që nga lindja e deri në vdekje, gjakmarrjen, pra vlera etike të definuara si nderi dhe respekti të cilin duhet ta ndërtojë dhe gëzojë një individ brenda bashkësisë shoqërore. E drejta zakonore shqiptare nuk e njeh jetën pa nder e respekt. *Kanunet* shqiptare rregullojnë edhe gjëra në shikim të parë margjinale, si për shembull statusin e farkatarit në një fshat, statusin e rroghtarit apo rradhën e përdorimit të ujit në mulli, që duken të thjeshta nga perspektiva e sotme, por të parapara në *kanun* si mbajtje e rradhës së funksionimit institucional e ekonomik gjithnjë duke pasur parasysh faktin që problemet e mëdha lindin shpesh nga gjërat e vogla. *Kanunet* përbëjnë një dëshmi faktografike mbi jetën materiale dhe veçanërisht dëshmojnë pasurinë shpirtërore kombëtare të kodifikuar nen pas neni në këto norma tradicionale. Themel i kësaj tradite zakonore shqiptare është pikërisht ky kanonizim monumental i faktografisë, dinamikës, relacioneve dhe mbi të gjitha i standardeve aksiologjike dhe përpjekjeve etnike shqiptare, një realizim i suksesshëm normativ, i veçantë duke pasur parasysh faktin që të rralla janë rastet e ngjashme në historinë e përpjekjeve njerëzore për të krijuar një shprehje autorefleksive të universit të vet kulturor (Myxik, 1994:10).

Kanunet e Lek Dukagjinit dhe Skenderbeut janë ruajtur për shekuj me rradhë në formë të shprehjes gojore nga një gjeneratë në tjetrën si dhe duke u praktikuar në jetën e përditshme të bashkësisë etno-shoqërore. Praktikimi i normave kanunore ka zgjatur më shumë në zonat Veriore ku jetojnë shqiptarët pavarësisht kufijve shtetërorë që kanë ndarë shqiptarët por që nuk ia kanë dalë të ndërpresin këto tradita zakonore shekullore. Por, shikuar nga aspekti ekspertizës dhe analizës së teksteve, normave dhe parimeve kanunore, një moment kyç përbën botimi i këtyre teksteve në formë të shkruar. Materialet për tekstet e këtyre kanuneve janë mbledhur në terren vite me rradhë për tu botuar më vonë si tekste të veçanta edhe atë, *Kanuni i Lek Dukagjinit* i botuar si rezultat i punës së jashtëzakonshme

të At Shtjefën Gjeçovit dhe *Kanuni i Skenderbeut* si rezultat i punës po aqë vetëmohuese të At Fran Ilisë nga Shkodra. Këto kanune, parashrimi normativ dhe të praktikuarit e të cilëve kanë peshën e tyre specifike nga aktet normative-zakonore krijojnë bazën organizative të një shoqërie pa praninë e një aparati shtetëror ose paralelisht me rregullat shtetërore të shteteve të cilët në periudha të ndryshme historike administruan territoret shqiptare. Nga kjo buron edhe funksioni kryesor i *Kanunit*: ai i krijimit të një jete të organizuar shoqërore e cila bazohet në respektimin e normave dhe ligjeve. Këtij funksioni të rëndësishëm të *Kanunit* i referohet edhe At Gjergj Fishta kur nënvizon se për secilin shtet i cili është i interesuar të funksionojë në bazë të parimeve racionale, e drejta zakonore është e një rëndësie të veçantë, dhe ajo e drejtë duhet pasur parasysh si nga ligjbërësit ashtu edhe nga qytetarët të cilët funksionojnë sipas këtyre ligjeve (Fishta, 1990). Sipas shpjegimeve të bëra në *Kanunin e Skënderbeut*, parimi bazë mbi të cilin sillen rregullat e kanunit është parimi i marrëveshjes. Është kjo marrëveshje e arritur mes përfaqësuesve të territorit banorët e të cilit janë të interesuar për të vënë rregull mbi sferat kryesore të jetës kolektive dhe familjare. Ligjet aprovohen nga persona të deleguar, *pleq (pleqnues)* të cilët e kanë për detyrë të diskutojnë e pleqnojnë për të sjellur vendimin përfundimtar, *atë që ju do vendosni, ne e pranojmë* (Kanuni i Skanderbegut, 1993:16). Pas kësaj llogaritet që rregullat kanunore kanë hyrë në fuqi, por me një mundësi të hapur që po e kërkoi nevoja me kërkesë të bashkësisë dhe me delegim të pleqnuesve të shikohen dhe trajtohen çështje të cilat mund të kenë nevojë të shqyrtohen në rrethana tjera. Kjo mundësi e rishikimit të çështjeve e karakterizon Kanunin e Skanderbegut, por nuk është e paraparë në Kanunin e Lek Dukagjinit. Marrëveshja si kuptim sublim i arritjes së pjekurisë së një komuniteti nga njëra anë dhe respektimi i rregullave si disiplinë kolektive nga ana tjetër, përbëjnë këto shtylla etiko-sociale të kanuneve shqiptare. Rregullat parimore vlejné në mënyrë të padiskutueshme për të gjithë, si për të dobëtin ashtu edhe për të fortin, si për të varfërin ashtu dhe për të pasurin sepse *Kanuni do pajtim, kanuni nuk do grindje* (Kanuni i Skanderbegut, 1993:18), dhe për të funksionuar në praktikë ky qëllim i lartë etik, ligji duhet të vlejë për të gjithë pa përjashtim. Fakti që rregullat kanunore kanë karakter primar në organizimin e jetës së komunitetit tek shqiptarët dëshmojnë shënimet e studiuesve dhe udhëpërshkruesve në tokat shqiptare, shënimet e të cilëve janë dëshmi e funksionimit të shoqërisë shqiptare si bashkësi jashta-territoriale në kuptimin politik të fjalës gjatë periudhës së shekullit 19të dhe fillimeve të shekullit 20. Këtë dukuri nënvizon edhe Edith Durham në shënimet e saja nga udhëtimet në tokat shqiptare të Veriut. Nga bisedat që bën me banorët e këtyre zonave dhe në pyetjet e saj lidhur me çështje të ndryshme të zakoneve dhe jetës së komunitetit përgjigja më e shpeshtë që merr është: *ashtu thuhet në Kanunin e Lekës*. Edhe pse emri i Lek Dukagjinit nuk njihet në Europën e kohës së Durhamit aqë sa njihet emri i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, sipas vlerësimit të saj dhe autorëve tjerë të kësaj

periudhe, bëhet fjalë për personalitet me ndikim të jashtëzakonshëm në jetën tradicionale shqiptare të bazuar në këtë traditë specifike zakonore. Sipas Durhamit këto rregulla tradicionale zakonore janë më të fuqishme edhe se vetë parimet religjioze: shprehja *kështu ka thënë Leka* ka fuqi më të madhe obligative edhe se dhjetë rregullat e Biblës, kurse mësimet e islamit dhe krishterimit, ligji i sheriatit dhe ligji kishtar, të gjitha këto i nënshtrohen *Kanunit të Lekës* (Durham, 1991:457). Prandaj, duke ndjekur këtë linjë mendimi duhet theksuar që vendosja në fuqi e kanuneve në traditën zakonore shqiptare do të thotë edhe vendosje e standardeve të organizimit të kësaj shoqërie. Asnjë shoqëri e asnjë komunitet në botë nuk mund të llogaritet si i organizuar përdërisa nuk etablohet sipas parimeve të dakorduara të cilat respektohen nga të gjithë, ndërkohë që këto kanune dëshmojnë përpjekjen e komunitetit për të vënë rregull në jetën kolektive dhe atë familjare. Standardet kanunore janë vlerësuar si tejet të ashpra varësisht nga çështja të cilën e rregullojnë, por megjithatë ato standarde duhen shikuar sot duke pasur parasysh si distancën kohore e poashtu edhe rrethanat objektive të komuniketit përgjatë shekujve kur këto *kanune* kanë qenë në fuqi. Gjithashtu, këto *kanune* duhen parë edhe në dritën e prurjeve etike dhe aksiologjike në shoqërinë shqiptare duke i definuar parimet morale të shoqërisë shqiptare të përshkruara në mënyrë inspirative nga autorë romantikë europianë të cilët për interesim kishin Ballkanin e trazuar të shekullit 19të. Një tokë që lind burra dhe shkruan historinë e fatit të tyre (Vaina, 1917:21), një Shqipëri që është nënë e rreptë burrash t'egër (Bajron, 2004), vend me një traditë e lashtë pellazgjike (Degrand, 1901:3) dhe vend ku gratë janë nëna të denja por pa ndonjë ndikim tjetër shoqëror (Pouqeville, 1813). Sado që të kenë qenë romantike këto përshkrime, apo të kenë parë kulturën shqiptare si një Lindje e Europës apo me gjykimin e një supremacie të qytetërimit Perëndimor (Said, 2009:65), nga këto përshkrime arrijmë të kuptojmë dukjen tonë kolektive si komb duke pasur parasysh mungesën e madhe asokohe të shënimeve autoriale shqiptare mbi kulturën shqiptare-arbërore.

### **Aksiologjia e traditës zakonore shqiptare**

*Shpija e Shqyptarit asht e Zotit dhe e mikut* (Gjeçovi, Kanuni i Lek Dukagjinit, 1983:110), është definicioni aksiologjik i vendosjes së barazisë mes trajtimit të mikut dhe nderit personal. Duke vendosur shenjën e barazimit mes Zotit dhe mikut *kanuni* vendos një obligim të jashtëzakonshëm moral dhe ardhjen e mikut në shtëpi e karakterizon si një vizitë hyjnjë. Ky definicion kaq i qartë dhe i thjeshtë në dukje shpjegohet me origjinën e lashtë të këtij kodi origjinë e cila nënkuptohet atëherë kur ky kod vendoset paralel miteve antike të lashtësisë greke. Nga këto tregime mitologjike ne arrijmë të vendosim këtë paralele me *kanunin*, duke parë se si perënditë edhe vizitojnë vdektarët në shtëpitë e tyre dhe këto vizita janë nder e gëzim për shtëpinë e vdektarit, por edhe rrezik nga tekat e mundshme të një perëndie në botën e përkohshme të një vdektari të

rëndomtë. Përgjegjësia mbi shtëpinë e cila pret mik është ajo e cila rëndon më shumë se jeta së bashku me vdekjen e anëtarëve meshkuj të kësaj shtëpie. Me kalimin e pragut të shtëpisë miku-vizitor fiton mbrojtje të posaçme. Kanuni obligon që të pritët si mik edhe armiku i gjakut, pra për sa kohë ai qëndron si mik, përkohësisht e humb statusin e armikut sepse obligimi i shtëpisë e cila e pret shkon përtej armiqësisë, përtej dëshirës për hakmarrje apo përtej egos njerëzore, meqenëse elementi mbinatyror i cili definon mikun kërkon vënien anash të vetive që mund të kishte njeriu i zakonshëm. Sipas këtyre rregullave kanunore i zoti i shpis *falet me mik, armen i'a merr, e i prin n'shpi* (Gjeçovi, KLD, 1983:110). Dorëzimi i armës si mjete mbrojtës i njeriut në një shoqëri gati se pa institucione shtetërore të cilat mbrojnë sigurinë e individit, është dorëzim i mbrojtjes personale shtëpisë nikoqire dhe kanuni në këtë pikë nuk është vetëm urdhërues, por njëkohësisht edhe shpjegues. Sipas këtij shpjegimi mbajtja e armës së mikut është shenjë burrnije e nderi, shenjë e mbrojtjes së tij dhe së fundmi shenjë e mbrojtjes së shtëpisë në rast të ndonjë qëllimi të keq të vizitorit-mik. Tani kjo shtëpi është institucioni mbrojtës dhe garantues i jetës së tjetrit dhe kjo grancë e sigurisë nuk përfundon vetëm brenda mureve të shtëpisë por është akoma më e gjerë dhe përfshin rrugën dhe kufirin e vendbanimit të nikoqirit i cili është i obliguar ta përcjellë mikun deri në fund të vendbanimit dhe me praninë e vet të garantojë sigurinë e mikut. Kjo traditë e lashtë zakonore nuk e ka si epiqendër formën duke përcaktuar qartë që në tryezën e bukës mikut i ofrohet ushqimi të cilin e konsumojnë të gjithë anëtarët e tjerë të familjes, sepse ndera nuk matet me sasinë apo kualitetin e ushqimit që i ofrohet mikut, por matet me gatishmërinë për të garantuar sigurinë e mikut. Sepse buka e dhënë të nderon, por edhe të obligon në rast rreziku, dhe mbajtja e pasojave të këtij rreziku është ndera kryesore e kryefamiljarit. Duke pasur parasysh këtë obligim të jashtëzakonshëm karshi mikut, është më se e qartë se vrasja e mikut në bukën tande përbën turpin më të madh që mund ti ndodhë një burri/kryefamiljari dhe është i obliguar të lajë gjakun e mikut se *baba, vllau e deri kushrinja e dalun falet, porse miku nuk falet* (Gjeçovi, KLD, 1983:112). Në kuptimet aksiologjike kanunore kulmi i të keqes që sipas kanunit kualifikohet si akt i pafalshëm është pabesia, vrasja e mikut nga shtëpia ku ai qëndron si mik. Pabesia dënohet me shkatërrim të shtëpisë nga katundi kurse i zoti i shtëpisë shkon gjak-humbës. Në një kodifikim ku secili akt kolektiv dhe personal i nënshtrohet parimit të besnikërisë e respektit nuk mbetet e drejtë gjaku e as respekti për të pabesin dhe pabesinë si dukuri.

Kjo qasje kaq e qartë dhe e pakompromis ndaj pabesisë shpjegon standardin e lartë etik që gëzon koncepti i *besës* në traditën zakonore shqiptare e cila së bashku me trajtimin e mikut gati se si një qenie hyjnore, definon *mikpritjen* dhe *besën* si dy shtyllat themelore aksiologjike të *kanuneve* shqiptare. Besa përbën obligimin etik për të qëndruar në fjalën e dhënë pavarësisht arsyeve të përbotshme apo të tejbotshme për të mos e mbajtur atë. *E dhashë fjalën, e jap shpirtin* (Kanuni i Skanderbegut,

1993:208), dëshmon vlerën ontologjike të fjalës së dhënë e cila shkon bashkë me shpirtin, pra tejkalon kufirin mes dy botëve, duke tejkaluar botën materiale për të vazhduar ekzistencën e saj në botën e ideve dhe pafundësinë e saj. E drejta zakonore rregullon çështjen e mbajtjes së *besës* në kuptimin normativ në jetën e përditshme të shoqërisë. Nuk parashihet dënim në mjete materiale për mosmbajtje të fjalës së dhënë, por thyerja e besës trajtohet si humbje nderi, e jeta pa nder nuk trajtohet si jetë e jetuar me të vërtetë. Kjo sa i përket definimit etik të *besës*. Në kuptimin praktik të përditshmërisë *besa* është marrëveshje e cila nuk ka alternativë tjetër përveç se që të respektohet. Kjo marrëveshje është posaçërisht precize në rastet e gjakmarrjes. Familja e gjakësit kërkon *besën* njëzetekatërorëshe nga familja e të vërtetë, pra garancën dhe sigurinë për të lëvizur lirshëm brenda kësaj kohe për të kryer obligime të ndryshme familjare. Bashkësia kanunore jep edhe *besën* e dytë për një muaj dhe kjo është mbrojtje brenda këtij muaji për familjen e gjakësit sepse me kanun është guxim dhe obligim të japësh *besë* dhe ta mbash të njejtën. Kjo garancë e cila përcakton nderin njerëzor shkon përtej etikës individuale duke u shndëruar kështu në një vlerë të përgjithëshme të kolektivit i cili ka përcaktuar rregullat e pathyeshme të jetës në bashkësi. Kështu që tradita zakonore shqiptare e ka krijuar dhe konceptin *rrugë nën besë*, dhe si të tilla definohej rrugët të cilat janë të garantuara për të kaluar dhe në të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet të ndodhë vrasja apo ndonjë lloj tjetër rreziku për kalimtarët. Dhe akoma më i jashtëzakonshëm është fakti që këto vendime janë respektuar, pa një kontroll apo institucion shtetëror i cili do të vëzhgonte respektimin e këtyre normave, por vetëm në bazë të këtyre rregullave kanunore respektimi i të cilave është siguruar nga vendimi për të respektuar rregullat e vetë-vendosura nga ana e bashkësisë dhe frikës jo nga ndonjë dënim me burgim a vdekje, por nga frika e humbjes së nderit si shtylla morale vertebrale e një burri apo familjeje.

Besës – kësaj kategorie sublimë të ekzistencës njerëzore tradita shqiptare i përshkruan edhe veti mbinatyrore të shprehura qartë në eposin popullor. Fjala është për baladën e Konstantinit, vëllait të ringjallur nga vdekja për të mbajtur fjalën e dhënë, baladë të cilës Dora D'Istria i referohet si Kënga e Garentinës duke thënë se tek shqiptarët ashtu si edhe te galët e vjetër fjala e dhënë obligon deri në varr (D'Istria, 2015:21). Dhe përtej varrit. Meqë vdekja nuk e ndalon dot realizimin e fjalës së dhënë-*besës*. Besa e cila ka mbetur e pambajtur për shkak të vdekjes ka fuqinë edhe të ringjallë përkohësisht të vdekurin për ta mbajtur premtimin dhe për tu kthyer më pas në botën e të vdekurve pasi të ketë kryer obligimin ndaj besës së dhënë. Ringjallja, ky fenomen i rezervuar për figura qendrore religjioze si Jezu Krishti, një kategori shtyllë e religjionit krishter, dëshmon edhe një herë qëndrimin e Edith Durhamit, por edhe të studiuesve tjerë të traditës shqiptare, kur nënvizojnë se ka raste kur parimet etike të rregullave zakonore shqiptare janë më të fuqishme edhe se vetë urdhëresat fetare (Durham, 1991). Dhe kjo i dedikohet faktit që kjo traditë

e vjetër zakonore daton nga antikiteti dhe së bashku me elementet tjera të kulturës shqiptare të cilat kanë elemente të kulturës shpirtërore të antikës ballkanase e bën që Dora D'Istria kur flet për shqiptarët, tu referohet si popull i kulturës së lashtë pellazgjike. Sipas këtyre të dhënave dhe gjithnjë duke pasur parasysh periudhën shekullore të zbatimit të *Kanuneve* në jetën e bashkësisë, është më se e qartë se këto norma tradicionale kanë funksion qenësor gjatë procesit të formimit shpirtëror kombëtar. Funksi- oni organizativ, etik dhe antropologjik i *kanuneve shqiptare* janë dëshmi se sa i rëndësishëm është një organizim normativ për funksionimin e një sho- qërie dhe roli që luan ky organizim në ndërtimin e vlerave etike kolektive, vlera të cilat identifikojnë një komb në kuptimin kulturor të fjalës.

### **Femra në traditën zakonore, martesë dhe trashëgimia**

Në traditën zakonore shqiptare e cila rregullohet sipas *kanuneve* gruaja ka një rol dhe pozitë periferike. Prania e saj ndjehet vetëm në periferinë e jetës shoqërore të vendosur dhe rregulluar sipas normave kanunore. Brenda sferës së rregulluar sipas këtyre normave, për gruan flitet në pjesët kanunore të cilat trajtojnë martesën, familjen, traditat e dasmës dhe të vdekjes dhe normat kanunore të cilat kanë të bëjnë me lindjen e fëmijëve. Të drejtat dhe obligimet e gruas parashihen dhe përcaktohen edhe në *nyet* të cilat rregullojnë gjakmarrjen, ndërmjetësimin si dhe të drejtat trashëgimore.

Saktësia kanunore është e padiskutueshme jo vetëm në obligimet të cilat individi nuk i diskuton dhe vetëm i zbaton, por edhe në definimin e këtyre obligimeve të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë prekin jetën e gruas e cila ashtu si edhe pjesa tjetër e shoqërisë u nënshtrohet këtyre zakoneve. Martesa sipas *Kanunit të Lek Dukagjinit* do të thotë shtëpisë ti shtohet një krah pune dhe të shtohet numri i pasardhësve. Edhe pse pjesa ku *kanuni* flet për martesën përbën pjesën më eksplicite ku flitet për femrën, megjithatë në kuadër të institucionit martesë ajo mbetet në pozitë marginale. Ajo nuk njihet si person-personalitet, por martesë i njeh asaj vetëm dytribute: aftësinë për punë dhe kapacitetin biologjik për të lindur fëmijë. Patriarkati si koncept nuk nënkupton vetëm nënshttrimin e femrës, por nënshttrimin e plotë të të gjithë anëtarëve të bashkësisë vullnetit të patriarkut. Prandaj, në këtë martesë të definuar si *m'u ba shpi e me i a shtue shpis nji rob ma tepër*, jo vetëm që nuk diskutohet dëshira e vullneti i vajzës për të hyrë në martesë, por as edhe i djalit i cili është subjekt i një martesë të tillë. Të rinjtë, pra as djali e as vajza nuk vendosin, vendimet janë vetëm në autoritetin e patriarkut-prindit i cili vlerëson dhe çmon nëse duhet lidhur një martesë apo jo, sepse pa diskutim patriarku vendos për jetën e fëmijëve të vet (Beauvoir, 2016:19). Ai djalë i ri i cili nuk ka prind vendos për martesë të vet, ndërkohë që një vajzë e re nuk e posedon këtë të drejtë, po qe se është fëmijë pa prind, për të vendosin vllëzrit apo kushërinjtë e saj. Gjuha me të cilën *kanuni* definon këto momente të rëndësishme për jetën e një vajze është e ashpër, konservative dhe patriarkale. Këto norma

përcaktojnë se për cilat gjëra vajza *nuk ka të drejtë*, pra, ajo nuk ka të drejtë të zgjedhë fatin, të përzihet në fejesë të vet e as ka të drejta për veshmbathjet e veta (Gjeçovi,KLD, 1983:55). Pra të pasurit të drejtë është një koncept inekzistent, në rastin e vendosjes së martesës së saj e drejta zakonore definon vetëm atë që vajza e re nuk ka të drejtë. *Kanuni* e njeh të drejtën e djalit për të prishur fejesën jo për ndonjë arsye konkrete por *njat here kur t'i teket djalit*, dhe me atë rast shenja e fejesës dhe paratë e dhëna për veshmbathjen e vajzës i mbesin shtëpisë së saj si gjobë për prishjen e fejesës. Këtë të drejtë *kanuni* nuk i'a njeh edhe vajzës, është e definuar se ajo nuk ka të drejtë të prishë fejesën për asnjë arsye. Fati i mëtejshëm i saj në një situatë kur është e obliguar të hyjë në një martesë të padëshiruar nga ajo, varet nga qëndrimi që do të mbante familja e saj. Nëse ajo nuk dëshiron të realizojë martesën dhe përkrahet nga familja, atëherë familjes së djalit i kthehet shenja dhe paratë e veshmbathjes por vajza nuk ka të drejtë të martohet për sa kohë është i gjallë i fejuari i saj. Edhe po u martua ai, vajza përsëri nuk ka të drejtë për martesë përderisa i fejuari i dikurshën nuk e lejon një gjë të tillë. Kurse në rast se vajza nuk dëshiron të martohet me të fejuarin dhe nuk përkrahet nga familja në një vendim të tillë, atëherë do të dërgohet me dhunë tek familja e caktuar për martesë edhe atë *me fishek më shinë* (Gjeçovi,KLD, 1983:58). Me këtë normativë kanunore legjitimohet e drejta për ta vrrarë nusen nëse ik nga i shoqi dhe për këtë familja e saj nuk kërkon gjak meqë është vrrarë me fishekun e shtëpisë së vet. Të drejta për të vendosur për martesën e saj *kanuni* i'a njeh vetëm gruas së vejë e cila jo vetëm që *flet vetë*, por edhe *i kthen krushqit nga rruga*. Një jetë e kaluar si fuqi pune në shtëpi të huaj në të cilën bëhet akoma më e huaj pas humbjes së bashkëshortit, dhe mospasja e një vendi për tu kthyer në shtëpinë e prindërve i lënë kësaj gruaje të drejtën të paktën për të folur për zgjedhjen e dytë të saj, meqë pa institucionin martesor është e pamundur ekzistenca e një gruaje e cila nuk posedon pronë, por vetëm siguron ekzistencën e vet jetësore në shtëpinë e një burri. Po ashtu *kanuni* njeh statusin e *zojës së shtëpisë* për gruan-bashkëshorte të kryefamiljarit, e cila udhëheq me shtëpinë dhe nevojat e brendshme të saj. Kjo pozitë është e ngjashme me pozitën e *dominas* tek romakët që llogaritet një avansim i pozitës së gruas në krahasim me rolin e saj në qytetet e Greqisë antike me përjashtim të Spartës (Beauvoir, 2016:99).

A ka vallë një çmim për grua? Sado të tingëllojë mizogjine apo diskriminuese kjo pyetje, megjithatë në *Kanunin e Lek Dukagjinit* ka një përgjigje, dhe ajo përgjigje është pohuese. *Nye* e nëntëmbëdhjetë e kreut të tretë të *kanunit* mban titullin *çmimi qi nepej e nepet për gra*, dhe përshkruan një traditë të mëhershme të pagesës deri më 400 grosh, për të përkufizuar shumën prej 1500 groshëve si çmim kanuni, i cili është edhe çmimi i gjakut të gruas ashtu si e përcakton ky *kanun*. Kjo normë kanunore në raste të caktuara është shpjeguar si shitje e gruas, të cilin e konsideroj si shpjegim të gabuar. Pa diskutim që *kanuni* është patriarkal në fjalë dhe në veprim, por duke pasur si koncept themelor etik *nderën* dhe

*burrninë*, gruan e trajton si qenie marginale, por jo edhe si objekt i shitjes. Këto mjete financiare i jepen familjes së vajzës së fejuar ashtu që të paguhet shpenzimet e përgatitjes së pajës, veshmbathjes dhe harxhimeve tjera të përcjelljes së saj nuse, duke qenë se familja e djalit atë e trajton pas fejesës si *rob' i shpis*, kurse familja e saj e trajton si *rob' i huej*. Ky obligim i familjes së djalit ndaj vajzës së fejuar saktësohet nominalisht në *nyen* e njëzetë të *kanunit* të emëruar si *Trashigimi i grues Shqyptare*, i cili qartëson se gruaja nuk ka pjesë në trashëgimi tek prindët dhe pronat e tyre meqë *kanuja e xen gruen si një tepricë në shpi*. (Gjeçovi, KLD, 1983:58).

Kur jemi tek trashëgimia, përveç nenit të sipërpërmendur 4/20 në të cilin përcaktohet që gruaja nuk ka të drejtë trashëgimore tek prindët e saj, *Kanuni* i kushton çështjes trashëgimore një kapitull të veçantë: *krye i tetët – trashigimet*. Dhe që në fillim të këtij kreu bëhet e qartë që *kanuni* njihet për trashëgimtar djalin e jo vajzën. Sipas këtyre normave përjashtuese ndaj gruas, ajo nuk është pjesë e trashëgimisë as te prindërit e as tek bashkëshorti, ajo është një prani e nevojshme për të funksionuar bashkësisht, një hallkë që mban familjen por të cilës nuk i njihet as edhe një pronë minimale për vehten e saj. Është forcë pune e cila nuk paguhet e shpërblehet dhe lind fëmijë për fatin e të cilëve nuk ka të drejtë të marrë asnjë vendim. Këtë përjashtim të plotë të gruas nga e drejta për të trashëguar pasuri nga prindi apo bashkëshorti, *kanuni* e shpjegon me qëllimin e mospërzierjes së fiseve dhe ruajtjes së vijës trashëgimore të gjakut si e vetmja të cilën e njihet kjo traditë zakonore. Edhe pse në *Kanunin e Skënderbeut* parashihet daja me *qit pushkë/me u hakmarrë për nip*, në traditën kanunore të Lek Dukagjinit është përjashtuar një mundësi e tillë (Elezi, 1983:87). Këto norma parashohin që edhe po të kenë vdekur të gjithë meshkujt e një shtëpie, e kjo shtëpi të kishte pasur edhe njëqind bija, asnjëra nga to nuk ka të drejtë trashëgimie në shtëpi të prindërve sepse *nip bije nuk mund të varet në krrabë t'ungjive* (Gjeçovi, KLD, 1983:70). Plangu (shpija) e mbetur vetëm në vajza/bija llogaritet si plang/shpi i shuem, sepse vajzat/bijat nuk mundën të sigurojnë vazhdimësinë e shtëpisë/fisit sipas linjës së gjakut, prandaj ato merren nën përkuqdesjen e kushëririt më të afërt i cili përkuqdeset për martesat e tyre dhe merr nën posedimin e tij pasurinë, gjërat dhe pronën e prindit të tyre. E drejta e vetme e cila u njihet këtyre grave është të shkuarit si mysafire në shtëpinë prindore pasi të jenë martuar dhe të priten me respekt nga kushëriri-trashëgimtar dhe familja e tij.

Nga të gjitha të drejtat e munguara të grave sipas *Kanunit të Lek Dukagjinit*, mohimi i të drejtës së trashëgimisë e vulos pozitën e saj tërësisht të nënshtruar në shoqërinë kanunore. Duke mos pasur të drejtën për të qenë pronare e një prone, e aq më pak për të drejtuar dhe organizuar punët në një pronë, gruaja varet nga një burrë përgjatë tërë jetës së saj. Ajo është tërësisht e varur nga babai i cili vendos për mënyrën dhe kualitetin e jetës së saj përderisa ajo jeton në shtëpinë e tij dhe në fund është ai i cili vendos për jetën e mëtejshme të saj duke përzgjedhur personin me të cilin ajo do të hyjë në martesë të dakorduar mes palëve, përkatësisht familjeve

të kryesuara nga burrat. Pas martesës ajo është në varësi të plotë nga bashkëshorti i saj i cili me *kanun* nuk ka të drejtë mbi jetën e gruas, por ka të drejtë jo vetëm ta këshillojë dhe qortojë bashkëshorten, por i njihet edhe e drejta e ushtrimit të dhunës fizike mbi të (rrahjes) po qe se ajo nuk u bindet urdhërave të tij. Gruaja ka të drejtë të kërkojë nga bashkëshorti ti sigurojë veshëmbathjen e saj, por ka edhe obligimin që t'i bindet bashkëshortit të saj. Duke pasur parasysh faktin që jeta në shoqëritë kanunore jetohet në bashkësi më të mëdha familjare, *kanuni* parasheh situatën e mundshme të dhunës fizike mbi gruan nga ana e anëtarëve tjerë meshkuj të familjes (kUNETËR e nipër). Në këtë rast obligim për dalëzotësi ka bashkëshorti i saj dhe nëse ai lejon një gjë të tillë, llogari për një rast të tillë nga familja e burrit kërkon familja e gruas. Nuk duhet anashkaluar poashtu dhe faktin që kryefamiljari-babai-patriarku ka të drejta autoritare mbi djemtë e tij, të ushtrojë dhunë fizike po qe se nuk i binden, po vrau babai djalin nuk i kërkohet gjak sepse *kanuni* e konsideron se ka vuarë vehten e vet, ta vendosë në punë me rrogë dhe të ketë ai të drejta të plota mbi fitimet e të birit sepse: *sa të jet ati gjall, i biri njehet si bulgë* (Gjeçovi, KLD, 1983:66). Ky zinxhir autoritar patriarkal nuk ndërpritet me vdekjen e patriarkut sepse normat kanunore kanë siguruar vazhdimësinë në figurën e birit të nënshtruar i cili tanimë është i gatshëm të bëhet nënshtruesi i pasardhësve të vet. E vetmja që nuk ka asnjë rrugëdalje nga zinxhiri i nënshtrimit është gruaja e cila pas vdekjes së bashkëshortit mbetet nën kujdesin e të birit, kurse një nen kanunor i jep të drejtën të birit edhe ta nxjerrë nënën nga shtëpia nëse ajo është ngatresatare. Tekstet kanunore janë të qarta dhe të padiskutueshme kur përcaktojnë që gruaja të punojë në shtëpi apo bujqësi, por të mos të ketë asnjë të drejtë mbi atë shtëpi e atë pronë. Brenda këtyre raporteve shoqërore gruaja është fuqi e lirë punëtore dhe si e tillë trajtohet edhe në shtëpinë e prindëve edhe në atë të burrit, një punë e cila mbetet e pavlerësuar deri në fund të jetës së saj si në kuptimin material ashtu edhe në kuptimin e ndikimit shoqëror. Sepse, në një shoqëri ku prona mbi tokën reflekton pozitë shoqërore dhe autoritet, ajo krijesë e cila nuk ka të drejtë të posedojë një copë toke nuk ushtron as edhe më të voglin ndikim në atë shoqëri. Në shtëpinë e babait vajza trajtohet si *mall i huej* sepse do i takojë shtëpisë ku do martohet dhe ajo shtëpi do kujdeset për veshëmbathjen e saj. As në shtëpi të burrit gruaja nuk fiton statusin e një personi autokton, sepse me gjak mbetet e lidhun për shtëpinë prindore të cilët mbeten përgjegjës për sjelljen e saj prandaj edhe *kanuni* definon se *grueja asht shakull për me bajtë*. Gruaja mbetet në një pozitë limbo dhe toka e vetme që i takon asaj është varri si prona e sigurtë e saj.

### **Gruaja dhe gjakmarrja, virgjëreshat e përbetuara dhe ndera e gruas**

Fenomeni i gjakmarrjes është pjesa e kodifikuar deri në detajet më të vogla në traditën zakonore shqiptare. Arsyet e gjakmarrjes, forma e hakmarrjes me vrasje, rituali i vrasjes, rituali i varrimit të të vrrarit në të cilin domosdoshmërisht merr pjesë edhe vrasësi/gjakësi, ditët e

përcaktuara të besës për gjakësin, janë parime të kodifikuara në mënyrë precize në të dy kanunet: atë të Skënderbeut dhe të Lek Dukagjinit. Duke pasur parasysh faktin që në këto normativa kanunore bëhet fjalë për atë linjë ndarëse mes jetës dhe vdekjes, kodifikimi është i qartë, preciz dhe i padebatueshëm, sepse *çmimi i jetës së njerit asht një, si për të mirin si edhe për të keqin* (Gjeçovi, KLD, 1983:129). Nga këto kodifikime kaqë precize vijmë në përfundimin që gjakmarrja është për vetmbrojtje dhe jo thirrje për dhunë kurse shoqëria kërkon mënyra për të reduktuar dhunën. Nga mënyra se si parashtrohet kjo çështje në *kanunet*, institucioni i gjakmarrjes është një instancë e qartë e dhunës defanzive të një shoqërie e cila është e detyruar të vetëmbrohet (Мухиќ, 1994:20). Gruaja sipas kësaj normative kanunore nuk hyn në gjak edhe po të vrasë dikend. Sipas normave kanunore secila vrasje krijon obligim për shtëpinë e të vrrarit që sa më shpejtë të marrë hak për gjakun e familjarit, por në qëftë se vrasja është kryer nga një grua, vrasja e një gruaje për të marrë hak, nuk e vë në vend gjakun e burrit të vrrarë nga një grua. Është kështu sepse çmimi i gjakut të gruas nuk është i barabartë me çmimin e gjakut të burrit. Gruaja nuk është e barabartë me burrin as në gjak e as në vdekje. *Kanuni* e definon si të barabartë çmimin e jetës si për të mirin ashtu edhe për të keqin, por ky parim nuk vlen për gruan gjaku i së cilës ka vlerën e gjysmës së gjakut të burrit. Në formën e detajuar të normimit të çështjeve lidhur me gjakun dhe vlerën e tij *kanuni* parasheh edhe rastet e vrasjes *pa hiri*, dhe në mënyrë të veçantë është paraparë vrasja aksidentale e gruas shtatzënë. Pasi vërtetohet nga pleqnuesit që vrasja është pa qëllim dhe aksidentale atëherë vrasësi do paguajë gjobë gjaku 3 qese për gruan e vrrarë dhe 3 të tjera për frytin e palindur. Por, nëse vrasësi fillon e kundërshton, atëherë *kanuni* parasheh hapjen e të ndjerës dhe nëse fryti është djalë vrasësi paguan 6 qese dhe në rast se është vajzë paguan 3 qese gjobë për vrasjen e bërë pa qëllim. Gjë që dëshmon edhe një herë dallimin në vlerë mes gjakut të një burri dhe një gruaje. Dhe nëse nisemi nga fakti që *kanunet shqiptare* kanë gjakun si shtyllë vertebrale të ndërtimit të normave të funksionimit shoqëror, dhe nëse gjaku është vendi, prona, jeta, vdekja, ekzistenca dhe nderi, atëherë në vlerësimin aksiologjik të bartësve të funksioneve shoqërore gruaja dhe jeta e saj vlejnë sa gjysma e një burri, kurse pozita materiale e saj në shoqëri është gati se inekzistente. Me përjashtimin e saj nga procesi i gjakmarrjes a mbrohet gruaja nga agresiviteti i shoqërisë është pyetja logjike e cila parashtrohet me këtë rast. Kjo tezë do të ishte pjesërisht e saktë, nëse kemi parasysh faktin që *kanuni* me norma të veçanta ndalon vrasjen e grave dhe fëmijëve, e bën të qartë që bashkëshorti nuk ka të drejtë ta vrasë bashkëshorten, dhe vrasja e gruas legjitimohet vetëm në rast tradhëtie bashkëshortore, por vetëm e vetëm nëse çifti zihet në flagrancë kur edhe ekzekutohen të dy aktorët, përndryshe *kanuni* nuk njeh konceptin e tradhëtisë bashkëshortore. (Gjeçovi, KLD, 1983:55,132,133). Pra teza se *kanuni* mbron gruan është pjesërisht e saktë sepse duke qenë në periferinë e shoqërisë, ajo është e

përrjashtuar nga të gjitha proceset: vendimet familjare, çështjet e trashëgimit, vendimet shoqërore dhe gjithësesi se edhe nga gjakmarrja si pjesë e pandashme e procesit shoqëror. Për aqë më shumë që këto norma përcaktojnë se edhe në rast të vrasjes, gjaku dhe jeta e dy gjinive nuk matet njësoj. Prandaj edhe vrasja e gruas trajtohet si një akt i cili do të fyente nderin e një burri. Kështu që gruaja përjashtohet nga gjakmarrja jo për tu mbrojtur, por thjesht sepse nuk është e vlefshme për të qenë pjesë e këtij procesi. Sepse po të ishte çështje e mbrojtjes dhe respektit ndaj gruas, atëherë asaj do ti çmohej munda më shumë, do kishte të drejtë të trashëgonte një shtëpi a tokë të sajën apo do të pyetej për martesën e saj e të fëmijëve të vet. Duke qenë një personazhe tërësisht e përrjashtuar nga ngjarjet shoqërore, përrjashtimi nga gjakmarrja është vetëm edhe një vërtetim i kësaj pozite të marginalizuar të gruas në traditën zakonore.

E njëjta linjë e argumentimit vlen kur flitet për kategorinë e *nderës* njëra nga kategoritë aksiologjike kryesore kanunore. Ndera është atributi kryesor që njeriu-burrë duhet ta ketë gjithnjë me vehte dhe sipas këtyre normave jetësore nuk vlen jeta pa nder. Ndera llogaritet e humbur për një person nëse nuk është marrë gjaku i familjes pas vrasjes së familjarit, nëse i ka ndodhë diçka e papëlqyeshme mikut në konak të tij dhe nëse i është çnderuar grua-familjare. Burri i cili ka humbur nderën, shërbehet me dorën e djathtë e kafeja i shërbehet nën gju si një përkujtim ditor se ndera duhet vënë në vend patjetër. Përrdhunuesi i një gruaje vritet e shkon gjakhumbës. Në traditën zakonore gruaja trajtohet kategori e pafuqishme duke qenë se nuk është e armatosur e as posedon pasuri të cilën do e mbronte me armë. Sipas kësaj, mbrojtja e nderit të gruas është obligim i burrit të saj, ai është zot dhe mbrojtës i saj, sepse duke mbrojtur gruan, burri mbron nderën e vet. Standardi kanunor në këtë drejtim është i qartë: *nëse një i huaj e sulmon gruan, nderën e saj e mbron i shoqi, kurse gjakun e kërkon prindi i saj* (Kanuni i Skanderbegut, 1993:29). Që do të thotë se nuk sulmohet personalisht gruaja, por burrat të cilëve ajo u përket. Prandaj edhe ndera si vlerë etiko-morale është kategori e vlerave maskuline, ashtu siç janë trimëria, mençuria, dhe besa, këto kategori të cilat bëhen ligje dhe standarde etike pasi të jenë vendosur nga burrat si përgjegjës të funksionimit të shoqërisë dhe ligjeve të vendosura nga ta. Në definimin kanunor theksohet qartë se gruaja ka detyrë *me i'a ruejtë nderen burrit*, sepse edhe kjo kategori morale është maskuline. Në këtë sistem njëgjjinor etik, ashtu si shtëpia, prona, arma, pleqnimi, fëmijët, të gjitha i takojnë burrit, atëherë edhe ndera është e tij dhe e askujt tjetër. Ky trajtim maskulin i nderës i cili respektohet burrërisht krijon hapësirë të sigurtë të lëvizjes së gruas shqiptare edhe jashtë shtëpisë se për gruan të gjitha rrugët janë në besë, dhe ky fenomen vihet në dukje nga përrshkrues të tokave shqiptare gjatë shekullit 19të, në të cilat shënime gruaja shqiptare është e paprekshme (Zamputi, 1961:111, Veliu, 1986:104). Gjegjesisht, nënvizuar nga Dora D'Istria: *gruaja shqiptare ashtu si në Angli apo Amerikë mundet lirisht të kalojë edhe në rrugët më të rrezikshme dhe të mos e ngacmojë*

*asnjeri, sepse fakti që është grua është mbrojtje më e madhe se një batalion i tërë* (D'Istria, 1859:256).

Me gjithë faktet e përmendura më sipër të cilat dëshmojnë për pozitën marginale të gruas në traditën zakonore, megjithatë në kuadër të këtyre normave strikte të sjelljes së gruas në shoqëri kjo traditë parasheh edhe një përjashtim për gratë të cilat për arsye të ndryshme heqin dorë nga martesë, gratë të cilat zgjedhin të kenë statusin e *virgjëreshave të përbetuara*, status i cili shpjegohet edhe si një nga mbetjet e pakta të matriarkatit (Hoxha, 2017). Me këtë akt, këto gra përбетohen në virgjëri të përhershme, deri në fund të jetës mbeten në shtëpinë prindërore, veshin rroba meshkujsh, kanë të drejtë pjesëmarrjeje në kuvendet e vendbanimeve të tyre. Janë disa arsye konkrete që këto gra të vendosin të kenë këtë status, edhe atë: për shpirt të vetin, kur familja nuk ka djalë, kur shtëpia mbetet vetëm me djem minorene, kur për ndonjë arsye vajza refuzon të martohet për të fejuarin e saj ( Kanuni i Skanderbegut, 1993:75). Duke qenë se *kanuni* nuk lejon që vajza të anulojë fejesën dhe nëse nuk ka përkrahjen e prindërve duhet të martohet me detyrim për djalin e fejuar, vendimi për tu përбетuar si virgjëreshë e liron nga obligimi dhe njëkohësisht e shpëton dhe familjen e saj nga ndonjë mosmarrëveshje më e madhe si rezultat i refuzimit të martesës të përcaktuar me *kanun*. Poashtu, në rastet e familjeve pa trashëgimtar mashkull, njëra nga vajzat përбетohej si virgjine dhe mbetej të jetonte në shtëpinë prindore. Megjithatë, pas vdekjes së saj, prona familjare trashëgohet nga anëtari më i afërt mashkull i familjes sipas linjës së gjakut, që do të thotë se *kanuni* mbetet i palëkundur në mohimin e të drejtës së gruas për të trashëguar pronën prindore. Është kërkesë kanunore që virgjëreshat e përбетuara të jenë të qëndrueshme në vendimin e tyre, sepse tradita nuk e njeh të drejtën për të ndryshur vendimin pasi që vajza të ketë deklaruar vehten si virgjëreshë e përбетuar, dhe një vendim eventual për të ndryshuar këtë do të nënkuptonte përjashtim të saj nga bashkësia. Kjo dukuri e virgjëreshave të përбетuara nënvizohet si tejet e veçantë në shkrimet e Edith Durham, e cila sjell edhe pjesëza bisedash me këto gra të cilat i ka takuar gjatë udhëtimeve të saj në Veriun shqiptar (Durham, 1991). Poashtu duhet theksuar, se dukuria e virgjërshave të përбетuara në traditën zakonore shqiptare nuk është parim i cili është bartur nga tradita e celibatit sipas kishës katolike. Kjo dukuri e virgjëreshave të përбетuara i përket periudhës paramonoteiste ashtu si edhe rregullat kanunore kanë vijën trashëguese kulturore të antikitetit ballkanik. Tradita e virgjinitetit askeptik krishter fillon të praktikohet në tokat shqiptare në shekullin 17të, pra shumë më vonë se praktikat kanunore. Për më tepër kur kjo traditë e përбетimit haset edhe tek shqiptarët me religjion islam, pra vajza deklarohet *sadik*-besatare, i shkurton flokët, vishet burrë e armatohet dhe merr pjesë në kuvendet e burrave (Zamputi, 1961:118).

Duke qenë në marginat e shoqërisë dhe pa ushtruar ndikim jo vetëm në procest shoqërore, po as në drejtimin e jetës së saj personale, duke

jetuar me shekuj si *tjetra* e cila është *shakull me bajtë* apo *bulg me punue*, dhe duke mos pasur asnjë alternativë për një status tjetër për vehten e saj pos revolucioneve të cilat janë akoma larg, përbetimi si virgjëreshë i mundëson asaj dalje nga bota e saj e kufizuar me muret e shtëpisë, në botën e *tjetrit*, aty ku diskutohet, luftohet dhe bëhet ndryshimi (Foucault, 1976). Kjo dukuri e kodifikuar në traditën zakonore shqiptare është në forma të ndryshme e pranishme në historinë e qytetërimit njerëzor, mbase jo e kodifikuar si *kanunet shqiptare*, por si dëshirë dhe nevojë identitare e gruas për të qenë pjesë e zhvillimeve shoqërore përtej shtëpisë së saj. Dhe nëse çmimi i këtij ndryshimi ka qenë këmbimi i identitetit të saj me një *identitet tjetër*, ajo e ka bërë këtë e vetëdijshme për rreziqet dhe pasojat e një vendimi të tillë.

### Shënime përmbyllëse

The lexicon of jurisprudence represents a distinct area of language, defined by a rigorous system of terms, concepts, and discourse structures that demand accuracy and a well-defined context. In the public domain, this vocabulary is especially propagated through the media, which play a crucial role in introducing legal terminology into public usage. This research aims to examine how the lexicon of jurisprudence is integrated and utilized within media discourse in Kosovo and Albania, employing a comparative approach to the application of this specialized lexicon. The analysis was carried out using a selected corpus of articles from online portals and daily newspapers in Kosovo (such as *Koha ditore*, *Bota sot*, *Gazeta Express*, *Klan Kosova*, etc.) and in Albania (such as *Dita*, *Gazeta shqiptare*, *Sot*, *Telegraf*, *Fjala*, *Liberale*, *Panorama*, etc.). To ensure balanced representation, approximately 100 articles from each country, published between 2013 and 2023, were examined.

**Keywords:** *jurisprudential lexicon, Kosovo, Albania, linguistic system, media.*

## Hyrje

Gjuha e medias, apo diskursi mediatik, përfshin dy elemente thelbësore: lajmin (tekstin e folur apo të shkruar) dhe procesin për prodhimin e këtyre teksteve. Dimensioni i parë, ai i tekstit, ka qenë qëllimi parësor i studiuesve të gjuhës së medieeve, veçanërisht për faktin se teksti kodon vlera dhe ideologji që ndikojnë gjerësisht te njerëzit dhe i reflekton ata. Ndërsa, dimensionin e dytë, ai i procesit të prodhimit të teksteve, që përfshin normat dhe shprehjet e lajmshkruesve, ka qenë në qendër të kërkuesve shkencorë, por për këtë çështje ende nuk janë realizuar mjaftueshëm vepra studimore.

Thënë përgjithësisht, studimi *Leksiku i jurisprudencës në disa medie të Kosovës dhe të Shqipërisë* synon të analizojë gjuhën e medieeve, duke u fokusuar më së shumti te leksiku i jurisprudencës, pra vështruar sipas një qasjeje sociolinguistike. Hulumtimi është përqendruar kryesisht në mediet e shkruara në Kosovë dhe në Shqipëri. Këtë përzgjedhje e përligjim me faktin se për analizën dhe hulumtimin e leksikut tekstet e shkruara janë më të favorshme, po ashtu edhe për faktin se, marrë parasysh natyrën e këtij studimi, është më i saktë dhe më praktik identifikimi i termave në tekstet e shkruara. Nga mediet në Shqipëri, janë hulumtuar, analizuar, si dhe është shkëputur material gjuhësor (përkatësisht fjalë terma) prej teksteve të ndryshme, të botuara në ato gazeta që vijojnë ende të botohen edhe në variantin e shtypur, konkretisht nga gazetat: “Dita”, “Gazeta shqiptare”, “Sot”, “Telegraf”, “Fjala”, “Liberale”, “Panorama” etj. Në disa raste, materiali gjuhësor është marrë edhe nga portalet mediatike me përmbajtje më cilësore lajmesh, si “Newsbomb”, “Arberianews.net”, “Shtypi.net”, “Balkanweb”, “Shqip”, “Faxnews”, “Reporter.al” etj. Pra, qëllimshëm jemi përcaktuar për këtë përzgjedhje mediesh për të shmangur lajmet e shkruara nga medie joserioze e pa përvojë, çka do të ndikonte edhe në cilësinë e këtij vëzhgimi. Ndërkaq, mediet e Kosovës, nga të cilat kemi vjelë material, janë: “Koha.net”; bota sot, “klankosova”, “dukagjini.com”, “televizioni7.com”, “kanal10.live”, “insajderi.com”, “kallxo.com”, “zeri.info”, “gazetaexpress.com”, “telegrafi.com”, “tëvë1.info”, “rtlive.com”; “botasot.info”.

Hulumtimi i termave është realizuar nëpërmjet vjeljes së tyre të drejtpërdrejtë. Korpuset e medieeve të Kosovës dhe të Shqipërisë janë krijuar si korpuset rasti, me material që përfshijnë një periudhë tetëvjeçare, përkatësisht vitet 2015-2023. Artikujt janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, ku fillimisht janë nxjerrë nga konteksti fjalët terma dhe më pas është bërë klasifikimi i tyre sipas fushës përkatëse.

## Roli i gjuhës në jurisprudencë

Ligji funksionon përmes gjuhës e gjuha është fillesa e të gjitha ligjeve. Çfarëdo mesazhi që ligji supozohet t'u komunikojë qytetarëve të caktuar, duhet të tejetohet përmes gjuhës. Para së gjithash, çdo veprim që buron nga zbatimi i ligjit duhet të programohet dhe përcaktohet përmes gjuhës. Dhe duke qenë se ligjet duhet të formulohen përpara se të ndodhë një veprim, procesi i ligjëbërjes shënon fillimin e të gjithave dhe gjuha qëndron në thelb

të këtij aktiviteti<sup>85</sup>. Para se të kalojmë në analizën e termave juridikë, fillimisht do të shpjegojmë termat *juridik, e drejtë, ligj, kod*.

Në të gjithë fjalorët shpjegues kuptimet e termit *juridik* jepen kryesisht nëpërmjet këtyre shpjegimeve: “Që lidhet me normat dhe ligjet e së drejtës, që lidhet me drejtësinë dhe me të drejtën”<sup>86</sup>; “1. Që bëhet, ushtrohet në drejtësi ose përpara drejtësisë. 2. Që ka lidhje me të drejtën, që prodhon efekte që lidhen me të drejtën”. I pari sinonim që renditet në këta fjalorë dhe që, siç del nga përkufizimi, shërben si referencë kryesore për këtë përcaktor të shprehur me mbiemër, është termi “e drejtë”. *E drejta* është një sistem rregullash dhe zgjidhjesh që organizojnë shoqërinë në emër të disa vlerave shoqërore, duke synuar drejtësinë sociale ose sigurinë e shoqërisë. E drejta korrespondon me tërësinë e rregullave shoqërore që drejtojnë raportet e njerëzve ndërmjet tyre ose me pushtetin, sjelljen e burrave dhe të grave në një shoqëri, raportet shoqërore. Në kuptimin e gjerë, *një ligj* është një dispozitë normative që vendos një rregull juridike për aplikim të detyrueshëm

*Një kod* paraqitet si një tërësi dispozitash normative, të bashkuara në një vepër, të cilat paraqesin një vijimësi logjike të librave, titujve, kapitujve, seksioneve, ndonjëherë edhe nënseksioneve, paragrafëve dhe në fund neneve. Kodet përmbajnë ekskluzivisht tekste të ligjeve ose të rregulloreve që kanë një përmbajtje zyrtare. Tekstet speciale, tekstet e shfuqizuara, komentaret, bibliografitë, referencat ndaj doktrineve dhe ndaj jurisprudencës që botuesit fusin në tekst ose në vijim të neneve të kodeve, nuk kanë fuqinë e ligjit.

Ligjet janë të shkruara sipas një stili të veçantë, që është specifik për këtë sferë të veprimtarisë njerëzore. Ndërmjet stileve funksionale të klasifikuara mbi bazën e kriterit të funksionit dhe të sferave të përdorimit në veprimtaritë e ndryshme njerëzore, si stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili fetar, stili shkencor-teknik dhe juridik-administrativ zënë një vend të veçantë<sup>87</sup>.

Sasia mbizotëruese e leksikut dhe sasia e kufizuar e tij në përbërje të stileve mund të krijonte një kundërvënie mbi një bazë më të gjerë në gjuhë për t’i rigrupuar stilet dhe për të veçuar kështu dy pjesë përbërëse kryesore në gjuhën shqipe: a) ligjërimin e përgjithshëm, i cili ka në bazë stilin e letërsisë artistike dhe pjesërisht stilin politiko-shoqëror dhe atë fetar me pjesët me përdorim të mjeteve shprehëse me karakter ndikues (politik) dhe sugjestiv (fetar); b) ligjërimi i specializuar që bashkon dy stilet me karakter të mirëfilltë special, stilin shkencor-teknik dhe atë juridik-administrativ<sup>88</sup>. Identifikimi i një terminologjie si sistem i veçantë mund të

<sup>85</sup> F. Vogel (red), *Legal Linguistics Beyond Borders: Language and Law in a World of Media, Globalisation and Social Conflicts.: Relaunching the International Language and Law Association (ILLA)*, Duncker & Humblot GmbH, 2019, f. 255-322.

<sup>86</sup> Grup autorësh, *Fjalor i gjuhës shqipe*, AShSh, IGJL, Tiranë, 2006, f. 423.

<sup>87</sup> A. Duro, *Terminologjia në ligjërimin e specializuar*, Studime Filologjike, 1997, f. 72.

<sup>88</sup> Po aty.

bëhet i plotë vetëm kur shihet në rrafshin e funksionimit të termave që e përbëjnë atë si shënues të koncepteve të një fushe të veçantë të dijes. Në varësi nga një tematikë e përbashkët në një fragment ligjërimit, mund të veçohet një grup termash, të cilët në tërësinë e tyre mund të përcaktojnë vlerën stilistike të fragmentit ligjërimit në fjalë<sup>89</sup>. Studiuesi Xh. Lloshi stilin juridik e përfshin si nënstil në stilin e veprimtarisë shtetërore e administrative, ku si kategori teksti përfshihen tekstet ligjore dhe kushtetuta<sup>90</sup>.

Ligjërata shtetërore është një ligjërata imponuese, pavetore. Funkcioni stilistik i ligjërimit të këtyre teksteve është kumtues dhe parashkrues, duke e bërë të detyrueshëm zbatimin e tyre. Tekstet ligjore shkruhen duke u kujdesur më shumë që të mos keqkuptohen, sesa që të kuptohen,- thotë studiuesi Xh. Lloshi.

Sfida kryesore e gjuhëtarëve, terminologëve, si dhe specialistëve të fushës ka të bëjë pikërisht me kuptimin e një ligji, teksti i të cilit hartohet dhe u drejtohet të gjithë njerëzve të një shteti të caktuar. Qartësia gjuhësore, e sidomos ajo terminologjike, lehtëson kuptimin, prandaj funksioni imponues dhe detyrues i tij del në pah më mirë duke u njohur dhe u zbatuar në masë. Gjuha e ligjeve, nuk është aq e thjeshtë për t'u kuptuar nga të gjithë dhe vështirësia e të kuptuarit shtohet edhe më tepër kur tekstet juridike përkthehen.

Le të shohim se cilat janë tiparet e leksikut të jurisprudencës në mediet e Kosovës e të Shqipërisë!

Në periudhën e pasluftës në Kosovë pati një zhvillim të hovshëm të legjislacionit. Kalimi nga njëri sistem në sistemin tjetër të qeverisjes, me ligje që hartoheshin aty për aty, me akte ligjore e rregullore, çoi në përdorimin e gabuar të shumë termave juridikë. Kjo erdhi edhe si rezultat i mungesës së seriozitetit të hartuesve të këtyre ligjeve, rregullave etj., përkthimin e gabuar apo mospërshtatjen e duhur të termit nga gjuha e huaj në shqipe etj. (kryesisht nga anglishtja në shqipe), si dhe “moszotërimi i mjaftueshëm i rregullave të terminologjisë profesionale, mosnjohja e duhur e gjuhës shqipe dhe e gjuhës angleze gjatë përkthimit të materialeve nga fushat e shumta të dijes krijojnë një varg termash juridikë të panevojshëm dhe jo përkatës për gjuhën tonë. Mungesa e normëzimit terminologjik dhe e fjalorëve profesionalë përkatës gjithëpërfshirës bënë që të krijohen anglicizma dhe neologjizma të panevojshëm në shqipe”<sup>91</sup>.

Në Kosovë, termat juridikë janë kryesisht huazime, ashtu siç janë në shumicën e gjuhëve evropiane, prandaj është i domosdoshëm një qëndrim korrekt ndaj termave. Të përkthehen a përshtaten kur shqipja i ka mjetet dhe të lihen siç vijnë nga gjuha hyrëse kur shqipja s'ka një gjegjëse të kënaqshme. Çështja e termave nga fushat e dijes apo veprimtarisë njerëzore duhet t'i lihet gjithnjë në dorë profesionistit. Megjithatë, gjatë

<sup>89</sup> Po aty.

<sup>90</sup> Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.

<sup>91</sup> Sh. Hoxha, A. Caka, A. Raça-Shala, *Terminologjia juridike anglisht -shqip në legjislacionin e Kosovës në periudhën 1999-2009*, f. 1-12.

periudhës së pasluftës në Kosovë, me gjithë përpjekjet e bëra në hartimin e fjalorëve terminologjikë për jurisprudencë nga disa autorë, që kryesisht janë bazuar në forca të veta, siç është *Fjalor i termave të drejtësisë*, i autorit Sylë Kasumaj<sup>92</sup> e ndonjë tjetër, janë bërë edhe disa përpjekje institucionale për hartimin e një glosari të legjislacionit me bashkëpunim profesionistësh të udhëhequr nga OSBE-ja (Organizata për Siguri e Bashkëpunim Evropian)<sup>93</sup>. Këto mangësi do të pasqyrohen padyshim edhe në medie.

Ashtu si terminologjia e fushave të tjera të dijës, edhe terminologjia e jurisprudencës paraqet të njëjtat probleme. Gazetarët, në shumicën e rasteve nuk i përkthejnë apo përshtatin termat edhe kur e kemi një gjejëse në shqipe. Po ashtu, duke qenë se lajmet nëpër portalet mediatike hartohen e publikohen shumë shpejt, gazetarët nuk ia kushtojnë gjuhës kohën e mjaftueshme. Po sjellim një shembull nga portali mediatik “Bota sot”: *Ky i fundit, para disa ditësh, ka shkruar se Tribunali Special për Kosovën ka lëshuar aktakuzën e tij Hashim Thaçi dhe tre ish-udhëheqës të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por nuk ka asnjë shenjë të trafikimit të organeve të marra nga të burgosurit serbë, gjë që ishte një turp i organizuar nga shërbimet sekrete serbe dhe ruse...*

...“Deklarata e z. S. Metais është e natyrës letrare, beletristike e filozofike e lansuar si një flokule voluntaristë, e cila nuk do të mund të reflektohej në rrafshin politik e juridik aktual. Së andejmi deklarata e tillë mbetet shprehje e një opinionit qëllim mirë dhe për aq mbetet një opinion publik dhe asgjë tjetër”, theksoi Smaka... (të vihet re përdorimi i fjalëve të huaja të panevojshme, si: *beletristike, e lansuar, flokule voluntaristë*) ...“Kolegjet prokuroriale e gjyqësore të specializuara janë themeluar nga Kuvendi i RK-së, me mbështetje implicite nga komponentë ndërkombëtare ndaj *abrogimi* i të cilave do të mund të bëhej në procedurë të njëjtë, e cila tejet vështirë do të mund të realizohej”, nënvizoi Smaka (“Bota sot”, 9 dhjetor 2020).

Nga shembujt e mësipërm, duket qartë se gazetari nuk i ka kushtuar aspak vëmendje gjuhës së përdorur në shkrimin e lajmit. E njëjta situatë haset edhe në mediet në Shqipëri.

Siç dihet, terminologjia na vjen në ndihmë për të shprehur qartë koncepte të caktuara. Një tipar i rëndësishëm i gjuhës së sferës juridike është mungesa e ambiguitetit (dykuptimësisë), që do të thotë se një ligj s’mund të hartohet në mënyrë të atillë që të ketë më shumë se një interpretim. Eliminimi i ambiguitetit, shpesh kërkon forma më të shtjelluara të shprehjes në krahasim me ato që përdoren rëndom në fjalimet e zakonshme ose në gjuhën e përditshme, ndërkohë që legjislacioni duhet të shprehet me një gjuhë më të përgjithësuar dhe me natyrë shumë më abstrakte. Ligjet duhet të sqarojnë sa më saktësisht dhe me një gjuhë të

<sup>92</sup> S. Kasumaj, *Fjalor i termave të drejtësisë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019. (Ky fjalor terminologjik është vlerësuar si njëri ndër fjalorët më të mirë që është botuar në Kosovë gjatë viteve të fundit).

<sup>93</sup> Po aty.

përgjithshme atë që është e sanksionuar, prandaj dhe terminologjia duhet të zgjidhet me kujdes që të shmangen keqkuptimet dhe interpretimet e shumëfishta. Kjo kërkon që e njëjta fjalë përgjatë gjithë tekstit juridik duhet të ketë po atë kuptim. Po ashtu, fjalët e përdorura në hartimin e ligjeve nuk mund të jenë polisemantike. Termat e kanë këtë tipar, pra, monosemantizmin. Kjo gjë e bën tekstin juridik të jetë i saktë, i zbatueshëm dhe i kuptueshëm.

Sa më i kuptueshëm të jetë ligji, aq më i saktë do të jetë interpretimi që i bëhet atij. Dhe sa më i saktë të jetë interpretimi, aq më i drejtë do të jetë vendimi kundrejt një çështjeje të caktuar. Megjithatë, jo në të gjitha rastet ndodh që tekstet juridike të jenë kaq të qarta. Më tej, edhe media si hapësira ku përpunohet e përcillet informacioni, tekstet gazetareske do t'i ketë të tejmbushura me fjalë e terma që nuk kuptohen nga publiku i paspecializuar. Në mediet në Shqipëri hasim shpesh lajme nga fusha e drejtësisë që përmbajnë shprehje ligjore të tejzgjatura; mospërdorim i standardit të gjuhës etj. Ja një rast nga "Gazeta shqiptare": "*Ministria e Drejtësisë u përfshi dje dhe sot në një furtunë shkarkimesh dhe arrestimesh, por vetë ministrja Etilda Gjonaj nuk ishte në detyrë. Ajo ia kishte deleguar që më parë kompetencat zëvendësministres, Teuta Vodo. Urdhri i delegimit është publikuar në Fletoren Zyrtare dhe nëpërmjet tij ministrja Gjonaj i ka deleguar Teauta Vodos të gjithë kompetencat e titullarit të kësaj ministrie, për vetëm 24 orë. Një rast i rrallë ky ku një ministre i delegon kompetencat e titullarit të ministrisë zëvendëses së tij vetëm për 1 ditë*" ("Gazeta shqiptare", 6 shkurt 2019).

Më poshtë po paraqesim një shembull tjetër:

*"Me delegimin e kompetencave, përveç reagimeve politike mbi lëvizjen e Ramës, po diskutohet edhe pjesa procedurale, për shkak se disa konstitucionalistë gjykojnë se kryeministri "shkeli betimin Kushtetues", pasi u betua edhe si ministër, ndërsa menjëherë ia kaloi kompetencat zëvendësministrit. I pyetur mbi "delegimin e kompetencave", Presidenti Ilir Meta reagoi në mënyrë të përmbajtur, teksa përmendi kushtetutën dhe nga ana procedurale e kishte të pamundur të mbante qëndrim për zgjedhjen e Ramës. "Presidenti nuk ndërhyr dhe nuk komenton për aktet e organizimit të brendshëm të ekzekutivit apo të ministrive. Unë si President i Republikës respektoj Kushtetutën dhe i kam shumë të qarta kompetencat e mia se cilit institucion mund t'i delegojë autoritetin kushtetues për të lidhur marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë"- deklaroi presidenti Meta*" ("Gazeta Mapo", 24 janar 2019).

Është e qartë që tekstet e mësipërme i drejtohen publikut të gjerë dhe një jospesialist e ka të vështirë të kuptojë terminologjinë e përdorur në këto tekste dhe si rrjedhojë nuk arrin të informohet për atë çka nënkupton shkruesi. Po t'i hedhim një sy Kodit të Procedurës Civile, do të shohim se ai nuk u drejtohet joprofesionistëve. Gjuha e tij nuk kuptohet lehtë, pasi shumë fjali janë të ngatërruara, janë bërë shumë referime të ndërlikuara dhe termat teknikë nuk janë vetëshpjegues. Kjo çon pastaj në vështirësi për

zbatimin e ligjit, duke qenë se termat janë të paqartë dhe të hapur për interpretime të ndryshme.

Më poshtë gjendet një listë me disa nga termat më të përdorur në fushën e jurisprudencës në mediet e marra në analizë, së bashku me shpjegimin e tyre.

**Abrogim-** Veprim formal i shfuqizimit të një ligji, akti juridik, ose dispozite tjetër ligjore.

**Akt nënligjor** - Vendim, rregullore, udhëzim i nxjerrë nga organet ekzekutive ose organet lokale për zbatim të ligjit, që karakterizohet normativ dhe është i detyrueshëm për të gjithë.

**Akt normativ** - 1. Akt i nxjerrë nga organet ligjvënëse, ekzekutive ose lokale që është i detyrueshëm për të gjithë. 2. Akt normativ i Këshillit të Ministrave, institucioneve të tjera qendrore ose organeve lokale - Akt i miratuar nga Këshilli i Ministrave, institucionet e tjera qendrore ose organet lokale, në rast nevojë dhe urgjence, i cili e humb fuqinë që nga fillimi në rast se nuk ratifikohet nga Kuvendi brenda një afati të caktuar kohor.

**Aktgjykim detyrues-** Vendim gjyqësor që është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjykatat e tjera në të ardhmen, si një precedent ligjor.

**Aktgjykim dënues-** Vendim gjyqësor dënues; vendim sipas të cilit refuzohet kërkesa e një personi, organizate, ose pale tjetër në një proces gjyqësor.

**Akuzues (organ)-** Pala që ngre akuzën para organit gjyqësor.

**Aleat** - Ai që lidhet e bashkërendon veprimet me një tjetër për qëllime të njëjta; përkrahës aktiv i dikujt. Aleat besnik (i ngushtë).

**Alimentacion-** Kontribut financiar i caktuar nga gjykata që një person është i detyruar ta paguajë për t'u siguruar që një person tjetër, zakonisht një fëmijë, të ketë të plotësuara nevojat bazë të jetesës.

**Amnisti** - Akt faljeje i nxjerrë nga Presidenti i Republikës për të gjithë personat (ose kategori të caktuara personash) që janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, ose që janë në procedim.

**Ankesë-** Shprehje formale e pakënaqësisë ose mosmiratimit në lidhje me një vendim gjyqësor, ndaj një veprimi të institucioneve të zbatimit të ligjit, ose një situatë tjetër ligjore.

**Antikushtetues-** Kundërkushtetues, vendim ose akt juridik që është në kundërshtim me kushtetutën, që shkelë parimet kushtetuese.

**Apelim-**Të drejtuarit një gjykate më të lartë për të rishikuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët; Ankimim.

**Arsyetim vendimi-**Pjesë e një vendimi gjyqësor ku gjykatat përcaktojnë dhe shpjegojnë bazën dhe arsyet juridike për vendimin e tyre.

**Arrestuar (i, e)-** Personi i cili me vendim të organit kompetent (gjykatës ose policisë) është privuar nga liria.

**Autopsi-** Procedurë mjekësore që realizohet në trupin e një të vdekuri për të zbuluar arsyet e vdekjes ose për të bërë vlerësime të tjera mjekësore.

**Balotazh-** Proces i votimit shtesë kur në votimin e parë asnjëri nga kandidatët nuk merr shumicën e votave të nevojshme për të fituar.

**Bandit-** Person ose grup personash që veprojnë në kundërshtim me ligjin, duke u përfshirë në aktivitete kriminale.

**Barazi para ligjit-** Koncept juridik dhe moral që përcakton se çdo individ dhe organizatë duhet të trajtohet me të njëjtin respekt; duhen të kenë të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta para ligjit, pa dallim dhe diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, besimit, kulturës, ose çdo karakteristikë tjetër personale.

**Bartje e kontratës-** Proces ligjor ku një person ose një kompani i bartë (transferon) të drejtat dhe detyrimet e një kontrate të nënshkruar në tërësi ose në pjesë tek një person tjetër.

**Bastisje-** Veprim i autorizuar nga gjykata kompetente që përfshin kërkimin dhe inspektimin e një vendi, një objekti, apo një personi për të zbuluar dhe siguruar prova të mundshme për një proces gjyqësor.

**Bashkëfajtor-** Person që bashkëpunon me një person tjetër në kryerjen e një vepre penale, që përfshin pjesëmarrjen aktive ose ndihmën në planifikimin, organizimin, ose kryerjen e një veprimi kriminal.

**Burim detyrimi-** Fakte juridike prej të cilave krijohen detyrimet.

**Cenim i përhershëm-** Shkelje në mënyrë të vazhdueshme e një diçkaje ose e një të drejte nga një person i caktuar.

**Cenim-** Veprim me të cilin shkelen interesat ose gjërat e dikujt, shkel diçka që është e paprekshme për dikë, prek diçka a dikë për t'i shkaktuar dëm.

**Çështje e gjykuar-** Rast që është shqyrtuar më parë, për të cilin është nxjerrë vendim nga një gjykatë apo një autoritet tjetër ligjor.

**Çështje juridike-** Situatë, mosmarrëveshje, ose problem që ka të bëjë me aplikimin, interpretimin, ose zbatimin e ligjit.

**Daktiloskopi-** Degë e shkencës së kriminalistikës që ka të bëjë me identifikimin e individëve përmes analizës dhe krahasimit të figurës së vijave papilare në lëkurën e gishtërinjve të duarve, shuplakave dhe të shputave të njeriut.

**Delikuencë-** Veprim a sjellje që shkelë ligjet ose normat shoqërore.

**Dosje kriminale-** Dosje zyrtare ose lëndë në të cilën janë të shënuara të dhëna mbi krimet e kryera dhe kryerësit e tyre.

**Dosje penale-** Të gjitha shkresat e lëndës që lidhën me veprën penale dhe me kryerësin e saj.

**Dyshim i arsyeshëm-** Njohuri për informacionin që do ta bindte një vëzhgues objektiv se një veprë penale ka ndodhur.

**Dyshim i bazuar-** Shkallë e lartë e besueshmërisë që një person ka kryer veprë penale.

**Dhënie e aktgjykimit-** Marrje vendimi; të gjitha veprimet gjyqësore që kryhen që nga momenti kur fillon këshillimi dhe votimi e deri në momentin kur aktgjykimi bëhet akt juridik.

**E drejta e jetës-** E drejtë themelore e njeriut e garantuar në një varg instrumentesh ndërkombëtare.

**Ekshumim-** Zhvarrosje e kufomës me qëllim kontrolli dhe autopsie (obduksioni), kur ka dyshime se vdekja është pasojë e një akti kriminal.

**Fajde-**Vepër penale kundër pasurisë, e paraparë me dënim në Kodin Penal, që nënkupton pranimin ose kontraktimin për vete apo për personin tjetër një sasi dukshëm jo proporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personit të tillë, gjendjen e rëndë të banimit, varfërisë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar drejt.

**Falsifikim-**Vepër penale kundër rendit publik dhe veprimeve juridike; krijimi ose prodhimi i paligjshëm i dokumentit, ndryshimi ose përdorimi i dokumentit të falsifikuar; ndryshimi i dokumentit të vërtetë.

**Falsifikues-**Personi i cili kryen vepër penale të falsifikimit, personi që përpilon, ndryshon një dokument ose e përdor dokumentin e falsifikuar me qëllim përfitimi material.

**Gazetë zyrtare** - Botim periodik që është autorizuar të publikojë njoftime publike ose ligjore.

**Guvernator** - Zyrtari më i lartë, që drejton e qeveris një provincë a një departament në disa shtete kapitaliste ose një shtet të veçantë në një federatë shtetesh kapitaliste; zyrtari më i lartë që përfaqëson shtetin sundues e që qeveris në një koloni.

**Gjykatë Kushtetuese** - Gjykata më e lartë në vend kur bëhet fjalë për interpretimin, mbrojtjen dhe zbatimin e kushtetutës.

**Inspektorat** - Organ shtetëror i ngarkuar të shohë punën e ndërmarrjeve a të institucioneve të caktuara, organ që kontrollon, që jep udhëzime për diçka a që merret me zgjidhjen e diçkaje; zyra e ndërtesa e këtij organi. Inspektorati shtetëror (rrugor, shëndetësor). Inspektorati i sigurimit teknik (i mbrojtjes, i farërave, i futbollit). Inspektoratet e punës. Punonjësit e inspektoratit.

**Institucion** - Organizëm shtetëror a shoqëror, që e zhvillon veprimtarinë e vet në një fushë të caktuar të ekonomisë, të shkencës, të arsimit, të kulturës, të jetës shoqërore, politike etj. Institucion shtetëror (shkencor, parashkollor, shëndetësor, artistik, shoqëror). Institucion ideologjik (politik, ushtarak). Institucion fetar. Institucionet qendrore.

**Kod penal** - Dokument që përmbledh të gjitha, ose një sasi të konsiderueshme të ligjit penal të një juridiksioni të caktuar.

**Kufi ligjor** - Kufizim në madhësinë ose sasinë e diçkaje të lejueshme ose të mundshme.

**Kushtetutë** - Ligji themelor i një shteti, që përcakton rendin politik dhe ekonomik e shoqëror të tij, sistemin e zgjedhjeve, organet e larta dhe lokale të pushtetit shtetëror e të administratës shtetërore, organizimin e mbrojtjes së vendit e të forcave të armatosura, të gjykatave e të prokurorisë si edhe të drejtat e detyrat themelore të shtetasve.

**Ligj** - Normë, rregull që vendoset nga organi më i lartë i pushtetit shtetëror dhe që është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore dhe për të gjithë shtetasit.

**Mbrojtje sociale** - Politika dhe programe të dizajnuara për të mbrojtur njerëzit nga goditjet dhe streset gjatë jetës së tyre.

**Ndjekje penale** - Akti ose procesi i mbajtjes së një gjykimi kundër një personi që akuzohet për një krim për të parë nëse ai person është fajtor.

**Pandehur (i,e)** - Ai që nxirret përpara gjyqit për fajë e veprime të kundërligjshme. **Paraburgim** - Koha nga dita e ndalimit të dikujt që dyshohet për një faj a krim deri kur jepet vendimi nga ana e gjykatës.

### **Përfundime**

Mediet në Kosovë, ashtu si edhe ato në Shqipëri, përdorin pak a shumë terma të njëjtë që i përkasin fushës së jurisprudencës, që në shumicën e rasteve janë të huazuara nga latinishtja dhe gjuhë të tjera, pra dalin të papërpunuar (të përkthyer ose të përshtatur).

Terminologjia e huaj ka vërshuar në masë të madhe, sidomos në fushat e dijës, ku kuptimet leksikore janë prurje të reja bashkë me elementet që ato emërtojnë. Sot edhe gjuha e jurisprudencës është bërë vatër e lindjes dhe e përdorimit të këtyre termave. Ata janë bërë pjesë e fondit aktiv të shqipes. Si rregull, pasurimi i çdo sistemi terminologjik më së shpeshti kryhet me qëllim të plotësimit të boshllëqeve, pra kur sistemi ka nevojë për një koncept të ri, pasi në rastin e mungesës në sistemin leksikor të gjuhës marrëse të fjalëve që ekzistojnë në një terminologji të huaj, lindë nevoja për të krijuar një term të ri, prandaj, procesi i huazimit të termave është shumë dinamik. Analiza e kryer dëshmon se sot, futja e termave të rinj në sistemin terminologjik është një proces i pakthyeshëm. Pavarësisht fanatizmit të disa studiuesve për "pastërtinë" e gjuhës, duhet pranuar se proceset e vazhdueshme që ndodhin në pasurimin e sistemeve terminologjike janë procese që ndodhin në të gjitha gjuhët e botës, të shoqëruara me një trysni të jashtëzakonshme nga gjuhët si anglishtja, gjermanishtja, frëngjishtja etj.

### Literaturë

**DURO, Agron, *Terminologjia në ligjërimin e specializuar, në: Studime Filologjike, 1997.***

**GASHI, Sejdi, *Çështje sociolinguistike të terminologjisë në mediet e Kosovës dhe të Shqipërisë, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2024.***

**HOXHA, Shpresa et.al. *Terminologjia juridike anglisht -shqip në legjislacionin e Kosovës në periudhën 1999-2009.***

**KASUMAJ, Sylë, *Fjalor i termave të drejtësisë, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019.***

**LLOSHI, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika, Tiranë, 1999.***

**THOMAI, Jani et.al, *Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Lletërisë, Tiranë, 2006.***

**Vogel, Friedemann (red), *Legal Linguistics Beyond Borders: Language and Law in a World of Media, Globalisation and Social Conflicts.: Relaunching the International Language and Law Association (ILLA), Duncker & Humblot GmbH, 2019.***

Faton KRASNIQI  
Instituti Albanologjik - Prishtinë  
[ffaton.krasniqi@hotmail.com](mailto:ffaton.krasniqi@hotmail.com)

**FJALËSI GJUHËSOR DHE ESTETIK I VEPRËS LETRARE TË BEQIR  
MUSLIUT  
THE LINGUISTIC AND AESTHETIC LEXICON IN THE LITERARY WORK  
OF BEQIR MUSLIU**

**Abstract**

Beqir Musliu, an important figure of 20th-century Albanian literature, left behind a rich literary and linguistic legacy closely connected to the development of modern Albanian literature. In Albanian literature of the 20th century, one of the most significant elements of its evolution has been the rich and expressive use of language. This phenomenon is particularly evident in the works of well-known modern writers who have contributed not only to the literary field but also to the enrichment and standardization of the Albanian language. This study focuses on the analysis of language and aesthetics in Musliu's works, emphasizing the influence his language has had on shaping a distinct literary and cultural identity.

**Keywords:** Beqir Musliu, lexicon, work, literature, aesthetics

**Abstrakt**

Beqir musliu, një emër i rëndësishëm i letërsisë shqiptare të shekullit xx, ka lënë një trashëgimi të pasur letrare e gjuhësore që lidhet ngushtë me zhvillimet e letërsisë moderne shqipe. Në letërsinë shqipe të shekullit xx, një nga elementet më të rëndësishëm të zhvillimit të saj ka qenë përdorimi i pasur i gjuhës. Ky fenomen është veçanërisht i dukshëm në veprat e shkrimtarëve të njohur modernë, të cilët kanë kontribuar jo vetëm në nivelin letrar, por edhe në pasurimin dhe standardizimin e gjuhës shqipe. Ky studim fokusohet në analizimin e fjalës dhe estetikës në veprat e musliut, duke theksuar ndikimin që ka pasur gjuha e tij në formimin e një identiteti letrar dhe kulturor të veçantë.

**Fjalët çelësa:** beqir musliu, fjalës, vepër, letërsi, estetikë

## Hyrje

Gjatë shekullit xx, studiuesit e historisë së letërsisë dhe të gjuhës shqipe, në veprat e tyre, i kanë kushtuar shumë rëndësi ndihmesës së shkrimtarëve dhënë gjuhës shqipe. Kërkimet e tyre të kësaj natyre ishin rrjedhojë e rilindësve shqiptarë të fund të shekullit xix, të cilët krijimtarisë së tyre letrare ju dhanë dimensione estetike dhe gjuhësore njëkohësisht. Fjalë, togfjalësha, neologjizma, kompozita etj., gjatë rilindjes kombëtare nuk patën krijuar vetëm bardët e mendimit shkencor (sami frashëri, jani vreto, konstantin kristoforidhi, faik konica, aleksandër xhuvani etj.) Po edhe krijuesit letrarë (jeronim de rada, naim frashëri, ndre mjeda etj.). Le të kujtojmë vetëm faktin se për të gjallë dhe gjatë gjithë shekullit xx naim frashëri, më parë se sa konstantin kristoforidhi që quajtur babai i gjuhës shqipe. Edhe gjuha e krijimtarisë së beqir musliut në poezi, prozë, dramë është i pasur në shumë aspekte: në kontekstin gramatikor, leksikor, sintaksor, stilistik e semantik.

Kjo traditë ka vazhduar edhe gjatë shekullit xx kur gjuha më nuk ishte vetëm objekt kujtese po edhe objekt studimi e standardizimi nga të gjithë idealistët postrilindas, nga krijuesit dhe nga studiuesit. Nuk është prandaj as e rastit që poetët si, gjergj fishta, aleksandër stavre drenova – asdreni, fan noli, lasgush poradeci, millosh gjergj nikolla – migjeni, ernest koliqi etj., u shquan për përdorimin e gjuhës popullore, për krijimin e fjalësit shumëkuptimor, për krijimin e neologjizmave dhe trajtave të reja semantike të fjalëve të vjetra, për resemantizimin e togfjalëshave dhe frazeologjizmave popullore etj.

Në gjysmën e dytë të shekullit xx kur letërsia shqipe shquhet për forma të reja letrare të shkrimit, krijues të shumtë do të shquhen në mënyrë të veçantë për përdorimin e gjuhës. Në fushë të poezisë kritika letrare dhe përgjithësisht historianët e letërsisë do ta shquajnë poezinë e martin camajt, azem shkrelit, enver gjerçekut, fatos arapit, xhevahir spahiut etj., prozën e jakov xoxës, ismail kadaresë, anton pashkut, dritëro agollit, jusuf gërvallës etj., kritikën dhe publicistikën e rexhep qosjes, Ramiz Kelmendit etj. Por në këtë rrjedhë na ka rënë rrasa të vëmë re përjashtimin e njërit prej krijuesve më të mirë, si beqir musliu, me prirje tejet të veçantë për përdorimin e gjuhës në poezinë, prozën dhe dramën e tij.

Beqir Musliu (Gjilan, 1945 – 1996), i takon brezit të krijuesve të gjysmës së dytë të shekullit xx, kryesisht viteve '60 -'80, i cili në letrat shqipe paraqitet me poezinë, prozën, dramën dhe kritikën letrare, përkatësisht teatrore. Shkrimtari beqir musliu, që në vitet '60 paraqitet me krijimet letrare duke botuar në fund të kësaj dekade njërin prej vëllimeve më të mira me poezi “Bukuria e zezë” (1968). Me këtë vepër dhe me veprat që do t'i pasojnë deri në fund të viteve '70 (Rima të shqetësuara“ (1965); “Lulëkuqet e gjakut“ (1966); “Skënderbeu ose shqiponja e maleve“ (1968); “Sezamet“ (1972); “Parabola“ (1976); “Darka e magjisë“ (1978); “Skënderbeu“ (2004) dhe “Orfeiana“ – Shtatë libra anatema (2004), Beqir Musliu do të shënojë majat më të larta të poezisë moderne shqipe.

Në vitet '70 beqir musliu iu bashkohet shkrimtarëve të cilët në mënyrë të veçantë do të merren me krijimtarinë romanore, për të vazhduar edhe në vitet '80, kur krahas romanit shkruante edhe dramën. Kështu, ai gjatë këtyre viteve ka shkruar disa vëllime me tregime dhe romane, por disa nga këto i ka botuar gjatë viteve '70 e '80, e pjesën më të madhe në vitet 2000: *Vegullia* (1979); *Mbledhësit e purpurit* (1982); *Kori i gjelave të vdekur* (2002); *Makthi* (2004); *Amullia* (2004), *Krupa* (2004), *Skërluta* (2004) dhe *Ndeshtasha* (2004). Në jetën letrare dhe kulturore beqir musliu do të veçohet në mënyrë të veçantë me shkrimin e dramave, një gjini letrare jo shumë e arrirë në letrat shqipe në prishtinë dhe në tiranë. Kjo sigurisht edhe është arsyeja pse veprat e tij dramatike do të botohen në prishtinë dhe në shkup.

Dramat e tij do të botohen veç e veç në revistën letrare të prishtinës "jeta e re" dhe në revistën letrare të shkupit "jehona", do të shfaqen në teatrot e këtyre qyteteve dhe do të realizohen edhe në televizionin e atëhershëm të prishtinës. Ato gjithashtu do të botohen edhe në dy vëllime të përbashkëta: *"Shtrigani i gjel-hanit" – libër-teatër, tetralogji* (Prishtinë, 1989), brenda të cilit ishin janë përfshirë dramat: *Unë Halil Garria* (1989); *Faustiana* (1989); *Ora e kukuvajkës* (1989); *Panairi i gjilanit* (1989); si dhe në vëllimin *"Rrakullima" II- teatër - libër, tetraptik* (shkup, 1990), në të cilin janë përfshirë dramat: *Murana* (1990), *Kori i korbave* (1990), *Familja e shenjtë*, (1990) dhe *Antifona* (1990). Gjatë gjithë kësaj kohe beqir musliu është marrë edhe me kritikën letrare dhe sidomos me kritikën teatrore, të cilat në punimin tonë nuk kanë qenë objekt hulumtimi.

Gjuha e krijimtarisë së tij në poezi dhe në prozë është e pasur në shumë aspekt: në kontekstin gramatikor, leksikor, sintaksor dhe stilistik e semantik. Megjithëse e vjelë nga tri gjini letrare: në poezi, në prozë dhe në dramë, gjuha e poezisë së tij, struktura leksikore, gramatikore, sintaksore dhe madje stilistike nuk dallon shumë as në planin morfologjik as në rrafshin sintaksor e stilistik.

### Fjalorth gjuhësor dhe estetik i beqir musliut

**Argoshë/t, em.** = puçrra të vogla që i dalin njeriut në trup nga vapa ose nga ndonjë sëmundje. Mbushet me argoshë. (jo vetëm gjuhën, po tërë trupin ma mbulonin *argoshët*. Ndiesha të ftohtë, ndërsa kërkoja të përhinë pluhuri, si krah turtulleshe, më mbuloi). (\**krupa*, 2004: 30).

**Agullon, fol.** = agullon dita, vagëllohet, mjegullohet, vishet. (ai ferku i parë i mëngjesit kishte zënë të *agullonte*). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 385).

**Ahasferi, em. Orient.** = e mendoj hermanin si një lloj *ahasferi* i cili përkundër disponimit të keq që mbante për të i ngjante një mbreti të humbur. (\**skërluta*, 2004: 68).

**Ajgëtim, fol.** = shoh, shquaj për së largu; vëzhgoj, përgjoj. (shihte çdo gjë si në mjegullirë, sikur nga dritarja e dhomës në dimër *ajgëtimin* e gjërave që janë jashtë). (\**amullia*, 2004: 254); ... (mund të *ajgëtohen* të gjitha gjërat, e

shumë më mirë do të mund t'i veneroj të gjitha ato sende e gjëra). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 73).

**Akacie, em.** = dru bishtajor i vendeve të ngrohta, me lëvore të plasarit, me gjemba. (akacie e bardhë e verdhë. Rrobat i kishte varur në një *akacie* në bregun e lumit të bukur). (\**kori i gjelave tëvdekur*, 2002: 10).

**Askëcilës, përem.** = përdoret për të treguar në mënyrë të papërcaktuar e të përgjithësuar. (e *askëcilës* fytyrë, le të mos jetë e fytyrës time). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 122); (ndryshkun ma shkriwe nga gjuha më le prapë në të njëjtën bozhure mu aty ku ta krijova atë imazh të verdhë prej të cilit u orvate të ikësh në *akëcilin* milenium). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 166).

**Askezë/a, em.** = (atë që ndodhi mdas këtij interludiumi mos e kërko më tej, meqë *askeza* u paralajmërua që në zanafillë). (\**shtrigani i gjel-hanit*, 1989: 215).

**Barabitet, fol.** = barazohet, nuk barabitet dot me të. (toka ndoshta do ta bëjë këtë gjë sepse toka është në mua e gurët në tokë prandaj krejt kjo do të jetë një trajtë mund të *barabitet* me të gjitha gjërat). (\**makthi*, 2004: 111).

**Bedeme/ja, em. Orient.** = pjesë muri, e ngritur si dhëmb mbi murin rrethues të një kështjelle, (përreth meje krijon *bedeme* të mykura të dergjura). (\**vegullia*, 1979: 138)

**Beronjë/a, em.** = grua që nuk bën fëmijë; shterpë. Mbeti beronjë. (*beronjat* do të lindin shumë fëmijë). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 422).

**Berre/ja, em.** = bagëti e imët; një kokë bagëti e imët. ((a po e sheh, të thashë unë, ai rri gati, vetëm një dremitje imja, ai do të këtu dhe të grah si *berreve*, atëherë nuk ka kush të të drejtojë në rrugë të drejtë, më tha engjullit tim). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 336)

**Bjerrasitësi, em.** Ai që e humb kohën kot. (këto janë vetëm punë të kota të një *bjerrasitësi* që nuk di se si t'i ikën kësaj humbelle e mbetet në syprinënë e saj). (\**skërluta*, 2004: 23.)

**Cimbuese, pickuese** = në vesh më ushtronte diçka *cimbuese*. Nuk isha në gjendje të logjikoja se krejt gjërat që ndodhnin në mua, ishin shkak i një mungese a një pamundësie, e cila ishte stroflluar në mua. (\**ndeshtrasha*, 2004: 59); pak më vonë një muzikë *cimbuese* e pushtoi dhomën, që i ngjante më tepër një ode ku rrinë burrat se sa një dhome të rëndomtë. (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 69).

**Cimleon, em.** Diçka që nuk të lenë të qetë, më cimleon. (më *cimleon* një diçka tjetër). (\**amullia*, 2004: 299).

**Ckopisur, i/e, mb.** I rraskapitur. = ai i *ckopisur* vetëm qëndronte në atë gjendje dhe me shtatë në dorë ua priste kokën kush e sulte atë. (\**vegullia*, 1979: 62).

**Çininë e purpurt, frazeol.:** hava e bukur çininë e purpurt ma seroi në mësallën time. (\**fshëhtësia e teatrit-libër*, në "rrakullima", 1990: 19).

**Çmerti/a, em.** = përshtypje me diçka të papritur a të pabesueshme. (në një qoshe të imazhit venerova diellin, por më *çmerti* kjo, se pak më parë këtë diell nuk e kam parë). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 29).

**Çongël/a, em.** = coptojnë, i bëjnë congël = (filluan t'i bijnë *çongël* edhe degët nga trangu i gjatë). (\**kori i gjelave të vdekur*, 2002: 111).

**Çora, fol.** = çjerr, çora. (unë klitha ti qeshe prapë, unë u *çora* ti më the bëju mullizezë). (\**shtrigani i gjel-hanit*. 1989: 459).

**Dispute, em.** = mund ë bëjmë *dispute* edhe më të gjata, me që unë e kam zgjedhur pikërisht këtë vend të të mund. (\**shtrigani i gjel-hanit*. 1989: 423).

**Ditëmëdrekë:** mund t'i shohesh yjet *ditëmëdrekë*. (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 361).

**Djerraditës/i, em.** = bjerraditës, ai që e humb kohën kot. (disa të tjerë sigurisht, *djerraditës* thonë në sheshin e kasabës). (\**vegullia*, 1979: 181).

**Dhelkon, fol.** = e përkëdhel, e ledhaton. Mbas një pauze të shkurtër nëna sikur e merr veten, shikon vogëlushin drejt në sy, pastaj e *dhelkon* atë, sikur të ishte ai vetë rexha. (\**shtrigani i gjel-hanit*, 1989: 310).

**Efendi/lerë, em. Orient.** = titull nderi që i jepej një njeriu me shkollë në periudhën e pushtimit osman; zotëri. (të thirrte shërbëtoret: avash, avash *efendilerë*, deri kur tju mësojë se çfarë pune duhet të bëni). (\**kori i gjelave të vdekur*, 2002:47).

**Egzegezë/a, em.** = (*shpëtove megjithatë nga tri shpërndërrimet e deritashme në të katërtën do t'i nxjerrë tri dredhë edhe në egzegezën*). (\**antifona, në "rrakullima"*, 1990: 417).

**Ferovisël/a, em.** Me agronin nuk do të dal më te stacioni i *ferovisël* për ta prituri dikë: ai nuk di çka pret, kurse unë pres një baba. (\**ndeshtrasha*, 2004: 65).

**Fëllime, mb.** = pellg i thellë. (ndërsa nëpër këtë farë *fëllime* frynte një fortunë). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 110).

**Fërgëllimë/a, em.** = lëkundje e shpeshtë dhe e lehtë e diçkaje në trajtën e valëve; dridhje e lehtë. (imzot, po unë krejt këtë udhëtim e paskam ëndërruar, apo *fërgëllima* ime e zbuloi edhe atë drithërim qiriri. (\**shtrigani i gjel-hanit*, 1989: 172); tyta është jeta e vdekja jonë mendoj hill kodra dhe një *fërgëllimë* ia ngjethi mishtë. (\**makthi*, 2004: 41).

**Fërku, ndaj.** = drita e parë mëngjesore. (kështu deri në *fërkun* e mëngjesit kur prapë gjelat kukuritnin). (\**kori i gjelave të vdekur*, 2002:38).

**Gilotinë/a, em.** = mekanizëm që përdorej në të kaluarën dhe që përdoret për t'u prerë kokën atyre që dënohen me vdekje. (të tjerët më fusin në *gilotinë*. (\**vegullia*, 1979: 105); unë viktimë e gjallë që më duhet të dalë para *gilotinës*). (\**kori i gjelave të vdekur*, 2002: 164).

**Gondo, fol.** Një për dejt e mi gjaku donte të më *gondo* aq. (\**vegullia*, 1979: 81).

**Govatë/a, em.** = enë e madhe, jo shumë e thellë prej druri, prej llamarine. (në atë arsenal të çuditshëm kish sëpata, shata, duar të këputura, sy të verbuar, zemra ende të gjalla *govata* me djersë, fuci me gjak, këmbë të sakatosura). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 273).

**Hajëthëm, mb.** = të hollë nga trupi e fytyra. (sikur në mes të murit e shoh një trajtë njeriu pak më të *hajëthëm* duke vizatuar nëpër atë mur diçka). (\**kori i gjelave të vdekur*, 2002: 70).

**Hajthëm, mb.** = i hollë nga trupi e nga fytyra. (nuk e kam asnjëherë aq të gjorë. Të *hajthëm*. Të frikshëm). (\**amullia*, 2004: 173).

**Hakamë/a, em.** = vrull i fuqishëm. (dikush fryu me *hakamë*, sa çel e mbyll sytë u rrënu kulla). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 44).

**Hakerruës, mb.** = kërcënues, kanosës. Vështrim hakërrues. (mos më shiko me atë shikim *hakerruës*, nuk jam unë fajtor përse ti nuk ke kokë). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 24).

**Imashku, em. Orient.** = nëpër buzë më lemerit një *imashk* i ndohtë. (\**vegullia*, 1979: 160).

**Janxhik/u, em. Orient.** = enë. (mori një *janxhik* me vete). (\**kori i gjelave të vdekur*, 2002: 91).

**Jasim/i, m. Orient.** = lutje fetare. = këndova edhe një *jasim* për shpirtin e talit. (\**vegullia*, 1979: 136).

**Kalamend, fol.** = lëkund dikë a diçka sa andej e këtej; e sjell rrotull derisa ia marr mendtë. Kalamend në djep. (mos u *kalamend* aty se mund të shtiem në atë varr). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 220).

**Lëmashk/u, em.** = shtresë a cipë e hollë që zë diçka nga sëmundja, kur prishet, lëmashku i lisave. (e kur e nzirrte nëpër gishta i mbetej një *lëmashk* i lemeritshëm: pshtirosej nga ai lëmashk, i vinte të vjell, por nuk mundte). (\**makthi*, 2004: 20).

**Laokont/i, em.** = (mund të më bartni deri në trojë të më sfidojnë, edhe po ia dëgojë gjëmët *laokonit* të marrë). (\**shtrigani i gjel-hanit*, 1989: 250).

**Mahagon, em.** = një lloj druri. (megjithatë, vetëm ajo më vente në gjumë, më përkundte në djepin e drurit, për të cilin thoshte se vetë babai e kishte mbaruar te një mik i largët prej drurit më të mirë *mahagoni*). (\**ndeshtrasha*, 2004: 38).

**Mahluk/u, em.** = torollak, njeri i paqytetëruar. (ç'i bëre rexhës moj shurra e *mahlukit*). (\**shtrigani i gjel-hanit*, 1989: 373).

**Myhyb/i, em. Orient.** = titull i sektit dervish. (nëse të gjejnë të fjetur do të shpallin për *myhyb* të taborit të djallit). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 362); (kij kujdes dhe ruju mire, se mund të jenë *myhybet* e melunit). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 337).

**Namaqorr/i, i/e, mb.** = njeri i pavëmendshëm. (po kush je ti or *namaqorr*). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 468).

**Namatisen, fol.** = fjalët që shqiptohen sipas besimeve të kota, moren gjithçka para veti. (xhelatët *namatisen* tanë dheun, banë shkrum...vallë, në votrën tonë jemi, s'kemi ku shkojmë prej saj!). (\**skenderbeu*, 1968: 35); (dinte të mendonte më gjatë dhe me thell. Frika e *namatiste*). (\**amullia*, 2004: 194).

**Ndryme, i/e, mb.** = e mbyllur. (dikush i hap buzët e *ndryme* për hi e vap'). (\**bukurija e zezë*, 1968: 26)

**Njajëzuan**, u bënë një. = (por kur sytë iu *njajëzuan* me terrin por ca libra ca fletore gjithfarë shkrimesh i shfletoi keto me një shpejtësi të madhe). (\**skërluta*, 2004: 86).

**Njajo, përem.** = (duke menduar se ajo është *njajo* kodra e ndritshme prej purpuri). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 141); (si e quan ai, është mu *njajo* shoqëri e djallit melun dhe ndjekësve të tij, pastaj të shkojmë me rend: në gllamë të gjilanit të varrezat e jevgive, ka ndezur zjarr dhe ka pjekur kallinj misri me dërrasat e nxjerra nga varrezat). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 254).

**Ofkëllimë/a, em.** = ushtimë e zërit, erës. (dëgjova predikusin se si vetëm leshoi një *ofkëllimë*). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 331); (o zot, ç'janë këto *ofkëllimë*? Unë jam fatimja, jote bijë. S'jam vdekja. S'jam murtaja. Fol, ç'ka ndodhur? (\**shtrigani i gjel-hanit*, 1989: 126); *ofkëllonte* ngapak pastaj zgjohej ngadalë). (\**kori i gjelave të vdekur*, 2002: 85).

**Oreol/i, em.** = duke vizatuar në fytyrën tënde atë *oreol* të viktimës. (\**antifona, në "rrakullima"*, 1990: 423).

**Pahiste, fol.** = palim, palsoje. (vetëm era i *pahiste* kurorat ngadalë lezëm, qetë). (\**makthi*, 2004: 103).

**Paltronë/a, em.** = mos ma harroni jetëshkrimin e purpurt në amfiteatrin e dyrrahut ku kam lozur mbretërin time që s'ishte, në një *paltronë* kam qenë me gencin mbret. (\**shtrigani i gjel-hanit*, 1989: 269).

**Qimemurrmja, mb.** = që e ka qimen të ndritur. (ajo *qimemurrja* me gojë të çaraveshur). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 224).

**Qiqra/sh, em.** = bimë barishtore me kërcell mjaft të degëzuar, me gjethe të vogla e të dhëmbëzuara (në cinitë e purpurta servohej njëlloj gjelle me specialitete *qiqrash*). (\**fshëhtësia e teatrit -libër*, në "rrakullima", 1990: 18)

**Retush/i, em.** = ndreqje e hollë e me mjeshtëri, që i bëhet një fotografie. (edhe në legjion demonësh të kanë zbritur në pasqyrë dhe po të bëjnë *retush* fytyrën). (\**shtrigani i gjel-hanit*, 1989: 200).

**Rigëllimë/a, em.** = zhurmë shiu, bujë. Mendon se kjo mund të jetë *rigëllimë* shiu i portës triumfale të orleumit. (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 151).

**Rrakadyl/i, em. Orient.** = që i kanë rrjedhur trutë, që nuk di se ç'thotë. (i tërë xhemati po *rrakadylet* pas atij arkivoli). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 275); (më vonë filloi prapë atë ritualin e pakmëparshëm, t'i sillej *rrakadyl* lisit, së pari ngadalë, pastaj duke shpejtuar). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 208).

**Salvues/it, em. Biblike.** = përndjekësit, kryesisht për arsye fetare. (ja *salvuesit* mistikë po t'i shkëpusnin gishtërinjtë). (\**ex libris*, në "rrakullima", 1990: 11).

**Sallanagjaku, em. Orient.** = njësi administrative në kohën e perandorisë osmane, me shtrirje tokësore të ndryshme. (në *sallanagjakun* e mbretit je kanë e na këtu). (\**amullia*, 2004: 64).

**Savanë/a, em.** = treva fushore me bar të lartë dhe me pemë e shkurre të rralla, që shtrihet në të dy anët e ekuatorit dhe që ka një stinë, të thatë e një

stinë me lagështi. (jam bërë si savanë. Nuk po lëviz vendit). (\**krupa*, 2004: 97); (mbase ti e ke ëndërruar për herë të tretë *savanën* e gjilanit dhe je kthyer në gllamë për t'ia sfiduar shtriganit të gjel – hanit varieteun teatror). (\**murana*, në "rrokullima, 1990: 40).

**Shalakatur, i. Mb.** = tund sa nga një anë në tjetrën, luhat; dredh. (i bëhej se kambanat e atij bregu kishin njëfarë tingëllime, kumbimi të jashtëzakonshme edhe se nuk u ngjanin kambanave të tjera që ishin në këtë breg ku qëndronte edhe hil kodra i *shalakatur*). (\**makthi*, 2004: 71).

**Shanjohet, fol.** = marr shenjë, marr vijën e shënjitimit. Shënjon mirë. Shënjoj në shenjë. (gratë që tremben natën dhe që u *shanjohet* farë shtrige: posa të bëjnë njetin se do t'u bashkohen mbledhësve të purpurit do të lirohen prej frikës dhe mundimit të pagjumësisë). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 46).

**Tebdil, ndajf. Orient.** = krejt ndryshe në veshje, në fytyrë, me pamje tjetër a me rroba të tjera për të mos u njohur. I veshur tebdil. U bë tebdil. (nuk kisha guxim as të ktheja kokën prapa. qyteza ishte bërë *tebdil*). (\**ndeshtrasha*, 2004: 31).

**Tëhuajsoheshin, folj.** Bëri tjetërsimin. = (më *tëhuajsoheshin*, as nuk mund t'i njihja gjurmet e mia nëpër fushë). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 40).

**Zilkë/a, em.** Vegla. = (atë e bart litë xhamalli me xhamallët e tij duke cingërruar me disa *zilka*, sikur paralajmërojnë zbritjen e satanait të madh). (\**shtrigani i gjel-hanit*. 1989: 538).

**Zorzaman, mb. Orient.** Kohë e vështirë. = (ju kam thënë se edhe për ju do të vijë një *zorzaman*). (\**amullia*, 2004: 243).

**Zmaltinë/a, f.** = (muri i shtëpisë u la në *zmaltinë*). (\**shtrigani i gjel-hanit*, 1989: 371).

**Zhurit, fol.** = e djeg shumë, e bëj shkrumb, e shkrumboj; e përcëlloj; e përvëloj. (e zhuriti bukën. E zhuriti flaka. Fashistët e zhuritën fshatin. E zhuriti me hekur të skuqur. As të robërohem deri në fund prej kësa skllavërie të tmerrshme ndjenjore që *zhurit* në shpirtin tim). (\**vegullia*, 1979: 34); (vetëm zërin ia dëgjoj, asgjë tjetër, por tash veç më *zhurit* nëpër ëndërrime e paktë). (\**mbledhësit e purpurit*, 1982: 36); (në shpirtin tim ka mbetur vetëm një ndjenjë *zhuritëse* që më mban ende në jetë). (\**vegullia*, 1979: 108).

## Përfundim

prej kërkimeve tona kemi mundur të konstatojmë rrafshe të shumta të modeleve mbi të cilat autori ka krijuar fjalë të reja, sikur janë: parashtesat dhe prapashtesat, në njërën anë dhe fjalëformat e kompozitat në anën tjetër. Leksiku i funksionalizuar nga trajtat dialektore të shqipës, me theks të veçantë të folmes qytetare të gjilanit, dukë përfshirë këtu togfjalëshat dhe frazeologjizmat (në këtë mënyrë ne vërejmë një prirje të tij, që bashkë me poetin dhe prozatorin musa ramadani të bëhen përfaqësues të stilit gjuhësor dhe sistemit tematik të qytetit të gjilanit, në

atë përmasë që disa nga poetët dhe prozatorët, bashkëkohës të tij, azem shkrel, din mehmeti, azem shkrel, të cilët në veprën e tyre ishin bërë fryma shpirtërore, stili gjuhësor dhe të menduarit krahinor të qyteteve a krahinave etnografike të tyre.

Leksiku i vjelë nga literatura orientale, me theks të veçantë antroponiminë dhe patroniminë e kësaj hapësire; etj. Në këtë traditë rrjedhë ndryshe nga shumë autorë që leksikun e njërit dialekt a të dialektit tjetër e përdorin thjesht për pasurimin leksikor të veprës së tyre, beqir musliu karakteristikat e këtij leksiku i funksionalizon në përmasa jo vetëm të ngjyresave stilistike po edhe plotësimin e tekstit dhe të temës.

Leksiku dialektor dhe sidomos frazeologjizmat e tij janë pjesë e strukturës së poezisë së tij, ndërsa fjalësi dhe togfjalësi oriental dhe personazhet e provinencës orientale janë kryesisht pjesë e prozës dhe dramave të tij. Në fund mund të themi se beqir musliu është kujdesur shumë që fjalësin e shqipes, fjalësin e ri të dalë nga ndërtimet gjuhësore të tij, togfjalëshat dhe frazeologjizmat e shqipes, si dhe prejardhjen orientale të tyre, etj., t'u jap natyrën e shqipes me të gjitha dimensionet gramatikore dhe semantike të saj.

Mund të themi se beqir musliu ka lënë një trashëgimi të pasur gjuhësore dhe letrare në letërsinë shqipe. Gjuha e tij është e karakterizuar nga një përdorim i lartë i fjalëve dhe frazave, si dhe nga krijimi i neologjizmave që i japin veprës një thellësi të veçantë. Nëpërmjet një analize të thelluar të aspekteve gramatikore, leksikore dhe stilistike, ky punim ka treguar se gjuha e musliut është një nga elementët kyç që i dha formë veprës së tij dhe që kontribuoi në pasurimin e gjuhës shqipe. Puna e tij është një shembull i qartë i sintezës midis estetikës dhe gjuhës, që ndihmoi në zhvillimin e letërsisë shqipe.

**Bibliografia**

- Rima të Shqetësuar*, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1965
- Lulëkuqet e Gjakut*, “Rilindja”, Prishtinë, 1966
- Skënderbeu ose Shqiponja e Maleve* - Kurorë Sonetesh, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1968
- Bukuria e Zezë*, “Rilindja”, Prishtinë, 1968
- Sezamet*, “Rilindja”, Prishtinë, 1972
- Parabola*, “Rilindja”, Prishtinë, 1976
- Darka e Magjisë*, “Rilindja”, Prishtinë, 1978
- Vegullia*, “Rilindja”, Prishtinë, 1979
- Mbledhësit e Purpurit*, “Rilindja”, Prishtinë, 1982
- Kori i Gjelave të Vdekur*, “Dukagjini”, Pejë, 2002
- Makthi*, “Faik Konica”, Prishtinë, 2004
- Amullia*, “Faik Konica”, Prishtinë, 2004
- Krupa*, “Faik Konica”, Prishtinë, 2004
- Skërluta*, “Faik Konica”, Prishtinë, 2004
- Ndeshtrash*, “Faik Konica”, Prishtinë, 2004
- Skënderbeu*, “Faik Konica”, Prishtinë, 2004
- Orfeiana – Shtatë Libra Anatema*, “Faik Konica”, Prishtinë, 2004
- Shtrigani i Gjel-Hanit” – Libër-Teatër, Tetralogji*, “Rilindja”, Prishtinë, 1989
- Unë Halil Garria*, në Vëllimin “Shtrigani i Gjel-Hanit” – Libër-Teatër, Tetralogji (“Rilindja”, Prishtinë, 1989)
- Faustiana*, Në Vëllimin “Shtrigani i Gjel-Hanit” – Libër-Teatër, Tetralogji (“Rilindja”, Prishtinë, 1989)
- Ora e Kukurvajakës*, Në Vëllimin “Shtrigani i Gjel-Hanit” – Libër-Teatër, Tetralogji (“Rilindja”, Prishtinë 1989)
- Panari i Gjilanit*, Në Vëllimin “Shtrigani i Gjel-Hanit” – Libër-Teatër, Tetralogji (“Rilindja”, Prishtinë, 1989)
- Rrakullima II- Teatër-Libër, Tetraptik*, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 1990
- Murana*, në Vëllimin “Rrakullima” II – Teatër-Libër, Tetraptik (“Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 1990)
- Kori i Korbave*, në Vëllimin “Rrakullima” II – Teatër-Libër, Tetraptik (“Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 1990)
- Familja e Shenjtë*, në Vëllimin “Rrakullima” II- Teatër-Libër, Tetraptik (“Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 1990)
- Antifona*, në Vëllimin “Rrakullima” II- Teatër-Libër, Tetraptik (“Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 1990).

**Punim studimor****Albulena DEHARI**

Universiteti Nënë Tereza –Shkup  
Fakulteti i Shkencave Humane  
[albulena\\_dehari@unt.edu.mk](mailto:albulena_dehari@unt.edu.mk)

**PASURIMI I GJUHËS NGA KADAREJA****LANGUAGE ENRICHMENT FROM KADARE**

Të punosh në lidhje me shkrimet e Kadaresë të duhet një jetë e tërë, pasi ai nuk i dha vetëm letërsisë shqipe vlera madhështore, por edhe gjuhës shqipe. futi fjalë e shprehje të reja, gërmoi në leksikun e shqipes dhe i nxori prej andej shprehjet më të bukura për t'i përshtatur më së mirë në veprën e tij të cilën e bëri aq tërheqëse për lexuesin sa që kur lexon atë, në të njëjtën kohë ndjenë edhe kënaqësi gjuhësore, pasi gjuha e Kadaresë është aq e pasur sa nuk lodhesh së lexuari asnjëherë.

Në këtë punim do të përpiqemi të sjellim pak nga ajo e shumta që Kadare i ka sjellë gjuhës dhe letërsisë shqipe. do të ndalemi kryesisht te neologjizmat të cilat janë aq të shumta në veprën e Kadaresë, për t'i parë disa prej tyre se si i ka krijuar me brumin e shqipes, cilat janë prapashtesat më të zakonshme në krijimin e këtyre neologjizmave, çfarë i bën të veçanta dhe sa shumë vlerë i kanë sjellë gjuhës shqipe.

Në këtë punim në fillim do të trajtohet çështja e krijimit të neologjizmave në gjuhën tonë, çka i dallon ato nga huazimet dhe me çfarë rendi gjuhësor janë të krijuara, për të kaluar mandej tek Kadareja i cili i solli mjaftueshëm fjalë gjuhës shqipe. në këtë punim mes të tjerash do të ndalemi pak edhe te vepra e fundit e Kadaresë ku ai flet për gjuhën standarde, për t'i parë më mirë këto pikëpamje të cilat ai i shpreh për gjuhën standarde.

Çelësi i fjalëve: Kadare, neologjizëm, shprehje të reja, kuptim, metaforë.

Langua geenrichmentfrom Kadareja

It takes a lifetime to workon Kadare's writings, as he not only gave great values to Albanian literature, but also to the Albanian language.

Introduced new words and expressions, dug in to the Albanian lexicon and extracted from there the most beautiful expressions to fit them better in his work, which he made so attractive to the reader that when he reads it, at the same time they also felt linguistic pleasure, since the language of Kadare is so rich that you never get tired of reading it.

In this paper we will try to bring a little of the many things that Kadare has brought to the Albanian language and literature. We will mainly focus on the neologisms which are so numerous in Kadare's work, to see some of them, how he created them with the Albanian dough, which are the most common suffixes in the creation of these neologisms, what makes them special and how much value they have brought to the Albanian language.

In this paper, at the beginning, the issue of the creation of neologisms in our language will be addressed, what distinguishes them from borrowings and in what linguistic order they are created, to then move on to Kadareja who brought enough words to the Albanian language. In this paper, among others, we will dwell a little on Kadare's last work where he talks about the standard language, in order to better see these views which he expresses about the standard language.

Keywords: Kadare, neologism, new expressions, meaning, metaphor.

#### Hyrja

Kadareja është padyshim ndër figurat kryesore të letërsisë bashkëkohore, pra letërsi kjo që përfshin vitet pas 90-ës. Në këtë kohë shkrimtarët ishin të sapo dal nga një sistem i rënduar komunist dhe kjo i bëri që shumica e veprave të tyre të përmbante tema në lidhje me atë sistem. Ishin të lodhur nga të diktuarit të asaj se çfarë shkruajnë, në këto kohë ata kishin mundësinë që më mos e shtypnin veten e tyre të shkruanin ashtu siç dëshironte sistemi, por mund lirisht të tregonin talentin e tyre.

Padyshim që Kadare është më prodhimi në fushën e gjuhës. Fjalë e shprehje të reja të përdorura në gjuhë dhe shumë fjalë të vjetra të cilat i ka kthyer, iu ka veshur kuptime të reja, të gjitha këto e bëjnë atë të veçantë, kështu shprehet edhe studiuesi Tefik Çausi: Kadare i njihen rreth 2000 fjalë, në fondin e krijimeve apo rivitizimeve gjuhësore, një pasuri kjo, e lakmueshme për çdo shkrimtarë.<sup>94</sup>

Kadare, jo vetëm në letërsi solli tema shumë interesante, bashkëkohore, por edhe në gjuhë solli shumë fjalë të reja. Deri në atë kohë nuk ishte përdorur fjala trotuar, nuk ishte përdorur fjala bulevard etj. Pra disa fjalë që ishin huazime të shqipes, por të ndërhuara me brumin e saj.

Brenda këtij punimi do të shohim fjalë që Kadareja ka shpikur dhe ka krijuar në veprat e tij. Ai ishte shumë i zoti në krijimet artistike sa që e njihnte shumë mirë edhe standardin e gjuhës. Në krijimin e fjalëve të reja ai nuk veprroi pas mendjes së tij, por ishte i përkushtuar që fjalët t'i krijonte me brumin e gjuhës shqipe. Kështu të gjitha fjalët kanë parashtesa e

<sup>94</sup> Çausi, Tefik, *Kadareja përmes pasqyrave*, Onufri, Tiranë, 2002.

prapashtesa të shqipes, janë fjalë që mund të lakohen e të zgjedhohen duke iu përshtatur aq mirë sistemit të gjuhës shqipe.

Fjalët e reja apo ndryshe ne në gjuhë i quajmë edhe si neologjizma, këto fjalë vijnë në gjuhën tonë, jo vetëm si fjalë e shprehje, por qëllimi i tyre është që ta pasurojmë gjuhën me më shumë fjalë, gjithashtu që ta pastrojmë gjuhën nga fjalë e shprehje të cilët përdoren pa vend në gjuhë, ku për të njëjtat ne kemi mundësi t'i kemi fjalët shqip.

Gjuha jonë ishte dhe vazhdon të jetë e stërmbushur me fjalë e shprehje të huaja të cilat nuk janë të nevojshme. Kadare ishte i vetëdijshëm për këtë gjë, ai përveç se u fokusua të sillte tema dhe ngjarje madhore në letërsi, por mbi supe ruante edhe rëndësinë dhe kultivimin e gjuhës tonë. Për këtë arsye ai konsiderohet si një kolos i rëndësishëm i letrave shqipe.

#### Metodologjia e punës:

Përmes metodës induktive kam izoluar leksemat e përshtatura për këtë punim, të cilat janë mbledhur jo menjëherë, por në formë graduale nga veprat në prozë të Ismail Kadaresë. Përzgjedhja e mjeteve gjuhësore është bërë në mënyrë individuale duke etiketuar fjalët të cilat janë neologjizma. Pas grumbullimit të tyre i kam klasifikuar në grupe përkatëse dhe më pas i kam përpunuar më shumë brenda punimit.

#### Krijimi i fjalëve të reja (neologjizmat)

Zhvillimet në teknik, teknologji, tregti etj. kërkojnë që kohë pas kohe të nevojiten fjalë e shprehje të reja për ta plotësuar fjalorin e gjuhës. Për të plotësuar këto kërkesa, në gjuhë lindën fjalë të reja, që quhen neologjizma. Lindja e fjalëve të reja nxitet edhe nga një shkak tjetër: nga leksiku i gjuhës dalin nga përdorimi e vjetrohën shumë fjalë dhe për t'i zëvendësuar ato duhen krijuar fjalë të tjera.<sup>95</sup>

Fjalët dhe shprehjet që Ismail Kadare i krijoi nuk ishin të pakta me titullin e romanit *Dimër i madh* ai përdori këtë metaforë e cila nënkuptonte shtypjen dhe mungesën e lirisë, gjithashtu me togfjalëshin *syri i errët i historisë* ku përshkruan për ngjarjet e dhimbshme si dhe misteret e së kaluarës, kemi edhe shprehjet *shkrimtari i oborrit* ku flet për ata intelektual të cilët punonin për pushtetin si dhe *muzgu shqiptar* gjithashtu edhe kjo një metaforë për kohën e vështirë të shqiptarëve.

Ismail Kadare padyshim që ka pasur një ndikim të madh në gjuhë, jo vetëm përmes përdorimit mjeshëtor të saj, por edhe duke futur fjalë e shprehje të reja, apo duke u dhënë kuptime të reja fjalëve ekzistuese.

Gjuha e tij ka qenë e pasur, e poetizur dhe me shumë figura stilistike sidomos me metafora, e cila ka ndikuar direkt në zhvillimin e leksikut të gjuhës. Pasi personazhet e Kadaresë nuk kanë qenë vetëm njerëz të thjeshtë, por ata kanë komunikuar me lexuesin siç thotë edhe profesoresha

<sup>95</sup> Thomai, Jani, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Botimi Toena, Tiranë, 2006, f.267.

Floresha Dado: rrëfimtari që komunikon drejtpërdrejtë me lexuesin, duke e lidhur atë pas vetës.<sup>96</sup> Për ta lidhur lexuesin pas vetes duhej një gjuhë e pasur, të cilën Kadare e kishte.

Kadare si një mjeshtër i madh, përveç leksikut ekzistues ka krijuar edhe shumë fjalë e shprehje të reja, të cilat i ka përshtatur aq mirë me brumin e shqipes sa që ne nuk duhet t'i neglizhojmë, por të mundohemi që t'i bëjmë pjesë të fjalorit tonë. Fjalët e shprehjet të cilat i ka krijuar janë emra, mbiemra, folje, parafjalë e ndajfolje do të përmendim disa prej tyre:

a) Emrat: *nënkresja, fushëtirë, boshësi, shkallinat, largësorët, terr, katunthi, thashethamnajën, pangutësi, Gjorku* ku për këtë personazh me një emër tipik studiuesi Çausi shprehet: një nga personazhet më të bukur e më tragjik të penës së autorit<sup>97</sup>, kjo tregon se Kadare krijoi edhe personazhin bashkë me leksikon e veprimin e tij.

Këtu kam shënuar disa emra që janë të krijuara nga vet Kadare siç e shohim nga aspekti morfologjik këta emra janë krijuar me parashtesa dhe prapashtesa të gjuhës shqipe kemi parashtesën *nën-* te emri i parë, pastaj prapashtesat *-(ti)re, -si, -inat, -ët, -thi* (kjo një prapashtesë që në gjuhën shqipe përdoret kryesisht për emrat e gjinisë mashkullore dhe tregon zvogëlim, pra një katund i vogël jo shumë i madh) *-najën -si*. Nga kjo që shohim të gjitha këto ndajshtesa janë të shqipes dhe Kadare vetëm me pak mundim ka krijuar emra të cilët përveç që e pasurojnë gjuhën, por në vete bartin edhe emocion.

b) Mbiemra: *gurbardhi, Zver, Mark Alemi, Gjoka, Gjoleka, Spirua, Bubullima, Murat Topulli, mjegullorë, me zë të drithëruar, ditë e mardhur, Doruntina Vranaj* etj. Nga këta mbiemra që kemi sjellë e të cilët janë krijuar nga Kadare arrijmë të kuptojmë se ai shumë ka dashur të krijojë fjalë të bukura në shqip, gjithashtu dhe të mos shkëputët nga historia e lashtë e popullit tonë, p.sh.: për mbiemrin *gurbardhi* kuptojmë diçka të fortë dhe të pastër, për mbiemrin *Zver* që mund ta gjejmë tek *Pallati i ëndrrave* arrijmë të kuptojmë një personazh misterioz që të jep një ndjesi të ftohtë, gjithashtu edhe mbiemri *Alemi* është te po i njëjti roman me këtë kuptojmë një mbiemër që figurës së personazhit i jep një rëndësi historike, mbiemrat e tjerë të cilët janë të personazheve të ndryshme që i kam paraqitur këtu shohim se kanë jehonë shqiptare dhe një tingëllimë tradicionale, por mund të jenë edhe të krijuar nga autori. Përveç këtyre kemi edhe mbiemra të përgjithshëm që ngjashëm si emrat janë krijuar duke marrë ndajshtesa siç janë prapashtesat, *-re, -uar, -ur*.

Përveç këtyre mbiemrave, Kadare te *Kështjella* ka paraqitur edhe mbiemra të cilët duken si të kohës osmane apo mbartin mbi vete histori të shekujve të mëparshëm. Ata nuk janë mbiemra real, por janë krijuar për t'i dhënë një fuqi më të madhe botës letrare të vetë autorit.

c) Foljet: *Hijezoj, Legjendarizoj, skëterrizophem, trishtohetuese, përshkoq, greminohej, ngjethet, u përndritën, historizoj* etj. Foljet janë fjalë

<sup>96</sup> Dado, Floresha, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006. f.104.

<sup>97</sup> Çausi, Tefik, *Fjalori i personazheve*, SHBE, Tiranë, 1995, f. 56.

që tregojnë një veprim, edhe këta që i ka krijuar Kadare janë të tilla pra fjalë që tregojnë një veprim të caktuar, por këto llogariten fjalë të reja në gjuhën shqipe të cilat janë ndërtuar duke u mbështetur te ndërtimi i foljeve në gjuhën shqipe. Këto folje në vete përmbajnë edhe elementin e figurshëm pra nëse e marrim foljen *historizoj* shohim se autori një ngjarje të caktuar dëshiron ta kthejë në histori apo *legjendarizoj* që është e ngjashme me historizoj. Folja *trishtohetuese* mbart mbi vete një kuptim të dhimbshëm pra një hetim trishtues që bëhet në formë mizore. Pra siç shprehet edhe studiuesi Jani Thomai: Vështrimi i përmbajtjes leksikore të fjalëve nuk e jep vetëm kuptimin që lidhet me diçka nga realiteti, por edhe të ngjyimeve që japin qëndrimin, vlerësimin, ndjenjat e folësit për atë që shënon fjala.<sup>98</sup>

Kadare përveç këtyre foljeve te *Pallati i ëndrrave* p.sh.: nga foljet ekzistuese ka sjellë kuptime të reja për foljen *të kontrollosh* e ka futur kuptimin të shtypësh, të cenosh, të ëndërrosh në formë të pavetëdijshme, por me pasoja politike, pra *nga ëndërrime* ke pasur pasoja politike, *të ndëshkosh* në formë të pa drejtë, në mënyrë paranojake, pra ndëshkohen njerëz për interpretime të ëndrrave të pabaza, *të përçash* në emër të frikës dhe kontrollit etj. Nga kjo shohim se autori duke qenë vigjilent në punën e tij këto folje nuk i ka përdorur në kuptimin e parë të tyre, por atë polisemik duke ju dhënë kuptime të reja dhe me këtë ka bërë që vepra të jetë tërheqëse dhe me një peshë të madhe për letërsinë shqipe.

Përveç krijimit të fjalëve të ndryshueshme Kadare ka krijuar edhe fjalë të pandryshueshme nga aspekti morfologjikë, pra fjalë të cilët nuk marrin trajta të caktuara, pra nuk ndryshojnë mbetën të njëjta, prej tyre ka krijuar ndajfolje e parafjalë. Po përmendim disa prej tyre:

d) Ndajfoljet: *padritë, asfare, asgjëkund, ngrirazi, shurdhëri, thikë, ngultazi, heshturazi, tërëzi, vetëtimthi* etj. Te ndajfoljet vërejmë se Kadare ka krijuar ndajfolje unike me një stil të veçantë, por edhe ata ekzistueset i ka përdorur duke ju dhënë një kuptim të figurshëm nga ai ekzistuesi. P.sh.: ndajfoljen *tërëzi* e përdor për të treguar një ngjarje ironike ose tragjike, *asfare* e krijuar nga *as+farë* dhe sjellë një kuptim dhe një ndjesi dramatike, gjithashtu edhe ndajfolja *thikë* ndonëse në kuptimin e parë dhe ndërtimin e saj është emër, por Kadare e sjellë me këtë formë pra duke e ia veshur petkun e ndajfoljes që ka kuptimin i mprehtë jo pra si emër.

e) Parafjalë: *Përtej, ndërmjetës, përmbi, nënllogaritur, nënkuptuar* etj. Edhe ndajfoljet ngjashëm si më lartë kanë një ngarkesë emocionale dhe janë të shprehura në formë simbolike, stilistike e metaforike, pra duke e kaluar përdorimin e tyre të zakonshëm.

#### Përfundimi

Nga kjo që kemi hulumtuar në veprat e Kadaresë vërejmë që ai nuk ka bërë vetëm gjestin e madh të krijimit të fjalëve të reja, por fjalëve të vjetra u ka dhënë jetë të re, pra kuptim të ri duke i kaluar në një kuptim modern e me këtë pra ai ndihmon në ruajtjen dhe ringjalljen e gjuhës sonë.

<sup>98</sup> Thomai, Jani, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, f.46.

Gjuha e Kadaresë është plot metafora, simbole e figura stilistike që rrallë përdoren më parë, po ashtu në veprën e tij ai solli një leksik të veçantë që ndërthur historinë shqiptare me mitin, e gjitha këto i ka të shprehura me një gjuhë shumë të pasur dhe mbi të gjitha me fjalë shqipe.

Huazimet gjithashtu janë pjesë e kulturës letrare të këtij kolosi duke i huazuar fjalët nga frëngjishtja, latinishtja, greqishtja shpesh herë duke i shqipëruar e duke i përshtatur në leksikun e gjuhës sonë, ai i ka dhënë një kontribut të madh gjuhës nga aspekti shkencor, ngjashëm si nga ai letrar.

Gjithë çfarë ka dhënë për gjuhën dhe letërsinë shqipe ne asnjëherë nuk mund t'i përmbledhim vetëm në një punim, pasi ai ka një numër të konsiderueshëm të veprave dhe për fat të mirë të gjitha janë me një peshë të veçantë dhe në një shkallë të lartë si nga aspekti gjuhësor ashtu edhe nga ai letrar. Këtu kam paraqitur vetëm një pikë të vogël nga ai oqean i madh, pra për të parë disa fjalë të Kadaresë nga romani *Kush e solli Dorëntinën, Pallati i ëndrrave, Kështjella* dhe disa emra e mbiemra të cilët janë të marrë edhe nga vepra të tjera në të cilët përmenden.

#### Bibliografia:

1. Dado, Floresha, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Tiranë, 2006.
2. Çabej. Egerem/ Xhuvani, Aleksander, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962.
3. Çausi, Tefik, *Fjalori i personazheve*, Tiranë, 1995.
4. Çausi, Tefik, *Kadareja përmes pasqyrave*, Onufri, Tiranë, 2002.
5. *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, (botuar nga) Akademia e Shkencave, Tiranë 2002.
6. *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, (botuar nga) Akademia e Shkencave, Tiranë 2002.
7. Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
8. Thomai, Jani, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1991.
9. Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.

ISSN 2671-3004

UDC 305:659.1(497.7)

Punim studimor

**Agron KURTISHI<sup>99</sup>, Agron VRANGALLA<sup>100</sup>, Avni AVDIU<sup>101</sup>**  
**Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup**  
**Fakulteti i Shkencave Sociale**

**GENDER STEREOTYPES IN MEDIA ADVERTISING IN NORTH  
MACEDONIA: AN EMPIRICAL STUDY**

**STEREOTIPET GJINORE NË REKLAMAT MEDIATIKE NË MAQEDONINË E  
VERIUT: NJË STUDIM EMPIRIK**

**Abstract**

When analyzing advertising content in a gender context—how women and men are portrayed—we must consider the dual role of advertising. It both reflects society and, at the same time, influences it.

This empirical study addresses gender stereotypes in advertisements broadcast in North Macedonia, analyzing the way women and men are presented in advertisements. Focusing primarily on television advertisements, the study identifies common characteristics of gender representation and their roles in different situations within the advertisement. Studies show that women are often portrayed in traditional roles, such as mothers and caregivers, with an emphasis on beauty and physical appearance, while men are portrayed as authoritative and active figures, emphasizing power and success. The analysis of these stereotypes reveals that such representations influence public perception and the formation of opinions about gender. The study offers recommendations for media and advertisers, emphasizing the importance of avoiding stereotypes and promoting a more equal representation of genders. This research contributes to raising awareness of the impact of advertising on gender perceptions and provides a basis for improving marketing practices in North Macedonia.

**Keywords: advertisement, men and women in advertisement, Stereotypes, North Macedonia, Society**

**Abstrakt**

---

<sup>99</sup> Associate Professor, Faculty of Social Sciences, Mother Teresa University, Skopje, North Macedonia, [agron.kurtishi@unt.edu.mk](mailto:agron.kurtishi@unt.edu.mk)

<sup>100</sup> PhD Candidate, Faculty of Social Sciences, Mother Teresa University, Skopje, North Macedonia, [agron.vrangalla@unt.edu.mk](mailto:agron.vrangalla@unt.edu.mk)

<sup>101</sup> Associate Professor, Faculty of Social Sciences, Mother Teresa University, Skopje, North Macedonia, [avni.avdiu@unt.edu.mk](mailto:avni.avdiu@unt.edu.mk)

Kur shqyrtojmë përmbajtjen e reklamës në kontekst gjinor, d.m.th se si portretizohen gratë dhe burrat, atëherë në e bëjmë këtë gjithmonë në sfondin e rolit të dyfishtë të reklamës, e cila edhe e pasqyron shoqërinë e saj edhe nga ana tjetër ka një ndikim te ajo. Ky studim empirik trajton stereotipet gjinore në reklamat e transmetuara në Maqedoninë e Veriut, duke analizuar mënyrën se si femrat dhe meshkujt paraqiten në reklama. Duke u fokusuar në reklamat kryesisht televizive, studimi identifikon karakteristikat e zakonshme të paraqitjes së gjinive dhe rolet e tyre në situata të ndryshme brenda reklamës. Studimet tregojnë se femrat shpesh paraqiten në role tradicionale, si ato të nënave dhe kujdestareve, duke theksuar bukurinë dhe pamjen fizike, ndërsa meshkujt paraqiten si figura autoritare dhe aktive, duke theksuar fuqinë dhe suksesin. Analiza e stereotipeve tregon se këto paraqitje ndikojnë në perceptimin e publikut dhe formimin e mendimeve rreth gjinive. Studimi përfundon me rekomandime për mediat dhe krijuesit e reklamave, duke theksuar rëndësinë e shmangies së stereotipeve dhe promovimin e një paraqitjeje më të barabartë të gjinive. Ky hulumtim kontribuon në rritjen e vetëdijes për ndikimin e reklamave në perceptimin e gjinive dhe ofron një bazë për përmirësimin e praktikave të marketingut në Maqedoninë e Veriut dhe me gjere.

**Fjalët kyçe: reklamë, femrat dhe meshkujt në reklamë, Stereotipe, Maqedonia e Veriut, Shoqëri**

### **Research Methods:**

For this analysis, which aims to provide data on the presence of gender issues in advertisements on national television, some of the UNESCO gender-sensitive media indicators related to gender portrayal in advertising content have been used. They are designed to include both quantitative and qualitative research approaches. These indicators have been appropriately adapted for the object of the study.

The quantitative aspect of the research provides data on the total number of advertisements, the number of advertisements analyzed from a gender perspective, their duration, the number of appearances of women and men in advertisements, and the duration of their screen time.

In addition to quantitative data, the qualitative analysis examined the way women and men speak in advertisements, assessing whether their portrayal is equal or objectifying and sexist, whether established stereotypes are reinforced, and whether new stereotypes are reinforced and created. The study also analyzed the terminology used by both genders in advertisements.

We also emphasize that the United Nations 2030 Agenda (Transforming Our World: The 2030 Agenda for Sustainable Development) with its 17 goals, and in particular Goal 5 "Achieve gender equality and empower all women and girls", has had a minor influence on our analysis. As a conclusion of this study, we aim to offer a modest contribution to this major and important UN agenda.

### **Results and Conclusion:**

Representation of Women:

- Women are often portrayed in traditional roles as mothers, caregivers, or as desired objects (by men).
- Advertisements for beauty and fashion products usually focus on physical appearance and beauty norms, reinforcing certain stereotypes.

### Representation of Men:

- Men are often portrayed in the roles of leaders, powerful workers, or as authoritative and intelligent figures.
- The majority of advertisements featuring men link them to success, intelligence, strength and the ability to provide.

The study emphasizes the importance of changing perspectives in the representation of women and men in advertisements. Improvement in this area can help challenge stereotypes and promote gender equality in North Macedonian society. To achieve this, it is necessary for advertisers to be aware of the impact of their messages and work to present both genders without using gender stereotypes and reinforcing them.

Media, as a major carrier of advertisements, must change its approach to stereotypical advertisements because, on the one hand, it seems to be fighting for gender equality, while on the other hand, by broadcasting stereotypical advertisements, it is again the one creating the main division between the two genders.

### **Introduction**

Advertisements are one of the most powerful tools for shaping social and cultural perceptions. In North Macedonia, as in many other countries, gender stereotypes play an important role in the way women and men are portrayed, and the consequences this portrayal has on society by entering into certain clichés (consciously or unconsciously). This empirical study examines these representations and their effects on society based on the analysis of various media advertisements.

The paper aims to analyze the portrayal of women and men in advertisements and examines the expectations and aspects of their influence. It analyzes whether specific gender stereotypes still have consequences for society today. Some of the important questions the paper attempts to answer are: Do men and women differ in their representation in advertisements? How are women and men portrayed? What vocabulary do they use and what are the specific topics for which they play different roles in advertisements? What products do they advertise? Do they speak the same way? Does one of them have a dominant role?

When analyzing advertising content in a gender context—how women and men are portrayed—we must consider the dual role of advertising. It both reflects society and, at the same time, influences it.

Gender and gender stereotypes are based on the distinction between "male" and "female" related to certain behaviors and external characteristics. Regarding the topic of stereotypes in advertisements between men and women, there are some (mainly Western) studies which, if analyzed, lead to a similar conclusion that advertisements make distinctions when it comes to the products they advertise and the genders that use them for these advertising products. Gender division is precisely made in advertisements by describing different preferences of the two genders. Thus, according to the advertisement, women prefer

beautiful and small things, while men prefer large and technical things. Women are portrayed as "caregivers" of the family and as enjoyers, while men are portrayed as heroes, all-knowing individuals and protectors of the family. The way women and men are portrayed in advertisements, the roles they play, the messages they convey, the ideal images or stereotypes they spread, and the impact they represent on potential consumers continue to be current issues. Advertisements represent the most frequent forms in which language is used as a tool to stimulate the buying impulse.

Studies show that women are often portrayed in traditional roles, such as mothers and caregivers, or as desired objects (by men) by emphasizing beauty and physical appearance where they ask questions and men answer.

On the other hand, men are portrayed as authoritative and active figures, in the roles of leaders, powerful workers, or as intelligent figures, emphasizing power and success.

The analysis of stereotypes shows that these representations influence public perception and the formation of opinions about gender.

By reading scientific works in this field and by seeing (analyzing advertisements), it is always found a reason why the discussion about stereotypes in advertisements remains important and requires critical reflection. This paper focuses on advertisements in North Macedonia.<sup>102</sup> A total of 100 advertisements for various products and companies have been analyzed, leading to an interesting conclusion that opens opportunities for further analysis in this field.

What is meant by stereotype? Since the term is used both in the title and within the text, it is important to briefly clarify the meaning of the word "stereotype" to provide the reader with a clear understanding of how the topic will be addressed. The term stereotype (Greek: stereos - solid, strong, and typos - fixed norm, characteristic trait) was first used in the social sciences in 1922 by Walter Lippmann, who tried to use that term to describe the "images in our heads". The first social psychological research on stereotypes began with an empirical study by Katz and Braly (1933). They defined a stereotype as "a rigid impression that corresponds only to a small extent with reality, but is created mainly by the fact that we judge first and see little later".

The Duden dictionary also defines the term stereotype as "a prejudice about oneself or others or about a thing; a fixed, overly simplified and often one-sided image". While the Britannica Encyclopaedia defines a stereotype as "a fixed, overly simplified and often one-sided belief about a group of people".

There are many definitions and from a large number we can extract a closer and simpler definition that would be graspable and understandable: stereotypes are "...a set of (negative) one-sided beliefs about the characteristics of members of a social group". In the context of this paper, the social group consists of the two genders—women and men.

---

<sup>102</sup> This type of study has been conducted for the the first time in North Macedonia and is crucial for guiding of advertisements, enterprises and the media that broadcast them. This paper also has a special significance for the entire society living in North Macedonia and beyond.

### Differences in Gender Advertising

Pedelty and his co-author, Morgan Kuecker, conducted a content analysis of 1,055 recent ads sourced from YouTube and found that male voiceovers outnumber female voiceovers by a ratio of 4:1, consistent with previous research on the topic. In 1975, men dominated 91% of voiceovers, but that number dropped to 80% by 1998, illustrating only a minor step toward gender parity over the course of nearly 25 years.

After 20 years, in 2018, Ogilvy reported that the difference was 79% to 21%, meaning the change over 20 years was only 1% in favor of women. Currently, in 2024, according to the study we have conducted in North Macedonia, the ratio between female and male speakers is 58.4% males and 41.6% females. We have an improvement in the situation in favor of women.

### The Study

The authors have analyzed selected televisions, cinema and internet (in audio-video format) advertising spots that are broadcast in all different media (both on TV and on the internet). The female-male communication in selected advertisements that are broadcast on TV in prime-time was analyzed. The study included a total of 100 advertisements from 46 different companies, of which 43 were foreign and only 3 were domestic, each representing a different business sector. Of the 100 advertisements analyzed, 16 advertisements were from domestic companies and the remaining 84 advertising spots were from foreign companies. The total duration of all advertising spots together was 33.35 minutes. Companies representing different industries have been analyzed, especially international European and American companies, as well as large domestic (North Macedonian) companies, which sell their products in more than one country, including North Macedonia.

The representation of characters in advertisements was done according to different fields/disciplines/divisions, as follows:

Appearance in the commercial	Female <input checked="" type="checkbox"/> Male
Speaker (narrator in the commercial)	Female <input checked="" type="checkbox"/> Male
Speaks the last sentence in the spot	Female <input checked="" type="checkbox"/> Male
How long does he/she speak in the commercial	Female <input checked="" type="checkbox"/> Male

### Results


What became evident after the analysis and represented a new finding in this analysis was that the absolute percentage of the 100 advertisements analyzed were foreign companies. In total, it was found that out of 100 advertisements, 84 were for foreign companies and only 16 were for domestic companies. In other words, 84% of advertisements analyzed are from foreign companies, which air their ads during prime time on TV and across social media and the internet, while only 16% of the advertisements are from domestic companies occupying space in the media of North Macedonia. Out of 100 advertising spots, 46 belonged to foreign companies and only 3 companies were domestic. That is, 46 foreign companies activated 84% of the advertising spots

in the media of North Macedonia, and 3 domestic companies activated 16% of the advertising spots.




**Graph 1: Advertising spots of companies**

Out of 100 advertising spots analyzed, the representation or appearance of women and men was approximately the same. That is, women appeared for a total of 20.06 minutes in the analyzed spots, while men had a slight advantage, appearing for 21.17 minutes.




**Graph 2: Representation of women and men in advertisements**

The next category of analysis was the speaker (narrator) in the advertisements. In this category, it was found that in 100 advertising spots, a man spoke in 62 spots, while a woman spoke in exactly half of them, or 31 spots. In 7 spots, both women and the men spoke together. This is illustrated in graph 3.



**Graph 3: Female and male speakers in advertisements**

The next category is the final sentence in the advertising spot, i.e., who speaks the final sentence in the advertising spot. Out of 100 advertising spots, in 28 of them the woman closes the advertising spot, i.e., speaks the final sentence, and in 72 of the advertising spots, the closing is done by the male voice. This is illustrated in graph 4.



**Graph 4: Speaking the final sentence in advertisements**

The results entered into a table looks as follows:

<b>Companies</b>	<b>46</b>	Domestic	Foreign
		<b>3</b>	<b>43</b>
<b>Ads</b>	<b>100</b>	<b>16</b>	<b>84</b>
<b>Duration of all ads</b>	<b>33.35 min</b>		
<b>Presentation of</b>	Females (in min) <b>20.06</b>	Males (in min) <b>21.71</b>	
<b>Speaker (narrator of ads)</b>	Female/100 ads <b>31</b>	Males/100 ads <b>62</b>	Together <b>7</b>
<b>Last sentence in the ad spoken by</b>	Females <b>28</b>	Males <b>72</b>	
<b>How long does talk in ads?</b>	Females (in min) <b>13.10</b>	Males (in min) <b>18.14</b>	

**Table 1: Summary of the analysis of 100 advertising spots**

In the second part of the analysis, the spots were also analyzed for the roles of the two genders that they had in the advertising spots. In this case, the role of the woman was analyzed from the qualities that showed the women in the advertising spots as: Housewife/Wife/Mother, Active Seductress, Desired Object and Woman in Leisure Time.

The role of the man was also analyzed from these roles with some other qualities such as: Househusband/Husband/Father, Expert/Specialist, Desired Object, Attractive and Adventurous.

Both analyses showed very interesting results which in terms of content do not differ much from the analyses done in Western countries, but given the fact that out of 100 advertising spots only 16 were domestic and 84 were foreign, and from the aspect of advertising companies out of a total of 46 companies only 3 were domestic and 43 were foreign, the result in this category was more or less expected. If the broadcasting of advertising spots was dominated by domestic companies, perhaps we could have had a different result.

Out of 100 advertising spots, a woman appears in 52% of them as Housewife/Wife/Mother. In 16% she appears as a Woman in Leisure Time. In 13% of the spots she appears as an Active Seductress, seducing the viewer with feminine elements. In 8% she appears as an employed woman (with an occupation) and in 11% she appears as a desired object.

Housewife/Wife/Mother	<b>52%</b>
Active seductress	<b>13%</b>
Object of desire	<b>11 %</b>
Leisure woman	<b>16 %</b>
Employed woman (woman in a profession)	<b>8 %</b>

**Table 2: Summary of the role of women in 100 advertising spots**

The next analysis was the role of the man in the advertising spots. Out of 100 advertising spots, a man appears in only 8% of them as a Househusband/Husband/Father. In 13% he appears as an Adventurous man. In 9% of the spots he appears as Attractive. In 6% he appears as a desired object and in the majority of advertising spots, i.e., in 64%, he appears as an Expert/Specialist.

Housemen/Husband/Father	8%
Expert	64%
Object of desire	6 %
Attractive	9 %
Adventurous	13 %

**Table 3: Summary of the role of men in 100 advertising spots**

The study shows that women are often presented in traditional roles, such as mothers and caregivers, or as objects of desire (by men) emphasizing beauty and physical appearance, where they ask questions and men answer.


On the other hand, men are presented as authoritative and active figures, in the roles of leaders, powerful workers, or as intelligent figures emphasizing power and success, who in advertisements are forced to give only answers (in the role of an expert on everything).

If we analyze a little bit the field where women are presented as women in the occupation (8%) and on the other hand as housewives, wives and mothers (52%), we can easily ascertain the cliché that men go to work and women stay at home.

The role of women in advertising	Housewife/Wife/Mother
	Actively seductive
	Object of desire
	Woman in her free time
	Employed woman (in a profession)
The role of men in advertising	Househusband/Husband/Father
	Expert/Specialist
	Object of desire
	Attractive
	Adventurer


**Table 4: Summary of the role of women and men in 100 advertising spots**

The final analysis is the Representation of female/male nudity in advertisements, Sexual Behavior and Sexually Attractive. The result here was also interesting as a woman is portrayed as an erotic object more often than a man in the analyzed advertisements, almost 3 times more than men when it comes to nudity. Advertising tends to portray the woman more naked than the man.




**Graph 5: Representation of nudity of women and men in advertisements**

Also, from the perspective of sexual behavior, the woman plays an important role in the advertisements of various products. She surpasses the man in this role by more than 10 times. Out of 100 advertising spots, the man appears in only 4 advertising spots with sexual behavior, while the woman appears in about 42 advertising spots, which shows that sexual behavior is an attribute of the woman in advertisements.



**Graph 6: Sexual behavior of women and men in advertisements**

The final graph shows the sexual attractiveness between men and women. Here, as in the previous graphics, the result shows that women surpass men by about 7 times. Only in 6 advertising spots do men show sexual attractiveness, while women are more active in this role in about 40 advertising spots.



**Graph 7: Sexually attractive effects of men and women in advertisements**

## Discussion

### *The Representation of Men*

Since the emergence of advertisements in the media, the man has typically been portrayed in advertisements as the head of the family—working and providing for his family, often depicted as a good connoisseur of technology (expert), and shown as a very capable individual. A special characteristic of the man in the advertisement is that he is always portrayed as successful. He is also shown as a real and active person, strong and sympathetic. He is often shown as infallible, seen everywhere both in public environments and within the home, easily climbing the career ladder in his professional life, which is very necessary for him to earn money to support his family. In advertisements, he can often be seen as independent, enjoying his freedom and seeking new things and adventures. He is often portrayed with an athletic, well-trained body and moderately pronounced muscles. Advertising allows the man to be portrayed as independent, objective, dominant, knowing very well what he wants and very determined.

Heidrun Abromeit also notes that men in advertisements represent power and success, and are portrayed as superior to women. A "real" man is a successful man who exercises a typical male profession and on whom the woman can rely (cf. Abromeit, 1980, p.36). The man is superior to the woman and he is able to solve in a short time of 30 seconds (the average length of advertising spots is 30 seconds) any kind of problem that a woman faces and not only. In other words, he is an ideal picture of a man.

This is also the reason why in the analysis of 100 advertising spots it is revealed that the man is the speaker of the ads at least 2 times more than the

woman, finishes the last sentence of the advertising spot almost 3 times more often than the woman and speaks almost 2 times more than the woman. Also, in his appearance he appears in 64% of advertising spots as an expert.

### ***The Representation of Women***

As for women, they are often portrayed in advertisements as mothers/housewives and wives. Interestingly, over time, she has changed her role a little from the stereotype that had been prevalent for a long time as mothers/housewives and wives, but this change has not fixed her role in advertisements and she has become closer to the male role (as an ideal man) since her new role has to do with seduction, eroticism, and the object of desire (sexual object). Although she shows some new characteristics in advertisements, the aspect of dependence on men continues to dominate. She also continues to ask questions (which means she does not know) while men only give answers (he is an ideal man who knows). An improvement in this aspect is that even when the woman is shown in the role of housewife/mother she is shown with a little more self-awareness than in previous advertisements, but her role has not changed. This means that the change within gender models is very small and is moving in very small steps.

According to Schmerl (1992):

Men are Head and costume;

Women are Body;

Men are viewers, evaluators or builders of the photograph;

Women are objects seen in the photograph;

Man is man, Woman only Gender;

Man is a director, judge, knower, selector;

The farm is object, photo, bait and silent projecting space.

### **Conclusions**

The study concludes that the gender roles that are often portrayed in advertisements affect both genders and reproduce stereotypes in the same way as before, not only in the society in North Macedonia but also in global societies. We say globally because the companies that advertise their products in North Macedonia are global companies and they produce their advertisements in one language (e.g. German or English) and distribute these advertisements all over the world which are then translated, synchronized and dubbed with the same roles that are played in the advertisement. Therefore, the trends in how stereotypical the advertisements will be and how these will change in certain countries in the world will not be led by the advertisements that are produced like in North Macedonia or some other small country, but by the advertisements of the leading companies in the market.

It is important to note that these advertisements affect gender inequality and not vice versa. Here it is worth mentioning what was highlighted at the beginning of the study, namely the United Nations 2030 Agenda (Transforming

Our World: The 2030 Agenda for Sustainable Development) which, as mentioned at the beginning, has a total of 17 goals and specifically goal number 5 is “to achieve gender equality and empower all women and girls”. According to the analysis, this will not be achieved until the trends set by advertising (and the media in general) are changed, since not only in advertising is the female gender discriminated against but in almost all media genres, starting from advertising, film, moderation, journalism, etc., which provide many (negative) examples of how we should behave with the female gender or what the female gender can be used for.

Një ndër armët kryesore të të gjitha regjimeve serbe ka qenë gënjeshtria dhe propaganda. Ish-kryetari i Jugosllavisë, shkrimtari dhe akademiku serb Dobrica Ćosić (Добрица Ћосић 1921-2014) e ka konfirmuar këtë duke thënë: “Ne serbët gënjejmë për ta mashtruar veten dhe për ta ngushëlluar tjetrin. Gënjejmë për bamirësi. Gënjeshtria, ne nuk na frikëson, por na trimëron. Gënjejmë me dëshirë dhe për njerëzillëk. Gënjejmë në shenjë nderimi. Gënjejmë për hirë të lirisë. Gënjeshtria është formë e patriotizmit tonë, është dëshmi e zgjuarsisë (intelegjencës) sonë të lindur. Ne gënjejmë

në mënyrë krijuese, fantastike, inventive..."<sup>105</sup>. "Mund të thuhet se propaganda intensive nacionaliste në Serbi ishte e nevojshme sepse për dallim nga elitat intelektuale, nacionalizmi nuk ishte i zhvilluar në popullatë"(Dimitrijević, V., 1996:694). „Megjithëse shumë mendojnë ndryshe, duhej bërë një përpjekje e madhe që serbët të bindeshin për saktësinë e gjithçkaje që disa anëtarë të racës së tyre kishin bërë gjatë luftërave të viteve '90-ta. Duhej të bindej populli serb se gjithmonë kishte bërë luftëra mbrojtëse e të drejta, të cilat gjithmonë i kishin filluar të tjerët. Nuk ishte aspak e lehtë të nxitej një njeri i zakonshëm, mesatar, që nga jeta e tij e qetë familjare të shkonte në front dhe të fillonte të vriste... Për gjithë këtë ishte e nevojshme një ideologji e mirëpërpunuar“(Babić, M., 2002:66).

## 2. Autoagresioni si mekanizëm psikologjik

George Packer në librin e tij *“Our man - Richard Holbrook and the end of the american century”* i përshkruan fillet e konfliktit në ish-Jugosllavi. Sipas Packer-it, nacionalizmi serb mori hov nga një akt vetëkënaqësie, i cili i shkoi huq një serbi të Kosovës (56 vjeçarit nga Gjilani Đorđe Martinović). Më 1985, përderisa një serb i Kosovës po tentonte të vetëkënaqej duke u ulur në shishe, akti i shkoi keq dhe shishja u thye. Në spital ai deklaroi se ishte dhunuar me shishe nga shqiptarët. Duke e marrë këtë akt si shkas, më 1986 u tubuan akademikët serbë dhe e përpiluan një elaborat, duke i hedhur në letër pretendimet nacionaliste serbe, të cilat më pas i sollën luftërat e përgjakshme në ish-Jugosllavi”<sup>106</sup>.

## 3. Nacionalizmi në përlligje të gjenocidit

Fenomenologjia e nacionalizmit serb nuk mund të shpjegohet vetëm me ngjarjet e dyzet viteve të fundit ose vetëm gjatë ekzistencës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Rrënjët e nacionalizmit janë shumë më të thella dhe ideja e tij udhëheqëse është ringritja e shtetit mesjetar, një ide që nga fillimi ka qenë e përealizueshme. Bëhet fjalë për një ide konservatore, rrënjët e së cilës gjenden në "Načertanien" e Ilija Garashaninit. Ajo ka qenë dominante si në politikën e brendshme, ashtu edhe në atë të jashtme të Serbisë dhe më vonë edhe në Jugosllavi.

Vërtet do të ishte e vështirë të pranohej se një kulturë, pavarësisht se për cilën kulturë bëhet fjalë, mund t'i shërbejë si nxitëse vetëdijes genocidale dhe gjenocidit. Megjithatë ideologjia, si përdorim i kuptimeve të formave simbolike në shërbim të pushtetit dhe dominimit, mund ta prodhojë vetëdijen genocidale. Për të prodhuar konflikte nevojitet një nxitës në formën e ideologjisë që do të përdorë të gjitha format simbolike të disponueshme për mobilizimin e ndjekësve të saj, pavarësisht se ku ndodhen ata. Kështu

<sup>105</sup> [https://archive.org/details/laz\\_je\\_srpski\\_drzavni\\_interes-dobrica\\_cosic](https://archive.org/details/laz_je_srpski_drzavni_interes-dobrica_cosic)

<sup>106</sup> <https://www.amazon.com/Our-Man-Richard-Holbrooke-American/dp/0307958027> / <https://www.meer.com/en/88156-the-martinovic-case-a-symbol-of-yugoslavia-ethnic-strife>

do të shohim se për qëllime ideologjike për ta arritur dominimin janë përdorur forma simbolike që ndodhen si në histori, ashtu edhe në epet serbe, në letërsi dhe në kulturë. Asnjë formë simbolike, e vetme, nuk është ideologjike derisa, në një kontekst të caktuar shoqëroro-historik, të përdoret për qëllime ideologjike, pra për t'i vendosur dhe ruajtur marrëdhëniet e dominimit dhe fuqisë që në këtë rast synohen të realizohen edhe përmes gjenocidit. „Megjithëse kultura popullore serbe është“, e themeluar në epet popullore që janë - shumë më tepër se epet e popujve të tjerë - të mbushura me etnocentrizëm dhe teocentrizëm, patetikën kombëtare, narcizmin dhe fantazitë apokaliptike, të obsesionuar me mitin e ashtuquajtur të Kosovës, ajo vetë kurrë nuk do të mund të bëhej nxitëse e vetëdijes genocidale“(Bartol, etj., 1997:29).

Te serbët stereotipet për muslimanët dhe shqiptarët janë të përafërta. Përshkruhen si primitivë, të pasinqertë, që nuk i duan popujt e tjerë, të papërmbytur, të ndyrë, të pakulturë, grindaveca, të trashë, egoistë e frikacakë.

Sociologu Herbert Kelman e ka vënë re mirë se: "Masakrat bëhen të mundshme në masën që ne i kemi privuar njerëzit e tjerë nga identiteti dhe komuniteti i tyre. Kështu, kur një grup njerëzish është plotësisht i definuar brenda kategorisë që i përket dhe kur ajo kategori është e përjashtuar nga bashkësia njerëzore, atëherë kufizimet morale kundër vrasjes së tyre kalohen shumë më lehtë..."(Kelman, H., 1973).

Për ta përligjur gjenocidin dhe për të prodhuar armiq si metoda të ideologjizuara u përdorën dehumanizimi dhe demonizimi i të tjerëve, ndarja nga tjetri, uniteti brenda racës dhe mohimi i krimeve.

"Rindërtimi i shtetit modern serb në fillim kishte karakterin e një lufte çlirimtare (Lufta e Parë Serbe 1804 dhe Lufta e Dytë Serbe 1814) kundër turqve, prandaj Serbia gjatë gjithë shekullit XIX ishte në një proces çlirimi. Në fillim të shekullit XX, pra që nga luftërat ballkanike, fillojnë luftërat e saj pushtuese dhe lufta për Serbinë e Madhe. Me krijimin e Jugosllavisë, populli serb u gjet në një shtet, që ishte edhe ideali i politikanëve serbë. Kur u bë e qartë se Jugosllavia e dytë nuk ishte e qëndrueshme mbi supozimet e vjetra që ishin të vetmet të pranueshme për elitën serbe (Jugosllavia unitariste), elita serbe nuk e pranoi, ajo aktivizoi programin 'çlirimi dhe bashkimi i të gjithë serbëve'"(Biserko, S., 2006:8).

„Në të gjitha planet serbomëdha dhe dokumentet programore të gjenocidit të çetnikëve përmendet se krijimi dhe organizimi i një Serbie homogjene (shtetit serb etnikisht të pastër) që do të përfshijë 'të gjithë territorin etnik ku jetojnë serbët', është 'detyra e parë dhe themelore' e të gjithë serbëve. Ideali i vetëm i shumë serbëve në 200 vitet e fundit është krijimi i një Serbie të madhe, të fuqishme dhe 'të pamposhtur' në Ballkan, ku do të jetojnë ekskluzivisht vetëm serbët ['Të gjithë serbët në një shtet', 'Serbia do të jetë e madhe dhe e fortë ose nuk do të ekzistojë', 'Njësia shtetërore, hapësinore dhe kulturore e të gjithë serbëve' etj.](Čekić, S., 1995:22,24).

#### 4. Beteja e Kosovës

Të përdorësh burime nga ish-hapësirat jugosllave për Betejën mesjetare të Kosovës, e cila ndodhi në fund të shekullit XIV në mes përkrahësve dhe aleatëve të princit serb Lazar dhe trupave osmane, është shumë e vështirë, para së gjithash për shkak të prirjes së tyre dhe përzierjes me legjenda dhe tradita popullore. Noel Malcolm në librin "*Kosova: një histori e shkurtër*" ka shënuar se: "Ekzistojnë dy supozime të përhapura për Betejën e madhe në Kosovë më 1389: se ishte një fitore turke që e shkatërroi Perandorinë Serbe dhe se serbët e mundur menjëherë ranë nën pushtimin osman. Të dyja janë të gabuara. Supozimi i parë injoron faktin se Perandoria Serbe u shpërbë pas vdekjes së car Dushanit më 1355. Shteti serb mbijetoi edhe shtatëdhjetë vjet, me ndërhyrje të kufizuara osmane në disa periudha. Ndërsa sa i përket rëndësisë së betejave, shumë historianë besojnë se fitorja e mëparshme e turqve pranë lumit Maricë në Bullgari më 1371 kishte efekte shumë më të largëta se Beteja e Kosovës: Beteja pranë Maricës në të vërtetë i hapi rrugë pushtimit osman në tërë Ballkanin. Megjithatë, është krejtësisht logjike që vendet qendrore serbe e konsideronin Betejën e Kosovës si një pikë kthese të rëndësishme, një ngjarje që tregonte se përpara ose më vonë, do të ndodhte shuarja e shtetit serb. Në çdo rast, rëndësia e kësaj beteje për popullin serb nuk mund të matet vetëm sipas pasojave të saj politike-strategjike. Historia e Betejës së Kosovës është bërë simbol i një lloj talismani të identitetit serb, kështu që kjo ngjarje ka një status që nuk e ka asgjë tjetër në historinë e serbëve. Emri 'miti kosovar' për këtë histori me ngarkesë ideologjike nuk do të thotë se gjithçka në të është e rreme, por më shumë se ajo ka veprimin e një talismani"<sup>107</sup>.

Beteja e Kosovës, përmes përdorimit ideologjik, është bërë një kategori jashtëkohore, një ngjarje historike që përmes epikës, mitit dhe formave të tjera të narracionit, është formuar në mënyrë që të ketë një përdorim jashtëkohor ose më mirë thënë, një përdorim të përjetshëm. Duke i relativizuar faktet historike të lidhura me këtë betejë dhe duke i theksuar ose shpikur elementet e reja të lidhura me të, janë krijuar kushtet që përmes narrativës dhe formave të tjera të transmetimit të simboleve të evidentohen kategoritë e përjetshme, siç janë lufta e së mirës dhe së keqes, drita dhe errësira, besimi dhe mosbesimi. Me këtë fetishizim është mundësuar që nga brezi në brez, të transmetohet një kontekst i përhershëm, para së gjithash simbolik dhe shumë shpesh edhe ideologjik. John Reed ka thënë: „Te serbët çdo ushtar i zakonshëm e di për çfarë po lufton. Kur ishte fëmijë, nëna e tij e përhëndeste me fjalët: 'Me shëndet, o hakmarrësi i Kosovës!'“(Dedijer, V., 1914).

Mungesa e fakteve autentike historike lidhur me këtë betejë, e ka hapur edhe më shumë hapësirën për manipulim dhe krijim ideologjik të

<sup>107</sup> [https://archive.org/details/kosovo-a-short-history\\_202104/page/n7/mode/2up](https://archive.org/details/kosovo-a-short-history_202104/page/n7/mode/2up)

simboleve. Ato pak fakte që janë të sigurta lidhur me këtë betejë mund të përmbledhen në disa fjalë. Luftimet ishin të ashpra, humbjet të rënda në të dyja anët. Edhe (princi serb) Lazar dhe (sulltani osman) Murat u vranë. Në fund të betejës, fusha mbeti në duar të turqve. Muratin e trashëgoi djali Bajazidi, i cili i komandoi disa njësi turke në betejë; më pas, ajo që mbeti nga ushtria e tij e ktheu në vendin osman për të siguruar trashëgiminë e fronit. Lazarin e trashëgoi djali i tij i ri Stefan Lazarević, i cili më vonë, sipas këshillës së nënës së tij, vejushës Milicë u bë vasal turk. Çdo gjë tjetër në lidhje me Betejën e Kosovës është e pasigurt: kush mori pjesë, sa ishin ushtritë, si u zhvillua beteja, cilat ishin pikat kryesore të kthesës në luftë, kur dhe si e zuri vdekja Lazarin dhe Muratin dhe nëse, në fund, duhet të mendohet se ishte një fitore apo një rezultat i paqartë...Faktet e pakta mbi këtë ngjarje tregojnë se Beteja e Kosovës nuk ishte një konflikt i përmasave kozmike, siç është paraqitur më vonë në historiografinë, politikën dhe sidomos në ideologjinë serbe. Këtë, kohëve të fundit, e kanë vënë re në kërkimet e tyre edhe autorët serbë, të cilët për shkak të ndikimit që ka pasur dhe ka në historinë moderne të Serbisë, kanë filluar ta vlerësojnë më seriozisht këtë ngjarje. Njëri prej tyre ka thënë:

„Para së gjithash, kjo ishte një betejë tipike mesjetare - si një mjet i fundit për zgjidhjen e tensioneve ndërmjet sunduesve. Megjithatë, Beteja e Kosovës është e paraqitur si një betejë mitologjike në të cilën serbët, duke mbrojtur vendin e tyre, mbrojtën dhe ruajtën civilizimin evropian të krishterë nga sulmi barbar i besimeve të huaja nga Lindja e Afërt“(Jovnović, Đ., 1999:3).

Megjithatë, për shkak të kthesës së madhe që ndodhi pas rënies së plotë të Serbisë nën pushtimin osman, veçanërisht për shkak të dallimeve civilizuese dhe fetare me pushtuesin, kjo betejë në kulturën popullore serbe mori një pikë kthese në historinë e popullit serb.

## 5. Poezia epike serbe

Përveç theksimit të simboleve të përzetshme të luftës midis të mirës dhe të keqes, tradita epike serbe i ka kushtuar një vëmendje të veçantë elementit fetar. Epi është një lloj poezie deskriptive që i përshkruan veprat e heronjve, trimërinë popullore ose individuale, nderet dhe madhësitë, duke përfshirë ngjarje dhe fenomene të ndryshme. Temat e epi janë vepra të mëdha dhe të çuditshme që lënë ndikim te të gjithë anëtarët e një populli në periudha të ndryshme. Në poezinë epike serbe, epi nënkupton luftën kundër armikut dhe një diskutim filozofik mbi të mirën dhe të keqen. Në çdo ep është një manifestim qendror i trimërisë, një hero që e përfaqëson *'idealit e trimërisë'*, i cili ngrihet në nivelin e supernjeriut. Në poezinë epike heroike serbe lidhur me Betejën e Kosovës, mund të veçojmë dy figura të tilla, secila prej të cilave, në mënyrën e saj, simbolizon ideale të caktuara, të cilat më vonë u përdorën gjerësisht në ideologjinë e madhe serbe - princ Lazari dhe Milosh Obiliçi. Poezia epike e lindur nga legjenda e Betejës së Kosovës nuk ka një autor të caktuar dhe kryesisht klasifikohet si poezi

popullore, e cila është transmetuar gojarisht, nga brezi në brez. Siç është thënë tashmë, historia nuk ofron ndonjë detaj të veçantë mbi këtë konflikt, por sipas fjalëve të njërit prej ideologëve modern serbomëdhenj, akademikut Matija Bećković: "Kënga gjithnjohëse dhe gjithpërfshirësia e saj morën përsipër përgjegjësinë për të përcaktuar rrjedhën e betejës, për të caktuar pjesëmarrësit dhe për të gjykuar fituesin. Kështu morëm hollësi të çmuara që vetëm poezia mund t'i zbulojë" (Bećković, M., 1989:6). Përveç rolit kulturor, poezia epike serbe merr edhe një rol religjioz dhe politik, veçanërisht ideologjik. Kjo poezi u përdor intensivisht për mobilizimin e masave për realizimin e qëllimeve politike serbomëdha.

Akademiku Milorad Ekmeçiq ka shkruar: "Çdo nacionalizëm fillon me mbledhjen e përrallave ose këngëve epike dhe ky, pra, është një nacionalizëm elitist" (Milorad, T., 2001:9).

Për rolin e poezisë epike serbe në krijimin e ideologjisë serbomadhe dhe mobilizimin e forcave për ekspeditat e përgjakshme, të cilat në vitet e '90-ta të shekullit të kaluar i përfshin hapësirat e ish-Jugosllavisë, është thënë shumë. Qëndrimet janë të kundërta, nga atribuimi i rolit kyç të traditës epike në ndërtimin e vetëdijes së prirur për krime deri te mohimi i rolit më të rëndësishëm të narrativës epike në krijimin e marrëdhënieve me popujt jo-serbë, veçanërisht me muslimanët.

Inkurajimi i serbëve për qërimin e hesapeve me muslimanët ndodhet në vazhdimësi në mitet e ripërtrira, në radhë të parë në mitin e Kosovës, i cili e nxiti kultin e viktimës, kurse 'popullin qiellor' e privoi nga përgjegjësia historike konkrete. Janë vënë në funksion të gjitha shtresat e mitologjisë laike, ortodokse dhe pagane. Konfirmimi për rinovimin luftarak të mitit të Kosovës kërkohet në shpërnguljen e vazhdueshme të serbëve nga Kosova si '*tokë e shenjtë*', e cila ndodh me shpejtësi pikërisht në vitet e eskalimit të krizës së Jugosllavisë dhe rritjes së nacionalizmit<sup>108</sup>.

„Beteja e Kosovës ka qenë dhe mbetet në vetëdijen popullore ngjarja qendrore e gjithë historisë serbe. Atje, në besimin e përgjithshëm, por të pabazuar, dështoi shteti serb, atje u varros pavarësia e tij, atje filloi robëria ndaj turqve“ (Zirojević, O., 1996:201).

Fshihet e vërteta se në këtë ngjarje, përveç serbëve, morën pjesë edhe përfaqësues të popujve të tjerë ballkanikë (dhe shqiptarët) që së bashku përpiqeshin të mbroheshin nga sulmi kërcënues i osmanëve. Disa të vërteta shpjegohen në një mënyrë historikisht të papërshtatshme. Interesat e ndryshme politike, rivaliteti mes tyre dhe zilia, mosuniteti i aristokracisë së atëhershme interpretohen si ndarje në ata që janë "të besueshëm ndaj Zotit dhe atdheut" dhe në ata që janë "tradhtarë". Kështu lindi miti se në këtë konflikt serbët arritën një fitore morale, duke u angazhuar për jetën e përjetshme në "*mbretërinë qiellore*" dhe se në nder të trimave serbë, tingëlluan kambanat e kishës madje edhe në Paris, me ç'rast civilizimi

<sup>108</sup> Popov, Srpska Dramejija, Ogledi, broj 155-156, 1-31. januar 1997, <http://www.yurope.com/zines/republika/arhiva/97/155/155-42.html>

evropian i krishterë në Kosovë u mbrojt me vendosmëri dhe përfundimisht, duke sjellë sakrificë të përmasave epike. „Dhe, si gjithmonë, edhe këtu mitet luftojnë me forcat magnetike dhe demonike për qëndrueshmërinë e tyre 'të besueshme'. Si të tilla, ato kanë një kuptim metafizik jashtë vetëdijes dhe arsyes dhe zakonisht janë të orientuara drejt figurave historike dhe ngjarjeve me karakter natyror. Thelbi i tyre është se zakonisht përmbajnë tregime për fatin e njeriut dhe për përballjen e njeriut me provat, me një përzjerje të vazhdueshme të racionale dhe iracionale“ (Kostić, D., 1991). Përveç përzjerjes dhe ndërthurjes së legjendës, iracionales dhe mitologjikes me historinë, gjithashtu këtu është intensifikuar elementi religjioz krishtero-ortodoks, duke e forcuar ndjeshëm ndikimin në vetëdijen e popullit. Kështu, “siç ishte vuajtja e Krishtit, vuajtja e atij që qëndron pa u lëkundur në kufirin e së mirës dhe dashurisë dhe për këtë arsye u dënua pa mëshirë nga ata që i mbrojtë dhe nga vetvetja dhe nga e keqja e brendshme e tyre, njashtu edhe ky popull, megjithëse besnikisht i palëkundur ruajtës i kufirit evropian të krishterë, ndëshkohet nga e njëjta Evropë, për shkak të moskuptimit të saj. Pse? Sepse madhësia e saj është më e madhe se ajo europiane. Sepse këtë të vërtetë Evropa nuk mund ta kuptojë. Të vërtetën që serbët e posedojnë që në lindje”<sup>109</sup>.

Këtë mit dhe stereotip iç Ivan Çoloviç e përshkroi kështu: “Në mbijetesën e serbëve, pavarësisht gjithçkaje dhe kundër të gjithëve, duhet të shohim gishtin e fatit, vullnetin e Zotit, kryqin serb. Serbët e kanë të shkruar të flijohen, pa asnjë rezervë dhe pa kushte, për vlerat që u është dhënë për t'i ruajtur nga Zoti: shpirti, kryqi i shenjtë dhe liria. Këtë angazhim për shpëtimin e vlerave më të larta njerëzore në një luftë të pamëshirshme kundër tiranëve të botës, serbët e kanë konfirmuar më qartë në Betejën e Kosovës, prandaj quhet Besëlidhja Kosovare. Edhe sot serbët janë ruajtësit e vlerave më të rralla dhe më të rëndësishme njerëzore, zemrës dhe shpirtit. Në një botë të materializmit të pashpirt modern, të një civilizimi të mirëqenies së rreme materiale dhe të pacifizmit qyqar, ata janë në krye të luftës për idealet e njeriut njëkohësisht luftëtar, të natyrshëm e të shenjtë. Në këtë luftë, ata nuk i frikësohen vdekjes, sepse pa vdekje nuk ka ringjallje kombëtare” (Çoloviç, I., 1995:27).

Forma simbolike të marra, nga tradita epike serbe, të përdorura për qëllime ideologjike kanë si qëllim përfundimtar krijimin e „*Serbisë së Madhe*“.

„Në të gjitha epet ekziston një element i fortë subjektiv, i cili mund të jetë doktrinar ose natyror, etik ose politik dhe ndonjëherë edhe historik, që i jep një dimension të veçantë konceptit të epikës. Në epin e Kosovës flitet për një sakrificë të vetëdijshme për '*kryqin e shenjtë*', '*lirinë e artë*', e cila është para së gjithash shpirtërore dhe veçanërisht për '*mbretërinë e qiellit*'. Sipas këngës '*Darka e princit*' para Luftës së Kosovës Lazari i grumbulloi në

<sup>109</sup> Jovanović, Đokica, *Politička i ideološka upotreba nacionalnog mita*, Filozofski fakultet, Niš: <http://www.komunikacija.org.yu/komunikacija/casopisi/junir/VII/d16/document>

Krushevc të gjithë aristokratët serbë. Në këtë këngë është karakteristike ngjashmëria e kësaj darke në Krushevc me Darkën e Fundit nga Dhjata e Re. Lazari del këtu sikurse Jezusi në Darkën e Fundit. Obiliçi e vrau sulltan Muratin dhe vetë u vra, ndërsa Vuk Brankoviçi e tradhtoi princ Lazarin dhe u arratis nga Kosova. Në këtë mënyrë, Vuk Brankoviçi e mori rolin e Juda Iskariotit nga Dhjata e Re. Kështu janë theksuar dy simbole shumë të rëndësishme, heroizmi në njërin anë dhe tradhtia në anën tjetër; Milosh Obiliçi dhe Vuk Brankoviçi përfaqësojnë simbole të përjetshme të këtyre veçorive. I pari nderohet pa kufij, ndërsa të dytit i drejtohen mallkime dhe kritika. Në këtë bazë është zhvilluar edhe një logjikë e veçantë e heroizmit dhe tradhtisë. Edhe në këtë poezi mund të vërehet ngjashmëria me tregimin e Dhjatës së Re për Jezu Krishtin. Edhe Lazari, ashtu sikurse Jezusi, me vetëdije shkon drejt vdekjes sikur ta merrte urdhrin nga Zoti.

Ndër personalitetet e tjera që zënë një vend të rëndësishëm në ciklin e këngëve epike, pa dyshim duhet të përmendet vajza e Kosovës dhe nëna e Jugoviqëve. Vajza e Kosovës, në Betejën e Kosovës, humbi të fejuarin e saj, të cilin, pas betejës, e kërkon në mes të rënëve. Nëna e Jugoviqëve, e cila sipas traditës poetike është vjehrra e Lazarit, në Kosovë i humbi nëntë djem dhe bashkëshortin. Këto dy gra, *'si simbol i përgjithshëm i vuajtjes në të gjitha luftërat'*, gjithashtu kujtojnë personalitetet nga Dhjata e Re, Marinë Magdalene dhe Marinë, nënën e Jezu Krishtit.

Episodi i ardhshëm nga legjenda kosovare që e meriton vëmendjen tonë është mallkimi që Lazari e bën mbi secilin që nuk vjen në Betejën e Kosovës. Sipas këngës me titull *'Mallkimi i princave'*, sulltan Murati i shkroi një letër Lazarit dhe i kërkoi të dorëzohet, përndryshe do të duhej të vinte në Kosovë për ta marrë tokën me shpatë. Pas leximit të letrës së Muratit, Lazari e shpalli mallkimin:

Kush nuk vjen në Betejën e Kosovës  
nga dora e tij asgjë mos u rritt,  
as në fushë gruri i bardhë,  
as në kodër rrushi i verës!  
"Kush është serb e nga fisi serb,  
dhe nga gjaku dhe gjenerata serbe,  
e që nuk vjen në Betejën e Kosovës,  
mos pastë nga zemra pasardhës,  
as meshkuj as vajza!  
Nga dora e tij mos lindt asgjë:  
verë e kuqe as grurë i bardhë!  
Mjerimi e mbuloftë brez pas brezi!<sup>110</sup>"

Zgjedhja e Lazarit për *'mbretërinë e qiellit'* gjithashtu paraqet një formë simbolike që merr dimensione ideologjike. Falë kësaj zgjedhjeje të Lazarit, serbët më vonë do të rezervojnë për vete statusin 'qiellor', të

<sup>110</sup> <https://www.rastko.rs/knjizevnost/usmena/kosovski-ciklus.html>

privilegjuar, të zgjedhur, duke u konsideruar një popull i zgjedhur dhe i privilegjuar.

Mbi themelet e mitit për *'popullin e qiellit'* është zhvilluar edhe politika për *'Serbinë e Madhe'*, duke e shndërruar këtë në një politikë me qëllime konkrete ekspansioniste. Kështu, serbët - ndryshe nga nazistët që e bazonin superioritetin e tyre në *'tiparet'* e racës germane - e kanë ndërtuar avantazhin e tyre mbi proviencën qiellore dhe zgjedhjen hyjnore.

Kështu Matija Bećković është shprehur: "Kosova është Krstova. Atje u kryqëzua mbretëria qiellore dhe ajo tokësore. Gjysma në ne, gjysma mbi ne...Kosova është kufiri mes dy Serbive. Zgjidhja tokësore e enigmës qiellore"<sup>111</sup>.

"Ky përcaktim për Kosovën dhe kjo Besëlidhje, është një aleancë që populli serb e ka lidhur me Zotin dhe e ka vulosur me gjakun e martirëve. Në Kosovë, populli serb votoi me shpirtin e tij për Mbretërinë e Qiellit dhe kjo ka qenë dhe mbetet e vetmja e drejtë e tij. Që atëherë, të gjithë serbët besnikë ndaj kësaj Besëlidhjeje, bëhen populli i Zotit - populli i ri i Krishtit, Serbia qiellore, pjesë përbërëse e Izraelit të Ri të Zotit"<sup>112</sup>.

„Serbët u mblodhën rreth figurave epike dhe ato u bënë për ta model dhe udhërrëfyes. Ndërkaq vetë Epi i Kosovës në hapësirën etnike serbe u shndërrua në një pjesë të pandashme të antropologjisë politike. Në të ngërthehet edhe urdhri i luftës për ripërtritjen e shtetit, përkatësisht *'perandorisë së humbur'* si personifikim i një shteti të madh dhe të fuqishëm“(Miloš, K., 1999:171-183).

Diplomati, politikani dhe biografi zyrtar serb i udhëheqësit të kryengritësve Karagjorgji, Stojan Nenadović ka shkruar: "Serbët e zemëruar, edhe pas kësaj (pas marrjes së Beogradit) i vranë turqit, kudo që i gjetën, nuk kursyen as të plagosurit, as gratë, as fëmijët turq." "Kur (Karagjorgji) erdhi në Beograd, në një mbledhje të fshehtë të Këshillit, u tha: se të gjithë turqit nga qyteti i poshtëm duhej të likuidohen...Dhe kjo masakër zgjati dy ditë, duke kërkuar dhe vranë turqit e fshehur nëpër shtëpi. Dhe u kursyen vetëm ata që premtuan se do të pagëzohen..."(Omerdić, M., 1999:6).

Kjo pra, është koha kur epika për Kosovën, përveç asaj letrare, merr edhe një dimension politik.

Epi i kaluar bëhet pjesë e së tashmes dhe në rastet e përshtatshme një pjesë e pandashme e diskursit politik. Kjo qasje e re ndaj trashëgimisë popullore në ideologjinë serbomadhe përdoret përmes dy metodave ideologjike - dyfytërisë dhe fetishizimit.

Duke i projektuar armiqte e tyre 'turq', ideologjia serbomadhe krijoi kushte për ta kompensuar humbjen e Kosovës me hakmarrje dhe besnikëri ndaj *'Besëlidhjes së Kosovës'*. Ky përdorim ideologjik i termit turq vazhdon edhe në kohën e sotme.

<sup>111</sup> M. Bećković, <http://www.geocities.com/byzantion2001/Pravednikistorija.html>

<sup>112</sup> Osnove Kršćanske vere, Pravednik, Šta je kosovski zavet', <http://www.geocities.com/byzantion2001/Pravednikistorija.htm>

Kështu Matija Beçkoviç në veprën “Kosova - fjala më e shtrenjtë serbe” shkroi: “Kosova është ekuatori i planetit serb. Çatia e botës së poshtme dhe themeli i botës së sipërme. Atje vetëdija e popullit serb u ndal në atë para dhe atë pas Kosovës. Kosova është një histori e serbizuar për Përmbytjen - Testamentin e ri serb”<sup>113</sup>.

Mitropoliti Amfilohije Radoviç, njeriu me reputacion i Kishës Ortodokse Serbe në Malin e Zi, në kohën e agresionit ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës për dimensionin e Dhjatës së Re të ‘Besëlidhjes së Kosovës’ u shpreh: “Besëlidhja e Kosovës nuk është gjë tjetër veçse në historinë serbe dhe qenien popullore serbe njëherë e përgjithmonë e thurur si Dhjata e Re në të gjithë plotësinë e saj. Dhe ashtu si Dhjata e Re është vulosur me gjakun e Krishtit, pas Darkës së Fundit, po ashtu është vulosur edhe flijimi kristian i Lazarit për Mbretërinë e qiellit, pas Darkës kosovare të Krishtit”<sup>114</sup>.

## 6. Miti i Vidovdanit

Simboli tjetër i marrë nga narrativa e Kosovës është edhe data e Betejës së Kosovës - 28 qershor. Tek ortodoksët 28 qershori festohet si Dita e Vidovdanit. Svetovid të sllavët e lashtë ishte perëndia suprem, për t'u njohur më vonë tek ortodoksët si shërues i sëmundjeve të syve. Me kalimin e kohës, Vidovdani u shndërrua në një kult të veçantë që lidh paganizmin dhe krishterimin. Kult i Vidovdanit u theksua vetëm në vitin 1976. Miodrag Popović në veprën ‘Vidovdani dhe Kryqi i Shenjtë’ shkroi: “Kulti i Vidovdanit, i cili përzien realitetin historik me realitetin mitik, luftën e vërtetë për liri me prirjet pagane të ruajtura (hakmarrja, therja dhe ofrimi i sakrificës, ringjallja e paraardhësit heroik), potencialisht përmban në vetvete të gjitha karakteristikat e mjediseve me impulse mitike të paedukuara. Si një fazë e caktuar në zhvillimin e mendimit kombëtar, ai ka qenë historikisht i nevojshëm. Por, si një gjendje e përhershme e shpirtit, kulti i Vidovdanit mund të jetë edhe fatal për ata që nuk janë në gjendje të çlirohen nga rrjetat e tij pseudomitike dhe pseudo-historike”(Popović, M., 1976:216). Është interesante se si Vidovdani nuk u festua si një festë zyrtare fetare deri në zgjimin e nacionalizmit. Që atëherë merr një dimension fetar, por edhe shumë më e rëndësishme, edhe një dimension politik dhe ideologjik.

“Dita e Vidovdan-it është festuar që nga 15 qershori. Parashtrohet pyetja, krejtësisht e arsyeshme, se nga vjen Vidovdani në traditën popullore serbe? Përveç kësaj, ai nuk është një figurë veçanërisht e rëndësishme në mitologjinë krishtere. Ekziston një enigmë dhe një pyetje e arsyeshme pse dita e vdekjes së Lazarit në Kosovë quhet Vidovdan? Si një festë sakrale, Vidovdani nuk është përmendur për shekuj, vetëm në shekullin XX ai u

<sup>113</sup> <https://sofiografkaskola.com/wp-content/uploads/2017/10/-pdf>

<sup>114</sup> [https://pure.uva.nl/ws/files/1513620/108592\\_UBA003000255.pdf](https://pure.uva.nl/ws/files/1513620/108592_UBA003000255.pdf)

zhvendos nga 15 qershori në 28 qershor. Merr një rëndësi të jashtëzakonshme dhe një dimension, si të shenjtë, por akoma më shumë si një shprehje politike. Kështu, kjo ditë është bërë shumë e rëndësishme për serbët ortodoksë, gjë që e tregojnë edhe disa ngjarje të rëndësishme që ndodhën në këtë ditë në fillim dhe në fund të shekullit të njëzet” (Popović, M., 1976:99).

Dy ngjarje që ndodhën më 28 qershor, në një farë mënyre, përfaqësonin hyrjen në kataklizma të mëdha. E para ishte atentati ndaj trashëgimtarit austro-hungarez Franz Ferdinandit dhe gruas së tij Sofia, i kryer më 28 qershor 1914 në Sarajevë.

Atentatin e kreu nxënësi i gjimnazit Gavrilo Principi, anëtar i organizatës ‘*Mlada Bosna*’, e cila e përfaqësonte degën boshnjake të organizatës sekrete serbe ‘*Crna ruka*’, e cila drejtohej nga koloneli i ushtrisë serbe Dragutin Dimitrijević Apis. „Megjithëse për shkak të tensioneve në mes fuqive të mëdha ekzistonin kushte për fillimin e Luftës së Parë Botërore, ky atentat, në një farë mënyre, e përshpejtoi fillimin e saj”<sup>115</sup>.

Ngjarja e ardhshme që ndodhi në këtë ditë është përkujtimi i gjashtëqindvjetorit të Betejës së Kosovës më 1989 në Gazimestan. Në atë ditë, në Kosovë u mbajt një miting i madh i serbëve, me të cilin u shënua ky përvjetor. Kjo ditë konsiderohet si fillimi i ndryshimeve të përgjakshme në ish-Jugosllavi. Serbëve të mbledhur iu drejtua presidenti i atëhershëm i Serbisë, Slobodan Milosheviq: Ai në mes tjerash tha: “Gjashtë shekuj më vonë përsëri jemi në beteja dhe para betejave. Ato nuk janë të armatosura, megjithatë as ato nuk përjashtohen”<sup>116</sup>.

## 7. Mbështetja e jashtme

Në artikullin ‘*The Kosovo Legacy*’ Thomas A. Emert shkruante se “gjatë Luftës së Parë Botërore, Serbia u bë “e përkdhelura” e publikut si britanik ashtu edhe atij francez, i cili e interpretoi vendosmërinë e Serbisë për të luftuar për lirinë e saj si një shprehje të shpirtit të saj kosovar. Në Angli më 1916 për nder të Serbisë u organizua një festë mbarëkombëtare në përvjetorin e Betejës së Kosovës. Informacionet për Serbinë u shpallën në mbarë Britaninë. Në Londër ishte hapur një librari me literaturë për Serbinë, të cilën shtëpitë botuese britanike e kishin shtypur në dhjetëra mijëra kopje. Pllakata me mbishkrimin ‘*Serbia heroike*’ ishin të ekspozuar dukshëm në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar. Shkollat dhe kishat organizonin ligjërata speciale dhe shërbesa përkujtimore në nder të festës serbe. Kinematë shfaqnin filma për Serbinë, Në disa teatro luhej himni kombëtar serb. Shtypi anglez raportoi për të gjitha aktivitetet në më shumë se katërqind shkrime. Historiani i njohur R. W. Seton-Watson, i cili mori pjesë në organizimin e festimeve të Betejës së Kosovës, përgatiti një fjalim

<sup>115</sup> Lora Silber i Alan Liti, Smrt Jugoslavije, [http://mmc.et.tudelft.nl/čsii/b92net/unifishedpeace/smrt\\_jugoslavije/podizanjeopt\\_uznice/carlazar.html](http://mmc.et.tudelft.nl/čsii/b92net/unifishedpeace/smrt_jugoslavije/podizanjeopt_uznice/carlazar.html)

<sup>116</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=gOQKF25loUc>

me titull ‘*Serbia, dje, sot, dhe nesër*’ që u lexua, në tërësi ose në pjesë, në gati dymbëdhjetë mijë shkolla dhe i njoftoi të rinjtë britanikë me historinë e Serbisë. Seton - Watson e përshkroi Betejën e Kosovës si një nga ngjarjet vendimtare në historinë e Evropës Juglindore<sup>117</sup>. Njëjtë shënohej edhe në disa vende perëndimore.

## 8. Kthesa reale e diagnostikimit të problemit

Në fund të shekullit të kaluar, qëndrimi ndaj tematikës kosovare ndryshoi dukshëm, në qarqet politike e shkencore. Në aspektin politik dëshmi e kësaj është intervenimi i Nato-s për ndalimin e gjenocidit serb ndaj shqiptarëve dhe çlirimin e Kosovës. Në aspektin shkencor përkushtimi ndaj traditës epike kosovare është studiuar seriozisht. „Në Kongresin e Tretë Botëror për Psikoterapi, të mbajtur më 1999 në Vjenë, ku morën pjesë 4000 pjesëmarrës nga 100 vende, doli themeluesja e psikodramës, ekspertja e OKB-së, një nga shkencëtarët më të mëdha të shekullit XX në fushën e psikoterapisë An Anselin Sucenberze, e cila i përsëriti disa qëndrime nga libri i saj bestseller ‘*Sindromi i paraardhësve*’, i përkthyer në të gjitha gjuhët e rëndësishme botërore dhe i shitur në 200.000 kopje.

Profesoresha Sucenberze shprehu qëndrimin e saj se “serbët edhe sot vuajnë nga trauma transgjenaracionale që e shkakton të keqen. Modeli i sjelljes serbe është bërë vrasja, që nga koha kur Millosh Obiliçi e vrau në gjumë sulltanin turk Muratin.

‘E shtëna e parë e Luftës së Madhe’ e cilëson historiani i famshëm A.J.P Tejlor në librin e tij ‘Lufta e Parë Botërore: Një histori e ilustruar’ momentin kur një i ri serbo-boshnjak i quajtur Gavrilo Princip më 28 qershor 1914 në Sarajevë e vrau arkidukën Franc Ferdinandin, trashëgimtarin e fronit të Austro-Hungarisë (Monarkisë së Habsburgëve) dhe gruan e tij, dukeshën e Hohenbergut. Kam lexuar të paktën 20 libra për luftën në Jugosllavi dhe në të gjitha thuhet e njëjta gjë - Slobodan Milosheviçi më 28 qershor 1989 i kujtoi serbët në Kosovë për traumën e tyre dhe menjëherë pas kësaj filluan masakrat kundër muslimanëve. Historia përsëritet në datat historike, si një sindrom i përvjetorëve, në familje dhe vende” - tha prof. Sucenberze. Duke iu referuar zbulimit të Frojdit për ‘*vetëdijen kolektive*’ dhe ‘*nëvetëdijen kolektive*’ të Jungut, prof. Suçenberze formuloi një teori sipas së cilës fenomenet patologjike nuk transmetohen vetëm në mënyrë të vetëdijshme nga një brez në tjetrin, por mbijetojnë dhe trashëgohen fshehurazi, transgjenaracionalisht. Një ndjenjë ose ose besim i caktuar mund të transmetohet për qindra vjet dhe të mbetet operativ në brezat që nuk kanë njohuri për atë pjesë”, - tha prof. Sucenberze. Prof. Sucenberze nuk është e vetme në studimin e këtij fenomeni. Etnopsikoanalisti zviceran Paul Parin, gjithashtu një emër me famë botërore, theksoi se “historiku i identitetit të serbët është derdhur fatalisht

<sup>117</sup> Report of Kosovo day celebrations, Kosovo Day, London, 1916, pp.11-25, navedeno prema Emmert, mimeo:21-23

në fashizëm. Kjo nuk ndodhi vetëm mes fshatarëve të zakonshëm. Edhe në qytetet e mëdha dhe në Beograd, ku jeton avangarda, artistët, shkrimtarët, aktorët, në një moment erdhi deri te një bindje e gjerë se Zoti, përmes atyre luftërave në kohët historike, para 600 vjetësh, shpalli popullin serb si të zgjedhur dhe të shenjtë. Ata ishin të gatshëm të vrisnin ose të vdisnin për këtë bindje”, - tha prof. Parin. Për këto fenomene te serbët flet edhe profesori amerikan Vamik Volkan, psikoanalist, i cili në librin e tij *‘Kufijtë e Gjakut’* (1997) i ka kushtuar pesëdhjetë faqe *‘sëmundjes serbe të quajtur Beteja e Kosovës’*. Prof. Volkan u shpreh se: ‘Serbët janë kthyer mendërisht në mesjetë dhe për këtë arsye kanë luftuar’<sup>118</sup>.”

### **Përmbyllje**

Në kuptimin popullor, Kosova është bërë paradigma e luftës së drejtë, sakrificës dhe vdekjes për *‘nderin e kryqit’* dhe *‘lirinë e artë’*. Për më tepër, ajo është bërë paradigma e vetëkuptimit kolektiv, metafora kryesore në interpretimet e mëvonshme të ngjarjeve historike, kyçe në shekujt XIX dhe XX. Kosova është bërë ngushtësisht e lidhur me jetën e një populli të tërë që gradualisht po bëhej i vetëdijshëm për veten si një komb brenda kombësive të tjera evropiane dhe që synonte të përcaktonte veten si një komb, ndryshe nga "ato" të Perandorisë Osmane. Etnocentricmi mitologjik i fryrë nga nacionalizmi patologjik eskaloj kobshëm në shovenizëm, duke iu kthyer bumerang politikës serbe. Marshet për beteja të reja në emër të lavdisë së rreme për betejat e vjetra, solli tragjedi për popujt përreth në ish-hapësirat jugosllave, ndërsa tragji-komedi për vetë popullin serb. Duke synuar ekzagjerimin e territoreve për arritjen e Serbisë së Madhe, shteti serb pësoi fiasko të vazhdueshme. Historia serbe është bërë një leksion edhe për popujt dhe brezat e tjerë në mbarë botën, për të mos ndërtuar projeksione të së ardhmes nga narracionet fiktive dhe mbi ngrehinat mitologjike të së kaluarës. Është mësim për të gjithë popujt se si mund të pësojë një popull, politika e të cilit synon të gllabërojë vende të huaja që nuk i përkasin.

<sup>118</sup> Marrë nga: Alispahić, Fatmir, Psihoanaliza zla, internetsko izdanje; <http://www.nippljiljan.com/politika.htm>

## Referenca

1. Babić, Mile, Kristološko utemeljene tolerancije nacionalno mitomansko prokletstvo, Kaligraf, Sarajevo, 2002
2. Bartol i Slaven Letica, Postmoderna i genocid u Bosni, etničko čišćenje velika prevara našeg doba, Naklada Jesenski i Turk, Hrvatsko sociološko društvo, Zagreb, 1997
3. Bečković, Matija, Kosovo najskuplja srpska reč, Glas crkve, Valjevo, 1989
4. Biserko, Sonja, Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa "Kovanje antijugoslovenske zavere", Knjiga 1, Svjedočanstva 26, Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji, Zagorac, Beograd, 2006
5. Čolović, Ivan., Mitska Srbija i komentari, Dijalog, pilot broj, jesenzima, 1995
6. Čekić, Smail, Uzroci, ciljevi i razmjere agresije na Bosnu i Hercegovinu 1991–1995, Vijeće kongresa bošnjačkih intelektualaca, Sarajevo, 1995
7. Dedijer, Vladimir, Sarajevo 1914, Просвета, Београд, 1966.  
<https://www.scribd.com/doc/182202880/Vladimir-Dedijer-Sarajevo-1914-pdf>
8. Dimitrijević, Vojin, Jugoslovenska kriza i međunarodna zajednica, u: Srpska strana rata, 1996
9. Herbert Kelman, Violence without moral restraint, Reflections On Dehumanization Of Victims And Victimizers, The Journal of Social Issues, sv. 29, br. 4, London, 1973
10. Kostić, Dragan, Psihološki rečnik, Savremena administracija, Beograd, 1991
11. Knežević, Miloš, Ciklusi Kosovskog mita, Nova srpska politička misao, god. VI, br. 3–4, Beograd, 1999, 'Osnove kršćanske vere', 'Šta je kosovski zavet', PRAVEDNIK: <http://www.geocities.com/byzantion2001/Pravednikistorija.htmstr>
12. Jovnović, Đokica, Politička I ideološka upotreba nacionalnog mita, Filozofski fakultet, Niš, 1999, str.3.
13. Milorad, Tomanić, Srpska crkva u ratu i ratovi u njoj, Medijska knjižara Krug, Beograd, 2001
14. Omerdić, Muharem, Prilozi izučavanja genocida nad bošnjacima(1992-1995), El-Kalem, Sarajevo, 1999
15. Popović, Miodrag, Vidovdani i časni krst, u: 'Srpska strana rata', Beograd, 1976
16. Šarić, Sabahudin, Velikosrpska ideologija, Institut za istraživanje zločina protiv čovječnosti i međunarodnog prava Univerziteta u Sarajevu-Naučnoistraživački institut Ibn Sina, Sarajevo, 2010
17. Zirojević, Olga, Kosovo u kolektivnom pamćenju, srpska strana rata, Beograd, 1996

Rilind MAHMUDI<sup>1</sup>, Majlinda ISMAILI-MAHMUDI<sup>2</sup>

([rilind.mahmudi@unt.edu.mk](mailto:rilind.mahmudi@unt.edu.mk))

([majlinda.ismaili@unt.edu.mk](mailto:majlinda.ismaili@unt.edu.mk))

<sup>1,2</sup>Mother Teresa University – Skopje, North Macedonia

## DIFFERENCES BETWEEN ACQUIRING ALBANIAN AND LEARNING ENGLISH AS A SECOND LANGUAGE

### DALLIMET MIDIS PËRVETËSIMIT TË SHQIPES DHE TË MËSUARIT E ANGLISHTES SI GJUHË E DYTË

#### Abstract

Language plays a vital role in human development, communication, and civilization. This paper explores the distinction between language acquisition and language learning, emphasizing how Albanian university students experience these processes differently when acquiring their mother tongue and learning English as a second language. The study provides a brief overview of key linguistic theories—from Saussure's *langue* and *parole*, Bloomfield's imitation theory, and Chomsky's Universal Grammar and *competence/performance* distinction, to Krashen's Monitor Model—that have shaped understanding the first and second language learning process. A survey carried out with students of Mother Teresa University in Skopje in North Macedonia investigated how participants perceive their acquisition of Albanian and their learning of English. The results show that students acquire Albanian unconsciously through natural interaction and exposure, while English is consciously learned through formal instruction, memorization, and rule-based practice. Furthermore, responses highlight that second language learning depends on age, motivation, and environment, and differs from the effortless, implicit nature of mother-tongue acquisition. The study concludes that while both processes aim at linguistic competence, their mechanisms and outcomes differ significantly.

**Key terms:** *Acquisition, learning, English language, Albanian language.*

#### Abstrakt

Gjuha luan një rol thelbësor në zhvillimin njerëzor, komunikimin dhe civilizimin. Ky punim shqyrton dallimin midis përvetësimit të gjuhës dhe të mësuarit të gjuhës, duke theksuar mënyrën se si studentët universitarë shqiptarë e përjetojnë ndryshe këtë proces gjatë përvetësimit të gjuhës amtare dhe gjatë të mësuarit të anglishtes si gjuhë e dytë. Studimi përfshin një përmbledhje të teorive kryesore gjuhësore — nga ndarja e Saussure midis *langue* dhe *parole*, teoria e imitimit e Bloomfield-it, Gramatika Universale dhe ndarja *kompetencë/performancë* e Chomsky-t, deri te Modeli i Monitorimit i Krashenit — që kanë ndikuar në kuptimin e procesit të të mësuarit të gjuhës së parë dhe të dytë. Një pyetësor i realizuar me studentë të

Universitetit Nënë Tereza në Shkup në Maqedoninë e Veriut kishte për synim të vlerësojë perceptimet e tyre mbi përvetësimin e shqipes dhe të mësuarit e anglishtes. Rezultatet tregojnë se studentët e përvetësojnë shqipen në mënyrë të pavetëdijshme, përmes ndërveprimit natyror dhe ekspozimit, ndërsa anglishten e mësojnë me vetëdije, nëpërmjet mësimdhënies formale, memorizimit dhe ushtrimeve të bazuara në rregulla. Për më tepër, përgjigjet tregojnë se të mësuarit e gjuhës së dytë varet nga mosha, motivimi dhe mjedisi, dhe ndryshon nga natyra e pavetëdijshme e përvetësimit të gjuhës amtare. Studimi arrin në përfundimin se, megjithëse të dy proceset synojnë kompetencën gjuhësore, mekanizmat dhe rezultatet e tyre ndryshojnë ndjeshëm.

**Fjalët kyçe:** *Përvetësimi, mësimi, gjuha angleze, gjuha shqipe.*

### **Purpose of Study**

The main purpose of this study is to explore and clarify the difference between language acquisition and language learning, focusing on how Albanian students experience these two processes in real life. The study aims to understand how the acquisition of the mother tongue (Albanian) occurs naturally and unconsciously, while the learning of English as a second language takes place through conscious and structured instruction. By comparing these two linguistic processes, the study seeks to identify similarities, differences, and influencing factors such as age, environment, and motivation. Another goal is to show how the process of learning English could become more natural and communication-based, resembling the way a first language is acquired.

### **Research Methods**

This study uses a mixed-methods approach, combining quantitative and qualitative methods to explore the differences between first language acquisition and second language learning. The study relies on qualitative analysis of linguistic theories. This includes reviewing works of Saussure, Bloomfield, Chomsky, and Krashen, which provide a conceptual framework for understanding language acquisition and learning. The qualitative component allows for interpretation of the survey findings with the focus on established linguistic theories, highlighting how students' experiences reflect or diverge from theoretical models of first and second language development. The main quantitative tool is a structured survey administered to university students whose mother tongue is Albanian. The survey consists of 20 multiple-choice questions, divided into sections addressing: (a) acquisition of the mother tongue, (b) learning English as a second language, and (c) perceptions of the differences between the two processes. The quantitative data allows for statistical analysis of patterns, such as the frequency of natural acquisition behaviors versus conscious learning strategies, and highlights general trends among the student population.

### **Introduction**

Language is a perfect tool for communication that enables human development and progress in all aspects. If there was no language, then,

everything would be limited for the human and today he would not have reached this stage of development. Human civilization is closely linked to language development. Thus, the more words a language has, the better the communication is.

An interesting question may be asked when it comes to language and the nature of language: “Is language natural or not?” Different opinions exist about this question, but a linguist needs to know that the language is not natural, because of the simple fact that humans created languages, but the need to communicate and to have a language is natural. The need to communicate vivified the idea of speaking more than one language, and humans started acquiring a foreign language, beside their mother tongue. The acquiring or learning process of the second language all the time needs to be close to the mother tongue in order to see possible differences and similarities. Thus, several opinions and theories have been given by outstanding linguists in first and second language acquisition.

### **A brief historical overview in first and second language acquisition**

Various studies exist on first and second language acquisition. This study takes into account only the most relevant and important ones. Without a doubt, Ferdinand de Saussure is a linguist who left behind theories that are mentioned even today in books and studies of various researchers dealing with second language learning. He was the first linguist who distinguished the terms *langue* and *parole* that are often used in different studies dealing with language itself (De Saussure 1959:9). For Saussure, “This distinction went under the labels of *langue* (knowledge of language) and *parole* (speech)” (Robinson, Ellis 2008:216). Studies on second language learning somehow started by Ferdinand de Saussure, and followed by well-known names like Harold E. Palmer, Leonard Bloomfield, Noam Chomsky, Larry Selinker, Stephen Krashen up to more recent linguists like Vivian Cook, Michael Tomasello, Eric Kellerman and Diane Larsen-Freeman. All these outstanding linguists have contributed to English language learning.

Chomsky rightfully holds his place among the greatest linguists, particularly for his contributions to both first and second language acquisition. Chomsky’s most important theory, which has to do with language, is the division between *competence* and *performance*. It is a theory which was first mentioned by Chomsky and as such still exists in second language acquisition studies. To understand how language is acquired, we can turn to Chomsky’s theory, which offers a foundational explanation of the process.:

*We must abstract for separate and independent study a cognitive system, a system of knowledge and belief, that develops in early childhood and that interacts with many other factors to determine the kinds of behavior that we observe; to introduce a technical term, we must isolate and study the system of linguistic competence that underlies behavior but that is not realized in any direct or simple way in behavior. (Chomsky 2006:4).*

Following Chomsky's studies, we should ask how an individual is able to acquire and use a language, and how they can distinguish correct from incorrect language. Chomsky answers this question with "Universal grammar":

*The study of universal grammar, so understood, is a study of the nature of human intellectual capacities. It tries to formulate the necessary and sufficient conditions that a system must meet to qualify as a potential human language, conditions that are not accidentally true of the existing human languages, but that are rather rooted in the human "language capacity," and thus constitute the innate organization that determines what counts as linguistic experience and what knowledge of language arises on the basis of this experience. (Chomsky 2006:24)*

Subsequently, studies related to language errors and Universal Grammar are taken into account by researchers dealing with second language acquisition. Various researchers try to determine speakers' access to Language acquisition device and to examine the intuitions of native or foreign speakers regarding grammatical correctness of sentences of the language being studied. To simplify, Universal Grammar is necessary for children to acquire their native language. Chomsky does not consider language as speaking in real life communication but as an inherent structure of features - or competence involved in any natural language grammar. After clarifying that competence is individual's ability to use language, performance is the use of language, or the result that comes out from the preliminary preparation. However, language use (production) is consciously or unconsciously related to psycholinguistics. Thus, "One of the most influential psycholinguistics models for speech production, developed by Levelt, views it as a linear progression of four successive stages: conceptualization, formulation, articulation and self-monitoring" (Scovel 1997:26). These are all mental processes, and before a child articulates a word or a sentence will necessarily pass through these stages. Although these stages will never be proven with facts because they are mental processes, it is somehow logical to rely on them because the individual cannot articulate an expression without preliminary preparation.

Leonard Bloomfield, another American linguist, is important regarding language studies. Bloomfield argues that learning a language can't be understood just by looking at rules or logic, because the meaning of expressions comes from the habits and associations of speakers, so truly acquiring a language requires observing how people actually use it, understanding its mental and social context, and seeing the specific patterns and contrasts that shape each language (Bloomfield 1983:71). Bloomfield also put forward the idea that, "The general description of a language should be scientific, and to him only an analysis based on 'real data' could be considered scientific" (Bot, Lowie, Verspoor 2005:28). In many cases, this idea is supported by linguists and consequently, results of researches carried out in real life situations are much more realistic than

those carried out in isolated areas. Bloomfield does not stop here but he sets the idea of natural formation by taking into account the imitation. According to Bloomfield, “Children were believed to acquire their native language by repeating and imitating their caretakers’ utterances” (Johnson 2004:19). This is more than probable because if we take a child born of Albanian parents and adopted by American parents, we will see that the child will speak English but not Albanian. As well, the child will acquire phonemes that belong to the language he speaks and will not be able to obtain phonemes of another language. Of course, if later the child begins to learn another language, then he will be able to acquire other phonemes.

### **Differences between second language learning and second language acquisition**

The difference between acquiring and learning a second language is the basis for understanding the language and the learning process. Linguists’ theories have undoubtedly influenced further development of linguistics in general, but the following part briefly describes the theory that made a major turn in language studies, especially on the acquisition and learning.

The Monitor Theory on language acquisition and learning explains first language learning as involving ‘acquisition’ and second language learning in adults. Monitor Theory hypothesizes that adults have two independent systems for developing ability in second languages, subconscious language acquisition and conscious language learning, and that these systems are interrelated in a definite way: subconscious acquisition appears to be far more important (Krashen 1981:5). Thus, language acquisition is unconscious and unintentional process, and language learning is a process where the individual intentionally and consciously learns the target language. We need to make it clear that language acquisition is very similar to the process children use in second language acquisition, but differs in adults who learn the target language intentionally and so changing the acquisition process into learning process. By this we understand that the process of acquisition requires meaningful interaction in the target language, a natural communication in which speakers are not interested in the form of expression, but with messages that they send and receive. Further, error correction and learning the rules are not relevant because they are concentrated in the sending of the message (Robinson, Ellis 2008:341).

However, today’s tendency is that a second language should be similarly acquired as the first one. We need to understand that language learning needs to be similar to language acquisition, and the individual/student is required to learn a foreign language/English almost in the same manner as the native language. This is possible if students communicate all the time in English and not native language, so that speeds up the process of acquisition, but it is also a way that may bring a more satisfactory outcome. Today, Albanian students understand the importance of speaking a foreign language and try to acquire English, which is present

in their school programs. Thus, the number of students who speak more than one language is constantly growing and statistics already show their results.

### **Survey Findings and Discussion**

The survey<sup>119</sup> involving 78 university students carried out at Mother Teresa University in Skopje, North Macedonia, provides a clear picture of how Albanian is naturally acquired as a first language, while English is consciously learned as a second language. Each question reveals patterns that not only confirm established linguistic theories, but also highlight how exposure, especially to English through media, has made it difficult to find the boundary between acquisition and learning.

Question 1 showed that 87.2% of students learned Albanian mainly by listening to parents, family, and friends. This is a natural process that aligns perfectly with Bloomfield's imitation theory, which argues that children acquire language by imitating those around them. It also reflects Saussure's concept of parole, as language use is developed through real-life communication rather than structured learning. Students likely chose this option because it best describes their earliest language experiences, i.e., hearing and repeating familiar speech in the home environment.

In Question 2, an even higher percentage of 93.6% said they started speaking Albanian by imitating words and phrases from family members. This result confirms that first language acquisition is an unconscious process based on repetition. The act of imitation is present in early communication, supporting Bloomfield's view that language develops through stimulus and response in a child's environment.

The results for Question 3 were more divided, though 52.6% said they learned Albanian vocabulary through formal lessons in school. This is interesting because it suggests that as children grow, the process of acquisition transitions into conscious learning. Vocabulary expansion continues at school but it is built on what they already learned naturally. The change from intuitive learning to explicit study reflects Chomsky's idea of performance and competence, where the innate system of language (competence) becomes supported by formal instruction (learning).

For Question 4, the most chosen answer (38.5%) was by studying grammar books and rules. This shows that learning grammar often happens later, through formal education, unlike early vocabulary or speech development. It also reveals how native speakers can consciously analyze a language they once used intuitively. According to Krashen's Monitor Model, we can use what we learn on purpose to improve what we already know naturally.

Question 5 revealed that 75.6% of students believe their understanding of Albanian developed through daily interactions and conversations. This

---

119

<https://docs.google.com/forms/d/1Z3kZPiDqepPimMQKfjqIrI01kxom3JJ0tn4jOz8z5Vk/edit#responses>

high percentage again confirms Krashen's Input Hypothesis, showing that comprehension grows through exposure to meaningful input. In Albanian, children are fully engaged in constant linguistic interaction, allowing natural acquisition without explicit teaching.

On the other hand, things change when learning English language. In Question 6, 34.6% said that they learned English by watching movies or listening to music. This shows that while English is taught formally, media exposure now plays a major role in learning a language. It represents a bridge between Krashen's "comprehensible input" and real-world communication, where learners pick up new structures naturally. Students may have chosen this option because modern learning extends beyond classrooms—songs, films, and online platforms have become vital English-learning tools in everyday life.

Question 7 reinforced this where 60.3% said they improve their English by watching series, movies, or videos. This suggests that entertainment media is perceived as the most engaging and effective form of exposure. The input from different contexts helps students become better at pronunciation, idioms, and fluency. It demonstrates how Krashen's natural approach works in real life, where fun, meaningful exposure replaces memorization.

In Question 8, 48.7% said using English in everyday life situations helps them gain fluency faster. This is an important result, showing that practical use matters more than theoretical study. It aligns with Chomsky's view that competence must translate into performance—language is not fully learned until it is used for communication. Students may have chosen this option because speaking English in daily life could make them feel more natural and confident, unlike repetitive classroom exercises.

Question 9 asked about the difference between classroom and natural learning. 43.6% responded that classroom learning focuses on rules, while natural exposure focuses on communication. This shows the general belief that formal learning improves grammar knowledge, but true fluency comes from real-world interaction. It also shows Krashen's distinction between conscious "learning" and subconscious "acquisition."

Question 10 revealed that 52.6% of students think adolescence (13–18 years) is the easiest age to acquire English naturally, contrary to 46.2% who chose early childhood (0–6 years). This likely reflects their own experience—many start English learning seriously in middle or high school, when motivation and exposure are strong. However, from a theoretical standpoint, Krashen and Chomsky would argue that earlier ages are more sensitive for natural acquisition. Still, the students' belief emphasizes the importance of motivation and opportunity rather than purely biological age. On the other hand, we witness many elementary school students who speak English fluently.

For Question 11, 64.1% said practicing English with friends or in daily situations helps the most in real-life communication. This practical view

supports Bloomfield's idea that language learning relies on habitual use. It also illustrates that students recognize communication, not rule memorization, as the key to fluency. They probably chose this answer because peer interaction feels less stressful and more natural than classroom correction.

In Question 12, an identical 64.1% believed that spending time in English-speaking environments builds the most confidence. This means that language use becomes spontaneous, supporting Krashen's affective filter hypothesis, where low anxiety and high exposure result in better language learning. Students recognize that real-world environments push them to use English naturally without overthinking rules and possible errors.

Question 13 showed that 33.3% struggle most with remembering grammar rules from class. This indicates that conscious grammar learning remains challenging and often disconnected from spontaneous speaking.

Question 14 found that 64.1% use English daily in conversation, media or social media. This shows that English is no longer confined only to the classroom, but it is part of students' everyday lives. Such constant exposure resembles the natural acquisition process of Albanian, suggesting that technology has made the boundary between learning and acquisition even smaller. This answer supports Krashen's idea that the more meaningful input a student receives, the more naturally acquisition occurs.

Question 15 had 62.8% choosing a mix of classroom learning and natural exposure as the most effective method. This answer shows that both conscious and unconscious learning play a role in learning a language. Students understand that grammar helps in using English correctly, while communication builds fluency.

Question 16 showed that 61.5% learned English grammar by memorizing rules from textbooks. This confirms that grammar is still primarily taught through instruction. It is again related to Krashen's model which is necessary for understanding rules but insufficient for real communication. Students likely chose this because grammar lessons remain a very important element of formal education in North Macedonia.

For Question 17, 34.6% said they expand vocabulary by using words naturally in everyday conversation. This is a positive sign, showing that students recognize the importance of active use. Compared with Question 3 (Albanian vocabulary), the process is more conscious but still communicative. This again aligns with Krashen's input and output hypothesis, where meaningful use transforms learned words into acquired ones.

Question 18 revealed that 53.8% of students correct mistakes naturally while speaking with others. This answer shows that error correction is not essential, but language improves through natural feedback. Students probably chose this because self-correction during communication feels more effective and less stressful than teacher correction, resembling how they refined Albanian as children.

In Question 19, 66.7% said English is taught systematically with rules, while Albanian was acquired naturally. This is one of the clearest confirmations of the study's hypothesis. It directly shows the difference between acquisition and learning as defined by Krashen. Students themselves recognize the fundamental difference: Albanian was acquired naturally, while English is learned on purpose.

Finally, Question 20 showed that 61.5% believe speaking English fluently is harder because it must be learned consciously through study. It confirms that students view English learning as conscious, planned and structured process, while Albanian fluency came naturally. Their experiences illustrate the idea of Chomsky's competence compared to Krashen's acquisition that learning English involves understanding and applying rules, while speaking Albanian comes from innate linguistic mechanisms developed early in life.

### **Conclusion**

The results of the survey support the theories discussed in the paper. Bloomfield's imitation theory helps explain how Albanian was acquired naturally through repetition and interaction. Chomsky's Universal Grammar highlights the innate ability that makes this process almost effortless, while Krashen's Monitor Model shows why learning English tends to be more conscious and structured. At the same time, exposure to English through movies, music, and social media lets students learn some of the language naturally, showing that learning and acquisition can happen together.

In short, Albanian is acquired naturally through daily use and social interaction, while English is learned more deliberately, requiring effort and exposure. Yet, thanks to technology and global communication, learning English is increasingly starting to feel more like acquiring a first language. The most effective approach, supported by both theory and student experience, is a balanced one, i.e., combining formal lessons with real-life exposure so that learning becomes as natural as possible.

### **References:**

- Bloomfield L. (1983). *An Introduction to the Study of Language*. John Benjamin Publishing Company.
- Bot K., Lowie W. & Verspoor M. (2005) *"Second Language Acquisition - An Advanced Resource Book"*, Routledge.
- Chomsky N. (2006) *"Language and Mind"*, Cambridge.
- De Saussure F. (1959). *Course in General Linguistics*. Columbia University Press.
- Johnson M. (2004) *"A philosophy of Second Language Acquisition"*, Yale University Press.
- Krashen S. (1981). *Second Language Acquisition and Second Language Learning*. Pergamon Press.
- Robinson P. & Ellis N. C. (2008) *"Handbook of Cognitive Linguistics and Second Language Acquisition"*, Routledge.
- Scovel Th. (1997) *"Psycholinguistics"*, Oxford University Press.

ISSN 2671-3004

UDC 81'27:659(510:496.5)  
316.722**Punim studimor****CHEN Fenghua**

Universiteti i Gjuhëve të Huaja i Pekinit (BFSU, Kina)

**Peizazhi gjuhësor si fushë studimi dhe trajtimi i tij në punimin e disertacionit “Peizazhi gjuhësor i hapësirave komerciale - Studim krahasues i Shqipërisë dhe Kinës” nga Benjamin Shurdhi****“The linguistic landscape as an area of research and its elaboration in the dissertation ‘The Linguistic Landscape of Commercial Spaces – A Comparative Study of Albania and China’ by Benjamin Shurdhi.”**

Peizazhi gjuhësor i referohet gjuhës së shkruar që mund të vëzhgohet në një zonë specifike. Gjatë dy dekadave të fundit, peizazhi gjuhësor është bërë gradualisht një pikë e nxehtë në studimet sociologjike në mbarë botën, duke krijuar një drejtim të ri studimesh në bashkërendim me disiplina të tjera, si semiotika, gjuhësia e aplikuar, përkthimi (si fushë studimore), psikologjia etj. Studimet në këtë drejtim kanë arritur rezultate të rëndësishme për aspekte të ndryshme që lidhen me konceptet sociologjike dhe etnolinguistike, politikën gjuhësore, analizën kontekstuale, formimin e identitetit etj. Siç shprehen edhe dy pionierët e kësaj fushe studimi, Landry & Bourhis, “peizazhi gjuhësor mund të shërbejë si treguesi më i drejtpërdrejtë dhe më i dukshëm i fuqisë dhe statusit relativ të bashkësive gjuhësore që ekzistojnë në një territor të caktuar”<sup>120</sup>. Pavarësisht se në Shqipëri janë bërë pak studime mbi peizazhin gjuhësor<sup>121</sup>, ndërsa në Kinë, studimet përkatëse e kanë zanafillën që në vitet '90 të shekullit XX, peizazhi gjuhësor ende është si një fushë relativisht e re studimore dhe një nga përparësitë kryesore në studimet e peizazhit gjuhësor është natyra e tyre ndërdisiplinore. Nga punimi me titull “Studime të peizazhit gjuhësor: perspektiva, teori dhe qasje”, studiuesi nga Singapori SHANG Guowen dhe ai norvegjez ZHAO Shouhui vërejnë se peizazhi gjuhësor është një praktikë

<sup>120</sup> Shih Landry, R. & Bourhis, R.Y., *Linguistic Landscape and Ethnolinguistic Vitality: An Empirical Study*, *Journal of Language and Social Psychology* 16 (1), fq. 29, 1997.

<sup>121</sup> Një punë pionieri në këtë fushë është punimi i Elsa Skënderi-Rakiplarit, *Peizazhi lingvistik i Tiranës*. “Albas”. Tiranë, 2023, 254 f.

e veçantë gjuhësore dhe njihet si një proces ndërveprues i diskursit shumëpalësh, prandaj rëndësia e studimit të peizazhit gjuhësor qëndron te dhënia e këtyre dëshmimeve gjuhësore në shoqërinë multikulturore të ndikuara nga epoka e globalizimit.<sup>122</sup>

Disertacioni “Peizazhi gjuhësor i hapësirave komerciale - Studim krahasues i Shqipërisë dhe Kinës” (viti 2025) i Benjamin Shurdhit – doktorant pranë Universitetit të Gjuhëve të Huaja të Pekinit, nën drejtimin shkencor të Prof. Dr. Ke Jing – është vlerësuar si një nga arritjet më të fundit dhe më të mirëpritura në studimet për peizazhin gjuhësor në Kinë. Ky punim është mjaft i rëndësishëm, sepse, bazuar në studimet e mëparshme teorike dhe praktike, autori përqendrohet tek analiza krahasuese e peizazheve gjuhësore të qendrave tregtare kineze dhe shqiptare, një temë e patrajtuar më parë nga studiuesit e të dyja vendeve. Ky punim, nga këndvështrimi ndërkulturor, duke krahasuar me kujdes një mori të dhënash të freskëta, kryen një hulumtim të thellë për disa çështje mjaft interesante, si ndryshimet kulturore, psikologjia shoqërore etj. gjatë procesit të modernizimit të të dyja vendeve. Disertacioni në fjalë shpalos mjaft vlera ndërkulturore dhe ndërdisiplinore.

## I

Punimi i doktorant Benjamin Shurdhit përqendrohet kryesisht tek emërtimet e markave (njësive tregtare) që ndodhen në qendra tregtare (sepse, sipas autorit, emërtimet përbëjnë elementin më të qëndrueshëm të njësive tregtare). Për efekt krahasimi, analiza kufizohet konkretisht te *Golden Resources Shopping Mall* (世纪金源购物中心) në Pekin dhe te tri qendra tregtare në Tiranë: *Tirana East Gate* (TEG), *Toptani Shopping Center* dhe *Qendra Tregtare Univers* (QTU). Si kriter përzgjedhjeje ka shërbyer madhësia e qendrave tregtare. Në Pekin është përzgjedhur qendra më e madhe tregtare e këtij qyteti, ndërsa në Tiranë janë përzgjedhur tri qendrat më të mëdha tregtare, për shkak se sipërfaqja e vetëm njëres prej tyre është mjaft e vogël në krahasim me atë të Pekinit. Qendrat tregtare në vetvete janë përfaqësuese të hapësirave komerciale në të dyja qytetet. Formatet gjithëpërfshirëse dhe të larmishme të bizneseve brenda tyre (qendrave tregtare) ndihmojnë në pasqyrimin e realitetit ekonomik dhe social të një qyteti apo edhe të një vendi, duke reflektuar ndryshimet në jetën shpirtërore dhe nevojat kulturore të njerëzve.

Konkretisht, për të realizuar një analizë shkencore dhe të arsyeshme, autori i grupon bizneset e larmishme të këtyre qendrave tregtare në katër kategori të dallueshme: *veshje dhe modë*, *bar-restorante*, *high tech* dhe *tjera*, bazuar në ngjashmëritë e tyre. Çdo kategori analizohet fillimisht nga ana gjuhësore dhe më pas nga pikëpamja sociolinguistike. Disertacioni në fjalë nuk trajton thjesht raportet gjuhësore të emërtimeve (në gjuhë

<sup>122</sup> Shih 尚国文, 赵守辉. 语言景观研究的视角、理论与方法. 外语教学与研究. 北京. 2014(02). 214-223页.

vendase apo të huaja) në aspektin sasior, por paraqet dhe analizon edhe raportin ndërmjet markave (vendase apo të huaja). Autori ndjek një mënyrë origjinale edhe për klasifikimin e emërtimeve të njësive tregtare, duke i kategorizuar ato në tri makrogrupe: *emërtime speciale*, *emërtime të kuptimshme* dhe *emërtime speciale + të kuptimshme*. Nga pikëpamja sociolinguistike, punimi paraqet me objektivitet kontrastin ndërmjet përkatësisë kombëtare të markave tregtare dhe gjuhës së përdorur në emërtimin e markës, çka ndikohet nga dy faktorë themelorë: *identiteti* dhe *globalizimi*. Mjaft interesante në këtë drejtim paraqitet kategoria *veshje dhe modë*, pasi kjo është e vetmja kategori në qendrat tregtare shqiptare që nuk ka asnjë emërtim në gjuhën shqipe, sepse dominojnë totalisht markat e huaja; ndërsa në qendrën tregtare të Pekinit, kjo është e vetmja kategori në të cilën dominojnë emërtimet në gjuhën angleze, ndonëse mbizotërohet nga markat vendase (kineze).

Duket qartë se autori është shumë kategorik në punën e tij dhe ndërmerr një analizë shumështrësore, duke kombinuar metodat sasiore dhe cilësore të studimit. Kjo qasje siguron një analizë të qartë dhe të strukturuar, bazuar në të dhëna të pasura, duke shmangur çdo pështjellim në procesin e hulumtimit. Për më tepër, autori përcakton qartë rolin e përbashkët të faktorëve ekonomikë dhe joekonomikë në formimin e peizazhit gjuhësor. Siç theksoi YAO Xiaofang në punimin e saj “Korniza teorike dhe metodat e kërkimit të peizazhit gjuhësor”, analiza e peizazhit gjuhësor në botë ka kaluar nga ajo thjesht sasiore në dinamikat komplekse politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të formuara nga gjuha, për të zbuluar çështje më të thella, si globalizimi, identiteti etj., nëpërmjet komunikimit shumëgjuhësh dhe multimodal në hapësirat publike.<sup>123</sup>

## II


Përveç strukturës shumështrësore me qëllim që të realizohet një analizë përqasëse sa më e thellë ndërmjet emërtimeve të njësive tregtare shqiptare ose kineze, vihet re se edhe teoritë e përdorura në këtë punim janë integruar në mënyrë inovative. Në fillim, autori ka përvetësuar teoritë e themeluesve të kësaj fushe studimi, të sociolinguistëve izraelitë Landry dhe Bourhis, të cilët me *peizazh gjuhësor* nënkuptonin tërësinë e shenjave gjuhësore të përdorura në tabelat publike në një rajon të caktuar.<sup>124</sup> Më pas, si bazë teorike për disertacionin në fjalë kanë shërbyer parimet e gjeosemiotikës të Ron Scollon dhe Suzie Wong Scollon, që edhe në ditët e sotme mbetet një nga teoritë më me ndikim për interpretimin e

<sup>123</sup> Shih 姚晓芳 . 语言景观学的理论框架和研究方法 北京第二外国语学院学报 北京 2021 (04). 101-115页.

<sup>124</sup> Shih Landry, R. & Bourhis, R.Y., *Linguistic Landscape and Ethnolinguistic Vitality: An Empirical Study*, *Journal of Language and Social Psychology* 16 (1), fq. 23-49, 1997.

shenjave.<sup>125</sup> Më konkretisht, në disertacionin e tij, autori mbështetet te parimi gjeosemiotik i vendndodhjes, të cilin e zhvillon dhe interpreton më tej. Duke interpretuar materialet e qendrave tregtare nga këndvështrimi sociolinguistik, ky studimi i ri në fushën e peizazhit gjuhësor sjell risi të shumta. Krahasimi i një vendi shumë të madh si Kina me një vend të vogël si Shqipëria mbart gjithashtu sfida ose vështirësi të shumta, të cilat autori i ka tejkaluar.

Në punim, autori vetë e sheh konfigurimin e peizazhit gjuhësor të hapësirave komerciale në Kinë dhe në Shqipëri si refleksion të zhvillimit ekonomik (kapacitetit të brendshëm prodhues), progresit teknologjik, identitetit dhe globalizimit etj. Krahasimi i këtyre faktorëve mund të zbulojë në mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe të saktë mënyrën e sendërtimit të peizazhit gjuhësor në të gjithë botën. Pjesëmarrja e subjekteve tregtare të hapësirave komerciale ndikohet nga faktorë politikë, ekonomikë dhe kulturorë. Emërtimet e këtyre subjekteve në vetvete, sipas autorit, ndikohen nga dy faktorë të tjerë: *identiteti* dhe *globalizimi*. Duke analizuar dhe krahasuar qendrat tregtare në Kinë dhe në Shqipëri, autori ia ka dalë të ndërtojë një kornizë universale analitike, e cila mund të shërbejë për studimin e hapësirave komerciale kudo në botë (shih skemën e mëposhtme).



Nga pikëpamja ime, një nga vlerat e këtij punimi është kurajoja dhe vullneti i autorit për t'u përballur me vështirësitë. Në emërtimet e ndara në kategori, ai ka ofruar një vizion të gjerë siç duhet, ku janë përfshirë individualiteti i subjekteve tregtare, ndjeshmëria e tregtarëve, tërësia e zhvillimit politik dhe ekonomik, si dhe racionaliteti i shoqërisë. Këto elemente mund të mbeten ashtu siç janë, ose të ndryshojnë, ose të kapërcehen, ose të transformohen. Prandaj, ky punim ka ngjallë refleksione të llojllojshme për çështje thelbësore të përbashkëta, duke i dhënë kështu një vlerë universale.

<sup>125</sup> Shih Scollon, R. & Scollon, S.W., *Discourse in Place: Language in the Material World*, London: Routledge, 2003.

## III

Bie në sy që logjika e emërimit dhe krijimi i markave tregtare jo vetëm që pasqyrojnë me ose pa vetëdije aspiratat e tyre të shumanshme, por gjithashtu zbulojnë risi kulturore dhe trende ndërkombëtare. P.sh. te pjesa e emërtimeve sipas sistemit “Pinyin” (sistemi fonetik i gjuhës kineze), dallohet kompania e madhe teknologjike XIAOMI si një nga shembujt më domethënës, e cila dallohet nga logoja e saj në formën e një kuadrati ngjyrë portokalli, brenda të cilit shkruhet me alfabet latin vetëm fjala *MI*, gjë që e bën këtë markë sa më të thjeshtë, aq edhe më të “kuptueshme”.

Pavarësisht nëse synon të arrijë modernizimin dhe ndërkombëtarizimin apo të krijojë një efekt tjetërsimi ose argëtimi, vetë emërtimi i bizneseve është bërë si një urë lidhëse ndërmjet zotëruesve të tyre dhe konsumatorëve. Prandaj, shpesh hasen në punim biznese me emërtime autoktone sidomos në kategorinë *bar-restorante*, sepse ushqimet apo mënyrat e të ushqyerit janë të lidhura ngushtësisht me traditën e konsumatorëve. Për shembull, emërtimi *ULLIRI*, shoqëruar edhe me imazhin e një dege me disa kokrra të kësaj peme, e bën mjaft autokton një restorant, sepse, së pari, është i emërtuar në gjuhën shqipe (si rrallë njësi tregtare); dhe, së dyti, simbolizon një bimë që kultivohet në Jug të Shqipërisë. Por ulliri kultivohet dhe është simbol edhe i vendeve të tjera të Mesdheut, si Greqia, Italia apo Spanja. Prandaj, pra, emërtimi në shqip dhe imazhi në logo që lidhet me pemën e ullirit, i japin këtij restoranti karakteristika sa lokale, aq edhe rajonale (mesdhetare).

Në këtë proces, si emërtimet që reflektojnë identitet, ashtu edhe ato që përmbajnë elemente të globalizimit, mbartin në vetvete karakteristika universale. Ky është edhe një aspekt i rëndësishëm i këtij punimi: autori e interpreton vazhdimisht zgjedhjen gjuhësore dhe konotacionet kulturore të markave tregtare kineze dhe shqiptare, duke dhënë informacione dhe detaje të ndryshme. Këtu nuk mund të mos përmenden dy marka me emërtime ndërgjuhësore. Njëra është çajtorja kineze 茶百道 (Cha baidao) – *ChaPanda*, me logon e saj panda (një lloj ariu që jeton në Kinë dhe njihet me emrin *panda* në shumë gjuhë të botës, kryesisht në ato indoeuropiane). Nëpërmjet transliterimit nga *baidao* në *Panda*, ky emërtim, nga njëra anë, ka kombinuar me zgjuarsi larminë e llojeve të çajit dhe imazhin e lezetshëm të pandës; dhe, nga ana tjetër, ka zbuluar prejardhjen e kësaj çajtoresje, nga qyteti i Chengdu-së (i cili njihet ndryshe edhe si *qyteti i pandave*, për shkak se këto të fundit gjenden me shumicë atje). Tjetra është bar-pastiçeria *KOKO*, e cila vetë është një fjalë që haset në disa gjuhë dhe ka kuptime të ndryshme, kështu që kur emërtohet, mund të ndihet sa globale, aq edhe lokale. Me këto përpjekje të shumta, punimi i ka tejkaluar kufizimet në kontekstin kohor dhe hapësinor, duke theksuar vizionin e tij global dhe ndërkulturor. Në të ardhmen, bazuar në këtë model studimi, mund të vëzhgohen dhe analizohen peizazhet gjuhësore të vendeve të ndryshme.

Nga aspekti i peizazhit gjuhësor të hapësirave komerciale të të dyja vendeve, vëzhgimi në thellësi i zhvillimit dhe synimeve të markave

tregtare, konteksti historik dhe kulturor i shoqërive, dukuritë gjuhësore që qëndrojnë pas tyre si dhe rrjedha logjike e analizës, i rrisin edhe më shumë vlerat shkencore të këtij studimi.

## IV

Megjithëse punimi i Benjamin Shurdhit përqendrohet te peizazhet gjuhësore të hapësirave komerciale të Tiranës dhe Pekinit në gjendjen e tyre aktuale, në brendësi të disertacionit bëhen edhe mjaft analiza historike për të shpjeguar tablonë e sotme të realitetit.

Si përbërës thelbësor i hapësirave publike urbane, peizazhi gjuhësor pasqyron në mënyrë gjithëpërfshirëse shkallën e shkëmbimit kulturor dhe të mësuarit e ndërsjellë midis qyteteve, konotacionet kulturore rajonale dhe politikën gjuhësore. Dihet që gjuha shqipe ndodhet në trysinë e fjalëve të huaja, në kohën e globalizimit dhe në fazën e integritit evropian, dhe sidomos për shkak edhe të në mungesës së një politike gjuhësore shtetërore, ajo po përballohet me një sfidë shumë të madhe. Ndërsa politika gjuhësore e Kinës e trajton në përgjithësi peizazhin gjuhësor të hapësirave publike, por nuk përcakton në mënyrë të drejtpërdrejtë se si duhet të jenë emërtimet e markave në hapësirat komerciale. Pavarësisht ndryshimeve në zhvillimin e politikave gjuhësore, Kina dhe Shqipëria përbashkohen në faktin që gjuhë zyrtare të vetme kanë gjuhët e tyre kombëtare, përkatësisht kinezishten dhe shqipen. Vlen të përmendet gjithashtu se në qytetet e mëdha kineze kryesisht, për shkak të lëvizjes së popullsisë aq të madhe dhe multietnike të këtij shteti si dhe për shkak të zhvillimit ekonomik të gjithanshëm, edhe dukuritë gjuhësore që bashkëshoqërojnë këto ndryshime janë shumë të larmishme, kështu që menaxhimi i peizazhit gjuhësor në Kinë duhet të integrohet në politikat urbane përmes dizajnit të nivelit të lartë, mbikëqyrjes legislative dhe pjesëmarrjes shumëplanëshe, në mënyrë që të nxisë zhvillimin e tij të harmonishëm dhe të rregullt. Duke marrë shkas nga ky disertacion, Prof. Dr. Emil Lafe ka bërë një propozim largpamës, që të vijohen vëzhgimet në këtë drejtim. Ai sugjeroi se studime të tilla mund të ndërmerren sërish pas një periudhe p.sh. 10-vjeçare, kështu që ne mund të shohim ndryshimet e peizazheve gjuhësore gjatë një afati kohor më të gjatë, për të shpjeguar zhvillimin e mëtejshëm të të dyja vendeve, sepse në epokën e globalizimit, qoftë për Shqipërinë, e cila po e mbështet zhvillimin ekonomik kryesisht në turizëm, ashtu edhe për Kinën, e cila po e rrit ndjeshëm cilësinë e prodhimeve të brendshme duke i kushtuar vëmendje të madhe inovacionit, është e mundur që, përmes peizazhit gjuhësor si dëshmi e gjallë, të paraqiten dhe të ruhen gjurmët e zhvillimit dhe ndryshimit të secilit vend dhe, në të njëjtën kohë, studimit i shtohen edhe më shumë vlerat e tij akademike.

Gjatë leximit të këtij punimi dhe pjesëmarrjes në mbrojtjen e tij, e përjetova edhe më shumë rëndësinë humane të këtij studimi. Rëndësia e këtij studimi nuk qëndron thjesht në aspektet teorike apo praktike, por më së shumti në vëzhgimet dhe reflektimet objektive të një studiuesi shqiptar në Pekin, në Kinën bashkëkohore, si dhe në analizën më të thellë të vetë Shqipërisë që përftohet si rezultat i krahasimit me Kinën.




Nga krahasimi i emërtimeve të bizneseve, në Shqipëri bie në sy menjëherë dominimi i kulturës perëndimore, ndërsa në Kinë vërehet

dominimi i gjuhës kineze në emërtimin e markave vendase, duke dëshmuar kështu ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar ndonëse jetojmë në një botë të globalizuar. Në aspektin emocional, më ka lënë përshtypje shumë të thella përvetësimi i gjuhës dhe kulturës kineze nga studiuesi Benjamin Shurdhi, çka i ka dhënë studimit një karakter të veçantë dhe unik, pasi nuk ka studime të mëparshme që krahasojnë elemente që lidhen me kinezishten dhe shqipen, ndonëse nga një perspektivë jo thjesht gjuhësore. Në lidhje me gjuhën kineze, ai ka arritur të zbulojë edhe mospërputhjet që ekzistojnë në disa raste midis përdorimit të sistemit fonetik (*Pinyin*) dhe hieroglifëve, dhe, në lidhje me këto të fundit, ai shkon më tej, duke arritur të dallojë hieroglifet tradicionale nga ato të thjeshtuara. Në mbyllje, duke përgëzuar autorin për marrjen e gradës “doktor” në saje të këtij disertacioni, po kujtoj një frazë të tij mjaft domethënëse: “Kam vërejtur mjaft dallime midis Kinës dhe Shqipërisë, megjithatë ne ende kemi shumë të përbashkëta”.

#### Bibliografi

1. Landry, R. & Bourhis, R.Y., *Linguistic Landscape and Ethnolinguistic Vitality: An Empirical Study*, *Journal of Language and Social Psychology* 16 (1), 1997.
2. Scollon, R. & Scollon, S.W., *Discourse in Place: Language in the Material World*, London: Routledge, 2003.
3. 尚国文, 赵守辉. 语言景观研究的视角、理论与方法. *外语教学与研究*. 北京. 2014(02). 214-223页.
4. 姚晓芳. 语言景观学的理论框架和研究方法. *北京第二外国语学院学报*. 北京. 2021(04). 101-115页.

## Numrat e botuara deri më tani

Kopertina e Revistës INTERKULTURA	Përmbajtja
	<p><i>Zeqirja NEZIRI - Aspekte ndërkulturore të kancelarisë së Skënderbeut (7-14)</i>  <i>Mustafa IBRAHIMI - Koncepte, dallime dhe konflikte të multikulturalizmit përballë globalizmit (15-28)</i>  <i>Rizvan SULEJMANI- Zgjidhja e konflikteve ndëretnike – rasti i Maqedonisë (29-44)</i>  <i>Avzi MUSTAFA - Kufiri ndërmjet kulturave të ndryshme, vështruar përmes romanit “Ballkanbabilonasit” të Luan Starovës (45-52)</i>  <i>Gjylmysere KASAPI - dallimet dhe ngjashmëritë në kulturat e familjeve maqedonase dhe shqiptare në Maqedoni (53-60)</i>  <i>Sefer TAHIRI - Skicë për mbindërtimin e Maqedonisë shumëkulturore dhe ndërkulturore (61-80)</i>  <i>Rubin ZEMON - Sfidat bashkëkohore në drejtimin e shoqërive të diversitetit (81-92)</i>  <i>Mirjana MALESKA - Multikulturalizmi - koncepti pluralist dhe tolerues për integrim (93-100)</i>  <i>Kosta MILLKOV - I kujt është vendi? Kufizime kulturore dhe territoriale në kontekst të konflikteve ballkanike dhe kriza e refugjatëve në lindjen e mesme (101-113)</i></p>
	<p>Aziz POLLOZHANI (rektor) – Respekti i ndërsjell – bazament i një kohezioni social në shoqëri – fjalë përshëndetëse  <i>Zeqirja NEZIRI - Pjetër Bogdani afirmues i teozofisë baroke (9-26)</i>  <i>Vebi BEXHETI - Përmasa universale në poezinë e Migjenit (27-32)</i>  <i>Mustafa IBRAHIMI - Elemente etnografike dhe arti shqiptar në muret e kishave të Prilepit dhe Ballkanit nga piktori mesjetar Onufri (33-46)</i>  <i>Sunaj RAIMI - Jan Kukuzeli – kompozitori shqiptar mesjetar me dimensione botërore (47-60)</i>  <i>Avzi MUSTAFA - Grigor Përlaçevi dhe kontributi i tij interkulturore (61-72)</i>  <i>Asllan HAMITI - Rëndësia e «Fjalorit tri gjuhësh» të Gjorgji Puleskit (73-88)</i>  <i>Nebi DERVISHI - Kontributi i Josif Bagerit për gjuhën dhe kulturën shqipe në Rekën e Epërme (89-98)</i>  <i>Mixhait POLLOZHANI - Tradita jonë interkulturore në artet pamore (99-112)</i>  <i>Rizvan SULEJMANI - Sa kanë ndikuar dallimet fetare dhe kulturore në formimin e kombit “modular” shqiptar? (113-130)</i></p>
	<p>Aziz POLLOZHANI (rektor) – Sistemi arsimor faktor i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie interkulturore – fjalë përshëndetëse  <i>Don Lush GJERGJI, Nëna Tereze - simboli i paqes dhe dashurisë, mishërimi dhe paradigma e interkulturalizmit universal (</i>  <i>Rizvan SULEJMANI, Arsimi interkulturore dhe kultura në kohë Pandemie</i>  <i>Mustafa IBRAHIMI, Reformet gjuhësore në arsimin e shoqërive shumëkulturore - rasti Maqedonia e Veriut</i>  <i>Rubin ZEMON, Historia, antropologjia dhe kompetencat ndërkulturore</i>  <i>Ajten HAJDARI-QAMILI, Iterkulturalizmi në institucionet publike në RMV</i>  <i>Berton SULEJMANI, Interkulturalizmi gjuhësor nëpërmjet frazeologjizmave në gjuhën shqipe dhe maqedonase</i>  <i>Ismet OSMANI, Interkulturalizmi në procesin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut</i>  <i>Sunaj RAIMI, Disa komponentë interkulturore në folklorin e helenëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotshëm</i>  <i>Mixhait POLLOZHANI, Arti si veprimtari e kultivimit të interkulturalizmit</i></p>

	<p>Zeqirja Neziri: Fati i të folmes së arbënesheve të Zarës</p> <p>Mustafa Ibrahim: Ekolinguistika përballë interkulturalitetit në një shoqëri shumëgjuhëshe</p> <p>Vebi Bexheti: Toka me shije, ulliri pak të hidhur pak të ëmbël</p> <p>Azis K. Pollozhani: Interkulturalizmi një paradigmë e re e shoqërive multietnike</p> <p>Begzad Baliu: Pikëpamjet e linguistike të profesor Shefki Sejdiu</p> <p>Ismet Osmani: Përkthimi si akt ndërkulturor</p> <p>Izaim Murtezani: Ligjërime imagologjike apo konstrukti diskurziv i tjetrit dhe tjetërsisë</p> <p>Teuta Arifi: Interkultura, një koncept progresiv i rilindjes kombëtare shqiptare</p> <p>Rubin Zemon: Ndërkulturalizëm pa kulturë dhe kontakte në Ballkanin Perëndimor</p> <p>Qatip Arifi: Anglishtja si lingua franca (alf) dhe aplikimi i saj në procesin e mësimdhënies së kësaj gjuhe</p> <p>Ajten Hajdari-Qamili: Leksiku ndërkulturor dhe ndërgjuhësor në të folmen urbane të strugës</p> <p>Sejdi M. Gashi: Roli i medieve në (mos) ngritjen e prestigjit të shqipes</p> <p>Agron Vrangalla: Analizë kritike e diskursit: gjuha e Albin Kurtit në intervistën e dhënë për CNN (31 maj)</p> <p>Kosovare Krasniqi: Imagologjia dhe përkthimi</p> <p>Arta Tika Bekteshi: Choosing the correct n-word or npi - a case study with albanian students</p> <p>Viktoria Elenova: Процесите кон восприемање и предавање странски јазик</p> <p>Јордана Шемко-Георгиевска - Елена Пренцова: Превод на билингвалните и дводомните културолошки елементи во примери од чикана поезијата</p> <p>Jetlira Beqiri: Interkulturaliteti në emërtimet e lidhjeve farefisnore në dialektet e gjuhës shqipe</p>
	<p>Mustafa Ibrahim: Kontributi i arbëreshëve për një alfabet të njësuar</p> <p>Zeqirja Neziri: Përpjekjet e shkrimtarëve të moçëm për një alfabet kombëtar</p> <p>Vebi Bexheti: “Trimdita”, Si metaforë e qëndresës arbëresho- shqiptare në poezinë e Zef Skiro Di Maxhos</p> <p>Xhemaludin Idrizi: Autorët arbëresh në tekstet shkollore të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut</p> <p>Begzad Baliu: Naum Veqilharxi: Ndërmjet dy rilindjeve</p> <p>Ismet Osmani: Mbi leksikun terminologjik të teksteve mësimore në shkollat nëntëvjeçare <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Ajten Hajdari - Qamili: <b>Error! Bookmark not defined.</b>interferenca gjuhësore mes shqipes, turqishtes dhe maqedonishtes në Maqedoninë e Veriut <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Farketa Dibra – Zeqiri: <b>Error! Bookmark not defined.</b>Kongresi i Manastirit - Ngjarje epokale e historisë dhe kulturës kombëtare <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Arta Tika Bekteshi - Teuta Agaj Avdiu: Mbi natyrën mohuese të përmrave të pacaktuar të shqipes <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Sejdi M. Gashi: Modaliteti i saktësisë dhe kuptimi kohor i formave foljore do të jem /do të kem në gjuhën shqipe (analizë kontrastive) <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Rilind Mahmudi, Majlinda Ismaili-Mahmudi: <b>Error! Bookmark not defined.</b>Roli i leksikut dhe i përkthimit në strukturën e fjalisë <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Mirvan Xhemaili: Përmirësimi i aftësisë së të lexuarit të nxënësve në gjuhën angleze përmes përdorimit të filmave</p> <p>Drita Xhemaili: Kompetenca gjuhësore e brezit të tretë të emigrantëve shqiptarë në Gjermani <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Rubin Zemon: “Imagjinareteti i Ballkanit në kontekstin global” <b>Error! Bookmark not defined.</b></p>

	<p>Muhamedali Ibrahim: Roli i diplomacisë ndërkulturore <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Avni Avdiu: Globalizmi mediatik <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Drenusha Kamberi: Telosi i kulturës kapitaliste <b>Error! Bookmark not defined.</b></p> <p>Albulena Dehari: Dallimet gjatë përshëndetjeve në mes gjinive të kundërta <b>Error! Bookmark not defined.</b></p>
--	--



**ISSN 2671-3004**